monumentet

DO NOT COPY

MATERIALET

E SESIONIT

III SHKENCOR

TE INSTITUTIT

MONUMENTEVE

TE KULTURES



12, 1976

DO NOT COPY

tina e parë: **Shtëpia ku më 8 nëntor 1941 u themelua Partia Komuniste Shqiptare**

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

monumentet

Materialet e sesionit III shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës

12, 1976

DO NOT COPY

u më 8 nëntor 1941 u themelua Partia Komuniste Shqiptare

MI I REDAKSISË

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës

Pranë Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës

Adresa e Redaksisë: Rruga Alqi Kondi Nr. 7

kopje | Formati 70 x 100/12 | Stazh: 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik Shtypshkronja «Mihal Duri» Tiranë

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

ARTIKUJ

Stilian Adhami
— Shtëpia muze e Partisë dhe ndërhyrjet konservuese në të 5

Koço Zheku
— Probleme të restaurimit në sistemet e fortifikimit të qyteteve ilire 17

Neritan Ceka
— Fortifikimi antik i Butrintit 27

Vangjush Manastirliu
— Varret monumentale të zonës së Mokrës (rrethi i Pogradecit) 49

Iliaz Kaca
— Disa monumente të panjohura në lokalitetin e Sllovës (rrethi i Dibrës). 53

Frederik Stamati
— Disa aspekte të konservimit të objekteve metalike arkeologjike 57

Gjergj Frashëri
— Problemi i restaurimit të oborrit të fortifikuar të kalasë së Krujës 65

Aleksandër Meksi
— Probleme dhe aspekte të restaurimit të kishave bizantine 75

Hasan Nallbani
—Probleme dhe aspekte të restaurimit të ikonave 87

Sulejman Dashi
— Kullat mesjetare të sahatit në vendin tonë 101

Shpresa Prifti
— Banesa shkodrane me çardak në të gjithë ballin 109

Leonard Suli
— Studim për restaurimin e banesës së Kabilajve në qytetin e Gjirokastrës 123

Burhan Strazimiri
— Banesa e vjetër e zonës së Prezës. 147

Pirro Thomo
— Arkitektura e banesave fshatare në Shqipërinë e Veriut gjatë shek. XIX. 159

Thanas Kamberi
— Vëndbanimet dhe banesat fshatare në Dropullin e Poshtëm 173

Faruk Zarshati
— Banesa popullore në Malësi të Lezhës 183

Fatbardha Shkupi
— Dekoracioni i arkitekturës popullore në qytetin e Shkodrës. (Historia e ndërtimeve, motivet e aplikuara dhe mjeshtrat) 195

DISKUTIME

Gjerak Karaiskaj
— Mbi fortifikimet e vona antike në vëndin tonë 221

Riza T. Drishti
— Qendrat zejtare të prodhimit të armëve dhe të barutit në Shqipëri. 229

Aleksandër Meksi
— Disa probleme të kishës së manastirit të Apollonisë 233

Gjergj Frashëri
Sulejman Dashi
— Rreth kumtesës: Kontribut i traditës vendase në arkitekturën e xhamisë tipike tiranase 237

Apollon Baçe
— Oborri i fortifikuar i qytetit mesjetar në Berat 243

DO NOT COPY

TABLES DES MATIERES

Pages

ARTICLES

Stilian Adhami
— La maison muséé du Parti et les interventions qui y ont été effectuées à des fins de conservation 5

Koço Zheku
— Sur la restauration des systèmes de fortification des villes illyriennes. 17

Neritan Ceka
— La fortification antique de Butrint et le territoire des Prasaibes. 27

Vangjush Manastirliu
— Les tombes monumentales de la zone de Mokër (District de Pogradec). 49

Iliaz Kaca
— De certains monuments inconnus de la localité de Sllove 53

Frederik Stamati
— Aspects de la conservation des objets archéologiques de métal. 57

Gjergj Frashëri
— Le problème de la restauration de la barbacane de la citadelle de Kruje. 65

Aleksandër Meksi
— Problèmes de la restauration des églises byzantines en Albanie. 75

Hasan Nallbani
— Problèmes et aspects de la restauration des icônes 87

Sulejman Dashi
— Les tours de l'horloge moyenâgeuses de notre pays 101

Shpresa Prifti
— L'habitation scutarine à tchardak (galerie ouverte) sur toute la façade. 109

Leonard Suli
— Etude sur la restauration de la maison des Kabilaj — Gjirokastër. 123

Burhan Strazimiri
— L'ancienne habitation de la zone de Preze 147

Pirro Thomo
— L'architecture des habitations rurales dans l'Albanie du Nord (XIXsc). 159

Thanas Kamberi
— Agglomérations et habitations rurales dans le bas Dropull 173

Faruk Zarshati
— La maison caractéristique de la Malësia de Lezhe 183

Fatbardha Shkupi
— La décoration de l'architecture populaire dans la ville de Shkodër. (Historique des constructions, des motifs et les maîtres populaires)..... 195

DISCUTIONS

Gjerak Karaiskaj
— A propos des fortifications de la basse antiquité de notre pays 221

Riza T. Drishti
— Les centres artisanaux de production d'armes et de poudre en Albanie. 229

Aleksandër Meksi
— A propos de quelques problèmes de l'église du Manastère d'Apollonie. 233

Gjergj Frashëri
Sulejman Dashi
— A propos de la communication: «Contribution de la tradition locale a l'architecture de la mosquée typique tiranoise». 237

Apollon Baçe
— La barbacane de la ville forte de Berat. 243

DO NOT COPY

Stilian ADHAMI

SHTËPIA—MUZE E PARTISË DHE NDËRHYRJET KONSERVUESE NË TË

DO NOT COPY

Në kryeqytetin tonë gjëndet një shtëpizë dykatëshe, e thjeshtë dhe e vogël. Në këtë shtëpizë, të futur thellë në rrugica gjarpëronjëse dhe që në pamjen e parë s'të bie në sy, këtu e 35 vjet më parë u themelua Partia Komuniste Shqiptare (sot Partia e Punës e Shqipërisë), pa të cilën nuk do të shihte kurrë ditë të bardha populli ynë.

Rrugica ku ndodhet kjo shtëpi dhe që sot quhet «Formimi i Partisë» është një rrugicë e ngushtë, me shtëpi përdhese, të ulta, me oborr të vogël përpara plot pemë. Nga kjo rrugicë, dikur e harruar, në thellësi të asaj lagjeje, që tani mban emrin e ditës historike «8 Nëntori», zunë fill rrugët më të gjera e të ndritura për mbarë popullin shqiptar.

Ndërtesa në të cilën atë natë nëntori u themelua Partia ndodhet në fund të kësaj rrugice të ngushtë, me portën atje ku formohet një kënd i drejtë me një rrugicë tjetër. Ajo ndodhet në atë lagje, që megjith emrin «Abdulla bej» që mbante dikur, ishte një nga lagjet më të varfra e të vjetra të kryeqytetit. Në këtë mjedis urbanistik, ku rrugët e rrugicat kthehen e piqen me njera tjetrën, me oborre të rrethuar me mure, që përbëjnë një mburojë të mirë ndaj vrojtimit të armikut, kjo ndërtesë pikërisht është shtëpi e zgjedhur në mes të popullit për një mbledhje të gjerë ilegale, në konditat e terorit dhe të përgjimit fashist.

Shtëpia-muze e Partisë është një monument i madh e i pavdekshëm, sepse këtu përfaqësuesit e grupeve komuniste, që ekzistonin në Shqipëri, nën dritën e mësimeve të marksizëm-leninizmit, bënë mbledhjen e tyre historike nga ku u themelua Partia heroike Komuniste e Shqipërisë, sot Partia e Punës.[1]

Duke kapërcyer pragun e gurtë të portës së jashtëme, hyhet në oborrin e kësaj ndërtese, nga e cila nisi një histori e madhe, historia e re e popullit shqiptar dhe u ndez ajo flakë, që do të përhapej anembanë vendit.



Planimetria e zonës ku ndodhet Shtëpia-Muze e Partisë

* * *

Nga ana tipologjike shtëpia e Partisë bën pjesë në atë tip të banesës qytetare, e cila kristalizohet aty rreth mesit të shekullit të 19 në vendin tonë. Së pari ky tip u përhap në Korçë, ku gjeti jo vetëm realizimet

1) Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë, Tiranë, 1969, f. 70.



Rrugica ku ndodhet Shtëpia-Muze e Partisë

më të shënuara, por edhe një larmi të theksuar va riantesh, që pasqyronin diferencimin e dalluar klaso Më vonë ai përhapet dhe në qendra të tjera qytetar të vendit, duke përfshirë këtu dhe Tiranën, banes tradicionale e të cilës për vetë karakterin e saj ta shmë ishte bërë anakronike. Dhe pikërisht duke fillua që prej viteve 20 të shekullit tonë, në Tiranë tipi i ba nesës së mirëfilltë qytetare përhapet gjerësisht[2]. Shtë pia e Partisë bën pjesë në njerin prej varianteve t thjeshtë të këtij tipi. Ajo numëron dy kate, prej t cilëve ai përdhes është pjesërisht nën tokë dhe ka nj lartësi të vogël, ndërsa kati i parë është më i lartë Planimetria e kësaj ndërtese është e thjeshtë: nj sallon i vogël ndërlidhës dhe anash tij dy ambient banimi. Kjo skemë përsëritet në të dy katet. Në katin përdhes, me ndriçim të pakët nëpërmjet 4 dritareve të vogla, të zbresin pak këmbë shkallë ndërsa në katin e sipërm të çojnë një palë shkallë të jashtme, që për-



Shtëpia-Muze e Partisë

2) E. Riza — K. Zheku, Banesa tiranase, në «Monumentet» nr. 2/1971, f. 113-127; E. Riza — B. Strazimiri. Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës, në «Monumentet» Nr. 3/1972, f. 119-138.

DO NOT COPY



Pllaka përkujtimore në murin e ndërtesës

fundojnë me një lloj verande. Ndriçimi i ambienteve të katit të sipërm është më i plotë dhe sigurohet nga 6 dritaret e pamjes kryesore. Brendësia e kësaj banese është tepër e thjeshtë, ajo nuk shquan për asnjë trajtim dekorativ. Në dallim nga brendësia, në pamjen kryesore, e vetmja e përpunuar, shohim një përpjekje për trajtimin dekorativ nëpërmjet korniza-ve rreth dritareve punuar me suva si dhe mbylljes së strehëve me dërrasa tavanore. Pamja kryesore është në kontrast të dukshëm me pamjet e tjera, ku muratura me qerpiç nuk është suvatuar.

Si nga jashtë, ashtu edhe nga brenda kjo shtëpi ruan origjinalitetin, me ato materiale e orendi, që ka pasur në ditët e themelimit të Partisë. Janë shtuar vetëm disa materiale dokumentare, të cilat pasqyrojnë ngjarjet kryesore, që paraprinë ato ditë vendimta-re.

Interes të veçantë paraqet dhoma përdhese nga e djathta. Kjo dhomë e vogël me oxhak, e ndriçuar nga një llambë vajguri nën trarët e dyshemesë, që ndante bodrumin e mbledhjes nga dhoma e katit të sipërme, është dëshmitarja e heshtur e ngjarjes më



Dhoma ku u zhvillua mbledhja historike e formimit të Partisë

DO NOT COPY



Rezolucioni i mbledhjes, karrikja ku rrinte shoku Enver Hoxha në mbledhjen e formimit të Partisë

DO NOT COPY

me rëndësi, që ka njohur historia e vendit tonë. Këtu në këtë dhomë komunistët shqiptarë krijuan Partinë.

Dhoma qëndron ashtu siç ishte në ato kohëra: tri tavolina të vjetra të vëna në formë këndi dhe mbi to kana e ujit, shishe e bojës dhe një bisht pene e vjetëruar; rreth tavolinave njëzet karrike të thjeshta. Këtu çdo gjë ka historinë e vet dhe flet qartë për atë ngjarje të madhe në ato ditë nëntori të vitit 1941. Të tërheq vëmendjen në të edhe oxhaku me qiriun mbi të dhe perustitë në vatër si dhe në një qoshe vendi i komunikimit të tavanit me katin e dytë. Por sytë e çdo vizitori vetiu drejtohen tek fotografia e shokut Enver Hoxha. Këtu gjithshka është e lidhur me emrin e tij. Këtu zë fill jetëshkrimi i lavdishëm i Partisë sonë.

Nga rëndësia e saj kjo mbledhje zë vendin e një konference, bile të një Kongresi të Partisë, sepse kjo ishte fitorja më e madhe gjer në atë kohë për klasën punëtore dhe gjithë punonjësit e vendit tonë. Këtë përcaktim historik e shpreh rezolucioni i mbledhjes së grupeve kryesore komuniste të Shqipërisë për krijimin e Partisë, d. 8 nëntor 1941, që është ekspozuar në murin përballë[3]. Ky është dokumenti i parë i Partisë. Në të përcaktohen bazat ideologjike dhe organizative të Partisë dhe përpunohen çështjet themelore të vijës së saj të përgjithshme për periudhën e Luftës nacionalçlirimtare[4].

Nga kujtimet e shokut Enver mbi themelimin e rinisë komuniste shqiptare[5] mësojmë disa hollësira edhe rreth shtëpisë së Partisë, ku bashkë me Qemal Stafën punoi edhe për organizimin e mbledhjes së rinisë. Kjo shtëpi ishte bërë qendra kryesore, ku shoku Enver punonte dhe merrte kontakt me shokët kryesorë, ku **«hynin dhe dilnin shokë të kontrolluar dhe me pikëpjekje».** Jo vetëm natën nën dritën e lla-

3) PPSH. – Dokumenta kryesore, I, Tiranë, 1960, f. 9-23.
4) Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë, Tiranë 1969, f. 71.
5) Zëri i Rinisë, d. 23/XI/1976.



Vatra dhe oxhaku në dhomën ku u zhvillua mbledhja



Shkalla e brëndëshme që komunikon me katin e sipërmë

DO NOT COPY

mbas me vajguri, por edhe ditën në dhomën e punës, ku vazhdoi ditë me radhë mbledhja për formimin e Partisë, ishin të detyruar të punonin me gjysmë drite, sepse, siç thotë në kujtimet e veta shoku Enver **«jashtë, nën strehë, që nga kollona e nënshkallës dhe deri në cepin e tejmë të shtëpisë kishim varur nja dy batanie dhe kishim rregulluar një vënd të vogël, ku delnim, çlodheshim dhe merrnim ca ajër pa u diktuar nga fqinjët»**[6] Dhe me të vërtetë, shtëpitë fqinje vetëm një mur i ndan nga Shtëpia e Partisë. Prej tyre, nëpërmjet një dericke të vogël, në ditët e para të nëntorit të 1941-së, hynin dhe dilnin shumë njerëz, disa prej tyre fjetën atje.

Gjatë ditëve dhe netëve që mbledhja zhvilloi punimet, në fshehtësinë më të madhe, armiku nuk mori vesh asgjë, sepse ishin marrë masat për të mos u diktuar nga armiku dhe për çdo të papritur. Për të mënjanuar çdo lëvizje nëpërmjet shkallëve të jashtëme, që mund të tërhiqte vëmendjen e armikut, ishin pregatitur shkallë lëvizëse, vendosur apostafat prapa derës e maskuar si raft librash dhe qepeni, nëpërmjet të cilëve kalohej nga dhoma e mbledhjes në dhomën e gjumit në katin e dytë dhe anasjelltas; musëndra qe përshtatur për fshehjen e dokumentave me dy dysheme paralele; dritarja, që komunikonte me kopshtet, shërbente për t'u larguar në raste rreziku, etj. Vetëm ditët e fundit, kur delegatët ishin shpërndarë, filloi të rrethohet lagja. Populli, megjithse në mes të armiqve, diti t'i ruajë me besnikëri themeluesit e Partisë. Kjo shtëpi, edhe pas themelimit të Partisë, shërbeu për një kohë si bazë e rëndësishme e Komitetit Qendror të Përkohshëm.

Gjithshka po ndryshon tek ne. Ashtu si mbarë vendi ynë, edhe Tirana çdo ditë zbukurohet. Vetëm kjo shtëpi monumentale me dy kate me një ballkon përpara, i rri besnike 8 nëntorit 1941. Dritaret, dyert, ballkoni, dhomat, janë po ato.

Kjo shtëpi, nga një ndërtesë e thjeshtë, është

6) Po aty.



Musandra me dysheme dyfishe për fshehjen e dokumentave



Dritarja dhe shkallët nga parashikohej largimi në rast rreziku

këthyer në një simbol. Kjo vatër e revolucionit popullor, që u këthye në Shtëpi-muze më 8 nëntor 1949, me rastin e përvjetorit të themelimit të Partisë dhe që historikisht është shtëpia e parë muze, që u ngrit në vendin tonë, është bërë një qendër pelegrinazhi për masat punonjëse e sidomos për rininë. Ajo do të shërbejë si vend edukimi e frymëzimi revolucionar për brezat e ardhshëm.

Asgjë nuk mund të kuptohet nga të gjitha ndryshimet kolosale, që kanë ndodhur në këto tri dekada e gjysëm në Atdheun tonë pa u nisur nga kjo shtëpi e vogël tiranase.

Siç thotë shoku Enver Hoxha: **«Partia u krijua në një shtëpi të vogël, por ajo ndërtoi një shtëpi të madhe, ndërtoi një jetë të re dhe po e çon popullin në ndërtimin e socializmit dhe më vonë në komunizëm».**

* * *

Duke marrë parasysh gjendjen teknike të këtij monumenti, nëpërmjet Ateljesë së Tiranës janë kryer dy herë punime në këtë monument. Në të dyja rastet ato kanë pasur karakter konsolidues si dhe konstruktiv, duke prekur disa elemente të degraduar. Preokupimi kryesor, që paraqiste ky monument, ishte prezenca e lagështisë kapilare në muret anësore të banesës, e cila me kohë do të binte pasoja në qëndrueshmërinë statike të tyre. Për të mënjanuar këtë rrezik, gjatë vitit 1971 rreth mureve, që shfaqnin këtë rrezik, u hapën pjesë-pjesë kanale, duke mundësuar hidroizolimin vertikal të mureve në kontakt me dheratë dhe duke ndërtuar përbri drenazhe dhe, së fundi, trotuar për të mënjanuar sa më shumë filtrimin e ujrave. Këto masa teknike dhanë rezultate të mira.

Gjatë vitit 1975 u ndie nevojë për një ndërhyrje të dytë me karakter restaurues rikonstruksioni. Struktura e çatisë prej lënde druri si dhe streha origjinale e ballit veshur me tavanore, paraqitej mjaft e degraduar. Për këtë arësye u vendos rindërtimi tërësor i tyre, duke ruajtur besnikërisht formulimin arkitektonik të elementeve, që dilnin në pamjen e jashtëme dhe duke përmirësuar skemën statike të konstruksionit të çatisë. Gjatë këtyre punimeve u krye dhe rikonstruksioni i rrjetit elektrik, i cili paraqiste rrezik djegëje[7].

Nga ana tjetër Instituti ynë, në kuadrin e detyrës së përgjithshme të gjurmimit të qyteteve tona për të

7) Arkivi i Institutit të monumenteve të Kulturës. Dosja e Shtëpisë Partisë.

DO NOT COPY

vënë në mbrojtje shtetërore lagje e rrugica, ansamble e monumente të veçuar me vlerë historike, arkitektonike dhe urbanistike, ka kohë, që ka piketuar në mënyrë paraprake edhe zonën e lagjes, ku ndodhet Shtëpia e Partisë dhe, së afërmi, pas një studimi më të plotë do ta propozojë në instancat më të larta për ta shpallur zonë-muze. Me këtë masë, jo vetëm që do t'u vihet fre definitivisht ndërtimeve të reja në këtë zonë dhe do të mënjanohet çfarëdolloj ndryshimi, që do të cënojë sadopak fizionominë urbanistike dhe silhuetën e kësaj zone, por do të krijohen kushtet e duhura për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e gjithë atij ansambli me tërë autenticitetin përkatës, që ka pasur në vitet e stuhishme të themelimit të Partisë.

Ndërkaq, gjatë këtij viti u vu në mbrojtje shtetërore një ansambël i përbërë prej katër banesash njëkatëshe, që ndodhen përbri shtëpisë, ku u themelua Partia[8], me një truall, që zë një sipërfaqe rreth 1000 m². Të gjitha këto banesa populore, jo vetëm që



Pamje nga punimet e restaurimit



8) Po aty

DO NOT COPY

dhe ato kanë lojtur rol historik në kohën e vet në funksion të Shtëpisë së Partisë, por në vetvete përbëjnë një kompleks, që paraqet interes edhe nga pikëpamja arkitektonike, duke qenë këto ndërtime të fillimit të shekullit tonë. Për arësye se gjatë periudhës 35 vjeçare, që ka kaluar qysh prej vitit 1941, janë bërë mjaft ndryshime në ambientet e banimit të këtij ansambli, duke ua përshtatur kërkesave gjithnjë në rritje, me qenë se janë bërë shtesa ambientesh gjatë kohës, kanë ndryshuar edhe shtresat e brendshme, janë hequr kalldrëmet me gurë lumi si dhe dyshemetë prej dërrase dhe janë zëvendësuar me shtresa çimentoje dhe në përgjithësi strukturat e këtyre banesave njëkatëshe janë të degraduara, shfaqet nevojë e domosdoshme për ndërhyrje restauruese. Sektori i monumenteve bashkëkohore dhe muzeumeve e ka pregatitur studimin dhe projektin përkatës të restaurimit dhe punimet do të kryhen vitin e ardhëshëm. Në punimet e restaurimit, i cili do të jetë i plotë, parashikohen një sërë punimesh që nga heqja e ambienteve të shtuara pas vitit 1941, ribërja e plotë e çative me strukturat e tyre mbajtëse, që sot janë të kalbuara, zëvendësim i dyshemeve prej dërrase, ribërja pjesore e dyshemesë me shtresa çimentoje, kryerja e plotë e suvatimeve të brendshme e të jashtme, restaurimi i strehëve të çatisë dhe dyerve e dritareve pjesërisht e deri tek sistemim i oborreve të brendshme, trajtimi i avllive ndarëse s edhe i një trotuari po prej guri, që do të shërbejë si drenazh për ujrat e shiut. Me këto ndërhyrje me karakter konservimi e restaurimi do të arrihet që të pasqyrohet koha e dikurshme, që të rikrijohen besnikërisht ambiente jetësore të vitit të themelimit të Partisë.

Duke u nisur nga fakti se ky kompleks banesash njëkatëshe gjatë Luftës antifashiste nacionalçlirimtare ka shërbyer si baza ilegale dhe baza të shtypit klandestin të Partisë janë pregatitur dy variante projekt-idesh, sipas të cilave parashikohet që këto ambiente të shfrytëzohen për veprimtari kulturore me masat në funksion gjithmonë të Shtëpisë – mëmë të Partisë. Në këtë mënyrë, jo vetëm që do të ngulitet më mirë tek vizitorët ideja e njohur se Partia u themelua në një lagje të varfër të Tiranës, por edhe do të rritet tek ata edhe më madhështia e këtij monumenti historik me vlerë të jashtëzakonshme.

DO NOT COPY

PLANIMETRIA E KATIT PERDHE



PLANIMETRIA E KATIT PARE





DO NOT COPY

Stilian ADHAMI

LA MAISON-MUSEE DU PARTI ET LES INTERVENTIONS QUI Y ONT ETE EFFECTUEES A DES FINS DE CONSERVATION

DO NOT COPY

RESUME

Dans la Capitale de notre pays il y a une petite maison d'aspect modeste, à deux étages, où a été fondé le Parti Communiste d'Albanie (aujourd'hui Parti du Travail), sans lequel notre peuple n'aurait jamais connu les jours heureux dont il jouit actuellement.

La ruelle où se situe cette maison, et qui maintenant s'appelle «Rue de la Fondation du Parti», est étroite; elle est bordée de maisonnettes à rez-de-chaussée, basses, ayant devant elles une petite cour plantée d'arbres. C'est à partir de cette ruelle, autrefois inconnue, située dans les profondeurs du quartier portant aujourd'hui le nom historique de «8 Novembre», que s'ouvrirent au peuple albanais tout entier des voies plus larges et plus lumineuses.

La Maison-musée du Parti est un monument historique immortel, parce que c'est ici que les représentants des groupes communistes qui existaient alors en Albanie, à la lumière des enseignements du marxisme-léninisme, ont tenu leur réunion historique qui a conduit à la fondation de l'héroïque Parti Communiste d'Albanie (aujourd'hui Parti du Travail).

C'est en traversant le seuil en pierre de la porte extérieure qu'on pénètre dans la cour de cette maisonnette à escalier extérieur, de cette maisonnette où s'amorça la nouvelle histoire du peuple albanais et d'où partirent les flammes qui allaient se répandre à travers tout le pays.

o
o o

Du point de vue de la typologie la Maison du Parti appartient au type de l'habitation urbaine, qui s'est cristallisée vers la moitié du XIXe siècle dans notre pays. Au début ce type s'est répandu à Korçe, où il a connu non seulement ses réalisations les plus réussies, mais encore un large éventail de variantes reflétant la différenciation de classe prononcée. Plus tard il s'étend dans d'autres centres urbains du pays, y compris Tirana, dont l'habitation traditionnelle était devenue désormais anachronique en raison même de son caractère. Et c'est justement à partir des années 20 de notre siècle que le type authentique d'habitation urbaine se répand largement à Tirana.

La Maison du Parti fait part d'une des variantes simple de ce type. Elle compte deux étages, dont celui au rez-de-chaussée étant en partie au-dessous du niveau du sol est peu élevé, tandis que le premier étage est plus haut. Sa planimétrie est simple: un petit salon mettant en communication les deux pièces destinées au logement et disposées chacun sur ses deux côtés. Le même schéma se répète dans les deux étages. Pour accéder au rez-de-chaussée, insuffisament illuminé par 4 petites fenêtres, il suffit de descendre quelques marches, tandis que pour monter à l'étage supérieur on traverse l'escalier extérieur, qui mène à une espèce de véranda. L'illumination des pièces de l'étage supérieur est meilleure, du fait qu'elle est assurée par 6 fenêtres percées sur la façade principale. L'intérieur de cette habitation est tout ce qu'il y a de plus simple, on n'y relève aucun traitement décoratif. A la différence de l'intérieur, la façade principale, elle seule, dénote un effort dans le sens de la décoration à travers des corniches de crépi encadrant les fenêtres et la fermeture des auvents avec les planches du plafond. La façade principale est en contraste évident avec les autres façades, dont la maçonnerie de glaise n'est pas revêtue de crépi.

De dehors comme de l'intérieur cette maison conserve son originalité, on y relève les mêmes matériaux et le même ameublement qui la caractérisaient pendant les jour de la fondation du Parti. On y a ajouté seulement des matériaux d'ordre documentaire, qui reflètent les principaux événements qui ont précédé ces journées d'importance décisive.

Un intérêt particulier présente la pièce au rez-de-chaussée située sur le côté droit. Cette petite chambre à foyer, illuminée par une lampe à pétrole accrochée au mur, au-dessous des travées du plancher séparant ce local souterrain de la pièce de l'étage supérieur, est un témoin silencieux de la grande audace sans précédent dans l'histoire de notre pays qui s'est manifestée au cours de la réunion qui y a eu lieu. C'est justement ici, à la lumière de cette lampe qui ne s'est pas éteinte des nuits entières, que les communistes albanais ont créé leur Parti à eux, qu'ils sont devenus maîtres des destins de leur Patrie et qu'ils ont lancé en ces journées héroïques un grand défi aux ennemis du pays.

Koço ZHEKU

PROBLEME TË RESTAURIMIT NË SISTEMET E FORTIFIKIMIT TË QYTETEVE ILIRE

Sistemet e fortifikimit të qyteteve ilire që janë zbuluar deri më sot në Lis, Zgërdhesh, Klos, Persqop, Dimal, Amantia, Antigone etj. paraqesin një sërë problemesh për konservimin dhe restaurimin e tyre.

Mbeturina të këtyre sistemeve, si trakte të mureve rrethuese të qyteteve, kulla mbrojtëse dhe hyrjet e tyre, në përgjithësi janë gjetur të gjymtuara ose të dëmtuara në kohë të ndryshme nga veprimet luftarake, cedime apo rrëshqitjet e terrenit, nga rritja e vegjetacionit sipër tyre, si edhe nga faktorë të tjerë që kanë vepruar për shekuj me radhë.

Në rastet kur qytetet ilire kanë vazhduar të jetojnë deri në kohën e mesjetës, muret mbrojtëse të kohës ilire janë meremetuar ose janë prishur, mbeturina të këtyre mureve janë përdorur si bazamente mbështetëse të kalave mesjetare dhe blloqet e gurëve të rrëzuara nga muret antike janë ripërdorur në muret me llaç gëlqere të fortifikimeve mesjetare.

Detyrat që dalin për çdo rast më vete janë urgjente dhe të shumanshme. Si detyrë kryesore paraqitet problemi i konservimit të menjëhershëm për të ruajtur të paprekur gjendjen e këtyre sistemeve ashtu sikurse dalin në përfundim të gërmimeve arkeologjike. Në rastet kur kjo gjendje nuk mund të arrihet të sigurohet për një kohë të gjatë për arsye se pjesë të mureve të zbuluara paraqesin rrezikshmëri shembjeje, sikurse ka ndodhur në Lis, Zgërdhesh dhe Klos, atëhere del nevoja e domosdoshme e restaurimit të tyre.

Duke pasur parasysh se mbeturinat e sistemeve mbrojtëse të qyteteve ilire përfshihen në fushën e monumenteve të arkitekturës antike, problemet e konservimit dhe ato të restaurimit zgjidhen në mënyrë të veçantë kundrejt monumenteve të kohëve më të vona.

Restaurimi i monumenteve të arkitekturës antike ka gjithmonë karakter anastiloze, d.m.th. ndërhyrja në to ka për qëllim rikompozimin konstruktiv dhe arkitektonik deri në masën që lejon materiali i ruajtur nga secili monument.

Në konditat e sotme nevojat e ndërhyrjes në rrënojat e mureve mbrojtëse të qyteteve ilire janë gjithnjë në rritje si në drejtim të konservimit ashtu edhe në thellimin e punimeve restauruese dhe në shtrirjen e tyre në qytete të ndryshme.

Po të kemi parasysh se sistemet e fortifikimit në qytetet ilire janë të një periudhe historike dhe nga ana tjetër se ato janë ndërtuar me të njëjtën teknikë, si edhe vetë faktin që gjendja e tyre në ditët tona paraqitet gjithashtu përafërsisht e njëllojtë, rrjedhimisht edhe problemet kryesorë që lindin në fushën e anastilozës janë në përgjithësi të njëllojta. Për këtë arsye mendojmë që në këtë kumtesë t'i trajtojmë këto probleme duke u bazuar kryesisht në masat, paraprake dhe punën konkrete që është bërë deri më sot në sistemin e fortifikimit të qytetit të Lisit.

Qyteti i Lisit është themeluar mbi truallin e një vendbanimi ilir të fortifikuar paraqytetar rreth fundit të shek. IV para erës sonë[1] (Fig. 1). I gjithë territori

1) F. Prendi — K. Zheku, **Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike,** Monumentet Nr. 2, 1971, f. 7-18.

DO NOT COPY

INST. MON. KULTURES
BIBLIOTEKA
Nr. INV. 8667

DO NOT COPY



Fig. 1

i këtij qyteti ka qenë i mbrojtur me një sistem fortifikimi shumë të fuqishëm. Perimetri i mureve rrethuese arrinte një gjatësi prej 2200 m. Hyrjet e qytetit dhe muret ishin të përforcuara me kulla të larta me formë të rrumbullakët dhe drejtkëndore.

Kërkimet dhe zbulimet gjatë dhjetë vjetëve të fundit nxorën në dritë thuajse gjithë trasenë e mureve të rrethimit, kullat mbrojtëse si edhe dhjetë nga hyrjet e këtij qyteti.

Rrënojat e mureve që ishin në sipërfaqe si edhe mbeturinat e konstruksioneve që u zbuluan u gjetën në pjesën më të madhe të rrënuara dhe ruanin në gjendjen fillestare vetëm 2-3 rreshtat e parë të muraturës, gjurmë këto të sigurta për ringritjen e tyre në lartësi.

Pjesët e tjera të këtyre mureve u gjetën të rrëzuara, të zhvendosura ose dhe të inklinuara që nga themeli për arsye të rrëshqitjes apo cedimit të terrenit në kohë të ndryshme (Fig. 2).

Në shumicën e rasteve blloqet e gurëve të rrëzuar nga muret antike u gjetën të palëvizura në vendin e rrëzimit të tyre në afërsi të mureve, por janë konstatuar edhe raste ku blloqet e rrëzuara janë ripërdorur në mure provizore të vona si edhe në muret me llaç gëlqereje në sistemet mbrojtëse të periudhës mesjetare (Fig. 3).

Në qytetin ilir të Lisit, i cili ka vazhduar të jetojë edhe gjatë kohës mesjetare, ka raste ku mbeturina të mureve antike që kanë qenë në gjendje të mirë janë shfrytëzuar si bazamente të mureve mbrojtëse mesjetare. (Fig. 4). Hyrjet e këtij qyteti u gjetën të mbyllura me mure provizore të ndërtuara me blloqet e gurëve të rrëzuara nga muret e tyre ose edhe me gurë të vegjël e copa tullash, mbeturina nga ndërtime të ndryshme. (Fig. 5).

Përpara një gjendjeje të tillë në radhë të parë delte si detyrë marrja e masave urgjente për konsolidimin dhe konservimin e rrënojave për t'i ruajtur ato

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

në gjendje sikurse u gjetën. Në radhë të dytë dilte nevoja e ndërhyrjes në stil më të gjerë për restaurimin e tyre.

Në fazën e parë punimet me karakter anastiloze filluan me ringritjen e blloqeve të rrëzuara në muret e hyrjeve dhe kullat që ruanin pjesën e poshtme të muraturës në gjendjen e tyre fillestare.

Ndër Problemet kryesore një rëndësi të veçantë kishte në rastet konkrete edhe njohja e gjithanshme e monumentit, konkretizimi i shkaqeve të rrëzimit, njohja mirë e gjithçkaje që ruhej në vendin e rrëzimit.

Në fazën e dytë punimet me karakter anastiloze u zgjeruan duke përfshirë edhe trakte muresh, të cilat u gjetën të dëmtuara nga lëvizje sizmike ose nga rrëshqitja e terrenit nën themelet e tyre.

Për këtë fazë problemet kryesore që kërkonin zgjidhje kanë qenë përcaktimi i saktë i profilit fillestar të terrenit dhe parashikimi i kuotave respektive simbas shkallëzimeve eventuale të themeleve të mureve të rrëzuara.

Të bazuar në të dhënat e përfituara nga studimi i hollësishëm i gjendjes për çdo rast më vete, punimet konkrete filluan me zëvendësimin e vëllimit të terrenit të rrëshqitur, duke ndërtuar një bazament mbështetës të ri prej muri butobeton. Këto bazamente janë ndërtuar 1,00-1,50 m të gjera për secilin themel.

Përpara fillimit të ringritjes së muraturës si problem që kërkonte një kujdes të veçantë paraqitej së pari rivendosja me saktësi e blloqeve të gurëve të themelit. Ky proces pune vështirësohet shumë për arsye se blloqet që formojnë rreshtin e parë dhe të vetëm të themelit nuk janë të gdhendura në faqet anësore, rrjedhimisht edhe gjetja e vendit të tyre fillestare arrihet indirekt vetëm duke iu referuar sipërfaqes së tyre të gdhendur. Në zgjidhjen e këtyre problemeve në mënyrë të posaçme ndikon edhe njohja deri në hollësitë më të vogla e parimeve konstruktive dhe metodave teknike që karakterizojnë ndërtimet fortifikuese në qytetet ilire.

Muret rrethuese të Lisit ngrihen mbi themele të ndërtuara me gurë jo shumë të trashë, por gjithmonë me sipërfaqe mbështetëse të madhe. Themelet ndërtohen me një radhë gurësh, të cilët kanë të gdhendur vetëm faqen e sipërme dhe janë vendosur bri njëri-tjetrit duke krijuar shtresa me nivele horizontale të shkallëzuara sipas pjerrësisë së terrenit (Fig. 6). Nëpërmjet shkallëzimeve të themelit vihen re edhe thyerje me disnivel, të vogla në sipërfaqet e blloqeve të themeleve. Këto dhëmbëzime prej 2-3 mm deri 2-3 cm që ruhen në sipërfaqet e gurëve të themelit janë gjurmë të sigurta për rivendosjen e blloqeve të rreshtit të parë të muraturës.

DO NOT COPY



Fig. 4

Themelet janë ndërtuar vetëm në pjesën ku mbështeten faqet e dukshme të muraturës, kurse bërthama nuk ka fare themel.

Në vende ku terreni ka pjerrësi të theksuar, themeli i faqes së jashtme të muraturës është vendosur në nivel më të ulët kundrejt faqes së brendshme.

Muret ngrihen në lartësi me blloqe gurësh të madhësive të ndryshme, të gdhendur me faqen ballore në përgjithësi me formë trapezoidale të çrregullt. Forma të përafërta drejtkëndore vihen re në blloqet e gurëve me të cilat janë ndërtuar qoshet e mureve. Në përpunimin e blloqeve të gurëve të muraturës faqja më e madhe e secilit bllok është paracaktuar si faqe ballore, faqja mbështetëse e tyre është e gdhendur imtë gjithmonë në një plan të sheshtë, kurse sipërfaqja e tyre shpeshherë është e gdhendur në dy plane me pjerrësi të ndryshme. Faqet anësore të blloqeve janë të gdhëndura për aq sa ishte e nevojshme për puthitjen e plotë bri njëri-tjetrit.

Për matjen dhe gdhendjen e blloqeve të gurëve në forma të çrregullta trapezoidale dhe poligonale, në kohën antike ka qenë përdorur një lloj skuadër me brinjë të lëvizshme, e cila mund të fiksohej në kënde të ndryshme. Një vegël e tillë që nuk përfshihet në pajisjet e muratorit të ditëve tona bëhet e domosdoshme në punimet restauruese për matjen e këndeve dhe gjetjen e vendeve fillestare të blloqeve në muraturë, një proces pune ky që është shumë i vështirë në rastet e rivendosjes së blloqeve të rrëzuara.

Punimet e restaurimit në mbeturinat e sistemeve fortifikuese të qytetit të Lisit ndryshuan në mënyrë rrënjësore gjendjen e tyre. Nga rrënojat e mureve që shkonin drejt degradimit të tyre të plotë u arrit që gjer më sot të restaurohen shtatë nga portat kryesore dhe kullat e tyre.

Në muret e rrethimit ku gjendja e tyre ishte në rrezik shembjeje punimet me karakter anastiloze kanë qenë të një mase më të madhe si në drejtim të ndërhyrjes në thellësi, ashtu edhe në shtrirjen e tyre. Deri më sot në këtë sektor janë restauruar trakte të ndryshme, gjatësia e përgjithshme e të cilave arrin rreth 300 ml dhe lartësia 2-4 m.



Fig. 5

DO NOT COPY



Fig. 6

Për probleme të një karakteri më të veçantë dhe me rëndësi për sa u përket zgjidhjeve konstruktive e arkitektonike si edhe metodave teknike të aplikuara, vlen të përmendim këtu edhe restaurimin e Portës së Brendshme të qytetit të Lisit që u krye gjatë viteve 1970-74.

Porta e Brendshme u zbulua gjatë punimeve konservuese në vitin 1969 dhe u gjet e vendosur në murin e brendshëm që ndante qytetin[2]. Funksioni i saj ka qenë t'i shërbente kryesisht zonës kodrinore dhe të komunikonte me qytetin e poshtëm breglumor. Emërtimi i kësaj porte lidhet pikërisht me këtë funksion.

Si rezultat i punimeve arkeologjike që u kryen në vazhdim në këtë sektor doli në dritë një kompleks i tërë arkitektonik me shumë interes. Përveç portës u zbulua një kullë mbrojtëse e ndërtuar në anën e majtë të hyrjes, pjesë të trakteve të murit të brendshëm si edhe një numër ambientesh ushtarake, ndërtuar në anën e brendshme të këtij muri.

Dëmtimet e njëpasnjëshme, cedimi dhe rrëshqitja e terrenit në një sipërfaqe të madhe e kishin kthyer këtë kompleks arkitektonik në një rrënojë pamja origjinale e të cilit nuk mund të përfytyrohej veçse në vija shumë të trasha (Fig. 7).

Si problem urgjent edhe në këtë sektor për fazën e parë paraqitej konsolidimi i pjesëve të mureve që kishin rrezik shembjeje dhe sistemimi i blloqeve të gurëve të rrëzuara. Nga sa mund të konstatohej rrëzimi i mureve dhe zhvendosja e bloqeve në muraturë ishte shkaktuar edhe në këtë rast nga lëkundjet sizmike dhe rrëshqitja e terrenit në dy drejtime (Fig. 8). Në drejtimin jugor muret u gjetën të zhvendosura që nga themeli në mënyrë progresive deri në 2 m larg vendit fillestar, kurse në atë perëndimor zhvendosja më e madhe arrinte 1.50 m.

Një problem me rëndësi të veçantë që paraqitej në këtë sektor ishte ai i studimit konstruktiv dhe arkitektonik i të gjithë kompleksit ku përfshihej Porta e Brendshme. Për këtë qëllim u rilevuan me hollësi gjendja e këtij monumenti dhe u hartua një planimetri e përgjithshme e gjendjes në përfundim të gërmimeve arkeologjike. Rilevimi i detajuar i gjithë blloqeve të gurëve të fasadave të mureve dha mundësinë e përcaktimit të gjatësive të trakteve të mureve. Vendosja e këtyre blloqeve grafikisht në planet e fasadave dha gjithashtu mundësinë që indirekt të përcaktoheshin edhe shkallëzimet eventuale të themeleve për secilën faqe muri më vete.

Në këtë mënyrë, duke patur parasysh edhe një numër të dhënash të tjera u arrit më në fund të hartohej planimetria e përgjithshme me përmasat dhe formën e saj origjinale. Ky studim paraprak ishte i nevojshëm për zgjidhjen e problemeve që lidhen direkt me nxjerrjen e kuotave të profileve të themeleve, përcaktimin e drejtimit të mureve dhe rivendosjen e blloqeve të gurëve në muraturë.

Problemi i piketimit në terren i planimetrisë së hartuar, përbën një nga problemet më të rëndësishme, sepse në raste të tilla punimet për ringritjen e mureve duhet të mbështeten fillimisht në dy, tri ose edhe më shumë pika të sigurta. Vetëm në këtë mënyrë krijohet mundësia e kontrollit të zbatimit të punimeve.

Këtë problem në Portën e Brendshme mund ta konsiderojmë të zgjidhur në mënyrë të sigurtë, sepse

2) K. Zheku, **Restaurimi i Portës së Brendshme në qytetin ilir të Lisit,** Monumentet 5-6 v. 1973, faqe 7-21.

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

pikënisjet për ringritjen e muraturës janë mbështetur mbi trakte ose themele origjinale të palëvizura nga vendi i tyre fillestar. Kjo gjë është vërtetuar edhe nga vendosja e blloqeve në lartësi të muraturës, ku blloqet janë puthitur mirë njëri me tjetrin dhe dhëmbëzimet apo kllapat në fugaturat horizontale korespondojnë sipas masave të blloqeve korresponduese për secilin rresht.

Gjatë restaurimit të Portës së Brendshme janë hasur vështirësi në ngritjen e faqeve të brendshme të muraturës, për arsye se blloqet e gurëve në këtë anë kanë qenë gdhendur me faqet anësore të prera me vija të drejta dhe kënde të papërcaktuara mirë. Rrjedhimisht edhe rivendosja e këtyre blloqeve kërkonte një vëmëndje të posaçme.

Nëpërmjet punimeve restauruese u ringritën në këmbë të gjitha strukturat e konstruksioneve që i përkasin kompleksit arkitektonik të Portës së Brendshme të mbështetura në bazament të ri dhe të sigurtë për kohën e ardhshme. Në këtë mënyrë mendojmë se kemi arritur në stabilitetin konstruktiv dhe formulimin arkitektonik të këtij monumenti në masën sa na lejoi materiali origjinal i trashëguar prej tij.

Gjatë këtyre punimeve ne kemi pasur parasysh që të ruajmë të paprekura dhe të qarta të gjitha gjurmët që koha e kaluar ka lënë në pjesë të ndryshme të këtij monumenti duke menduar se në këtë mënyrë ai na paraqitet me pamjen e tij origjinale që ka pasur në një periudhë kohe të caktuar, përpara rrëzimit të tij (Fig. 9).

Restaurimi i Portës së Brendshme të Lisit është pjesë e një plani shumëvjeçar që në kombinim me gërmimet arkeologjike ka për qëllim të krijojë një pamje deri diku të plotë të fizionomisë së një qyteti ilir. Një plan më i gjërë për restaurimin e sistemeve të fortifikimeve të qyteteve ilire është në studim nga ana e Institutit tonë dhe po zbatohet edhe në qytete të tjera ilire si në Zgërdhesh, Klos, Bylis etj.

Ringritja në këmbë e fortifikimeve ilire është bërë në vendin tonë një veprimtari e organizuar mbi baza shkencore dhe lidhet drejtpërdrejt me vlerësimin e madh e të merituar që i kushtohet kulturës ilire, që trashëgojmë nga e kaluara e lashtë.

DO NOT COPY

Koço ZHEKU

PROBLEMES RELATIFS A LA RESTAURATION DES SYSTEMES DE FORTIFICATION DES VILLES ILLYRIENNES

RESUME

Les systèmes de fortification des villes illyriennes, qui ont été mis au jour jusqu'à présent à Lis, Zgërdhesh, Klos, Persqop, Dimal, Amantie, Antigonée et ailleurs, soulèvent une série de problèmes relatifs à leur conservation et à leur restauration. Les débris de ces systèmes, entre autres des tronçons de murs d'enceinte des villes, des tours défensives et leurs entrées, sont en général dégradés ou endommagés par suite des opérations militaires qui ont eu lieu en des périodes de temps différentes, de l'affaissement ou de l'éboulement du terrain, de la végétation qui y a poussé ainsi qu'en raison d'autres facteurs qui ont exercé leur influence des siècles durant.

Les tâches qui s'imposent en chaque cas particulier ont un caractère pressant et multiple. La principale d'entre elles est cependant le problème de la conservation immédiate de ces systèmes de fortification, de manière à les maintenir dans l'état qu'ils ont vu la lumière à la conclusion des fouilles archéologiques. Toutefois, s'il n'est pas possible de maintenir cet état pendant une période de temps relativement longue, du fait que les murs mis au jour risquent de s'écrouler, alors il est indispensable de procéder à leur restauration.

Etant donné que les systèmes de fortification des villes illyriennes appartiennent à la même période de temps et se caractérisent par une technique de construction analogue, et qu'en, plus actuellement l'état dans lequel ils sont conservés est identique, il en ressort que les problèmes confrontant l'anastylose soient en général les mêmes. Ces problèmes seront examinés surtout dans le contexte des mesures préliminaires et du travail concret déjà réalisés dans le système de fortification de la ville de Lis.

Les travaux de recherche et d'étude effectués pendant ces dix dernières années, dans la ville de Lis, ont mis au jour presque tout le tracé des murs d'enceinte, les tours défensives et dix parmi les entrées de cette cité.

Les décombres des murs couvrant la surface du terrain, ainsi que les débris de constructions mis au jour se trouvaient pour la plupart dans un état délabré, ne conservant que les deux ou trois premières rangées de la maçonnerie, ce qui pourtant constituait une base suffisament solide pour leur reconstruction en hauteur. En ce qui concerne les autres parties de ces murs, elles étaient écroulées, ou encore déplacées ou inclinées depuis leur fondement en raison de l'éboulement ou de l'affaissement du terrain en différentes périodes de temps.

Dans la ville illyrienne de Lis, qui a continué à exister même pendant le Moyen âge, dans certains cas les anciens murs relativement bien conservés ont été utilisés comme soubassement des murs défensifs de la période moyenâgeuse. Les entrées de cette ville avaient été murées provisoirement avec des blocs de pierre qui s'étaient écroulés de leurs murs ou avec des petites pierres et des morceaux de briques appartenant à d'autres constructions.

Face à cette situation, il fallait en premier lieu prendre des mesures pressantes tendant à la consolidation et à la conservation de ces ruines, de manière à les maintenir dans l'état où elles furent retrouvées. Après quoi il fallait intervenir de grand style pour leur restauration. Dans la première phase, les travaux relevant du domaine de l'anastylose furent commencés par la remise en place des blocs écroulés des murs des entrées et des tours conservant encore intacte la partie inférieure de leur maçonnerie. Pendant la deuxième phase, ces mêmes travaux d'anastylose concernèrent aussi les tronçons de murs, qui avaient été endommagés par les mouvements sismiques ou par l'affaissement du terrain au-dessous de leurs fondements. En l'occurence les principaux problèmes qui attendaient une solution étaient le problème de définir exactement le profil initial du terrain et celui de prévoir les cotes respectives selon les échelonnements éventuels des fondations des murs écroulés.

Partant des données acquise grâce à l'étude minutieuse de la situation en chaque cas particulier, le travail concret a débuté par la substitution du volume de terrain éboulé, en construisant un soubassement nouveau de béton armé. Quant à l'épaisseur de ces soubassements, elle a été de 1,00-1,50 m pour chaque fondation.

Avant de commencer la reconstruction de la maçonnerie, il fallait sans faute établir le mode de remise en place avec exactitude des blocs de pierre de la fondation. C'était à un problème très difficile, du fait que les blocs constituant la première et seule rangée des fondations n'avaient pas leurs face latérales équarries, en conséquence pour trouver leur place initiale

DO NOT COPY

on ne pouvait agir qu'indirectement par référence à leur surface dégrossie. Evidemment la connaissance des principes de construction est d'une grande aide en ce cas.

Les murs d'enceinte de Lis s'élèvent sur des fondations de pierres de dimensions non grandes, dont la seule face supérieure est équarrie; elles sont disposées en une seule rangée et conformément à l'inclination du terrain. Mais là où le terrain est très escarpé, la fondation du parement extérieur de la maçonnerie se trouve à un niveau plus bas par rapport à celui du parement intérieur. Les murs sont construits avec des blocs de pierres de différentes dimensions, dont la partie frontale en général de forme trapézoïdale irrégulière est équarrie. En ce qui concerne les angles des murs, on y relève des blocs de pierre ayant des formes angulaires presque analogues.

Les travaux de restauration effectués parmi les ruines des systèmes défensifs de la ville de Lis ont radicalement modifié leur état. Parmi les ruines de murs en voie de dégradation intégrale, à ce jour ont été restaurées sept des portes principales et les tours qui les flanquent. En ce qui concerne les murs d'enceinte, qui étaient exposés au péril d'écroulement, les travaux d'anastylose effectués ont assumé de plus grandes proportions tant pour ce qui concerne la profondeur des interventions que leur extension. A ce jour ont été restaurés en ce secteur différents tronçons, dont la longueur totale est de 300 ml environ et la hauteur de 2-4 m.

En 1969, pendant les travaux de conservation, a été mise au jour entre autres La Porte Intérieure, aménagée dans le mur intérieure séparant la ville. En ce qui concerne sa fonction, elle était destinée à desservir principalement la zone mamelonnée et assurer la communication avec la ville basse longeant la rivière. A la suite des travaux effectués dans ce secteur, un complexe architectonique de grand intérêt a vu le jour. Les endommagements successifs, l'affaissement et l'éboulement du terrain sur une grande surface avaient converti en ruine ce complexe architectonique, au point qu'on ne pouvait représenter que sommairement dans l'esprit son aspect original.

Dans ce secteur aussi, pendant la première phase, le problème plus presant qui se posait était celui de la consolidation des murs présentant un danger d'écroulement et la remise en place des blocs de pierre. A première vue, dans ce cas aussi l'écroulement des murs et le déplacement des blocs de la maçonnerie étaient dus aux mouvements sismiques et à l'éboulement du terrain en deux directions. En effet, en direction sud les murs s'étaient progressivement déplacés des fondations jusqu'à 2 ml loins de leur place initiale et en direction occidentale jusqu'à 1.50 m. Le relèvement détaillé de tous les blocs de pierre appartenant aux parements des murs a facilité la détermination de la longueur des tronçons de murs. A la suite de la production graphique de ces blocs sur les plans des façades, il a été de même possible de déterminer indirectement les échelons éventuels des fondations pour chaque parement de mur. Ainsi, en nous fondant aussi sur un nombre d'autres donneés, nous avons pu finalement élaborer la planimétrie générales dans ses dimensions et formes originales.

Le problème du piquetage sur le terrain de la planimétrie dressée représente un des problèmes le plus important, du fait qu'en ce cas les travaux de reconstruction des murs doivent s'appuyer au commencement sur deux, trois ou même plus points de repère sûrs. C'est là la seule manière de vérifier l'exactitude des travaux réalisés. En ce qui concerne la Porte intérieure, ce problème a été résolu à partir de points de repère sûrs, parce que pendant la reconstruction des murs on s'est appuyé sur des tronçons ou des fondations n'ayant pas subi des déplacements.

Pendant la restauration de La Porte Intérieure on s'est heurté à des difficultés en ce qui concerne la reconstruction des parements intérieurs de la maçonnerie, du fait que les blocs de pierre relevant de la partie intérieure du mur étaient équarris de manière à avoir les faces latérales en lignes droites et les angles non bien définis. En conséquence la mise en place de ces blocs exigeaient une grande attention.

A la suite des travaux de restauration, toutes les structures des constructions relevant du complexe architectonique de La Porte Intérieure ont été redressées et appuyées sur un nouveau soubassement solide. En agissant de la sorte nous pensons avoir assuré la stabilité de la construction et la formulation architectonique de ce monument dans la mesure que nous le permettait les matériaux originaux disponibles.

La restauration de La Porte Intérieure de Lis fais part d'un plan pluriannuel, qui, en combinaison avec les fouilles archéologiques, sera en mesure de reproduire un aspect jusqu'à un certain point complet de la physionomie d'une ville illyrienne. Notre Institut est en train d'élaborer un plan beaucoup plus vaste pour la restauration des systèmes de fortification des villes illyriennes, qui sera appliqué aussi à d'autres agglomérations urbaines comme Zgërdhesh, Klos, Bylis et autres.

DONOTCOPY

DO NOT COPY

Neritan CEKA

DO NOT COPY

FORTIFIKIMI ANTIK I BUTRINTIT DHE I TERRITORIT TË PRASAIBËVE

Në qoftë se do të dëshironim të jepnim tablonë e zhvillimit të një qendre antike në planin e fortifikimeve, Butrinti do të përbënte një shembull mjaft të qartë, ku evolucioni urban shoqërohet me zhvillimin e teknikës së ndërtimit në muret e qytetit dhe me krijimin e një sistemi të plotë mbrojtjeje në tërë krahinën, qendër e së cilës isthe Butrinti, i vendosur në këndin j.l. të gadishullit të Ksamilit. Butrinti kishte një pozitë mjaft të mbrojtur nga sulmet e befasishme nga deti apo nga toka. Kanali natyror i Vivarit krijonte nga ana tjetër lidhjen e vazhdueshme me detin, duke e kthyer qytetin në një skelë. Ai ishte njëkohësisht edhe dalja më e volitëshme në det për tërë pellgun e lumit Pavlla, sepse i gjithë bregdeti nga j.p. apo p., megjithëse ka gjire të mira, është krejt i thatë dhe ndahet nga prapatoka me kurrize shkëmbore ose këneta.

Kjo krahinë, që veçohej nga pjesa tjetër e Kaonisë nga Mali i Milesë, mjaft i pasur me kullota, duke pasur si bërthamë të saj fushën e Vrinës, njihej në kohën antike si territor i prasaibëve[1]) (Tab. 1).

Përveç Buthrotit, që ishte qendra kryesore e këtij territori, siç provohet nga vetë rëndësia, monumentet dhe fakti i gdhendjes së mbishkrimeve të koinonit, aty kishte edhe një qendër tjetër të madhe qytetare në Çukën e Ajtojt, si dhe një sërë fortifikimesh të vogla si Karaalibej, Vagalati, Qenurio, Katoaitoj dhe muri i Demës[2]).

I gjithë ky sistem fortifikimi, i cili pasqyron zhvillimin ekonomik dhe politik të kësaj treve, është rezultat i një evolucioni të gjatë. Për studimin e tij, sot mund të mbështetemi në vrojtimet e monumenteve, që ruhen në sipërfaqe, kryesisht mure rrethuese dhe në të dhënat e gërmimeve arkeologjike të zhvilluara në Butrint dhe Çukën e Ajtojt. Vetë Butrinti përbën kyçin për një studim të tillë, jo vetëm se ka qenë për një kohë të gjatë objekt i gërmimeve arkeologjike, por edhe për faktin se në muret e tij janë pasqyruar të gjitha fazat e evolucionit urban në territorin prasaib.

QYTETI I BUTRINTIT

Kodra, mbi të cilën ngrihet qyteti antik, përveç mbrojtjes, që i sigurojnë ujërat e liqenit të Vivarit, ka shkëmbinj të paofrueshëm nga ana j.p., mbi të cilët pason një shesh i përshtatshëm për banim, që zbret butë drejt veriut. Një qafë e ulët, që ngushtohet ndërmjet liqenit dhe Vivarit, e kthen territorin e Butrintit në një gadishull të vogël.

Fortifikimi antik përfshin tërë kodrën, deri mbi ndarjen e saj nga qafa (tab. 2). Traseja e tij mund të ndiqet veçanërisht qartë në anën veriore dhe lindore, ku ka shërbyer si substruksion i mureve të vona antike. Në anët e tjera linja e murit plotësohet nga trakte të shkëputura, që kanë mbetur pas daljes së

1) Dh. Budina, K. Bozhori, **Mbishkrimet antike të teatrit të Butrintit,** «Studime historike», 2, 1966, 156.

2) Në vrojtimet e bëra në Butrint, Çukën e Ajtojt, Demë dhe Vagalat autori ka pasur ndihmën e prof. S. Islamit dhe L. Papajanit dhe disa nga pikëpamjet e shprehura në këtë artikull janë frut i diskutimit të përsbashkët.

tij jashtë përdorimit. Fortifikimi antik, i ruajtur në këtë mënyrë, na paraqet disa trase të veçanta dhe një numër teknikash, që lidhen me fazat e ndryshme të zhvillimit të tij.

Në studimin mbi fortifikimet e Butrintit, Ugolini është përpjekur të japë skemën planimetrike të qytetit dhe të bëjë klasifikimin tipologjik të muraturave si dhe datimin e tyre[3]. Ai dallon një rrethim të sipërm, që përfshinte majën e kodrës dhe përfaqësohet nga një trakt muri «pelazgjik», një tjetër «poligonal primitiv» dhe nga një i tretë me blloqe të mëdha poligonale[4]. Një rrethim të dytë përfaqësonte sipas tij trakti mbi analemën p. të teatrit, të cilit ai i gjen vazhdime me një teknikë tjetër nga lindja dhe veriu[5]. Rrethimi i tretë, i poshtmi, ndiqet prej tij në tërë anën v.,l. dhe pjesërisht në atë j.l. dhe j.p., duke mbetur hapur ana p[6].

Kjo skemë e bazuar në një rikrijim të traseve në bazë të trakteve të shkëputura, pa lidhje tipologjike, mbetej në pjesën më të madhe të saj hipotetike. Hamondi, që u bëri një shqyrtim kritik përfundimeve të Ugolinit, nuk pranon me të drejtë rrethimin e dytë, por duket se shkon larg, kur mohon edhe murin j. të akropolit, të cilin e konsideron mur mbajtës[7].

Po aq i paqëndrueshëm paraqitet edhe klasifikimi tipologjik i muraturave dhe datimi i tyre nga Ugolini[8]. Periudha e parë e ndërtimit përfaqësohet sipas tij nga trakti «pellazgjik» i anës jugore. Periudha e dytë karakterizohet nga përdorimi i poligonalit, ndërsa në fund të shek. V, fillim i shek. IV, vendoset prej tij, si një periudhë e tretë, muratura «me blloqe me gjashtë faqe». Periudha e katërt me «blloqe të mëdha paralelopipedë» dhe ajo e pestë me «blloqe të vogla paralelopipedë», datohen respektivisht në shek. IV dhe II p.e.sonë.

E meta themelore e këtij klasifikimi qëndron në faktin, se në ndarjen e tipeve merret për bazë vetëm forma e gurit, dhe si rrjedhim vendosen në kohë të ndryshme duar të ndryshme të së njëjtës periudhë.

Edhe Hamondi mbështetet po në këtë koncept, por në drejtimin e kundërt, duke bërë një thjeshtim të stileve në bazë të formës së gurëve. Ai pranon dy tipe katërkëndëshi, të cilat diferencohen vetëm nga përdorimi i shkallëzimeve si dhe një tip të tretë, më të vonë, poligonal[9]. Në këtë mënyrë paraqitja dhe interpretimi i derisotshëm i fortifikimit të Butrintit nuk i përgjigjet realitetit dhe ka sjellë një konfuzion të dëmshëm për studimin e fortifikimeve antike të vendit tonë. Për këtë arsye është i nevojshëm një riparashtrim në vija të përgjithshme i gjithë materialit të njohur dhe shqyrtimi kritik i tij[10].

Vështrimin e parë do ta hedhim mbi zhvillimin urbanistik të qytetit, në atë mënyrë, që pasqyrohet në muret rrethuese të tij. Këtë do t'ia kundërvëmë konceptit statik të Ugolinit, që dallon vetëm ndarje të brendshme të qytetit, duke i marrë si zbatim të një ideje të vetme urbanistike.

Në fillimet e veta jeta në Butrint është zhvilluar në pjesën më të lartë të kodrës, ku është gjetur edhe shtresa me materiale korintike të shek. VII-VI p.e. sonë[11].

Konturet e vendbanimit, përcaktoheshin gjatë tërë anës jugore nga rënie shkëmbore, ku shtigjet mbylleshin nga mure të shkëputur. Ana lindore e murit përfaqësohet sot nga trakti i njohur me gurë të papunuar, me boshllëqe të mëdha, i cili ka shërbyer më vonë si substruksion i murit mesjetar (Fig. 1). Dy trakte të tjera me teknikë tjetër, të përshkruar gjithashtu nga Ugolini[12], na japin të drejtën të mendojmë se traseja ka ndjekur një linjë të përafërt me atë të murit mesjetar me një gjatësi rreth 300 m, duke përfshirë një sipërfaqe rreth 0,4 ha.

Nga natyra e shtresës kulturore dhe vendi i kufizuar i vendbanimit, që po e quajmë Butrint I, duket qartë se ai kishte karakter paraqytetar, me shenja të qarta të zhvillimit të procesit urban. Shprehje e tipareve të reja, që po fitonte vendbanimi, janë rindërtimet e pjesshme të murit ekzistues me një teknikë më të përparuar. Trakti përfaqësues i saj gjendet në mesin e anës jugore, ku mbyllte një shteg ndërmjet shkëmbinjve. Në një gjatësi prej 9 m muri ka dy kthesa me kënd të drejtë, që i japin pamjen zigzage (Fig. 2).

3) L.M. Ugolini, **L'acropoli di Butrinto,** Roma 1942, f. 26-44.
4) **Po aty,** f. 26-27.
5) **Po aty,** f. 28-30.
6) **Po aty,** f. 30-37.
7) N.G. Hammond, **Epirus,** Oxford, 1964, f. 109.
8) L.M. Ugolini, **vep. cit.** f. 44.
9) N.G.L. Hammond, **vep. cit.** f. 100-101.
10) Në artikullin **Harta arkeologjike e bregdetit Jon dhe e pellgut të Delvinës»,** «Iliria», I, 1971. Dh. Budina e ka prekur vetëm shkarazi fortifikimin antik, pa mbajtur qëndrim kritik ndaj studimeve të mëparshme, për këtë problem.
11) D. Mustilli, **Relazione preliminare sugli scavi archeologici in Albania (1937 – 1940),** «Rendiconti della classe di scienze morali e storiche», VI, II, 1941, f. 686-687.
12) L.M. Ugolini, **vep. cit.,** 26-27.

DOKTORATURA

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

Blloqet janë me përmasa të mëdha, mbi 2 m gjatësi dhe 1 m lartësi. Zotërojnë format trapezoidale dhe më rallë ato poligonale me kënde të zgjatura në drejtimin horizontal. Në plotësimin e këndeve janë përdorur gurë të vegjël trekëndësh dhe faqet e blloqeve janë punuar rrafsh. Nga pikëpamja tipologjike kjo është një muraturë trapezoidale-poligonale me faqe të rrafshuar, mjaft e afërt me «trapezoidalin e çrregullt» të Skrantonit, që vazhdon të përdoret në krahinat fqinje të Greqisë në shek. V p.e.[13] sonë. Në vendin tonë një muraturë të afërt e gjejmë në Amantia, me elemente më të përparuara teknike, siç janë kalimi në trakte me forma të sheshta katërkëndëshe dhe prerja e anës së gurëve. Për këtë arsye duhet të mendojmë për murin trapezoidal-poligonal të Butrintit një kohë para gjysmës së parë të shek. IV, kur datohet me siguri muri respektiv i Amanties[14].

Zhvillimi i mëtejshëm i vendbanimit të fortifikuar në Butrint lidhet me periudhën qytetare. Gjurmët më të hershme arkeologjike të saj përfaqësohen nga monedhat prej argjendi të shek. IV p.e.sonë të gjetura në territorin e Butrintit[15]. Karakteri i përparuar qytetar i qendrës pasqyrohet edhe në krijimin e një sistemi krejt të ri fortifikimi. Traseja e mureve të tij mbyll një rrethim të plotë të kodrës, duke u varur nga qafa për të kaluar rrëzë shpateve të saj në anët veriore, lindore dhe jugore. Ndërsa ana veriore dhe lindore e murit rrethues mund të ndiqet pothuaj pa ndërprerje, ana jugore mund të plotësohet ndërmjet një trakti rreth 20 m në v.p. të portës me kulla dhe trakteve, që janë ruajtur mbi teatër, në pjesën v.p. dhe v.l. të koiloneve të tij. Nga pjesa perëndimore ruhet vetëm një hyrje dhe ndonjë shenjë e shkëputur nën shkëmbinjtë e anës j.p. të kodrës. Fortifikimi i vjetër nuk u zhduk, por mbeti brenda të riut në funksionin e një akropoli, që zinte majën më të lartë të kodrës.

Në një gjatësi prej 870 m, muret përfshinin një sipërfaqe rreth 4 ha. Linja e tyre karakterizohet nga kthesat e vazhdueshme me kënd të gjerë apo të ngushtë, që i japin pamjen e dhëmbëve të sharrës. Kullat mungojnë dhe rolin e tyre e luajnë daljet në formë bastioni. Hyrjet janë vendosur në numrin dhe në

13) R. Scranton, **Greek Walls,** Cambridge, 1941, f. 189.

14) N. Ceka, **Qendrat e fortifikuara të amantëve,** «Monumentet», 10, 1975, f. 50.

15) L.M. Ugolini, **vep, cit.,** f. 234-235 jep një monedhë të Korkyrës të viteve 450-300, tri statere të Dyrahut pa emër nëpunësi, që datohen nga H. Ceka, **Probleme të numismatikës ilire,** Tiranë 1965, f. 16, në vitet 430-350, dy monedha të Korintit të viteve 400-328, një e Sikionit e 400-300 dhe një e Kaulonias (480-420), që vijnë nga një thesar i gjetur në nekropolin e Butrintit.



Fig. 3

vendet e duhura, në përshtatje me kërkesat e jetës qytetare.

Porta I (Fig. 4), që po e quajmë e Liqenit, përbën nga skema planimetrike një variant të hyrjes ballore, tipike për vendbanimet e periudhës paraqytetare (Tab. III a). Për të siguruar një mbrojtje më të mirë, në anën e majtë të hyrjes muri rrethues është nxjerrë 2 m përpara, duke formuar një farë bastioni me gjatësi rreth 20 m. Korridori i hyrjes është tepër i ngushtë (1,50 m) në raport me gjatësinë (5,25 m) dhe lartësinë (rreth 5 m). Mbulimi i tij është bërë me plla ka, që rendojnë pjesërisht mbi konsola me prerje harkore.

Porta II, që njihet me emrin Porta e Luanit, ka një skemë më të përpunuar me korridorin e krijuar ndërmjet krahëve paralelë të murit (Tab. III, b). Me gjithë rindërtimin e krahut të majtë dhe mbulesës, ajo ka ruajtur përmasat e korridorit që është 2.15 (1.65) m i gjerë dhe 2,90 m i gjatë. Të njëjtën skemë planimetrike ka edhe porta III në anën veriore me gjerësi 2,40 m dhe gjatësi të korridorit 5,50 m.

Porta IV në anën perëndimore, është për sa i përket planimetrisë një variant i Portës së Liqenit me një bastion në anën e djathtë. Përmasat e hyrjes nuk mund të caktohen për shkak të dëmtimit të anës së majtë të saj.

Nga elementet e tjera të planimetrisë mund të shënojmë një bastion në anën veriore dhe një dhëmbëzim me majë të prerë, në anën verilindore, të cilin Ugolini e ka quajtur gabimisht bastion[16]

Ndërlikimi i planimetrisë në periudhën e tretë të ndërtimit shoqërohet me evolucionin e teknikës, që zhvillohet brenda kuadrit të muraturës trapezoidal-poligonale. Traktet me përfaqësuese, që gjenden te Porta e Liqenit dhe në perëndim të saj, janë ndërtuar me blloqe trapezoidale me shumë shkallëzime, me faqe guroreje. Rreshtat që thyhen vazhdimisht kanë lartësi 0,50 x 0,80 m. Lidhja e brendshme është bërë me gurëlidhës, çdo dy radhë në largësi 2,20 m, por jo në një vendosje të plotë vertikale (Fig. 3). Gjerësia e murit është 3,80 m.



Fig. 4 a



Fig. 4 b

16) Ugolini, **vep. cit.,** f. 63 nuk e ka vënë re këtë rindërtim, gjë që i ka shpëtuar edhe K. Zhekut, **Restaurim i portës së Luanit në Butrint,** «Monumentet», 1, 1971, f. 80.

DO NOT COPY



Fig. 5

Një pamje më të qetë ka në fasadë trakti në anën j.l., që takohet me portën me kulla. Me gjithë përdorimin e shkallëzimeve, pothuaj për çdo gur, rreshtat ruajnë të njëjtën lartësi 0.55 m, gjë që i jep murit një pamje izodomike. Gurëlidhësit janë përdorur në të njëjtën largësi (2,30 m), por me një vendosje të rregullt vertikale.

Prirje tjetër e kësaj murature është drejt poligonalit, gjë që duket qartë në pjesët e ruajtura të këtij rrethimi mbi koilonet p. të teatrit. Muri i vendosur mbi shkëmb përbën një kalim gradual nga trapezoidali me rreshta të thyer në një poligonal të rreshtuar me faqe guroreje (Fig. 4 b). Në faqen e murit është gdhendur një vijë peshimi. Të njëjtën pamje ka edhe një trakt në anën v.p., që kalon gjithashtu në muraturën trapezoidale.

Muraturën e Butrintit III mund ta cilësojmë si trapezoidale me rreshta të thyer me faqe guroreje. Ajo përfaqëson një zhvillim të mëtejshëm të trapezoidalit me faqe të sheshtë të Butrintit II, duke përdorur elemente të reja, siç janë lidhja e brendshme me parete ndarëse, apo faqet e papunuara në fasadë, që i japin pamjen e ashpër. Kjo teknikë ndeshet në mjaft qendra të tjera kaone si Finiqi, Çuka e Ajtojt, Borshi, Himara, etj., ndërsa jashtë tij e ndeshim tek amantët, në kalanë e Mavrovës.[18]

Ndërsa nga pikëpamja ushtarake rrethimi i dytë i Butrintit ishte i kënaqshëm, nga pikëpamja urbanistike krijonte një difekt, duke e shkëputur qytetin nga arteri kryesor i jetës ekonomike, Vivari. Gjithashtu mbetej e kufizuar edhe hapësira për ndërtimet.

Zhvillimi i mëtejshëm i qytetit bëri të domosdoshme

18) N. Ceka, **Qendrat e fortifikuara..**, f. 39-40.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

shfrytëzimin për këtë qëllim të sipërfaqes së përshtatshme ndërmjet murit të akropolit dhe Vivarit dhe shtroi nevojën e një fortifikimi të ri të kësaj ane. Kjo u realizua me anë të ndërtimit të një traseje të re të murit rrethues, që degëzohej nga e vjetra në vendin e Portës VI, për të dalë përpara teatrit.

Linja e vjetër e murit në këtë pjesë u prish dhe materiali u ripërdor.

Vetë teatri është një ndërtim i kësaj periudhe, pasi ngritja e tij u bë duke prishur trasenë e rrethimit të dytë, nga e cila mbetën traktet mbi analemnën. Muri mbështetës i teatrit nga ana v.l. është trajtuar me të njëjtën teknikë si e murit rrethues, me të cilin ka të përbashkët edhe përdorimin e kontraforteve.

Në të njëjtën kohë u bënë edhe ndërtime të pjesshme të trasesë së vjetër të murit rrethues ndërmjet pikave B-C dhe D-E. Porta e Luanit pësoi gjithashtu një rindërtim të të gjithë krahut të majtë dhe mbulesës, duke ruajtur skemën e parë planimetrike.

Porta VI (Fig. 5) përfaqëson një ndërtim krejt të ri të kësaj periudhe, që dallohet qartë nga ngjitja me trasenë e murit të periudhës Butrint II. Edhe nga trajtimi planimetrik ajo paraqet një ndërtim në terren të



Fig. 6

sheshtë. Në kompleksin prej dy hyrjesh, që mbrohen nga një kullë katërkëndëshe dhe një tjetër në formë potkoi[19], kryesore ka qenë ajo ndërmjet dy kullave. Gjithashtu zgjatja e kullës në formën e shkronjës U është bërë me qëllim, që prej saj të mbrohej pa pengesë edhe hyrja sekondare pas kullës katërkëndëshe[20].

Një trakt i mirë i kësaj periudhe shënon rindërtimin e murit j.p. të akropolit të vjetër, i cili, me sa duket, u zgjat në drejtim të V.l. deri në takimin me murin e jashtëm. Kjo mund të mendohet nga një trakt i tipit Butrint III në pikat A – P. Në këtë mënyrë u eliminua akropoli i vjetër dhe sipërfaqja e Butrintit u nda në dy pjesë, që mund t'i quajmë qyteti i sipërm dhe ai i poshtëm.

Ndërtimet e Butrintit III u realizuan me muraturë të tipit trapezoidal izodomik. Trakti me përfaqësues në pikat B–C është ngritur me blloqe të gjata trapezoidale me lartësi 0,35 m. Rreshtimi është izodomik, pa përdorim shkallëzimesh; faqja e gurëve është rrahur me çekan në një sipërfaqe të frytë. Lidhja e brendshme është bërë me ndarje tërthore, që dallohen në fasadë çdo 2,60 m. Në faqen e murit ka një vijë peshimi me seksion katërkëndësh.

Të njëjtin trajtim të jashtëm ka edhe muri i kullës në formë potkoi, ndërsa kulla katërkëndëshe ka një ndryshim stilistik me punimin më të rrafshtë të faqeve, prerjen e anëve dhe pamjen pseudoizodomike të rradhëve (Fig. 5).

Një dorë të veçantë përbën në këtë periudhë muri përpara teatrit (Fig. 6). Ai ruhet në një vijë të drejtë 1-p, në të dy anët e një hyrjeje ballore (V). Është ndërtuar me blloqe trapezoidale dhe katërkëndshe me faqe pak të fryra ose të rrafshuara me çukitje, si e kullës katërkëndëshe. Radhët janë izodomike me lartësi 0,45 m, ndërsa drejt p. kalojnë në 0,53 m. Pjesa më perëndimore e murit kalon në poligonal të rreshtuar me faqe të fryrë, në një mënyrë që të kujton muraturën analoge të luginës së Drinosit[21].

Gjerësia e murit është 2,45 m dhe përshkohet nga ndarje tërthore, të cilave u korespondojnë në faqen e brendshme kontraforte të vendosura çdo 3 m[22]. Ato janë ndërtuar me tek gurë, me dalje 0,86 m,

19) Kulla u zbulua gjatë gërmimeve të bëra para Çlirimit (shih D. Mustilli, vep. cit., f. 66. Më 1976 u kryen gërmime nga bërthama arkeologjike e Butrintit dhe punime restaurimi nga G. Pani. i cili zbuloi dhe hyrjen e dytë.

20) Nuk përjashtohet mundësia që kjo formë ishte më e përshtatëshme për shkarkimin e forcave, që krijoheshin gjatë punës së makinave të luftimit të vendosura mbi kulla.

21) Shih A. Baçe, **Vështrim mbi qendrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos,** «Monumentet», 4, 1972, 109.

22) Një vendosje e tillë ndeshet edhe në Amantia, në murin mbajtës, poshtë murit me kontraforte të anës v. Shih N. Ceka, **Qendrat e fortifikuara...,** f. 28.

ballë 0,82 dhe kanë në anë vija peshimi. I gjithë ky trakt muri dallohet nga pjesa tjetër e ndërtimeve te Butrintit IV nga trajtimi më pak i fryrë i faqeve, kombinimi i formave më të rregullta katërkëndëshe me ato poligonale dhe lartësia më e madhe e rreshtave. Ka mundësi që për këtë të ketë luajtur rol ripërdorimi i materialit nga muri i vjetër.

Gjithashtu te bie në sy mungesa e mbrojtjes në hyrjen V, ndërsa ajo VI, e njëkohshme me të, përforcohet nga dy kulla. Ka mundësi që të kemi të bëjmë jo me një hyrje direkte, por një të tillë të brendshme, brenda një oborri të fortifikuar. Pjesë e tij duket se është një fragment muri me një portë me hark në j.p. të hyrjes 5.

Përveç murit rrethues, së njëjtës periudhë ndërtimi i takon edhe muri mbajtës në anën l. të teatrit, i cili karakterizohet nga përdorimi i blloqeve të gjata trapezoidale, rreshtimi izodomik me lartësi 0,28 — — 0,37 m dhe përdorimi i kontraforteve (Fig. 7).

Një teknikë të ngjashme punimi e gjejmë edhe në një mur në p. të teatrit dhe në një banesë në j. të Portës së Liqenit. Kjo na bën të mendojmë, se kjo periudhë ndërtimi përkon me një fazë të lulëzimit të qytetit dhe njëkohësisht të një kohe, kur ndihej një rrezik i jashtëm.

Për datimin e kësaj periudhe na shërben si **terminus ante quem** koha e mbishkrimeve më të hershme të teatrit. Në përgjithësi është pranuar mendimi se ato i takojnë fundit të shek. III p.e. sonë[23]. Vetë përmendja e koinonit të prasaibëve në këto mbishkrime ka të bëjë me gjendjen politike pas vitit 232, kur u krijuan koinone autonome në kuadrin e Republikës skllavopronare të Epirit[24]. Kjo është edhe koha kur presioni i shtetit ilir në këtë trevë merr formën e ndërhyrjes së armatosur me fushatën e vitit 230 kundër Foinikës dhe me vendosjen e garnizonit ilir në Korkyrë[25]. Në këto ngjarje Butrinti nuk përmendet, por është logjike që ai t'i ketë reflektuar ato nëpërmjet ripërtëritjes së fortifikimit të tij.

Në këtë rast është me interes shqyrtimi i shtrirjes gjeografike të koinonit të prasaibëve, duke u mbështetur në shpërndarjen e qendrave të fortifikuara. Vendosja e tyre në një hark të jashtëm që kalon nga Dema në Karailibej, Vagalat dhe Çukën e Ajtojt, shënon edhe kufirin e territorit prasaib (Tab. I).

Një hark i dytë fortifikimesh të tipit kullë si Qenurio, Malathreja, Katoaitoj lidhen me mbrojtjen e rrugëve, që të çojnë në qendër të koinonit.

Ky sistem fortifikimesh, që mbyllte një territor të përcaktuar nga pikëpamja gjeografike, është mjaft homogjen edhe nga pikëpamja arkitektonike.

Çuka e Ajtojt, që përbën qendrën e dytë të rëndësishme të prasaibëve ka qenë objekt gërmimesh dhe kemi për të edhe një përshkrim të murit rrethues[26]. Megjithatë e shohim të nevojshme të japim një tabllo më të plotë të këtij fortifikimi.



Fig. 7



Fig. 8

23) L.M. Ugolini, **vep. cit** f. 206-208
Dh. Budina, K. Bozhori, **vep. cit.**, f. 156.
24) P. Cabane, L'Epire Besançon, 1976, f. 386-389.
25) J. Islami, **Vendi dhe roli i shtetit ilir në botën mesdhetare** «Kuvendi I i studimeve ilire» I, 1974, f. 98-99.
26) Dh. Budina, Harta..., f. 317-319.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 9

Kodra në formën e një koni, që ngrihet në skaj të fushës së Vrinës, pritet gjatë anës veriore nga një rënie shkëmbore, ndërsa drejt jugut zbresin tarraca të përshtatshme për banim. Në këtë anë shtrihej edhe vendbanimi në një sipërfaqe rreth 5 ha dhe gjatësi të mureve rrethuese 1400 m. Një vrojtim i planimetrisë



nxjerr në dukje se ai ndanej në dy pjesë jo të barabarta (Tab. IV). Kurora e kodres qarkohet nga një mur, i cili karakterizohet nga linja zigzage dhe mungesa e pjesë e kullave. Në drejtim të perendimit zbresin prej tij dy mure paralele, që zgjerohen për të përfshirë një tarrace, ku gjendet një godinë e madhe. Është e qartë se kemi të bëjmë me një zgjerim më të vonë të qytetit,[28] gjë që mbeshtetet edhe nga rutja në përdorim e kullave për mbrojtjen e mureve dhe të hyrjes. Kjo gjë të kujton shtesën lindore të qytetit të Amanties[29].

Në pjesën e vjetër të mureve të qytetit vërehen në sipërfaqe katër hyrje. Hyrja I (Tab. III, d) në anën p. ka korridor paralel me murin me gjatësi 4,70 m dhe gjerësi 3,10 m (Fig. 8). Hyrja II (Tab. III, c) ka në parim të njëjtën skemë planimetrike, por thyerja e linjave të mureve ka krijuar një mbrojtje më të mirë të korridorit, që nuk të fut drejtpërdrejt në kështjellë. Hyrja III (Tab. III, f) është një deriçkë me gjerësi 1,50 m, që përshkon me një zigzage trashësinë e murit, në të njëjtën mënyrë si në Pepel[29]. Edhe hyrja IV (Tab. III, e) mund të themi se ka në bazë skemën e korridorit paralel me murin rrethues, veçse largësia ndërmjet dy mureve është më e madhe. Për këtë arsye porta kufizohet me dy mure anësore në një hapësirë prej 2 m. pas së cilës zgjerohet korridori. Ky tip hyrjeje ndodhet edhe në periudhën I të Amanties[30].

Pjesa e shtuar e fortifikimit ka një hyrje nga p. të vendosur pas një kthese të murit rrethues, që krijonte një mbrojtje të mirë në krahun e majtë[31]. Në anën e kundërt hyrja mbrohej nga një kullë katërkëndëshe me dalje, 2,20 m dhe ballë 7,60 m (Tab. III, g). Një hyrje e vogël ballore (V) gjendet në anën e kundërt, pas një kthese këndrejtë të murit rrethues. Kjo pjesë e fortifikimit përforcohet në këndin p. nga një kullë katërkëndëshe 7 x 4 m. (Nr. 1) dhe në anën l. me një kullë në formë sektori rrethor (Fig. 9).

Për sa i përket teknikës së ndërtimit, fortifikimi i vjetër i Çukës së Ajtojt është realizuar me poligonal të rreshtuar, që kalon në trapezoidal me rreshta të thyer me faqe gurore ose të rrahur me çekan. Muri i gjatë në të dyja anët e hyrjes I është vendosur mbi shkëmb ose duke përdorur si bazë një rresht gurësh

27) H. Hammond, Epirus, f. 94 e ka shpjeguar gabim këtë fenomen, duke përfytyruar një mur të brendshëm qarkues, i cili nuk ekziston.
Dh. Budina, **Harta...** f. 317, nuk e ka dalluar fare këtë ndarje.

28) N. Ceka, Qendrat e fortifikuara.... f. 25.

29) A. Baçe, **vep. cit.,** f. 107. Kjo ngjashmëri dhe qenie e një kulle në Pepel tregojnë se fortifikimi është i periudhës qytetare dhe jo prehistorik, siç mendon autori.

30) N. Ceka, **Qendrat e fortifikuara....,** f. 27.

31) Dh. Budina, **Harta..** f. 317, nuk e ka dalluar këtë hyrje dhe quan gabimisht si hyrje kryesore portën me qemer të rremë të një muri tarracimi.

pak të punuar, që dalin 0,10 - 0,15 m jashtë. Bllo-qet poligonale me faqe gurore, janë vendosur në rreshta me përdorim të shpeshtë shkallëzimesh dhe pykash, ndërsa te qoshet në krah të djathtë të hyrjes është përdorur trapezoidali me rreshta të thyer. Të dyja qoshet janë të peshuara dhe një vijë tjetër peshimi është krijuar në murin e majtë të korridorit.

Gjatë gjithë anës v. muri është poligonal dhe i tillë vazhdon edhe me anën I. Pas kthesës në pikën F poligonali i rreshtuar shoqërohet me trapezoidalin me rreshta të thyer (Fig. 10). Po kështu ndërmjet G – H kemi një trakt të gjatë trapezoidal me përdorim të shpeshtë shkallëzimesh dhe mbushjesh trekëndëshe apo katërkëndëshe, që të kujton muraturën e Klosit.

Pas kthesës në pikën H muratura poligonale kalon në një trapezoidal izodomik me lartësi rreshti 0,50–0,52 (Fig. 11). Kthesat në formë dhëmbësh sharre janë punuar gjithmonë me trapezoidal, ndërsa pas tyre vazhdon muratura poligonale (Fig. 12). Ndërmjet tyre muri bën disa ngjitje prej 3 m dhe pastaj zbret përsëri, gjë që tregon se ato kishin funksion përforcimi.

Trashësia e murit është 3,50 m me ndarje tërthore çdo 3,50 m, por gurëlidhësit nuk dallohen rregullisht në fasadë. Në faqet e murit janë përdorur vija peshimi.

Shtesa perëndimore e kështjellës është ndërtuar me të njejtën teknikë, por më me pak kujdes. Në anën j. të saj muri është vendosur pjesërisht mbi shkëmbin e punuar dhe kalon nga trapezoidali në kullën 3 në poligonal të rreshtuar dhe përsëri në trapezoidal me mbushje të ralla pykash. Punimi i faqes së gurëve është bërë me çekan dhe është lënë më i fryrë se në fortifikimin e vjetër. Gjithashtu vijat e bashkimit nuk kanë atë puthisje të përsosur si më parë.

Kjo pjesë e fortifikimit lidhet me godinën e madhe, që mund të jetë një pallat, e cila është gërmuar pjesërisht. Për ndërtimin e saj është përdorur muratura poligonale e vërtetë me faqe të sheshta, ndërsa njëra prej hyrjeve, që përshkon murin e tarracimit, është mbuluar me qemer të rremë diedër. Gërmimet e kanë datuar këtë godinë në fund të shek. IV dhe fillimin e shek. III p.e. vonë[32]. Kjo na shërben si datë edhe për datimin e mureve të shtesës dhe na jep të drejtë të mendojmë për pjesën kryesore të



Fig. 10

kështjellës një kohë më të hershme rreth mesit të shek. IV p.e.sonë. Këtë do ta mbështeste edhe ngjashmëria e teknikës së ndërtimit me atë të Butrintit II, me të cilën ka të përbashkët edhe mungesën e kullave, përdorimin e kthesave dhëmbë sharre dhe tipin e hyrjes me korridor paralel me murin[33].



Fig. 11

32) Dh. Budina, **vep. cit.,** f. 320, citon raportin e H. Cekës për datimin e materialeve në fund të shek. IV, fillimin e shek. III p.e. sonë, por këto nuk mund të shërbejnë si **terminus** për të gjithë vendbanimin, me që vijnë vetëm nga pjesa e shtuar e tij.

33) Këto veçori janë vënë në dukje nga S. Islami, **Problèmes de chronologie de la cité illyrienne,** «Agloméroations fortifiées illyriennes», Sarajevo 1975, f. 42 që e klasifikon Çukën e Ajtojt në tipin e parë të fortifikimeve me muraturë poligonale.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 12



Fig. 13

Shtegu ndërmjet liqenit dhe Malit të Milesë, që të çon në fushën e Vrinës, zotërohet nga kodra e Karaalibejt, mbi të cilën ngrihet një fortifikim antik. Ne e njohim atë sipas përshkrimit të Hammondit dhe Dh. Budinës. I pari[34] ka vënë re dy trakte në anën p. dhe j. të kodrës, gjë që të bën të mendosh për një kështjellë. Sipas Hamondit muratura katërkëndëshe nuk e ruan rregullisht rreshtimin dhe janë përdorur pykat për mbushjen e boshllëqeve. Dh. Budina jep vetëm një mur nga ana j.p. me blloqe paralelopipede, të punuar trashë në faqe dhe me një puthitje jo fort të mirë. Në bazë të teknikës së ndërtimit ai e daton në shek. IV-III p.e.sonë. Autori jep edhe një fotografi, nga e cila duket se muratura është trapezoidale me rreshta të thyer me faqe guroreje dhe përdorim të shpeshtë shkallëzimesh e pykash. Si e tillë ajo qëndron krahas ndërtimeve analoge të Butrintit III dhe Çukës së Ajtojt I.

Në sistemin e përbashkët të mbrojtjes së territorit prasaib Karaalibej luante rolin e një kështjelle dhe njëkohësisht është një vendbanim që nga rëndësia vinte pas Butrintit dhe Çukës së Ajtojt.

Rruga tjetër për në territorin prasaib, që vinte nga veriu gjatë bregdetit, kontrollohej nga muri i Demës, i cili e ndërpriste gadishullin e Ksamilit në vendin më të ngushtë. Muri, që fillon në bregun e liqenit, i ngjitet kodrës në vendin ku gjendet sot manastiri i shën Gjergjit dhe zbret që aty në bregun e detit Jon[35].

Nga ana e liqenit ruhet vetëm një këmishë e murit me gjerësi 2,20 m, ndërsa në majë, ku duhet të ketë qenë hyrja, matet një gjerësi 7 m e murit. Gurët janë katërkëndësh të mëdhenj (deri 2,90 x 1,10 m), faqe janë të sheshta, brinjët anësore disa herë të pjerrta. Në mes të faqes perëndimore ka një trakt të ruajtur, ku gjerësia e murit arrin në 9,60 m[36]. Në strukturën e tij dallohen dy këmisha, secila me gjerësi 2,80 m si dhe mbushja prej 5 m, mbi të cilën, me sa duket, kalonte rruga për lëvizjen e ushtarëve në rast lufte. Çdo 3-4 m mbushja, që është bërë me gurë të vegjël, përshkohet nga ndarje tërthore. Blloqet e gurëve në fasadë janë katërkëndësh me faqe të sheshtë. Rreshtat janë izodomike me lartësi 0,75-0,81 m me përdorim të rrallë shkallëzimesh (Fig. 13), por më poshtë ndryshojnë përsëri lartësitë e gurëve, të cilët arrijnë përmasa gjigante (2,67 x 1,53 m). Vihet re se murit i është dhënë pjerrësi nga brenda.

Muri përfundon rreth 20 m mbi bregun e detit me tërë gjerësinë e tij prej 9,20 m (Fig. 14), që luan në këtë mënyrë rolin e një kulle, që kontrollon hapësirën e kufizuar poshtë saj[37]. Të tetë rreshtat e ruajtur ka-

34) Epirus, f. 98-99.

35) L.M. Ugolini, **L'Albania Antica,** I, 1927, f. 151, jep një përshkrim të mangët dhe e interpreton gabimisht murin si një barrierë të gadishullit. N.G.L. Hammond, **Epirus,** f. 99, ka parë pjesën p. të tij dhe vetëm e tipizon nga pikëpamja e teknikës së ndërtimit si katërkëndësh me blloqe të mëdhenj me faqe të sheshtë.

36) Dh. Budina, **Harta...** f. 290 e jep gjerësinë e murit vetëm 4 m.

37) Ugolini, **Alb. Ant.** I, f. 151 e ka marrë këtë pjesë gabimisht si kullë, gjë që e përsërit edhe Dh. Budina, **Harta...,** f. 290



Fig. 14

në një pamje izodomike me lartësi 0,70 m dhe shkallëzohen duke lënë një prag për të penguar lëvizjen e blloqeve si në murin e akropolit në Apoloni[38].

Funksioni i këtij muri del i qartë po të shikohet në gjithë kompleksin e mbrojtjes së territorit prasaib, ku ai përbën pjesën më perëndimore të rrethit të jashtëm të fortifikimeve. Sidoqoftë në kuadrin e këtyre fortifikimeve ai dallohet nga stili i veçantë; muratura katërkëndëshe me faqe të sheshtë nuk ndeshet në asnjë fortifikim tjetër prasaib, ndërsa në Kaoni ai gjendet vetëm në një shtesë të fortifikimit të Borshit[39], e cila nuk duhet të jetë më e hershme se shek. III p.e.sonë.

Në brezin e parë të fortifikimit të territorit prasaib bën pjesë edhe kulla e Vagalatit, e cila kontrollon një shteg, që ngjitet nga lindja për në malin e Milesë dhe vrojton rrugën, që futet nga Pavlla nëpër grykën e Bogazit. Ky vend strategjik zihej më parë nga një fortifikim prehistorik, i cili përfshin pjesën më jugore të malit brenda një muri 170 m të gjatë. Ana p. e tij është lënë e hapur, meqë shkëmbi, që bie thikë mbi grykën e Bogazit, përbënte një mbrojtje të sigurtë natyrore. Giatë murit, që kalon në formë harku në anën lindore, ka vetëm një hyrje ballore dhe mungojnë krejtësisht kullat (Tab. V, 1). Muri ka gjerësi 3,30 m, me dy paretet dhe mbushjen prej gurësh të vegjël. Në fasadë të bie në sy një vendosje e shrregullt e blloqeve krejt të papunuara, që kombinohen me pjesë të tëra prej gurësh mesatarë dhe të vegjël (Fig. 15).

Lartësia e ruajtur e murit nuk e kalon 1,10 m dhe nga materiali i rrëzuar kuptohet se muri nuk ka qenë shumë i lartë, sepse shërbente vetëm si gjoks mburoje.

Brenda fortifikimit nuk gjenden gjurmë banesash apo keramike.

Rreth 100 m në l. të këtij fortifikimi kapet fillimi i një muri perpendikular me vijat rushkulluese, i cili pas 24 m përfundon në një kullë katërkëndëshe 9,50 x x 6,55 m. (Tab. V, 2), Ruhet kati i parë i kullës (Fig. 16) me një hyrje 1,25 m të gjerë nga j.l. Në tri anët e tjera ka nga një frengji për shigjeta në lartësi 1 m nga dyshemeja. Gjerësia e frengjive është e ndryshme, por ato janë trajtuar njëlloj, duke u kufizuar anash prej pllakash guri dhe mbulohen nga gurët e radhës që vjen sipër.

Trashësia e murit të kullës prej 1,20 m formohet nga dy blloqe gjatësore ose një tërthor, të vendosura pa një rregull të caktuar. Blloqet kanë forma trapezoidale me punim të fryrë të faqes. Rreshtat janë paralelë, me shkallëzime të rralla, që e ndryshojnë lartësinë e tyre nga 0,35 në 0,45 m; ka edhe dy rreshta me pllaka për nivelim, por përshtypja është izodomike. Balli i kullës, që sheh nga pjerrësia, është shkallëzuar deri në lartësinë e ruajtur dhe në qoshet janë gdhendur kanale peshimi. Po në të njëjtën mënyrë është punuar edhe muri i gjatë, funksioni i të cilit është krijimi i një platforme të mbrojtur në shpinë të kullës, në të cilën mund të qëndronin më shumë luftëtarë se në kullë. Gjithashtu ajo përbënte një rrugë të sigurtë për të zënë me shpejtësi edhe kreshtën mbi grykën e Bogazit. Përveç një shkalle anësore të vendosur 4,80 m nga hyrja e kullës, duket se kalimi nga kulla në mur bëhej edhe drejtpërdrejt.

Ky fortifikim i tipit kullë është i lidhur vërtet me vrejtimin e luginës së Pavllës, siç mendojnë Hamondi dhe Dh. Budina[40], por këtë funksion ai e kryen në sistemin e përgjithshëm të fortifikimit të territorit prasaib. Vetë vendosja e kullës tregon se aty kalon një farë kufiri ndërmjet këtij territori dhe pjesës tjetër të trevës kaone.

38) H. Ceka, **Të dhëna paraprake mbi gërmimet në Apolloni,** Buletin Arkeologjik, 1, 1969, f. 78.

39) J. Koçi, **Raport mbi punimet e pastrimit në murin rrethues të Kalasë së Borshit,** Arkivi i Qendrës Arkeologjike, Tiranë 1976.

40) **Epirus,** f. 96; **Harta....** f. 317.

DO NOT COPY

Në qoftë se muri i Demës, Karaalibej, Vagalati dhe deri diku Çuka e Ajtojt përbëjnë rrethin e parë të mbrojtjes së territorit kaon, ka edhe një rreth të dytë të përbërë vetëm nga kulla, të cilat kontrollojnë rrugët e brendshme të këtij territori. Më përfaqësuese prej tyre është fortifikimi i Malathresë në rrugën, që të shpie nga Çuka e Ajtojt në Butrint. Në zgjidhjen planimetrike ai përfaqëson një farë oborri të fortifikuar me sipërfaqe 0,42 ha[41], që ndahet në tri pjesë prej



Fig. 15



Fig. 16

dy mureve të brendshme; një ambient i katërt, i përzgjatur ngjitet me të nga ana e veriut. Muret pothuaj janë rrafshuar dhe mbi sipërfaqe ruhet krahu i djathtë i një porte, që lidh oborrin e parë me të dytin. Gjerësia e saj është 1,40 m dhe në lartësinë 1,96 m ruhet blloku i parë i qemerit të rremë. Në anën v.l. të oborrit të tretë ruhet një kullë katërkëndëshe 5 x x 2,50 m (Fig. 17). Muri i saj qëndron mbi një cokol prej dy radhësh, që dalin 0,15 m nga plani vertikal i murit. Mbi to vijnë 11 radhë të tjera izodomike me lartësi rreth 0,40 m. Blloqet janë trapezoidale gëlqerore, me faqe të punuar me fryrje. Në qoshet e kullës janë gdhendur kanale peshimi. Në territorin brenda mureve gjenden mjaft fragmente keramike të shekujve të fundit p.e.sonë.

Të bie në sy ngjashmëria e plotë e stilit të ndërtimit ndërmjet Vagalatit dhe Malathresë nga njera anë me ndërtimet e Butrintit IV nga ana tjetër. Në të tria rastet kemi përdorimin e trapezoidalit izodomik me faqe të fryrë, me përdorim të rrallë shkallëzimesh, në një kohë kur kulla ka zotëruar në formulimin arkitektonik të fortifikimeve. Nga kjo pikëpamje duhet të pranojmë se ato janë realizuar në të njëjtën periudhë, në zbatim të një koncepti të vetëm mbrojtje.

41) Dh. Budina, **Harta...**, f. 322-323.

DO NOT COPY



Fig. 17

* * *

Analiza arkitektonike e fortifikimeve na ndihmon të krijojmë një tabllo të përgjithshme për procesin e urbanizimit në territorin prasaib, i cili zhvillohet në tri etapa kryesore.

Në etapën e parë kemi tri fortifikime prehistorike; Butrintin, Kalivonë[42] dhe Vagalatin I. Nga vendosja e tyre dhe veçanërisht nga kontrolli i grykës së Bogazit kuptohet se ato lidhen në një sistem të vetëm mbrojtjeje përreth fushës së Vrinës. Së bashku me territorin malor, që e kufizonte nga lindja dhe jugu ajo përbënte territorin e një njësie politike, të lindur në etapën e shthurrjes së rendit fisnor. Ende nuk kemi të dhëna të sakta për kohën e ngritjes së këtyre fortifikimeve, por nga teknika e ndërtimit mund ti vendosim përgjithësisht në periudhën e parë të hekurit.

Faza e dytë i takon periudhës qytetare dhe paralajmërohet në sistemin e fortifikimit nga shfaqja e muraturës trapezoidale – poligonale me faqe të sheshtë të Butrintit II. Në këtë fazë kemi formimin e plotë të të tri vendbanimeve qytetare: Butrinti, Çuka e Ajtojt dhe Karaalibej. Krijimi i tyre është i lidhur me procesin e natyrshëm të zhvillimit të marrëdhënieve skllavopronare në Epir. Që ky është një proces i vrullshëm, e tregon lindja e njëkohshme me të njëjtën teknikë ndërtimi dhe veçori planimetrike e tri vendbanimeve të mësipërme. Kjo ngjashmëri shtrihet edhe në një radhë qendrash të tjera të Kaonisë si Foinike, Ripësi[43], Borshi dhe Himara.

Të dhënat e Butrintit na ndihmojnë për ta datuar krijimin e këtyre qendrave rreth mesit të shek. IV p.e. sonë.

Faza e tretë e procesit urban në Butrint lidhet me etapën e fundit të lulëzimit të rendit skllavopronar në Epir. Rënia e monarkisë dhe krijimi i Republikës Epirote u dha mundësi grupeve lokale të skllavopronarëve të forcojnë ndikimin e tyre në krahinat përkatëse. Mbi këtë bazë u ndërtua një sistem politik republikan, që merrte parasysh autonominë e territoreve të veçanta, që njihen me emrin koinone. Një nga këta është edhe koinoni i prasaibëve. Përveç qyteteve të vjetra, në kufijtë dhe rrugët e këtij koinoni ngrihen një radhë fortifikimesh, që i garantojnë atij mbrojtjen në kushtet e turbullta politike, që pasojnë vitin 232.

Këtu duhet marrë parasysh edhe faktori i jashtëm politik, në ndërhyrjen e armatosur të shtetit ilir mbi këto zona në vitet 231-230. Pushtimi i Foinikës dhe vendosja e garnizonit ilir në Korkyrë kanë kërkuar forcimin e mbrojtjes së territorit prasaib dhe me këtë mund të lidhet ngritja e murit të Demës dhe kullave të Vagalatit, Malathresë, Qenurios etj.

Edhe periudha që pasoi deri më 168, ka favorizuar këtë proces dhe nuk përjashtohet që një pjesë e fortifikimeve të Butrintit, që dallohen stilistikisht brenda kësaj faze, të jenë ndërtuar pikërisht në këtë kohë.

42) Për Kalivonë shih Dh. Budina, **Harta...,** f. 324-325. Kthesat në një kënd të ngushtë, rrafshimi i faqes së jashtme dhe kujdesi për pushitjen e gurëve e afrojnë këtë fortifikim me fazën Butrint II.

43) Për Ripesin shih Dh. Budina, **Kalaja e Ripësit,** «Iliria» I, 1971, f. 69-81. Nga fotografitë duket se kemi të bëjmë me trapezoidal me rreshta të thyer, që shoqërohet me poligonalin si në Butrint dhe Çukën e Ajtojt. Nga planimetria del e qartë se ka një fazë të parë të një vendbanimi të periudhës së parë të hekurit, me planimetri rrethore, me një hyrje në kënd të drejtë si e Mbolanit. Pjesërisht ai është përdorur në fortifikimin e periudhës qytetare, si një ndarje akropoli, ndërsa pjesa tjetër ka mbetur pa funksion jashtë tij. Kjo e fundit është konsideruar nga Dh. Budina si kullë e rrumbullakët më e vonë.

DO NOT COPY

TAB. I



DO NOT COPY

FORTIFIKIMI ANTIK I BUTRINTIT
(PERIUDHAT E NDERTIMIT)



DO NOT COPY

TAB. III



DO NOT COPY

ÇUKA E AJTOIT –



DO NOT COPY

FORTIFIKIMI PREHISTORIK I *Bogazit*



KULLA E *Vagalatit*



DO NOT COPY

Neritan CEKA

LA FORTIFICATION ANTIQUE DE BUTRINT ET LE TERRITOIRE DES PRASAIBES

DO NOT COPY

RESUME

Si quelqu'un désire dreser un tableau du développement d'un centre antique sur le plan des fortifications, Butrint lui offre un exemple très évident, du fait qu'ici l'évolution urbaine s'associe au développement de la technique de construction des murs de la ville et à la création de tout un système défensif s'étendant à toute la région des Prasaïbes, dont Butrint était le chef-lieu.

En dehors de Butrint, qui était le chef-lieu de ce territoire, comme l'atteste son importance même, les monuments qui s'y trouvent et les inscriptions du koïnon, il y avait dans cette région, à Çukë d'Ajtoj, une autre agglomération urbaine importante et une série de petites fortifications comme celles de Karaalibej, Vagalat, Qemurio, Katoajtoj et le mur de Deme.

En ce qui concerne les fortifications de Butrint, Ugolini s'est efforcé de donner le schéma planimétrique de la ville et de procéder à la classification typologique des murailles et à leur datation. Mais son schéma reste dans sa plus grande part hypothétique, du fait qu'il reconstruit le tracé sur la base de tronçons détachés n'ayant aucune connexion typologique entre eux. Hammond, qui a soumis à un examen critque les conclusions d'Ugolini, n'accepte pas avec raison le deuxième mur d'enceinte, mais il va trop loin quand il nie aussi l'existence du mur méridional de l'Acropole, qui, à son avis, est un mur de soutènement.

Le défaut essentiel de cette classification consiste dans le fait que la répartiton des types se fonde seulement sur la forme de la pierre, ce qui a eu comme conséquence l'attribution de constructions successives d'une même période à des temps différents.

Hammond aussi se fonde sur cette même conception, mais dans un sens opposé, en simplifiant les styles sur la base de la forme des pierres. En conséquence, tant la description que l'interprétation actuelle de la fortification de Butrint ne répondent pas à la réalité et ont entraîné une confusion nocive dans le domaine de l'étude des fortifications anciennes de notre pays. Voilà porquoi il est indispensable de procéder à un nouvel exposé, en grandes lignes et sous un angle critique, de toute le matériel connu.

Nous comencerons par examiner le développent urbaniste de la ville de Butrint, come cela se reflète dans ses murs d'enceinte.

A ses débuts la vie à Butrint s'est développé dans la partie plus élevée de la colline, où l'on a aussi récupéré des couches de matériaux corinthiens des VIIe-VIe siècles av. n.è.

Les contours de cette agglomération urbaine étaient limités sur tout le côté par des roches escarpées, tandis que les tronçons détachés qui ont été utilisés à nouveau dans le soubassement du mur moyenâgeux sur les côtés E et S nous induisent à raison de penser que le tracé suivait une ligne approximative a celle du mur moyenâgeaux sur une longueur de 300 m environ, en couvrant de la sorte une surface de près de 0,4 Ha.

De par la nature même de la couche culturelle et de l'emplacement limité de l'agglomération urbaine, que nous allons dénommer Butrint I, il apparaît clairement que nous sommes en présence ici d'une phase préurbaine comportant toutefois des signes évidents du processus urbain en plein développement. Les nouveaux traits qu'étaient en train d'acquérir cette agglomération urbaine sont représentés par les reconstructions partielles du mur existant, et cela à travers une technique plus avancée pour l'époque. Pour le complètement des angles ont été employées de petites pierres de forme triangulaire, dont les faces extérieures sont aplaties. Du point de vue typologique, nous sommes en présence d'un maçonnerie trapézoïdale-polygonale à faces aplaties assez proche de celle «trapézoïdale irrégulière» de Scranton, que l'on continue d'employer dans les régions voisines de la Grèce pendant le Ve siècle av.n.è. Chez nous une maçonnerie pareille se trouve à Amantie, toutefois avec des éléments techniques plus avancés, comme le sont les tronçons de différentes formes quadrangulaires et l'équarissage latéral des pierres. Voilà pourquoi le mur trapézoïdal-polygonal de Butrint doit appartenir à une période de temps antérieure à la première moitié du IVe siècle, qui est la date certaine du mur analogue d'Amantie.

Le développement plus poussé de l'agglomération fortifiée de Butrint s'associe à la création d'un système entièrement nouveau de fortifications.

D'une longueur de 870 m, les murs circonscrivaient une surface de près de 4 hectares. La ligne de ces murs se caractérise de détours continus à angle obtus ou aigu, leur confèrent l'aspect des dents d'une scie. En l'absence de tors, leur fonction est remplie par des saillies en forme de bastion. Les entrées

DO NOT COPY

sont amenagées dans le mur et l'endroit appropriés, conformément aux exigences de la vie citadine.

La Porte Nº 1 (Fig. 3), connue sous le nom de Porte du Lac, représente un schéma planimétrique de la variante à entrée frontale, qui est typique pour les agglomérations de la période préurbaine (Tab. III a). En vue de garantir une protection meilleure, sur le côté gauche de l'entrée le mur d'enceinte forme une saillie de 2 m, en constituant de la sorte une espèce de bastion long de 20 m environ.

En ce qui concerne la Porte Nº 2, connue sous le nom de Porte du Lion, elle se caractérise par un schéma plus élaboré à travers le couloir aménagé entre les flancs parallèles du mur (Tab. III, b). Un schéma planimétrique identique caractérise la Porte Nº 3 sur le côté septentrional.

Quand à la porte Nº 4, située sur le côté occidental, elle représente du point de vue de la planimétrie une variante de la Porte du Lac avec un bastion sur son côté droit.

Parmi les autres éléments de la planimétrie mentionnons encore un bastion sur le côté septentrional et une denture à pointe acérée sur le côté SE, qu'Ugoloni a dénommé par erreur bastion.

La planimétrie de la troisième période de construction se présente, plus compliquée: on relève une évolution de la technique dans le contexte même du style trapézoïdal. Les tronçons plus représentatifs, se trouvant à la Porte du Lion et dans sa partie occidentale, sont construits avec des blocs trapézoïdaux à plusieurs degrés et à face de carrière. Les rangées en constante inclination ont une hauteur variant de 0,50 à 0,80 m. Leur liaison intérieure est réalisée à chaque deux rangées sur une hauteur de 2.20 m, mais non pas d'une manière entièrement verticale (Fig. 3). La largeur du mur est 3.80 m.

Par ailleur, cette muraille se caractérise par sa tendance au polygonal, ce qui apparaît clairement dans les parties conservées de cette enceinte au-dessus du théâtre. Le mur placé sur les roches constitue un passage graduel du trapézoïdal à rangées inclinées au polygonal avec des blocs de pierre à face de carrière (Fig. 4).

En conséquence la maçonnerie de Butrint peut être qualifiée de trapézoïdale, avec des rangées de blocs inclinés à face de carrière. Elle représente un développement plus poussé par rapport au trapézoïdal aux faces aplaties de Butrintit II, en y employant de nouveaux éléments come la liaison intérieure par des parois de séparation, ou encore les faces non équarries de la façade, qui lui confèrent un aspect ruvide. Cette technique se retrouve dans plusieurs autres centres chaoniens comme Finiq, Çuka d'Ajtoj, Borsh, Himare, etc., et hors de ce territoire dans celui des Amantins, dans la forteresse de Mavrove.

La deuxième muraille de Butrint est satisfaisante du point de vue militaire, mais elle présente un défaut du point de vue urbaniste, en ce qu'elle détache la ville de son principal artère économique, Vivar. Par ailleurs, une telle disposition limite beaucoup l'espace destiné aux constructions.

Par suite du développement ultérieur de la ville, il a fallu exploiter à cette fin les terrains situés entre le mur de l'Acropole et Vivar et construire, dans le même temps, une nouvelle fortification de ce côté. Ce qui a été réalisé par la mise en place d'un nouveau tracé du mur d'enceinte, se ramifiant de l'ancien à la Porte Nº 6 pour déboucher devant le théâtre.

Dans cette zone l'ancienne ligne du mur a été détruite et ses matériaux furent employés de nouveau.

Le théâtre, lui aussi, est une construction de cette période, parce qu'il a été élevé après avoir détruit le tracé de la deuxième muraille, dont il ne reste que des tronçons au-dessus du théâtre. Le mur de soutènement de celui-ci se caractérise sur le côté NE par une technique analogue à celle du mur d'enceinte; ces deux murs utilisent en commun les contreforts.

Dans le même temps, l'ancien tracé du mur d'enceinte a été reconstruit en partie.

La Porte Nº 6 (Tab. III, c) est une construction entièrement nouvelle de cette période, du fait que sa jonction au tracé du mur de la période Butrint II se distingue clairement. Même du point de vue planimétrique elle représente un schéma plus avancé, s'adaptant à la guerre avec des machines d'encerclement utilisées sur une terrain plat.

Un tronçon relativement long de cette période indique la reconstruction du mur SO de l'ancienne acropole, qui, à ce qu'il semble, a été allongé en direction NE jusqu'à sa conjonction avec le mur extérieur. C'est ainsi qu'a été éliminée l'ancienne acropole et que la surface de Butrint a été divisée en deux parties, que nous pouvons appeller la ville haute et la ville basse.

En ce qui concerne les constructions de Butrint III, elles furent réalisés selon la maçonnerie de type trapézoïdal isodomique. Le tronçon plus représentatif aux points B-C a été construit avec des blocs de pierre longs trapézoïdaux d'une hauteur de 0,35 m. La disposition en rangées est de nature isodomique, sans l'utilisation d'échelonnements; la face des pierres a été travaillée avec un marteau pour lui donner une forme enflée. La liaison intérieure a été réalisée par des séparations transversales se distinguant sur la façade à chaque 2.60 m. Sur la face du mur il y a une ligne à section triangulaire.

Une construction à part de cette même période est le mur s'élevant devant le théâtre (Fig. 8). Elles est conservée actuellement sur une ligne droite E.-O., sur les deux côtés d'une entrée frontale. La partie occidentale de ce mur devient polygonal par la disposition des blocs de pierre du côté de leurs face enflées, ce qui nous rappelle la maçonnerie analogue de la vallée de Drinos.

D'une épaisseur de 2.45 m, ce mur est traversé par des separations transversales auxquelles correspondent sur la face intérieurre des contreforts aménagés à chaque 3 m.

Voilà comment nous avons traité une hache ailée mise au jour au village d'Ungrej. Sa surface gravement endommagée était en bonne partie parsemée de vésicules. L'objet en question a été radiographié par des rayons X. Comme l'a indiqué la radiographie, le traitement complet de cette hache aurait entraîné l'élimination de certains de ses contours et créé un orifice dans sa partie supérieure. En présence de l'effet destructeur de la corrosion, il a été décidé de procéder au traitement de cette hache. Tout d'abord il a été chauffé au soufflet pour en faire évaporer les chlorures ferriques et ferreux, parce que nombre d'objets de ce genre sont traversés par la rouille en forme de coin et leur nettoyage superficiel ne suffit pas à rétablir la situation. Après le procédé électrolytique, la hache a acquis des contours analogues à ceux de la radiographie. Ensuite nous l'avons fait bouillir dans une solution d'eau ne contenant pas de sels et légèrement alcalinisée jusqu'à l'élimination totale des ions du C^-, SO_4^- et NO_3^-. Après son séchage au laque, elle a été plongée dans un bain de paraffine. Le modelage des contours abîmés et de l'orifice a été obtenu par leur traitement avec du «Duracril spécial», mélangé à du bioxyde de manganèse, ce qui a donné à l'objet en question une coloration noire mate presque analogue à celle du ferro-ferrite.

Cette méthode a pleinement justifié son emploi, parce que les objets traités depuis 5 ans selon ce procédé n'ont pas manifesté des symptômes de dégradation bien que conservés à une humidité relative variant de 90 à 98 pour cent.

Ces derniers temps nous avons appliqué avec succès la méthode du nettoyage mécanique des objets de fer, dont la patine est couverte d'une couche de minéralisation.

Citons encore le cas d'un clou découvert à Paleokaster. Tout d'abord il a été radiographié. Ensuite les enflures provoquées par la corrosion ont été éliminées avec une petite pierre de corindon maniable et les dépôts terreux très résistants au moyen d'une brosse en fil de fer circulaire. Le nettoyage, effectué jusqu'à la limite de la patine, a donné des résultats satisfaisants. Quant à la conservation de cet objet, nous avons appliqué le même procédé.

Quoique notre expérience en ce domaine est de courte durée, nous pouvons en dégager les conclusions suivantes:

1. La protection cathodique des objets archéologiques de métal, notamment de ceux en fer, est une mesure indispensable pour leur conservation.

2. En ce qui concerne les objets en fer, caractérisés par une corrosion en coin des cristaux, leur protection cathodique est inefficace si elle ne s'associe pas au traitement thermique.

3. Le traitement électrolytique ne s'applique qu'aux objets conservant dans un état satisfaisant leur noyau métallique.

4. Le paraffinage des objets métalliques est une mesure provisoire tendant à la protection des métaux de l'humidité de l'atmosphère. Leur meilleure protection se réalise toutefois par l'application des laques synthétiques.

5. En ce qui concerne la méthode de conservation suivie pour le nettoyage des bronzes dorés, il est difficile pour le moment d'en tirer des conclusions définitives étant donné la courte durée de temps écoulé depuis son application.

DO NOT COPY

Gjergj FRASHËRI

PROBLEMI I RESTAURIMIT TË OBORRIT TË FORTIFIKUAR TË KALASË SË KRUJËS

DO NOT COPY

Të rralla janë në Ballkan kalatë mesjetare të veshura me një lavdi aq legjendare sa ç'është Kalaja e Krujës. Si dëshmi e një lufte të shquar çlirimtare, Kalaja e Krujës në radhë të parë të imponon një respekt të madh historik. Merita kryesore e lavdisë së saj u takon pa dyshim luftëtarëve trima shqiptarë dhe kapitenit të tyre të pavdekshëm, Skënderbeut. Megjithatë nuk mund të mohohet kontributi që dhanë muret e kalasë së bashku me pozitën e saj në fitoret e bujshme që korrën shqiptarët në shek. XV. Si i tillë ky monument historik dhe arkitektonik, i cili për më tepër mbart në kompleksitetin e vet vlera artistike e ndërtimore shqiptare, i është nënshtruar prej disa vitesh një pune studimore për mirëmbajtjen dhe restaurimin e saj. Në këtë kumtesë do të parashtrojmë rezultatet e punës studimore të arritura deri tani mbi një nga komponentet e rëndësishme të këtij monumenti, mbi oborrin e fortifikuar të kalasë.

Kalaja e Krujës është ndërtuar mbi një kreshtë shkëmbore, e cila me siluetën e saj monumentale ka ngjallur te banori krutan ndjenjën e sigurisë. Veç kësaj natyra e ka pajisur kreshtën shkëmbore me dy artere uji të pishëm, një çështje aq jetike për një kala sa dhe pozita strategjike. Të dy burimet ndodhen në kuota më të ulëta se sipërfaqja e kreshtës — njëra në faqen veriore, tjetra në ekstremin perëndimor të saj. Burimi i parë, ndonëse pranë hyrjes së kalasë, ka mbetur gjithmonë jashtë mureve rrethuese. Edhe burimi i dytë sot ndodhet jashtë mureve në hapësirën që vendësit e quajnë «Tasllojë», nga turqishtja «tas» (kupë metalike), ndoshta nga se ky burim në kohën e sundimit osman ka qenë pajisur me kupë prej metali.

Me muret rrethuese të kalasë në shpinë dhe e rrethuar dikur me mure të forta në anën e jashtme, Tasllloja ka qenë kështu një lloj oborri i fortifikuar (fig. 1). I mbrojtur në këtë mënyrë brenda këtij oborri, burimi i Tasllojës i ka shërbyer kalasë në çdo kohë. Sot muri i jashtëm i oborrit është krejtësisht i degraduar, sa ka humbur edhe formulimi i tij planimetrik. Sipas kritereve të restaurimit gjendja e tij klasifikohet në kategorinë e **rrënojës historike.** Kanë mbetur në këmbë vetëm tri fragmente muresh, të cilat të bindin se oborri i fortifikuar zinte një vend të rëndësishëm në konceptimin arkitektonik të kalasë (fig. 2). Evidentimi i këtij oborri bëhet i domosdoshëm për përfytyrimin e tërësisë së monumentit, prandaj nevojitet që ai të vlerësohet e të restaurohet.

Burimet e shkruara mbi Kalanë e Krujës janë mjaft të varfëra. Prej tyre nuk mësojmë dot se kur është ndërtuar oborri i fortifikuar, nëse ka qenë konceptuar që në ndërtimin e parë të kalasë dhe cila ka qenë pamja e tij arkitektonike. Vetëm nga M. Barleti mund të nxjerrim ndonjë konkluzion të tërthortë. Kur ai shpreh bindjen se ujët nuk do ta detyronte Krujën të pësonte tragjedinë e Sfetigradit, kuptohet se burimet e kalasë ishin të sigurta. Tërthorazi kjo dëshmon për ekzistencën e oborrit të fortifikuar. Më poshtë ai shkruan se Kalaja e Krujës ka pasur vetëm një portë. Nga kjo mendohet se në muret e jashtme të oborrit nuk ka pasur hyrje dhe se tuneli që lidh sot Tasllojën me kalanë shërbente si hyrje e brendshme (fig. 3). Tuneli tepër i ngushtë e bënte të pakalueshme hyrjen në kala, në rast se oborri do të binte në duart e armikut. Ai pohon gjithashtu se në dy anë të kalasë nga ana e hyrjes (veriore) dhe përballë Tiranës së Vogël (perëndimore) muret kanë pasur shumë kulla, mbasi vetëm nga këto anë terreni nuk ishte aq i mbrojtur. Me këtë njoftim ai na jep një element të rëndësishëm rreth pamjes arkitektonike të oborrit të fortifikuar. Ekzistencën e një muri të dy-



Fig. 1

DO NOT COPY

fishtë në anën perëndimore të kalasë e kanë pranuar J. Hahni, M. Shuflai dhe në ditët tona S. Adhami. Por ndonjë studim rreth fizionomisë së oborrit dhe kohës së ndërtimit të tij, ende nuk është bërë. Është kërkesë e procesit të restaurimit në rastin e kalasë së Krujës, që të evidentohet pikë së pari kjo gjymtyrë e humbur e kalasë, duke njohur fillimisht kështu tërësinë e monumentit. E vetmja mundësi për të hedhur një farë drite në këtë pjesë të monumentit mbetet studimi në vend i gjurmëve të saj.

Oborri i fortifikuar i krojeve ka pamjen e një kalaje me përmasa të vogla, aneks i kalasë së mirëfilltë. Nga ana e jashtme oborri mbrohej me anë të një muri, i cili, duke ndjekur buzën e sheshores përpara burimeve, na paraqitet në formë të harkuar. Prej punimeve të pastrimit e të gjurmimit arkitektonik të kryera në monument, kemi përftuar një sërë të dhënash të konsiderueshme, me interes edhe për oborrin e fortifikuar. Për sa i përket murit të jashtëm, deri sot janë fiksuar tri kulla (kullat 1, 2, 3) së bashku me gjurmët e mureve ndërlidhëse (fig. 2). Muri i brendshëm, pjesa që deri sot i korrespondon oborrit të fortifikuar, është i pajisur me katër kulla (4, 5, 6, 7). Funksioni i tij i dyfishtë, si mur i kalasë së mirëfilltë dhe si mur i brendshëm i oborrit, është me vlerë të veçantë kompozicionale. Krahasimi i kullave të tij me kullat e jashtme të oborrit do të na ndihmojë për të gjetur lidhjen kronologjike që ekziston midis oborrit dhe kalasë.

Materialin më interesant për t'ju referuar na e

jep kulla 4, e cila ndodhet në pikën veriore të oborrit (fig. 4). Në të vihen re tri ndërhyrje, të cilat ia kanë ndryshuar planimetrinë fillestare. Pjesa e poshtme me gurë porozë, pak a shumë katërkëndëshe, lidhur me llaç shumë të fortë dhe me fuga të thelluara, duket se i takon shek. XI-XII. Planimetria e kullës së kësaj periudhe është e vështirë të zbulohet, sepse gjatë rindërtimit të mëvonshëm mbi të, ajo ka pësuar devijim duke marrë formën gati katrore që ka sot. Në këtë rindërtim takohet qartë teknika e njohur e periudhës bizantine, e lojës ritmike të gurit me tullën e hollë që e rrethon dhe me fuga shtresërrafshta llaçi, që e shohim të jetë përdorur në shek. XIII-XIV. Deri në thepisjen shkëmbore, kullës i anësohet një mur përforcues i mëvonshëm, i cili i përket ndërhyrjes së tretë ndërtimore, e cila flet për një ndërtim të shpejtë që duhet të ketë ndodhur në shek. XV.

Kulla 5 nën të cilën ndodhen krojet, është në gjendje të rrënuar. Mbeturinat e saj tregojnë se ajo përbëhej prej dy ambientesh. Edhe këtu janë gjurmët e ndërtimit të shek. XI-XII, të një natyre me fazën e parë të kullës 4. Kullat 6, 7 me planimetri gjysmë rrethore janë vendosur në terrenin më të ulët të kreshtës dhe janë konceptuar për mbrojtjen e hyrjes së tunelit (fig. 5). Tek ato shihen më tepër se te kullat e tjera, veçanërisht te kulla 7, rindërtimet e periudhës së Skënderbeut, mbasi për nga teknika ngjasojnë me ato të kullës së rrumbullakët, që ndodhet në hyrje të kalasë. Njoftimi që na jep Barleti, sipas të cilit Skënderbeu gjatë periudhës së qetësisë (1460-62) meremetoi kullat e anës veriore dhe perëndimore, gjen kështu vërtetim në terren. Në këto kulla nuk mungojnë edhe gjurmë ndërtimesh të shek. XIII-XIV. Një vlerë të veçantë arkitektonike ka tuneli që shpon diametralisht kullën 6, ndërtim i shek. XI-XII. Tuneli është i një natyre me qemeret e nikeve të hyrjes së kalasë. Ai përbën një aspekt origjinal për monumentin dhe flet për traditën e pasur ndërtimore vendëse.

DOZOI COPY



Fig. 2

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 5



Fig. 4

Problematikën më të ndërlikuar restauruese e paraqet pjesa veriore e murit të jashtëm të oborrit. E vetmja dëshmi materiale në këtë pjesë është kulla I. Me lartësi deri 8 m në të dallohen dy ndërhyrje. Pjesa e poshtme, që tani shërben si xokolaturë, ka planimetri trapezoidale me ballin e gjerë nga jashtë (fig. 6). Teknika e saj e ndërtimit përkon me atë të fazës së parë të kullës 4, ku janë karakteristikë gurë të madhësive mesatare, lidhur me llaç gëlqereje shumë të fortë e me fugatura të thella ndërmjet gurëve, teknikë kjo e shek. XI-XII. Pjesa e sipërme, që ruan pak a shumë po atë planimetri është një rindërtim i mëvonë dhe flet për një rikonstruksion të plotë të kësaj kulle. Pranë kësaj kulle rezultuan edhe gjurmët e një stere, e cila përkon me fazën e parë të ndërtimit të kullës. Për shkak të dëmtimeve të konsiderueshme që kanë pësuar formacionet e shkëmbit në anën lindore të kullës 1, kanë humbur gjurmët e murit, i cili mbyll-



Fig. 6



Fig. 7

te oborrin, që nga kulla 1 deri te muret e kalasë së mirëfilltë. Megjithatë, me pikënisje nga fragmenti i murit që del në faqen veriore të kullës 1 (fig. 7), dhe nga gjurmët që na rezultuan nga analiza konstruktive në pikën a, mundëm të formulojmë deri diku në mënyrë hipotetike planimetrinë e këtij muri.

Kulla 2 ndodhet në pjesën qendrore të murit të jashtëm të oborrit (fig. 8). E ngritur mbi një masiv shkëmbor, ajo ka planimetri në formë freskoreje dhe lartësi 8 m. Ndërtimi me gurë egzistues të fazave më të hershme, lidhja me llaç shumë të fortë, i cili krijon shtresa të rrafshta në sipërfaqen e muraturës si dhe elemente të tjera të konstruksionit të saj (si brezat, vendet e skelave), flasin për një ndërtim të shek. XIII--XIV. Me interes të veçantë janë gjurmët e murit lidhës midis kullës 1 dhe 2. Nëpërmjet një trakti muri me gjerësi mbi 2 m, kuptohet se në ndërtimin e tij është aplikuar tradita e njohur antike në ndërtimet e mureve rrethuese, me ngritje paretesh anësore prej murature të rregullt, ndërsa seksioni i brendëshëm i murit mbushet me materiale të ndryshme të hedhura.

Me rëndësi janë edhe mbeturinat e kullës 3, të



Fig. 8

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 9



Fig. 10

cilat flasin gjithashtu për një ndërtim të shek. XIII--XIV, i vendosur pothuaj në një aks me kullat 6, 7. (fig. 9). Ndërtimi i saj është kushtëzuar nga nevojat e përforcimit të mëtejshëm të mbrojtjes së kalasë në këtë anë dhe i mbulimit të plotë të rrezes së shikimit të hyrjes së tunelit. Prej punimeve të pastrimit u përftua planimetria gjysmërrethore e kësaj kulle. Prezenca e një vrime që shpon tejpërtej kullën në trajtën e një kalimi të fshehur, si dhe tuneli i nëndheshëm që na rezultoi nga gjurmimi arkitektonik pranë kësaj kulle, tregojnë mundësinë për ekzistencën në shekujt mesjetarë të një llagëmi të fshehtë, të cilën e ka supozuar dhe M. Shuflai. Rezultate dha edhe gjurmimi i murit lidhës midis kullës 2 dhe 3 (fig. 10). Kulla 3 e mbyll rrethimin e jashtëm të oborrit në anën jugore. Gjurmë të zbehta murature në drejtimin lindor, na bëjnë të konkludojmë se muret e kalasë së mirëfilltë mbas kullës 3 qenë vendosur më poshtë terrenit, ndaj asaj që janë sot.

Nga sa u parashtrua shkurtimisht, mund të nxirren këto konkluzione:

Në bazë të gjurmëve të hetuara deri sot rezultor që Kalaja e Krujës është ndërtuar gjatë mesjetës së hershme, por në shek. XI ajo i është nënshtruar një rindërtimi të plotë. Pikërisht gjatë këtij rindërtimi ajo është pajisur edhe me oborrin e fortifikuar. Në këtë mënyrë oborri i fortifikuar i Kalasë së Krujës është pjesë përbërëse dhe e pandarë e tërësisë së monumentit. Oborri i krojeve ka pësuar rindërtime të ndryshme, po ashtu siç kanë pësuar edhe muret e kalasë së mirëfilltë. Riparime në këtë pjesë të monumentit janë bërë edhe gjatë periudhës së luftës heroike të shek. XV. Meqënëse deri sot në rrethimin e jashtëm të oborrit nuk shihen gjurmë rindërtimesh të kryera gjatë sundimit turk, mund të thuhet se degradimi i tij ka filluar pas pushtimit të kalasë më 1478.

Oborri i fortifikuar është ndërtuar në radhë të parë për fuqizimin e terrenit të ulët jugperëndimor të

kalasë me anën e dy mureve rrethuese. Shtrirja e murit të jashtëm të oborrit përfshin krejt këtë terren kritik të kalasë dhe caqet e tij anësore arrijnë deri aty ku fillon ashpërsia natyrore e kreshtës. Ndërtimi i tij ka zgjidhur në të njëjtën kohë edhe sigurimin e ujit të pishëm. Fakti që krojet mund të siguroheshin me një hapësirë më të vogël oborri, provon se ky funksion, edhe pse i domosdoshëm, ka qenë i radhës së dytë. Në këtë drejtim ndërtuesit e kanë pasuruar funksionin e burimit edhe me një vepër krijuese-inxhinjerike. Për shfrytëzimin e ujit të burimeve, në rast se oborri do të binte në duart e armikut (duke e gjetur rrjedhën e ujit në nëntokën e kreshtës), është hapur një pus mbi kreshtë, brenda mureve të kalasë. Për çdo rrezik që paraqitej, bllokohej në fundin e pusit dalja e ujit për në oborr dhe uji tërhiqej kështu nga brenda kalasë.

Të dy funksionet e oborrit janë realizuar nëpërmjet një arkitekture me përmbajtje të shëndoshë mbrojtëse, gjë që u provua gjatë luftërave të shek. XV. Ndërtimi i oborreve të fortifikuara është një tradite kompozicionale e njohur në kalatë tona, si përshembull oborri në hyrjen e Kalasë së Beratit, Shkodrës etj. Por në rastin e Kalasë së Krujës kjo traditë ndërtimore është pasuruar në dy drejtime: në funksionin e mbrojtjes së burimeve dhe në vendosjen e tij jo në hyrje, por në shpinë të kalasë. Për formën e realizimit të oborrit ndërtuesit kanë pasur parasysh hapësirën relativisht minimale midis dy mureve të oborrit, për të bërë të pamundur qëndrimin e armikut në rast se ai binte në duart e tij.

Punimet e pastrimit e të gjurmimit arkitektonik, krahas evidentimit planimetrik, dhanë elemente të dobishme për konservimin e restaurimin e oborrit të fortifikuar të krojeve. Por si pjesë e krejt monumentit, oborri i krojeve nuk mund t'i nënshtrohet që tani ndërhyrjes së thellë shkencore, pa vlerësimin restaurues të të gjithë monumentit, punë që është duke u kryer.

Prandaj ndërhyrja jonë mori karakter provizor. Tani për tani ndodhemi në fazën e konsolidimit konstruktiv dhe të mirëmbajtjes së tij të vazhdueshme, deri në vlerësimin e përgjithshëm të monumentit.

DO NOT COPY

Gjergj FRASHËRI

LE PROBLEME DE LA RESTAURATION DE LA BARBACANE DE LA CITADELLE DE KRUJE

RESUME

Rares sont dans les Balkans les forteresses moyenâgeuses couvertes d'une gloire si légendaire comme l'est la citadelle de Kruje. En tant que témoignage d'une remarquable lutte de libération, la citadelle de Kruje suscite avant tout un grand respect historique. Evidemment tout le mérite de cette gloire revient aux combattants courageux albanais et à leur Capitaine immortel, Skanderbeg. Malgré cela l'on ne peut nier la contribution apporter par les murs de cette citadelle, et par sa position même, aux victoires éclatantes remportées par les Albanais au XVe siècle. Voilà pourquoi ce monument de portée historique et architectonique, renfermant en plus de grandes valeurs sur le plan artistique et de construction, est depuis quelques années l'objet d'études relatives à son entretien et à sa restauration. Dans cette communication nous illustrerons les résultats atteints à ce jour dans un des composants le plus important de ce monument – la barbacane ou cour fortifiée de la citadelle.

La Citadelle de Kruje, qui se dresse sur une cime rocheuse, a suscité de par sa silhouette monumentale parmi les habitants du pays un sentiment de sécurité. En plus la nature a doté cette crête rocheuse de deux artères d'eau potable, ce qui pour une forteresse est d'une importance tout aussi vitale que sa position stratégique. Ces deux sources se trouvent à une côte moins élevée que la surface de la crête, l'une d'elle sur son versant septentrional, et toujours hors du périmètre des murs d'enceinte, et l'autre à son extrémité occidentale. La deuxième source également se trouve actuellement hors des murs – dans l'espace que les gens du pays appellent «Taslloje» (du turc tas = coupe métallique), peut-être en raison du fait qu'elle était dotée d'une coupe métallique pendant l'occupation ottomane.

Grâce aux murs d'enceinte s'étendant dans sa partie postérieure et entourée autrefois par une muraille puissante du côté extérieur, Taslloje a représenté une espèce de cour intérieure fortifiée ou barbacane. Protégée à l'intérieur de cette barbacane, la source de Taslloje a continuellement rendu des services à la Citadelle. Actuellement le mur extérieur de cette espèce de cour est complètement dégradé, au point d'avoir même perdu sa formulation planimétrique. Selon les critères de restauration, à son état actuel il appartient à la catégorie des ruines historiques. Trois fragments de murs conservés à ce jour indiquent que cette cour fortifiée occupait une place importante dans la conception architectonique de la citadelle. Aussi son identification devient-elle indispensable si l'on veut se former une idée sur l'ensemble de ce monument.

Les sources écrites, fort peu nombreuses en ce sens, ne renferment pas des indications sur la date de construction de cette cour fortifiée; de même elles n'indiquent pas si nous sommes en présence d'un ouvrage conçu dès la première construction de la forteresse, ni ne fournissent des données sur son aspect architectonique. Les écrits de M. Barletius nous permettent toutefois de dégager certaines conclusions indirectes. Ainsi, quand cet auteur affirme que l'on pouvait compter sur les sources d'eau, il témoigne par là indirectement qu'elles étaient protégées. Plus loin, ce même auteur écrit que la forteresse n'avait qu'une seule porte. Il en découle qu'il n'y avait pas d'entrée dans les murs extérieurs de la barbacane et que le tunnel reliant actuellement Taslloje à la forteresse servait à l'époque d'entrée intérieure. Barletius affirme également que de ce côté là la forteresse était flanquée de nombreuses tours, en nous fournissant de la sorte un important élément sur l'aspect architectonique de cette cour fortifiée. Avant de procéder à la restauration de la citadelle de Kruje, il importe d'identifier tout d'abord cette partie constitutive actuellement disparue, sans quoi on ne peut avoir une idée complète sur l'aspect initial de ce monument.

Cette barbacane a l'aspect d'une forteresse de dimensions plus petites que la forteresse originale, elle lui servait d'annexe. Les travaux de nettoyage et les recherches architectoniques nous ont permi de reconstruire sa planimétrie. Vue de l'extérieur, cette cour était protégé par un mur arqué, où l'on peut encore remarquer trois tours (1, 2, 3) ainsi que les murs qui les reliaient. Le mur intérieur, et précisément sa partie correspondant jusqu'à l'heure actuelle à la barbacane, est flanqué de quatre tours (4, 5, 6, 7). Par la confrontation de ces tours nous pouvons établir les liens chronologiques existant entre la barbacane et la forteresse elle-même.

Les tours du mur intérieur dénotent en général trois interventions. Celle des XIe-XIIe siècles par des pierres poreuses, plus

DO NOT COPY

ou moins carrées, liées avec du mortier très solide et pourvues de joints profonds. La deuxième intervention relève des XIIIe-XIVe siècles: elle est réalisé selon la technique bien connue byzantine de la pierre entourée de briques. Quant à la troisième, on peut l'attribuer au XVe siècle.

En ce qui concerne les tronçons de la muraille extérieure conservés à ce jour, ils dénotent deux interventions: la première pendant les XIe-XIIe siècles (la partie inférieure de la tour 1) et la deuxième pendant les XIIIe-XIVe siècles (les tours 1, 2, 3). En raison des graves dommages enregistrés par la formation rocheuse sur le côté oriental de la tour 1, les traces du mur circonscrivant la cour sont disparues. Malgré cela, partant du fragment de mur existant de la tour 1 et des traces relevées sur le point a, nous avons réussi à formuler plus ou moins hypothétiquement la planimétrie de ce tronçon de mur. En général la construction des murs se caractérisent par la tradition antique connue en ce domaine: parements latéraux élevés et remplage de la section intérieure du mur.

Des données exposées plus haut, on peut dégager les conclusions suivantes:

Sur la base des traces identifiées à ce jour, il ressort que la Citadelle de Kruje a été construite pendant le haut Moyen âge, en enregistrant toutefois une reconstruction complète pendant le XIe siècle. C'est justement au cours de cette reconstruction qu'elle a été dotée de la barbacane dont il est question. Donc cette cour fortifiée de la Citadelle de Kruje est partie intégrante et un composant indisible de l'ensemble du monument. La cour attenante aux sources d'eau a été reconstruite à plusieurs reprises, comme l'ont été les murs de la forteresse originale. D'autres interventions de ce genre ont été effectuées en cette partie du monument même pendant la lutte héroïque conduite pendant le XVe siècle. Etant donné que des traces de reconstructions effectuées pendant la domination turque n'ont pas été relevées jusqu'à ce jour sur les murs extérieurs de la barbacane, il ressort que sa dégradation a commencé après l'occupation de cette forteresse en 1478.

La barbacane protégeant les sources d'eau a été construite tout d'abord dans le but de renforcer le terrain en dénivellement, sur le côté sud-ouest de la forteresse, à travers deux murs d'enceinte. L'extension de son mur extérieur englobe toute la surface de cette partie moins protégée de la forteresse et ses limites latérales se prolongent jusqu'au point où débute la pente naturelle de la crête rocheuse. Par la construction de cet ouvrage il a été apporté dans le même temps une solution au problème de la protection des sources d'eau. Le fait que ces sources pouvaient être protégées par un ouvrage d'extension plus petite, prouve que cette fonction, malgré son caratère indispensable, est d'une importance secondaire. Par ailleurs, les constructeurs ont enrichi le rôle de cette source par un ouvrage inédit d'ingénierie. Si par hasard la barbacon était tombée dans les mains de l'ennemi et que celui-ci avait découvert la voie souterraine par laquelle la source déversait l'eau sur la surface du sol, il y avait alors un puits creusé dans la crête rocheuse, à l'intérieur des murs de la forteresse. En cas de danger les combattants pouvait bloquer au fonds du puits le déversement de l'eau à surface de la barbacane, tout en conservant la possibilité de le puiser dans la partie intérieure de la forteresse.

La construction des barbacanes a d'anciennes traditions dans la composition de nos forteresses. Exemple la barbacane à l'entrée de la ville forte de Berat, de Shkoder et ailleurs, Mais dans le cas de la citadelle de Kruje cette tradition se trouve enrichie en deux directions; ici la barbacane protège les sources d'eau et elle s'élève non pas à l'entrée, mais derrière la forteresse. En ce qui concerne la forme de sa réalisation, les constructeurs ont tenu compte du fait de ne laisser qu'un espace relativement minimal entre les deux murs de la cour fortifiée, de manière à ce que les assaillants ne puissent résister ici même, s'ils réussissaient à s'emparer de la barbacane.

La barbacane protégeant les sources d'eau, en tant que composante de tout le monument, ne peut devenir l'objet d'une intervention de restauration profonde, sans avoir analyser préalablement les travaux de restauration pour l'ensemble du monument, ce que nous sommes en train de faire.

DOKUMENTOZ

DO NOT COPY

Aleksandër Meksi

PROBLEME DHE ASPEKTE TË RESTAURIMIT TË KISHAVE BIZANTINE NË SHQIPËRI

DO NOT COPY

Në territorin e vendit tonë ruhet një numër jo i vogël kishash bizantine. Gjendja e tyre nga ana e qëndrueshmërisë së përgjithshme ose e elementeve të veçanta strukturale si dhe transformimet e tyre gjatë shekujve e kanë bërë të domosdoshme ndërhyrjen e restauratorit për konsolidimin e tyre dhe ndalimin e dëmtimit të mëtejshëm si dhe për nxjerrjen në dukje të vlerave të fshehura ose të transformuara që ruajnë këto monumente. Paraprakisht le të shprehim qëndrimin tonë mbi aspektet teorike të restaurimit arkitektonik, d.m.th. ç'kuptojmë me konservim dhe restaurim të monumentit, me qëllim që të shmangim çdo keqkuptim, përderisa këto terma përdoren edhe në mënyra nga më të ndryshmet deri në të gabuara. Me konservim ne kuptojmë gjithë punimet për mirëmbajtjen, që në mënyrë të vazhdueshme kryhen te monumenti për të ruajtur gjendjen ekzistuese, ndërsa restaurimi është tërësia e punimeve që ka për qëllim jo vetëm të ruajë vlerat e monumentit, por dhe t'i vërë në dukje ato duke respektuar tek ai dokumentin historik e artistik. Njëkohësisht pranojmë se të dy këto nocione ndodhen ndërmjet dy rasteve ekstreme: mirëmbajtjes korente dhe punimeve vlerësuese dhe secili prej tyre përmban elemente të tjetrit. Studimi për restaurimin e këtyre monumenteve nuk mund të mos shihej në një plan më të gjerë se studimi në veçanti i çdo rasti për arsye se mjaft prej tyre paraqesin të njëjtën specifikë restaurimi dhe mjaft aspekte të veçanta zgjidhen në të njëjtën mënyrë.

Ndërhyrjet e para në këto monumente të filluara që me vënien e tyre nën mbrojtje shtetërore kanë konsistuar në mirëmbajtjen e thjeshtë. Në disa kisha punimet duhej të merrnin patjetër një karakter restaurues, sepse prekja e pjeshme do të binte më vonë ripërsëritjen e punimeve. Prandaj krahas studimit arkitektonik kusht i domosdoshëm për një ndërhyrje në monumentet u fillua dhe studimi lidhur me punimet që do të kryheshin në to, duke pasur si qëllim shpëtimin nga dëmtimi i mëtejshëm dhe nxjerrjen në dukje të vlerave të tyre. Paraqitja e këtyre studimeve dhe e rezultateve kryesore të deritanishme të praktikës sonë konservuese restauruese përbëjnë objektin e këtij komunikimi.

* * *

Jo të gjitha kishat bizantine kanë ardhur deri në ditët tona në të njëjtën gjendje, rrjedhimisht dhe ndërhyrjet në to nuk janë të njëllojta. Duke u nisur nga ky kënd vështrimi, ne i kemi ndarë ato në dy grupe kryesore.

A. **Kishat rrënojë**

Një pjesë e kishave rrënojë ruhen me mure deri në një farë lartësie, ndërsa të tjerat kanë të dëmtuara vetëm kornizat e pjesët e sipërme të mureve ku mbështetet çatia. Në monumentet e para (Mullet, Kamenicë, Butrint, Çiflig) punimet kanë konsistuar dhe do të konsistojnë në konservimin e tyre si në rrënojat e zakonshme që është e vetmja zgjidhje. Në të dytat (Sop) muret ruhen deri në nivelin e çatisë dhe për mendimin tonë konservimi i tyre ka konsistuar në pastrimin nga rrëzimet dhe mbulimi me çati pas plotësimit në një rrafsh të mureve.

B. **Kishat që mund të restaurohen dhe të konservohen si çdo monument tjetër.**

Në këtë grup hyjnë pjesa më e madhe e kishave bizantine që deri vonë ishin në funksionim. Koha ka lënë në to gjurmët e saj, duke dobësuar strukturat dhe duke ua ndërruar pamjen nëpërmjet meremeti-

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

meve të ndryshme, sidomos në çatitë, pjesët e sipërme të mureve dhe dritaret, gjithashtu dhera dhe mbeturina ndërtimesh mbulojnë pjesën e poshtme të mureve. Për arsye funksionale, në më të shumtën e rasteve për shtim ambientesh ndihmëse ose zgjerim të ambienteve kryesore, këto monumente janë transformuar së tepërmi dhe ruajnë gjurmë të shumë fazave ndërtimore. Duke qenë këto transformime të ndryshme për secilin monument, edhe ndërhyrjet tona konservuese dallojnë nga rasti në rast. Si parim bazë është nevoja e konsolidimit dhe vlerësimit të tyre në vetvete dhe në lidhje me ambientin si dhe respekti për dokumentin historik dhe veprën e artit.

Për shkak të ndryshimeve që monumentet kanë pësuar gjatë shekujve, jo kurdoherë është i mundur kthimi i tyre në fazën origjinale. Rastet që kemi hasur në praktikë janë tri. I pari (Mesopotam, Kurjan, Marmiro, Durrës) është kur monumenti nuk kthehet dot në fazën fillestare, mbasi ka humbur gjatë kohës elemente, formën e të cilëve është e pamundur ta përcaktojmë me saktësi dhe që sidoqoftë nuk mund të rindërtohet, sepse një veprim i tillë do të ishte falsifikim i dokumentit historik. Rasti i dytë është kur shtesat që janë vënë për të përforcuar monumentin nga cedimet, dobësimet e strukturave, mund të hiqen veçse duke vënë përforcime të reja brenda strukturave, gjë jo gjithmonë e mundur dhe e lehtë, sepse do të duhej të hiqnim afresket ose të kryenim operacione komplekse dhe mjaft të vështira (Mesopotam, Labovë, Mborje, Peshkopi e Sipërme). Rasti i tretë (Perhondi, Zvërnec, Apoloni, Durrës, Peshkopi e Sipërme) është kur shtesat kanë vlerë historike ose artistike, heqjen e të cilave e quajmë të padrejtë, sepse ato përbëjnë një dokument historik artistik në mjaft raste me rëndësi të dorës së parë.

Restaurimi i monumenteve në shqyrtim kërkon edhe zgjidhjen e problemeve të veçanta si rikompozimin e elementeve arkitektonike dhe trajtimin e fasadave. Dritaret, kornizat, dyert në pjesën më të madhe janë të dëmtuara ose të transformuara. Eksperienca na ka treguar se duhet ta shikojmë çdo rast në veçanti, duke pasur parasysh që të rikompozojmë vetëm pjesët e vogla, të cilat dëmtojnë anën estetike ose që janë të domosdoshme për funksionin e ndërtesës. Jemi munduar që pjesët e reja të dallohen nga afër, në mënyrë që të mos ngatërrojnë studjuesin, ndërsa nga larg të mos dëmtojnë pamjen si dhe të kenë karakter reversibël, të mund të hiqen kur të konsiderohen të panevojshme ose të gabuara. Për sa i përket trajtimit të fasadave, jemi munduar t'i pastrojmë ato nga suvatimet, njollat me llaç të hedhura gjatë meremetimeve që kanë pësuar në kohë si edhe nga çdo dëmtim tjetër. Por gjithnjë kemi ndërhyrë sa më pak, për të mos humbur jo vetëm gjurmët e transformimeve, por dhe patinën e vjetër të mureve, pjesë tashma e historikut të tyre.

Këto janë rastet kryesorë të hasura nga ne në praktikën restauruese të monumenteve të kësaj gjinie. Vërejmë se jo gjithnjë është e mundur të kryhet në momentin e sotëm një ndërhyrje restauruese, për ar-

DO NOT COPY

sye se paraqiten vështirësi tani për tani të pakapërcyeshme si përforcim i strukturave të dëmtuara kur muret janë me afreske ose kryerja e operacioneve të papërftuara prej nesh, si forcim i mureve me injektim etj. Gjithashtu në ndonjë rast, duke mos qenë të sigurtë për suksesin dhe drejtësinë e ndërhyrjeve tona, jemi detyruar të mos prekim monumentin, për t'i lënë kohës të vendosë për drejtësinë e ideve tona restauruese.

Për nga mundësia e restaurimit, kishat do t'i ndanim në dy grupe kryesore: në të parin ato që për vetë gjendjen e tyre mund të konservohen edhe duke pasur në një shkallë shumë të vogël elemente të restaurimit, në grupin e dytë ato që mund të restaurohen plotësisht.

Si thamë dhe më lart jemi munduar që krahas studimit të arkitekturës të kryejmë edhe studimin lidhur me restaurimin e secilit monument, duke hedhur për çdo rast një ide restaurimi që më vonë gjatë hartimit të projektit të restaurimit ka marrë një fizionomi të plotë. Sigurisht që vetë punimet e restaurimit, për shkallën e madhe të prekjes së monumentit, mund edhe të kenë prurë ndryshime në projektin e restaurimit.

Mendojmë të japim shkurtazi aspekte nga restaurimi i disave prej tyre. Po e fillojmë me restaurimin e kishës së Marmiroit (sh. XIII) kryer në vitin 1967.[1] Prej saj ruheshin naosi dhe pjesërisht tamburi dhe kupola, ndërsa në gjendje rrënojë narteksi (fig. 1). Projekti i restaurimit përmbante çlirimin nga shtesat për të nxjerrë formën kryq i lirë, plotësimin e kupolës dhe të tamburit, konsolidimin e mureve të dëmtuara, ndërtimin e çative me tjegulla dhe konservimin e mbeturinave të narteksit. Pranuam nevojën e restaurimit edhe me aspekte kompletimi për shpëtimin e monumentit nga dëmtimi i mëtejshëm, konsideruar këtu vendndodhja e tij, dhe vlerësimin brenda mundësive që paraqiste monumenti.

Punimet e restaurimit u filluan me pastrimet nga rrëzimet, për të pasur të qartë monumentin. Pas kësaj u forcuan qemeret dhe kupolat, pajanduam muret dhe u fillua çlirimi nga shtesat, si ato në krahët e kryqit, ashtu edhe ato mbi çati, duke nxjerrë të lirë formën e vjetër. Pas çlirimit nga shtesat u konsoliduan muret ekzistuese, tamburi dhe kupola, duke i plotësuar deri në nivelet e dikurshme në bazë të gjurmëve që ruheshin. Nëpërmjet këtyre punimeve naosi mori formën e tij të dikurshme, kryq i lirë me kupolë dhe çati me frontone mbuluar me tjegulla. Së fundi u sistemuan mbeturinat e mureve të narteksit. Nga një monument i destinuar të rrënohej, kisha ruan vlerat e saj dokumentare, duke rifituar deri në një farë mase dhe ato estetike. (fig. 2).



Fig. 3



Fig. 4

Gjatë vitit 1970 u ndërmorën ekspedita restaurimi në kishat bizantine të Beratit; e Shën Mëhillit dhe të Shën Triadhës në qytetin e Beratit si dhe të Shën Kollit në fshatin Perhondi pranë po këtij qyteti.

1) A. Meksi, **Restaurimi i kishës së Marmiroit** Monumentet 2, 1971, 73-83.



Fig. 5



Fig. 6

Në kishën e Shën Mëhillit në Berat (sh. XIV)[2] nga studimi rezultoi se hajati i shtuar pranë narteksit ishte mjaft i vonë dhe pa asnjë vlerë arkitektonike, madje fshihte vlerat e monumentit (fig. 3). Gjithashtu u arrit të saktësohen dhe të evidentohen në vend tërë elementet e vjetra të kishës si: kornizat, dritaret etj. Prandaj u synua që monumenti të kthehej në fazën e parë të ndërtimit. Restaurimi filloi me punimet çliruese. Në fillim me heqjen e hajatit në anën perëndimore dhe më tej me uljen e terrenit në anën lindore pranë apsidës, deri në nivelin e dikurshëm, duke nxjerrë në dukje dhe dritaren e saj dyshe. Pas këtyre çlirimeve u hoq çatia e vonë me rrasa, guri mbi naos, narteks e kupolë, së bashku me mbushjet nën to dhe muret që plotësonin pjesët e rrëzuara duke pasur kujdes të mos hiqej asnjë element i vjetër. Pastrimi i çatisë së kupolës nxori qartë formën e vjetër të mbulesës dhe tjegullat mesjetare të tipit solen. Rezultoi gjithashtu se çatia ka qenë e kurbëzuar vetëm në faqet e përparme, të dukshme. Në naos dhe narteks nuk u gjetën gjurmë të çatisë, ndërsa korniza dhembë sharre ndiqej nga fragmentet e saj ose nga gjurmët e tullave në llaç. Pas heqjes së gjithë shtesave dhe riparimeve na mbetej të përcaktonim mënyrën, me të cilën do të bënim restaurimin. Duke pasur parasysh gjendjen e mirë të monumentit dhe shkallën e ruajtjes së tij, menduam të kompletonim elementet arkitektonike si kornizat dhe pjesët e vogla të dëmtuara, për t'i dhënë pamjen e dikurshme. Gjatë plotësimit të kornizave nuk luajtëm asnjë nga tullat e vjetra edhe kur ato ishin të dëmtuara, me qëllim që vlera dokumentare e monumentit të mos humbte. Pas plotësimit të kornizave dhe tullave të hequra në mure kaluam në pastrimin e fasadave nga njollat e llaçit dhe ngjyrosja e mëvonshme me bojë të kuqe. Këto operacione ishin mjaft të vështira dhe na detyruan të përdornim gëryerje mekanike që preknin edhe tullat më tepër sesa ne dëshironim. Për sa u përket fugaturave u detyruan që t'i plotësojmë thuajse kudo, sepse ato ishin mjaft të dëmtuara dhe me kohë mund të shkaktonin shkëputjen e tullave nga fasadat. Duke qenë se ruhej një nga dritaret e vjetra të kishës, sipas këtij modeli u plotësuan gjithë dritaret e tjera. Operacioni i fundit ishte mbulimi i çatisë me tjegulla vendi duke iu përmbajtur formës së vjetër të çatisë. Pas restaurimit (fig. 4) mund të themi se monumenti paraqitet me vlerat e tij shkencore jo vetëm të paprekura, por dhe të nxjerra në dukje, ndërsa nga ana estetike, edhe pse ka një atmosferë pak a shumë të re, ai del me një fytyrë shumë më interesante dhe më piktoreske se përpara restaurimit.

Restaurimi i kishës së Shën Triadhës në Kala të Beratit (sh. XIII-XIV)[3] ndryshonte nga i mësipërmi për masat dhe ndryshimet në problematikën që shtronte (fig. 5). Detyrat e restaurimit qenë heqja e ambientit shtesë në anën veriore të narteksit, hapja e dyerve

2) A. Meksi **Tri kisha bizantine në Berat,** Monumentet 4, 1972, 59-102.
3) A. Meksi, **po aty.**

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

dhe dritareve, nxjerrja e formave të vjetra të çatisë, rikompozimi i elementeve arkitektonike si korniza, dritare, mbulimi i çatisë dhe çlirimi nga dherat në anën lindore dhe veriore. Rruga që ndoqëm edhe këtu ishte po ajo. Filluan me pastrimin e dherave në anën veriore dhe lindore për të gjykuar më mirë për gjendjen e monumentit. Krahas pastrimeve të dherave hoqëm mbulesën e vonë me rrasa guri duke filluar që nga kupola. Pas heqjes së rrasave mbi kupolë dolën në llaç gjurmët e çatisë së dikurshme në dy faza të vjetra ndërtimi. Çatia më e vjetër është e njëjtë me të Shën Mëhillit, ndërsa çatia e dytë është ngritur më lart. Pastrimi i çatisë dhe i mbushjeve të elementeve këndore mbi naos dhe narteks nxori formën e vjetër të çatisë në formë kryqi dhe gati kudo gjurmët e korniza ve të vjetra, çka na dha mundësi për të përcaktuar dhe formën e çatisë së dikurshme, si për naosin, ashtu edhe për narteksin e mëvonshëm. Me pastrimin nga dherat nxorëm të plotë faqen veriore me portën e naosit dhe niken mbi të. Në anën lindore ndërmjet mureve mbajtëse që lidhin kishën me rrethimin e dytë të kalasë gjetëm apsidën trifaqëshe me dritaren e vjetër me skelet gëlqereje. Punimet çliruese përfunduan me hapjen e dyerve të zëna dhe të dritareve dëmtuara.

Restaurimin plotësues e filluam me rindërtimin e kornizave të naosit dhe narteksit. Problem paraqiste krijimi i kornizave të pjerrëta në frontone ku gjurmët e vjetra qenë të pakta. Rikompozimin e tyre e bëmë duke u nisur nga kornizat horizontale dhe që në majë të frontonit të mos dilnin mbi dritaret e tamburit. Si rrjedhim frontonet përfunduam me një vijë pak të kurbët, një zgjidhje kjo e zakonshme për kishat bizantine (shembullin më të afërt e kishim në Shën Mëri Vllahernën (sh. XIII), po në Berat dhe e të njëjtit tip arkitektural). Pas kornizave ndërtuam çatitë duke u nisur nga format ekzistuese për naosin dhe narteksin, ndërsa për kupolën zgjodhëm fazën e dytë, sepse nga faza e parë ruanim si ekzemplar të njëjtë çatinë e kupolës së kishës së Shën Mëhillit. Kompletimi i dritareve u bë sipas formës së vjetër, e cila ishte e ruajtur qartë. Pas saj u fillua trajtimi i fasadave. Këtu, në ndryshim nga restaurimi i kishës së Shën Mëhillit, prekëm vetëm pjesët e dëmtuara keq, duke ruajtur në tërësi pamjen e vjetër të kishës. Punimet e restaurimit ndihmuan për vlerësimin maksimal arkitektonik të kishës së Shën Triadhës (fig. 6).

Për nga rëndësia e monumentit dhe kompleksiteti i detyrave si në planin arkitektonik ashtu dhe konsolidues, restaurimi i kishës së Shën Kollit në Perhondi[4] përbënte një ndër rastet më të vështira të restaurimit të kishave bizantine. Në gjendjen e sotme kisha u takonte disa fazave ndërtimi (fig. 7). Faza e parë i përket fundit të shek. XI, faza e dytë fillimit të shek. XIII, faza e tretë shek. XIII-XIV, në shek. XVIII janë shtuar hajatet, ndërsa në vitet 30 të shekullit tonë është

4) A. Meksi **Arkitektura dhe restaurimi i kishës së Perhondisë** Monumentet 5-6, 1973, 19-42.

DO NOT COPY



Fig. 9



Fig. 10

transformuar narteksi. Ideja e restaurimit kishte për qëllim vlerësimin e bazilikës dhe kambanores bizantine unikale për vendin tonë duke ruajtur gjithë fazat e periudhës së parapushtimit turk, sepse shtesat e tjera të mëvonshme ishin pa vlerë arkitekturore, dhe dëmtonin soditjen e monumentit.

Restaurimi filloi me çlirimin nga shtesat e katit të dytë narteksit dhe hajatit. Ndryshe nga dy rastet e mësipërme ku rikompozuam vetëm elemente të vençanta arkitektonike, këto duhej të riformonin murin ndarës naos-narteks, i cili gjatë rindërtimit të viti 1931 ishte prishur që nga themeli. Për të lënë s gjurmët e këtij ndryshimi të ndjeshëm ashtu dhe të ndërhyrjes sonë jo të vogël, ndërtuam mbi një tra beton-arme vetëm murin e nefit qendror që do të dilte jashtë çatisë së narteksit, sepse ishte i domosdoshëm për ekzistencën normale të ndërtesës. Pas këtij filluam ndërtimin e kornizave, gjurmët e të cilave, pë sa i përket nefit qëndror, ruheshin si në fronton, ashtu dhe në pjesën e drejtë. Ndryshe prej tyre në nefat anësorë me pjesët e sipërme të mureve të transformuara gjatë rindërtimeve të ndryshme ruhej vetëm një fragment kornize në anën lindore të prothesit. U detyruam të ndërtojmë një kornizë të re me dhëmbë sharre në nivelin ku ruheshin muret, duke mos prekur kështu muret e vjetra. Ky ishte një princip që e përdorëm, përderisa pranuam të ruanim të gjitha gjurmët e vjetra, sado të fragmentuara. U rikompozuan gjithashtu dritaret e nefit qendror të gjymtuara gjatë rindërtimit të shek. XVIII, forma e vjetër e të cilave rezultoi e qartë. Restaurimi vazhdoi me ndërtimin e çative të reja me kapriata pa tavan për të lejuar vrojtimin e fragmenteve të afreskave të shek. XIII-XIV. Edhe këtu trajtimi i fasadave ishte problem jo vetëm sepse muret e çatisë së nefave anësorë dhe narteksit ishin të disa fazave të ndërtimit, por edhe sepse ishin të lyera me gëlqere ose të suvatuara. Pastrimin e tyre e bëmë në mënyrë mekanike duke e kombinuar me përdorimin e solucionit të acidit klorhidrik. Pastrimin nuk e çuam deri në prekjen e tullave, për të mos humbur ngjyrën e vjetërsisë, sepse një gjë e tillë do të binte në kundërshtim me fasadat me gjurmë të ndryshme duarsh ndërtimi.

Punimi i fundit ishte restaurimi i kambanares, ku ishin transformuar dy dritaret dyshe, të cilat i rikompozuam në bazë të dritares së ruajtur. Përveç restaurimit në anën e jashtme u punua dhe në interier duke nxjerrë në dukje dyshemenë e shek. XVIII me fragmente të shek. XI, të cilat nuk i prekëm, duke lënë në të njëjtën kohë në dukje themelet e murit ndarës naos-narteks, të prishur siç pamë në vitin 1931. Pra me restaurimin u nxorën në pah vlerat e vërteta estetike të monumentit, duke ruajtur të paprekur në të njëjtën kohë dokumentin historik (fig. 8).

Restaurimi i fundit që u ndërmor në 1970 është ai i kishës së Shën Kollit në Kurjan[5] e shek. XIII-XIV e rindërtuar në shek. XVI kur edhe është pikturuar nga Joani dhe Nikolla i Onufrit (fig. 9). Ky rindërtim i bërë me tulla dhe me llaç balte ka zhdukur çdo gjurmë për të përcaktuar formën e vjetër. Veç kësaj në shek.

5) A. Meksi, **Dy ndërtime të tipit trekonkësh** Monumentet 7-8, 1974, 229-246.

XIX në anën jugore është shtuar një ambient që përpara restaurimit ishte gjysmë i rrënuar. Vetëkuptohet që restaurimi do të kishte karakter çlirues për sa i përket hajatit jugor, për të nxjerrë në dukje jo vetëm gjithë kishën, por edhe murin me tulla dhe fragmente skulpturore të marra nga Apolonia ose gjetkë. Nga ana tjetër duhej të ribëheshin tërësisht strukturat e çatisë në gjendje të keqe, që do të nxirrnin në dukje dhe afresket nën tavan. Restaurimin e filluam me heqjen e hajatit të vonë, prishjen e çatisë, shtyrjen e murit të pjerur të narteksit dhe lidhjen e brezave beton-arme për të konsoliduar dhe ndërtuam kornizën mbi të. Korniza që këtu nuk ishte në nivelin e murit të dikurshëm nuk u bë me dhëmbë sharre, që të kuptohej lehtë se kemi të bëjmë me një kornizë të re dhe jo në vendin e saj. Pas saj ndërtuam çatinë me kapriata që lejojnë shikimin e afreskeve. Veprimi i fundit ishte pastrimi i mureve nga mbeturinat e llaçeve të rëna gjatë meremetimeve të mëparshme, ndërhyrje minimale që nuk e ndërroi aspak pamjen e mureve. (fig. 10).

Përveç këtyre restaurimeve janë ndërmarrë punime dhe në një seri kishash të tipit njënefësh si Shelcan, Pojan, Bual, Sop, të cilat kanë konsistuar në konservimin e mureve dhe ndërtimin e çative të reja që në mjaft raste japin mundësi edhe për vlerësimin e pikturave deri atëherë të fshehura nën tavane. Po kështu një punë e vazhdueshme konservuese është kryer në të gjitha monumentet bizantine.

Pra nga rasti në rast (gjendja e monumentit dhe transformimet e tij në kohë) ka ndryshuar dhe mënyra e restaurimit si në tërësi, ashtu dhe në trajtimin e elementeve të veçanta arkitektonike. Eksperienca e fituar në çdo rast shërbeu së tepërmi për restaurimet e mëvonshme.

Punimet konservuese-restauruese të kryera në monumentet bizantine të vona janë një kontribut jo vetëm si restaurim, por edhe për historinë e arkitekturës së vendit tonë, sepse kanë ndihmuar së tepërmi në vlerësimin shkencor të këtyre monumenteve me nxjerrjen në dukje të formave të vjetra dhe të mbuluara dhe ajo çka është mjaft e rëndësishme të thekshet nëpërmjet prekjes në thellësi të monumentit, në masën që asnjë sondazhi nuk mund t'i lejohej, janë përfituar shumë të dhëna arkitekturore dhe në drejtim të strukturës dhe teknikës së ndërtimit. Jo më i vogël gjithashtu është kontakti me arkitekturën bizantine, deri më sot i mundur vetëm për studjuesin.

PROTECTED COPY

Aleksandër MEKSI

DO NOT COPY

PROBLEMES ET ASPECTS DE LA RESTAURATION DES EGLISES BYZANTINES EN ALBANIE

RESUME

Sur le territoire de notre pays sont conservées de nos jours encore nombre d'églises byzantines. En considération de leur état, il a fallu intervenir par des travaux de restauration afin de les consolider pour empêcher de la sorte leur endommagement ultérieur et en faire ressortir les valeurs, Il importe tout d'abord d'expliquer ce que nous entendons par conservation et par restauration d'un monument, et cela afin d'éviter tout malentendu possible à cet égard. Par conservation nous concevons tous les travaux d'entretien effectués de manière continue afin de conserver un monument quelconque dans l'état qu'il se trouve. La restauration, par contre, comprend la totalité des travaux réalisés non seulement dans le but de conserver à un monument les valeurs qui le caractérisent mais encore de les faire ressortir, à condition cependant de respecter sur le plan historique et artistique son caractère documentaire. Dans le même temps ces deux notions se situent entre deux cas extrêmes: l'entretien habituel et les travaux de valorisation, et chacune d'entre elles comporte des éléments de l'autre. L'étude des églises byzantines à des fins de restauration ne pouvait être conçue que sur un plan plus vaste que chaque cas particulier, et cela en raison du fait que nombre de ces monuments se caractérisent par une spécifique de restauration analogue et mains de leurs aspects particuliers sont résolus de la même manière.

Une fois ces églises placées sous la protection de l'Etat, les premières mesures prises à leur égard se sont limitées à l'entretien pur et simple. Toutefois, dans certains monuments il a fallu procèder à leur restauration afin d'éviter plus tard une répétition des travaux partiels. Aussi, parallèlement à l'étude architectonique de ces monuments, il a fallu entreprendre des études relatives aux travaux à effectuer pour éviter leur endommagement et mettre en relief les valeurs qu'ils renferment. L'illustration de ces études et des principaux résultats obtenus à ce jour dans le domaine de la conservation et de la restauration constituera précisément l'objet de la présente communication.

o o
o

Les églises byzantines héritées du passé ne se trouvant pas dans un même état de conservation, les interventions qui les ont concernées ne pouvaient être en conséquence de même nature. Une telle conception du problème nous a induit à les diviser en deux groupes principaux.

A. Eglises en ruine

Lloji i mekanizmit të përdorur në secilën kullë sahati diktoi dhe sasinë e kateve të mësipërme, kurse më vonë modifikimi i mekanizmit nga orë matës me tingull në mekanizëm me fushë ore ka sjellë ndryshime në pamjen origjinare të disave prej tyre. Si shembull kullat e sahatit në Tiranë (Fig. 2,2 a) dhe Kavajë (Fig. 3,4) janë konstruktuar duke u ruajtur nga projekti origjinar vetëm kati i parë. Ndryshimet që pësuan këto kulla sahati kanë sjellë për mendimin tonë humbje të vlerave arkitektonike tradicionale për këtë gjini ndërtimore, prandaj dhe punimet konservuese apo të mirëmbajtjes që janë kryer në to sipas fazës së fundit ndërtimore mendojmë se janë të diskutueshme në aspektin teorik të vlerësimit e restaurimit të monumenteve.

Zgjidhje interesante paraqiste kulla e sahatit në Prezë pas rikonstruksionit (Fig. 5). Ambienti i mekanizmit dhe kambanës (kati i dytë i kullës)qe mbyllur me mure; në to qenë çelur vendet për fushat e orës dhe nga tri dritare hark në çdo anë. Kjo pamje

mendojmë se duhej vlerësuar për restaurim, ngaqë përfaqësonte evolucionin e plotë të kësaj kulle. Rikompozimi i saj (Fig. 6), duke mos e konsideruar fazën e fundit, ka sjellë që ky monument të humbasë cilësitë e një historiku të plotë si kullë fortifikuese kalaje, Kullë vrojtuese, Kullë sahati.

Përvoja e pasur ndërtimore vendëse e konceptoi kullën e sahatit si element të rëndësishëm urbanistik si për zgjedhjen e vendit të vendosjes, edhe në përkujdesjen e veçantë dekorative estetike.

Kullat u ndërtuan në sheshet e pazarit ose pranë tyre. Janë shfrytëzuar ose kuotat më të larta, që kulla të dominojë jo vetëm pazarin por krejt qytetin.

Na tërheq vëmendjen ngritja e sahateve qytetare mbi rrënojat e kullave të vjetra të kalave, pranë ose në afërsi të pazarit, që siguronte bazamente të sigurta dhe ndihmonte në lartësimin e kullës, duke i shtuar asaj vlera monumentaliteti. Me interes është dhe fenomeni i adaptimit të kullave ekzistuese, kambanoreve, apo i ndërtimeve të llojeve të tjera, me funksionin e sahatit qytetar.

Për ilustrim kemi zgjedhur tre ekzemplarë:

Kulla e sahatit të Peqinit (Fig. 7) shquhet për origjinalitet në formimin kompozicional, proporcione harmonike në tërësi, mjeshtëri të hollë e një teknikë të pjekur. Ajo u ndërtua rreth viteve 1840 në bashku



Fig. 3



Fig. 4

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6

me xhaminë, si pjesë përbërëse e të njëjtit projekt. Nga tradita gojore mësohet se për ndërtimin e saj qenë shfrytëzuar gurët nga një faltore më e vjetër dhe realizimi qe kryer nga po ata mjeshtër, që kishin ndërtuar më parë kullën e sahatit të Tiranës. Kjo kullë është e tipit trekatësh dhe arrin një lartësi prej 21 metrash. Kati i parë, si ambient ku varen peshat, ka brenda akoma sot shkallët origjinale prej druri, të konstruktuara thjesht e me kritere racionale (çdo pesë këmbë shkallë një sheshpushim). Kati i dytë fillon me një dysheme, ku ndodhet i montuar mekanizmi i orës. Ky kat, ashtu si i pari, është i mbyllur. Formohet simetrikisht prej harqesh të verbra dyshe dhe mbulohet nga një kube mbi tromba anësore. Në këtë kube ka sot dy dalje, njera është e vonë, kurse tjetra, ajo origjinarja, të drejton për në ambientin e tretë, në atë të kambanës. Ky ambient i fundit, i formuar nga katër kolona të gurta njëcopëshe, me kapitele të gdhendura, harqe e kube, ka qenë i hapur. I vetmi ndryshim, që i është bërë katit, është mbyllja e hapësirës ndërmjet kolonave me mure, çelja e vendeve për fushat e orës dhe hapja e një kalimi të domosdoshëm për nevojat e rregullimit të akrepave orëshënues.

Vlerat unikale të këtij monumenti si dhe nevojat, që ai ka si rezultat i humbjes së qëndrueshmërisë që nga koha, kur u rrënua faltorja, e bën të domosdoshme ndërhyrjen tonë restauruese e vlerësuese.

Kulla e Elbasanit (Fig. 8) daton në vitin 1899, por nga të dhënat dokumentare rezulton që Elbasani ka pasur një kullë sahati që në fillim të shek. XVII. Hani



Fig. 7

(1854) dhe Hekardi (1865), ndonëse japin një përshkrim të hollësishëm të sheshit pranë kalasë, nuk përmendin praninë e ndonjë kulle. Në vitin 1869 Tozeri ka vërejtur një kullë sahati, papërmendur ndonjë veçori. Në studimin mbi Kalanë e Elbasanit të Gj. Karaiskajit, është shfaqur mendimi se në vendin, ku ndodhet kulla e sotme, ndodhej një e vjetër prej druri, ndërsa mendimi ynë është se në të njëjtin vend janë ndërtuar rradhazi tri kulla. E para në shek. XVII, e përmendur nga Çelebiu, u rrënua para vitit 1854. Kulla e dytë prej druri, e ngritur gjatë viteve 1865-1869, pas rrënimit u zëvendësua me kullën më të re, në pranverë të vitit 1899. Atë e ndërtoi vetë populli elbasanas (siç shkruhet në mbishkrimin mbi portën e hyrjes së kullës) dhe vlerësimi që i jep më 1931 Valishi, duke e cilësuar të vjetër turke, është i gabuar. Në mbishkrim thuhet gjithashtu se ky sahat tregon saktë nga të katër anët orë e minut dhe kja na bind se mjeshtrit ndërtues e konceptuan që në fillim me fusha. Kjo kërkesë funksionale nuk kërkoi shtimin e ndonjë kati të veçantë, të posaçëm, por fushat u vendosën në murin e katit të dytë. Kulla është e tipit trekatësh. Zhvillohet me planimetri katrore (4,3 x 4,3 m). Deri në lartësinë 3 m është ndërtim prej guri, më sipër vazhdon prej tulle, duke ruajtur të gurta qoshet. Dy katet e tjera janë vazhdim i të parit dhe ndahen nga njeri-tjetri nga një soletë (sot e rindërtuar me beton-arme). Edhe kjo kullë kurorëzohet nga një kube. Teknika e ndërtimit dhe e materialeve të përdorura (hekuri në brezat e murit dhe për tirande, druri për shkallë dhe dysheme, tulla e pjekur mirë në kupolë dhe mure, suvatimi dhe trajtimi koloristik) tregojnë për vazhdimësi të traditave vendase dhe përvetësim të tek-



Fig. 8

DO NOT COPY

nologjive më të reja. Në gjendjen e sotme nuk shohim nevojën për ndërhyrjen restauruese.

Për kullën e sahatit të Krujës (Fig. 9) studimi dhe restaurimi i së cilës është kryer nga punonjësit e Institutit Monumenteve të Kulturës po kufizohemi vetëm me disa vlerësime.

Kjo kullë është më e vjetra nga ato që ruhen sot, e ndërtuar në shek. XI-XII, apo dhe më parë, si pikë vrojtimi. Autorë të ndryshëm e cilësojnë si kullë kambanash, kurse funksionin për sahat ajo e mori në shek. XVII. Në gjendjen, që paraqitej si dhe në vendin ku ngrihej plotësonte më së miri kushtet e funksionit të ri si sahat qytetar për t'i shërbyer tregut dhe qytetit. Ka një lartësi nga tabani rreth 16 m, fillon piramidale dhe vazhdon prizmatike me bazë katrore. Kolona guri që mbajnë sipër çatinë e drujtë e mbyllin këtë kompozim. Sipas këtij modeli ajo dhe është restauruar.

*
* *

Kulla e sahatit si një kategori arkitektonike, që reflekton kushtet ekonomiko-shoqërore të epokës, duke i materializuar këto si në konceptim, ashtu edhe në teknikën e materialin e përdorur, përbën për historinë e arkitekturës sonë mesjetare një kapitull të veçantë. Në këto përmendore kulture mbulojmë aftësitë krijuese të mjeshtërve tanë popullorë, të cilët kanë ditur të bashkojnë elemente të stileve të ndryshme, duke futur shumë gjëra vetiake të reja dhe në këtë drejtim ato janë të pasura me vlera të shumta njohëse.

Duke pranuar që secila prej tyre paraqet rast unik si vepër arti, si dëshmi kulture dhe si përmendore historike, në të njëjtën kohë objekte në vazhdimësi funksionale, do t'i pranojnë këto kritere bazë edhe për trajtimin e përkujdesjes konservuese restauruese, që zhvillohet nga Instituti ynë në praktikën socialiste të restaurimit.



Fig. 9

DO NOT COPY

Sulejman DASHI

LES TOURS DE L'HORLOGE MOYENAGEUSES DE NOTRE PAYS

RESUME

L'organisation corporative en tant qu'institution du système féodal, dont la formation s'est achevée dans les villes albanaises pendant les XVIIe-XVIIIe siècles, a créé des conditions favorables au développement rapide de la vie urbaine. Les corporations exerçaient aussi des fonctions municipales, entre autres celle de la construction de tours de l'horloge.

Les commerçants albanais, qui avaient des contacts fréquents avec les villes européennes, apportèrent à leur retour les mécanismes nécessaires dont les constructeurs du pays s'en servirent pour construire sur les places publics des tours munies d'une horloge. Les historiens relèvent que la présence des tours de l'horloge dans les agglomérations urbaines habitées par des Albanais, par rapport aux autres provinces de l'empire ottoman, est un trait qui les caractérise dès le XVIIe siècle.

La première tour de l'horloge fut contruite à Shkup pendant les années 1560-1570. D'autres villes renommées de l'époque disposaient aussi de tours semblables, comme Elbasan, Prizren, Berat, Kruje et Shkoder. En ce qui concerne les villes de Korçe, Prishtine et Peje, les corporations y construisirent des tours de l'horloge pendant le XVIIIe siècle. Plus tard, pendant le XIXe siècle, d'autres villes à économie artisanale comme Kavaje, Tirana et Peqin, voir même quelque village comme Preze et Libohove, sont pourvus de tours semblables. De même les villes de Durres, de Gjirokaster, de Delvine, ainsi que la Forteresse de Kanine, disposaient d'une tour de l'horloge.

Ces tours sont de deux types: à deux et à trois étages. Pour les deux types, le premier étage est élevé et fermé par un mur de pierre massif, ne disposant, que d'une seule entrée. Il se développe en hauteur selon une planimétrie carrée et est illuminé par quatre fenêtres munies de meurtrières. Il apparaît clairement que la technique suivie pour leur construction est celle employée dans les tour plus anciennes du pays, d'où aussi leur nom de «kulla».

Le type d'horloge employé dans chacune de ces tours est en fonction du nombre des étages supérieurs de la tour même; plus tard l'emploi de cadrans, servant à indique l'heure par des aiguilles et munis d'une sonnerie, a entraîné des modifications quant à l'aspect original de certaines de ces tours. Exemple les tours de l'horloge de Tirana et de Kavaje qui ont été reconstruites, en ne conservant du projet initial que le premier étage. Evidemment ces modifications ne pouvaient ne pas toucher les valeurs architectoniques traditionnelles de ces ouvrages.

* * *

Grâce à la grande expérience accumulée dans le secteur du bâtiment, les tours de l'horloge furent considérées à l'époque comme un important élément urbaniste, d'où le soin consacré au choix de la place où elles seront construites et en particulier à leur décoration esthétique.

Ces tours furent érigées sur la place du marché où à sa proximité, la préférence allant toutefois aux terrains élevés. A cette fin on s'est servi aussi souvent des anciennes tours de forteresse ou de quelque campanile.

La tour de l'horloge de Peqin se distingue par l'originalité de sa composition, par des proportions harmoniques dans l'ensemble, par une technique ayant atteint son développement et par l'habileté de ses constructeurs. Elle fut construite vers 1840 avec la mosquée adjacente, faisant partie intégrante du même projet de construction. Les gens du pays racontent que la réalisation de cet ouvrage est l'oeuvre des mêmes maîtres bâtisseurs qui avaient mis ouparavant en place la tour de l'horloge de Tirana. Elle est à trois étages et atteint une hauteur de 21 m. Le premier étage, où sont placés les poids, comporte encore son escalier de bois original. Le deuxième étage débute par un plancher, où ont été assemblés les mécanismes de l'horloge. Cet étage se compose symétriquement par des arcs doubleaux, il est couvert par une petite coupole s'appuyant sur des colonnes latérales. En ce qui concerne la troisième pièce, celle du campanile, elle comporte quatre colonnes monolithes, à chapiteaux travaillés, des arcs et une petite coupole; elle est fermée. La seule modification apportée au deuxième étage consiste dans le murage de l'espace séparant les colonnes et dans l'ouverture pratiquée pour les cadrans et pour le passage conduisont à l'horloge en cas de nécessité de réparations.

La tour d'Elbasan. Elle porte la date de l'année 1899, mais les sources documentaires indiquent qu'il y avait à Elbasan une

DO NOT COPY

tour de l'horloge dès le commencement du XVIIe siècle. A notre avis sur la même place ont été construites successivement trois tours: la première pendant le XVIIe siècle, comme l'indique Celebi, et détruite avant 1854. Une deuxième tour de bois fut construite pendant les années 1865-1869; puis, après sa destruction, elle fut remplacée par une nouvelle tour au printemps de l'année 1899. Celle-ci a été mise en place par les habitants mêmes d'Elbasan, comme il ressort d'une inscription figurant au-dessus de la porte d'entrée à la tour. L'inscription indique, par ailleurs, que cette horloge désigne les heures et les minutes que l'ont peut voir des quatres côtés, ce qui nous induit à penser qu'elle fut conçue dès le commencement comme une horloge à cadrans. Cette exigence fonctionnelle n'a pas nécessité l'adjonction d'un nouvel étage, du fait que les cadrans sont placés dans le mur du deuxième étage. Cette tour appartient au type à trois étages. Elle se développe selon une planimétrie carrée (4,3 x x 4,3 m) jusqu'à une hauteur ed 3 m; ses murs sont en pierre, plus haut viennent des briques, mais les angles sont toujours de pierre. Cette tour aussi est couverte par une petite coupole. La technique de construction et les matériaux employés, ainsi que le traitement sur le plan du coloris, témoignent de la continuité de la tradition locale et de l'assimilation de technologie nouvelles.

La tour de l'horloge de Kruje est la plus ancienne parmi ce type de tour conservée de nos jours. Sa construction remonte aux XIe-XIIe siècles, peut-être même avant. A son commencemen c'était un clocher et ce n'est que plus tard, au XVIIe siècle qu'elle a été munie d'une horloge. Grâce à son état et à la position qu'elle occupait, cette tour était en mesure de remplir au mieux sa nouvelle fonction. D'une hauteur de près de 16 m à partir du niveau du sol et de forme carrée à sa base, elle se dresse au comencement comme une pyramide pour prendre ensuite la forme d'un prisme. Cette composition se termine par des colonnes de pierre soutenant le toit de bois. Sa restauration a été achevée selon le même modèle.

La tour de l'horloge, en tant que catégorie architectonique reflétant au mieux les conditions économiques et sociales de l'époque, qui sont matérialisées soit dans la conception que dans la technique et les matériaux employés, représente dans l'histoire de notre architecture moyenâgeuse un chapitre à part.

POOR COPY

Shpresa PRIFTI

DO NOT COPY

BANESA SHKODRANE ME ÇARDAK NË GJITHË BALLIN

Në verilindje të Kalasë së Rozafatit shtrihet qyteti i Shkodrës, një nga qytetet e vjetra të vendit tonë, i cili ruan pasuri të mëdha kulturore në fushën e banesës popullore, të trashëguara këto nga shek. XVIII-XIX[1], periudhë gjatë së cilës Shkodra pati një lulëzim të madh.

Në Shkodër deri rreth mesit të shek. të kaluar u ndërtua në masë të gjerë banesa e hapur me çardak në variante të ndryshme, tip ky i njohur dhe i përhapur dhe në qytete të tjera të Shqipërisë si në Berat, Elbasan etj.

Banesa shkodrane, duke u vendosur në një terren fushor, gjen liri të madhe veprimi në kompozimin e saj planimetrik, duke pasur tendencën e shtrirjes në horizontalitet. Banesa vendoset në një truall të gjerë, rrethuar me mure të larta që arrijnë në disa raste dhe 5 m. lartësi. Zakonisht balli i saj nuk sheh në rrugë. Lidhja me rugën bëhet me anën e portës dy flegërshe me përmasa të mëdha, të trajtuara me mjaft përkujdesje.

Banesa shkodrane me çardak është klasifikuar në disa variante që nuk janë gjë tjetër veç shkallë zhvillimi nga banesa e hapur drejt asaj të mbyllur dhe pikërisht: «me çardak në gjithë ballin», «me çardak në njërin krah» dhe «me çardak në qendër»[2].

Gjatë shek. XVIII dhe sidomos deri nga çereku i shek. XIX Shkodra ishte qendër e madhe e prodhimit dhe shkëmbimit të Shqipërisë së Veriut, por një kohësisht dhe qendër e rëndësishme tregtare[3]. Shtresave të borgjezisë në lindje si dhe atyre me origjinë çifligare banesa me çardak ua plotësonte mirë nevojat jetësore, prandaj kjo banesë mori përhapje të gjerë. Çardaku në këtë banesë luante rol kryesisht për qëllime të punës. Këtu, krahas përpunimit të produkteve bujqësore, bëhej rritja dhe përpunimi i krimbit të mëndafshit, punohej tezgjahu, por në të njëjtën kohë çardaku kryente dhe funksione të mirëfillta banimi.

Me fillimin e rënies së fuqisë ekonomike të qytetit rreth fundit të shek. XIX kemi dhe ngadalësimin e veprimtarisë ndërtimore në lëmin e banesave. Me kalimin e kohës, me rënien e tregtisë dhe të zejtarisë, çardaku fillon dhe humbet një sërë funksionesh, të cilat deri atë kohë e justifikonin sipërfaqen e tij mjaft të madhe, që herë-herë jo vetëm e arrinte të njëjtën sipërfaqe me pjesën tjetër të banimit, por dhe e kalonte atë. Nga ana tjetër, rritja e familjes në numër si dhe ndarja e saj lindën nevojën e krijimit të ambienteve të reja për banim.

Duke qenë se ky tip banese ofronte mundësira të shumta për një trajtim të ri në planin kompozicional ashtu dhe në atë arkitektonik, për faktin se çardaku është një sipërfaqe mjaft e madhe, qenë mundësitë që ky i fundit të pësonte ndryshime të njëmbasnjëshme.

Simbas rastit dhe nevojës kemi mbylljen e çardakut në njërin apo të dy krahët dhe ndërtimin në to të ambienteve të banimit. E njëjta gjë ndodh dhe në hajat.

Të gjitha këto ndryshime të bëra në kohë dhe për shkaqe të ndryshme sollën transformimin e variantit të parë të banesës së hapur shkodrane, atij me çardak në gjithë ballin, transformime që konsistojnë në mbylljen apo zvogëlimin e sipërfaqes së çardakut. Sot ky variant takohet shumë rrallë në gjendjen fillestare.

Objekti i kësaj kumtese do të jetë trajtimi i va-

1) E. Riza, **Banesa popullore në Shkodër gjatë shek. XVIII-XIX,** Monumentet, 4, 1972, 141.
2) E. Riza, **Po aty,** 153.
3) **E. Riza, Po aty,** 145.

riantit të parë të banesës me çardak, atij me çardak në gjithë ballin duke u përpjekur për një karakterizim të kësaj banese për faktin se shumica e tyre janë të transformuara në kohë.

Mjaft nga ekzemplarët që do të paraqesim për të ilustruar temën janë rikonstruktuar në bazë të vrojtimeve me vend dhe të dhënave gojore. Në paraqitjen e materialit do të nisemi nga shembujt më të thjeshtë të këtij varianti, me dy ambiente në kat, deri në ato me 3 ose më shumë të tillë.

Banesa Nr. 1 (Tab. I).

Së pari banesa ka qenë e variantit me çardak në gjithë ballin me dy ambiente në çdo kat. Në katin përdhes është ndërtuar ahuri që zë gjithë sipërfaqen nën ambientet e katit. Komunikimi i tij me ambientin e jashtëm bëhet nëpërmjet një porte të madhe njëflegërshe druri dhe ndriçohet nga disa hapësira në formë frëngjije. Lidhja me çardakun bëhet me shkallë guri njërampëshe të trajtuara si një bllok masiv guri të vendosura jashtë konturit të çardakut. Në katin e parë bri çardakut janë vendosur radhazi oda e miqve dhe oda e zjarrit, të cilat komunikojnë me çardakun dhe ndërmjet tyre. Nga të dhënat gojore, oda e mirësot është mjaft e transformuar, del se ka pasur një musandër dhe në faqen përballë hyrjes një oxhak të thjeshtë. Oda e zjarrit ruhet në gjendje origjinale mjaft mirë, me disa ndryshime të vogla të bëra më vonë. Elementi më i rëndësishëm është vendi i zjarrit ndërtuar në murin anësor. Ai përbëhet nga vatra dhe bri saj një tymar me seksion 1/2 rrethor i cili mbyllet lart në formë konike. Oda e zjarrit ka gjurmë të një furre.

Elementi themelor i kompozicionit, çardaku, zë një sipërfaqe të konsiderueshme në krahasim me ambientet e banimit, kështu, ndërsa hapi i ambienteve të banimit është 5,6 m, çardaku arrin në 3,7 m gjerësi. Komunikimi i odës së miqve me çardakun bëhet nga një derë njëflegërshe druri, hapsira e së cilës mbulohet me një qemer 1/2 rrethor ndërsa ajo e odës së zjarrit trajtohet e thjeshtë, mbuluar me një arkitra. Ambjentet sanitare janë prapa banesës jashtë konturit të saj.

Banesa Nr. 2 (Tab. II).

Kjo banesë është pothuaj identike me banesën e parë për nga kompozimi planimetrik i ambienteve të saj, me ndryshimin se shkalla këtu është futur brenda sipërfaqes së çardakut. Ndërsa në banesën e parë çardaku është i hapur në të dyja anët, këtu njëra faqe e tij është e mbyllur me mur guri, vazhdim i murit anësor të vetë banesës. Përbri çardakut në krahun e djathtë ndodhet oda e zjarrit dhe në të majtë oda e miqve. Oda e miqve ka një trapazan të thjeshtë ndërsa oda e zjarrit ka pasur një musandër. Përveç dy dyerve me të cilat bëhet lidhja e tyre me ambjentin e jashtëm, në çardak del dhe një dritare e odës

TAB. II



PAMJE KRYESORE



KATI I PARE

DO NOT COPY

së zjarrit. Sipërfaqja e çardakut është më e madhe se ajo në banesën e parë në krahasim me ambientet e banimit.

Dy shembujt e mësipërme paraqesin raste disi të ndryshme të banesës me çardak në gjithë ballin me dy ambjente në kat. Po kalojmë tashti në dhënien e disa shembujve të tjerë ku përbri çardakut takojmë 3 ose më shumë ambjente në kat.

Banesa Nr. 3 (Tab. III).

Është një nga banesat më karakteristike të Shkodrës. Në katin përdhe është ndërtuar një ahur i vetëm ndërsa hajati shtrihet nën çardak. Në çardak gjejmë të vendosura radhazi në qendër odën e zjarrit e cila merr dritë nga një baxhè në çati dhe anash saj dy ambiente, prej të cilave i djathti oda e miqve dhe i majti odë qëndrimi apo fjetjeje.

Në qendër të kompozimit të fasadës ndodhet shkalla dyfishe prej guri, e cila mbështetet në konstruksionin e dy qemereve, njëri çerekrrethor dhe tjetri gjysmërrethor. Ky është varianti më i zhvilluar i shkallës në banesën shkodrane, mjaft monumentale dhe madhështor në krahasim me pamjen arkitektonike të lehtë dhe transparente të çardakut. Vendosja e shkallëve në qendër të çardakut e zvogëlojnë sipërfaqen e tij prandaj ai vjen dhe zgjerohet nga çdo anë rreth 1.5 m, tej gjatësisë së përgjithëshme të ambjenteve të banimit për të krijuar qoshqet karakteristike. Çardaku është rreth 15 m^2 më i madh se sipërfaqja e ambienteve të banimit, përfshirë këtu dhe trapazanet. Përbri trapazaneve duke dalë në formë katërkëndëshi të drejtë prej ballit të prapëm të banesës, janë ndërtuar ambientet sonitare për çdo dhomë.

Banesa në gjëndjen e sotme ka pësuar transformime rrënjësore por sipas vrojtimeve tona, në krahun e majtë të çardakut bri odës së mirë ka shenja që tregojnë se aty ka qenë ndërtuar një qoshk i ngritur rreth 90 cm nga niveli i dyshemesë së çardakut. E njëjta gjë mund të supozohet dhe për krahun tjetër të çardakut m.q.s. dhe ky vjen më i dalur.

Banesa Nr. 4 (Tab. IV)

Ndryshe nga banesat e tjera, shkallët që të çojnë në kat janë njërampëshe të ndërtuara vetëm në katër këmbët e para prej guri, të cilat vijnë në formë gjysmë rrethore, ndërsa pjesa tjetër është prej druri. Ky është varianti më i hershëm dhe i thjeshtë i shkallës në banesën shkodrane. Në vetvehte kjo shkallë është mjaft transparente dhe e lehtë, dhe lidhet mjaft mirë me kompozimin arkitektonik të çardakut. Çardaku këtu zë një sipërfaqe më të madhe se ajo e banimit. Gjurmë të qoshkut nuk duken, por kjo nuk e përjashton mundësinë e ekzistencës së tyre në gjithë këtë sipërfaqe kaq të madhe. Bri çardakut ndodhen në qendër oda e zjarrit, në të majtë të saj oda e mirë, ndërsa në krahun e djathtë oda e ndenjjes. Të bie në sy dekori i pasur i odës së mirë e cila ka një tavan, musandër dhe trapazan të gdhëndura mjaft hollë dhe me shije, në krahasim këto me dekorin dhe varfërinë e pajisjeve të odës së zjarrit. Karakteristike për këtë banesë është se ajo nuk ka «rrugina» që krijojnë një komunikim imtim ndërmjet tre ambjenteve. Përveç dy dritareve mbrojtur me hekura në çardak del dhe dritarja e trapazanit të odës së mirë mbuluar me kafaz druri.

Banesën shkodrane me çardak në gjithë ballin e takojmë rrallë dhe me më shumë se tri ambente në kat.

Banesa Nr. 5 (Tab. V)

Është një nga banesat më të mëdha të qytetit të Shkodrës. Banesa ka në kat 4 ambiente përveç çardakut. Në qendër ndodhet oda e zjarrit, e cila ruan në gjendje thuajse të plotë kompozimin origjinal duke ruajtur një vatër zjarri mjaft interesante të ndërtuar në faqen anësore. Vatra në formë katërkëndëshi këndrejtë përfundon lart në formë konike. Pjesa e poshtme është e ngritur nga dyshemeja rreth 60 cm. dhe e dalur nga muratura 15 cm. Në këtë pjesë ka dy të thelluara që shërbejnë për ndezjen e zjarrit. Në qoshen e murit bri çardakut ndodhet furra e pjekjes. Oda e mirë ndodhet në krahun e majtë të odës së gatimit dhe trajtohet mjaft pasur nga ana e dekorit të elementeve të saj përbërëse. Dy odat e tjera vijnë më të vogla në sipërfaqe dhe kanë një trajtim më të thjeshtë të elementeve. Në çardak shihen qartë gjurmët e sofasë në krahun e djathtë, e ngritur kjo disa këmbë shkallë nga dyshemeja e çardakut, ndërsa në faqen tjetër një qoshk i mbyllur me perde të holla çatmaje. Shkallët këtu janë dyrampëshe masive prej guri.

Çardaku në banesën shkodrane (Fig. 1) është një element sa i zakonshëm, aq dhe i rëndësishëm për një sërë funksionesh që kryen. Gjithmonë ka formë katërkëndëshi kënddrejtë me brinjë më të gjatë vendosur në ballin e banesës. Balli i tij formohet nga një apo dy rreshta kolonash druri që përfundojnë me jaskëtë të gdhendur me mjaft shije dhe mbyllen me parmakë të thjeshtë druri. Çardaku është pa tavan duke qenë kështu i zbuluar gjithë konstruksionin e çatisë.

Çardaku si ambient i hapur që komunikon direkt me natyrën (Fig. 2) dhe shërben si vend çlodhës dhe soditës i saj ka bërë të mundur që dora e mjeshtrit

DO NOT COPY



Fig. 1

DO NOT COPY

të krijuar këtu ambiente të qeta të ngritura disa këmbë shkallë nga dyshemeja e çardakut. Këto ambiente të lehta, sofaja dhe qoshku, i cili ngrihet mbi lartësinë e së parës të rrethuar me parmakë (Fig. 3) e pasurojnë shumë fasadën e banesës shkodrane. Kjo sjell që sipërfaqja e çardakut të ndahet në dy pjesë: sipërfaqja aktive dhe ajo e pushimit.

Me zvogëlimin dhe mbylljen e çardakut, qoshqet dhe sofatë kthehen plotësisht në ambiente banimi duke u rrethuar me porete të holla çatmaje (Fig. 4). Në dukje këto ambiente bien menjëherë në sy për funksionin e tyre fillestar, ngaqë dritaret e tyre qëndrojnë më lart se ato të ambienteve të tjera, për shkakun e disnivelit të tyre nga dyshemeja e çardakut.

Në gjendjen e sotme çardaqet e paprekura janë të pakta, megjithatë disa prej tyre ruhen akoma në gjendje origjinale.

Vendi më interesant dhe dominues në to është qoshku i ngritur dy këmbë shkallë (Fig. 5) nga dyshemeja e çardakut në formën e një platforme. Ajo është e vendosur në drejtim të: kafazit të shkallëve, në hapësirën e fundit të kolonave. Në njerën anë kufizohet me mur guri i cili është vazhdimi i murit të vetë banesës, ndërsa në dy anët e tjera me parmakë të thjeshtë. Jastëqet e kolonave janë të punuara me mjaft shije me dekoracion plastik (Fig. 6).

Në një banesë tjetër karakteristike shkodrane çardaku ka një kompozim më të arritur, ndarja e sipërfaqes aktive dhe asaj të pushimit është më funksionale (Fig. 7). Sofaja ndodhet në krahun e djathtë e ngritur tre këmbë shkallë nga dyshemeja e çardakut, në formë gjysmë rrethore. Anash shkallës janë të vendosura parmakët (Fig. 8). Përbalë kësaj sofaje, në vazhdim të kafazit të shkallëve, i ngritur një këmbë

DO NOT COPY



Fig. 2

më lart ndodhet qorshku, vendi i preferuar i krejt të familjes.

Banesa me çardak në gjithë ballin është tipi më i thjeshtë i banesës së hapur shkodrane. Më i përhapur është veçanërisht varianti me 3 ambiente me kat. Në banesat me çardak në gjithë ballin të bie në sy tipizimi qoftë i vetë kompozimit planimetrik volumor të banesës, ashtu dhe i njësive të saj themelore: çardakut, odës së zjarrit, e odës së mirë.

Banesa është gjithmonë dykatëshe dhe ka formën e rregullt të katërkëndëshit të drejtë me brinjën më të gjatë në ballë. Kati përdhes në të gjitha rastet është i pabanuar. Këtu kemi ahurin një të tërë apo të ndarë në mes me mur guri që shtrihet nën ambientet e katit dhe hajatin, i cili ndodhet nën çardak dhe ka të njëjtën sipërfaqe me të. Bërthamën e kompozimit të katit të parë, i cili luan funksione të mirëfillta banimi, e zë oda e zjarrit. Simbas rastit në të dy krahët



Fig. 3

e saj vendosen oda e mirë dhe ajo e ndenjjes. Kompozimi i këtyre ambienteve përbën një katërkëndësh të drejtë, i vendosur gjithmonë bri çardakut.

Oda e gatimit zë një sipërfaqe më të vogël se oda e mirë për faktin se qëllimi i saj është thjesht gatimi, ndërsa pritja dhe ndenja e miqve bëhet në odën e mirë. Të bie në sy kontrasti i madh në trajtimin arki-



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6



Fig. 7

DO NOT COPY



Fig. 8

tektonik të brendësisë së tyre, kështu trajtimit primitiv të odës së zjarrit nuk i përgjigjet dekori i pasur i odës së mirë. Oda e mirë trajtohej me përkujdesje, sepse shpeshherë shkalla e dekoracionit të saj pasqyronte dhe shkallën e pasurisë së të zotit të banesës.

Çardaku është elementi kryesor i banesës së hapur shkodrane. Simbas rastit dhe kompozimit të tij, në njërën apo të dy krahët vendosen sofate dhe qoshqet, të cilat marrin pjesë në formulimin arkitektonik të vetë banesës. Çardaku për funksionet e shumta që kryen, zë një sipërfaqe të konsiderueshme në krahasim me ambientet e banimit. Ai luhat në kufijtë nga raporti 1 : 0.75 deri në 1 : 1.25.

Duke qenë kjo banesë e hapur në gjithë ballin, krijohet mundësi e plotë e lidhjes së saj me natyrën. Ekzistenca e strehëve të gjera si dhe e çardakut bashkë me elementet e tij përbërëse, krijon në fasadë kontraste të forta dritë-hije si dhe një pamje mjaft të lehtë dhe transparente të vetë banesës.

Dy variantet e dyta të banesës shkodrane, «ai me çardak në njërin krah» dhe me «çardak në qendër», janë forma më të vona zhvillimi të banesës shkodrane që konsistojnë në zvogëlimin e çardakut, pra në fillimin e zhdukjes së tipit të banesës së hapur shkodrane.

DO NOT COPY

TAB I



PAMJE KRYESORE

0 5 M



KATI PERDHE



KATI I PARE

DO NOT COPY

TAB. III



PAMJE KRYESORE

0 5 M



KATI PERDHE



KATI I PARE

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TAB. IV.



PAMJE KRYESORE

0 5 M



KATI PERDHE



KATI I PARE

et celle à gauche de chambre de séjour ou de chambre à coucher.

Au centre de la composition de la façade (Fig. 1) est aménagé un double escalier de pierre s'appuyant sur deux voûtes, dont l'une en quart de cercle et l'autre semicirculaire. C'est là la variante la plus évoluée de l'escalier dans l'habitation scutarine, ayant un caractère monumental et grandiose par rapport à l'architecture légère et transparente du tchardak.

La maison N° 4 (Tab. IV)

A la différence des autres maisons, les escaliers conduisant au premier étage sont à une rampe et n'ont que les quatre premières marches en pierre. C'est là la variante la plus ancienne en date et la plus simple de l'escalier dans l'habitation scutarine. En ce cas le tchardak s'étend sur une surface plus grande que la surface destinée à l'habitation vraie et propre. Des traces du «qoshk» n'ont pas été relevées, ce qui n'exclut pas la possibilité de son existence sur une surface si étendue. A proximité du tchardak sont disposées en son milieu la chambre du feu, à sa gauche la chambre des amis et à sa droite la chambre de séjour.

La maison N° 5 (Tab. V).

C'est une des habitations la plus grande de la ville de Shkoder. Son premier étage comporte quatre pièces en plus du tchardak. Au centre vient la chambre du feu, qui, à son état actuel, conserve presque entièrement sa composition originale. A relever surtout le foyer, d'un grand intérêt, aménagé sur la face latérale du mur. De forme rectangulaire, il se termine en haut en forme de cône. Sa partie inférieure s'élève environ 60 cm du niveau du plancher et dépasse de 15 cm la maçonnerie. C'est ici qu'ont été aménagées deux cannelures servant à allumer le feu. A l'angle du mur, à proximité du tchardak se trouve le four. La chambre des amis se trouve à la gauche de la chambre du feu, où l'on prépare les aliments, et ses différents éléments constitutifs se caractérisent par un décor riche. Quant aux deux autres chambres, elles sont plus petites et se caractérisent par un traitement plus simple de leurs éléments.

Le tchardak (Fig. 2) est un élément habituel et dans le même temps très important, de l'habitation scutarine, en raison d'une série de fonctions qu'il remplit. Il a toujours la forme d'un rectangle, dont les côtés plus longs longent la façade de l'habitation. Sa façade comporte une ou plusieurs rangées de colonnes de bois se terminant par des arêtes travaillées avec beaucoup de goût et elle est fermée par une balustrade de bois simple. Le tchardak n'étant pas plafonné, toute la construction du toit reste découverte.

Le tchardak, en sa qualité de pièce ouverte communiquant directement avec le milieu environnant (Fig. 3), sert dans le même temps comme lieu de séjour et donne la possibilité à ses habitants d'admirer la nature qui s'étend devant leurs yeux. C'est pourquoi les mains habiles des maîtres bâtisseurs ont aménagé ici des éléments tranquilles et quelque peu plus élevés, par rapport au niveau du plancher. Il s'agit de constructions légères, le «sofa» et le «qoshk», dont le deuxième s'élève au-dessus du la premier entouré d'une balustrade (Fig. 4), en embellissant de la sorte la façade de l'habitation scutarine.

Par la réduction des dimensions du tchardak et par sa fermeture, le «sofa» et le «qoshk» finissent par devenir des pièces destinées à l'habitation, une fois qu'ils sont entourés de parois en pan de bois. (Fig. 5). Il n'est pas difficile de relever leur fonction initiale, d'autant plus que leurs fenêtres se trouvent à un niveau plus élevé que celui des autres pièces, en raison de la différence de niveau par rapport au plancher du tchardak.

Actuellement peu nombreux sont les tchardaks conservés à leur état original, la plupart d'entres eux ayant subi des modifications.

Cette maison d'habitation ouverte sur toute la longueur de la façade communique directement avec la nature environnante. Ses auvents larges, ainsi que son tchardak avec ses éléments constitutifs, créent sur la façade un profond contraste de lumière et d'ombre et confèrent à l'habitation même un aspect plus léger et transparent.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Leonard SULI

STUDIM PËR RESTAURIMIN E BANESËS SË KABILAJVE NË QYTETIN E GJIROKASTRËS*)

Në kompozimin arkitektonik të lagjes «Teqe»[1] bën pjesë dhe banesa e Kabilajve (Fig. 1). Ajo është e qarkuar me mure rrethuese, brenda të cilave ndodhen dy oborre. Në të parin afër portës kryesore është vendosur odajashta, kurse në të dytin vetë banesa (Tab. 1). Banesa e Kabilajve i përket fillimit të shek. XIX. Ndërtimin e saj, si dhe atë të Zekateve, banorët e vjetër të qytetit e lidhin me emrin e Ali Pashë Tepelenës. Mendohet se banesa në fjalë është «saraj»[2] i Nelo Kabilit, i cili ishte pronar tokash dhe sipërmarrës në punimet e kalasë. Ndërtimi i plotë i banesës duhet të ketë përfunduar në vitin 1816[3]. Emërtimi «saraj» nuk është ndonjë ekzagjerim i madh për këtë banesë, që me përmasat e mëdha, me karakterin e theksuar monumental, me pasurinë e madhe të ornamentikës përbën një rast bindës të nivelit të lartë që arriti banesa gjirokastrite[4].

Kjo banesë gjatë kohës ka pësuar shumë transformime dhe është dëmtuar rëndë nga bombardimi i vitit 1941. Kështu që ajo ndodhet në një gjendje jo të mirë teknike (Fig. 2), e si pasojë restaurimi i saj na paraqitej me një sërë problemesh, si nga pikëpamja konstruktive, ashtu dhe nga ana arkitektonike. Prandaj u pa e domosdoshme të bëhej në radhë të parë studimi i gjendjes së monumentit në tërë kompleksin e tij, përcaktimi i fazave kryesore të ndërtimit, ndryshimet e tjera që ka pësuar si në kohë dhe së fundi hartimi i projektit të restaurimit. Pikërisht rezultatet e këtij studimi, të kryer në vitin 1974, janë dhe synimi i këtij artikulli.

Gjendja dhe ndryshimet që ka pësuar monumenti në kohë. Muret rrethuese që qarkojnë banesën janë të ndërtuara me gurë të lidhur përgjithësisht me llaç gëlqereje. Lartësia e tyre është kushtëzuar nga forma e terrenit. Në pjesën verilindore dhe veriperëndimore, ku muri arrin deri në 5 m, ai forcohet me kontraforte (Fig. 3). Gjatë kohës muri veriperëndimor është ndërprerë nga vetë banorët për të pasur një lidhje direkt me oborrin e dytë ku është vendosur banesa. E orientuar nga lindja, paralel me rrugën që të çon në lagjen «Dunavat», ndodhet porta kryesore e hyrjes (Tab. 2), nëpërmjet së cilës komunikohet me oborrin e parë. Porta është e harkuar dhe ka relativisht përmasa të mëdha; mbi harkun gjysmërrethor, i cili mbulon hapësirën e portës në pjesën e përparme, janë ndërtuar dhe dy harqe të tjera dekorative që influencojnë pozitivisht në pamjen e saj. Hapësira e brendshme mbulohet me arkitrarë druri. Të dy flegrat prej druri lisi

---

* Rilevimet janë të autorit E. Harxhit dhe B. Penxhës, vizatimet të F. Zarshatit, fotot të E. Rizës dhe R. Veselit, por janë shfrytëzuar dhe fotografitë e vjetra që ndodheshin në arkivin e Institutit.

1) Lagjja e vjetër «Teqe» sot quhet lagjja «Partizani». Banesa e Kabilajve ndodhet në rrugën «Abdyl Frashëri» Nr. 6.

2) turq, pallat. Me këtë emër e quajnë banesën e Kabilajve banorët e vjetër të qytetit.

3) Një nga banorët e vjetër të banesës thotë se mban mend shifrën 6; e cila ishte shifra e fundit e datës së shënuar në banesë.

4) E. Riza. **Banesa e fortifikuar gjirokastrite,** Monumentet 1, 1971, f. 130.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 1

dhe katarahu mungojnë. Duke u bazuar në teknikën e ndërtimit të konstruksionit prej guri në krahasim me atë të portave të tjera të qytetit, dallojmë se gjatë kohës ajo ka pësuar një rikonstruksion. Përbri portës së mësipërme, në brendësi të oborrit të parë, është vendosur odajashta (Tab. II) që shërbente sipas pozitës shoqërore të pronarit të banesës si vend qëndrimi për trimat, shërbyesit, miqtë e dorës së dytë etj.[5] Ndërtimi është dykatësh dhe pjesërisht trekatësh prej guri, me shtrirje sipërfaqësore thuajse të barabartë në të dy katet e sipërme. Katet ndërlidhen me shkallë të brendshme prej druri. Kati përdhes përbëhet prej 4 ambientesh, të cilat janë pa tavan, të pasuvatuara dhe të pashtruara. Ambienti Nr. 1 ka shërbyer si nëndivan dhe ka ndërlidhje të drejtpërdrejtë me dy ambiente. Këtu janë vendosur shkallët prej druri që të lidhin me katin e parë. Në pamjen jugore është vendosur hyrja, e vetmja që ka pasur odajashta, e cila më vonë është murosur. Ambienti Nr. 2 ka shërbyer si depo dhe merrte një dritë të pakët nga frëngjia e vendosur në faqen veriore, përbri së cilës më vonë është hapur një derë. Ambienti Nr. 3 merr dritë nga dy dritare të faqes lindore, kurse në faqen jugore ndodhet oxhaku dhe dy kamare anash tij. Ekzistenca e tyre përbën një rast të rrallë në ambientet e katit përdhe të odajashtës. Ambienti Nr. 4, në brendësinë e të cilit të çojnë shkallët prej druri ka mundësi të ketë shërbyer për mbajtjen e barit të kafshëve. Ai është i mbuluar me qemer cilindrik me hark gjysmërrethor, i forcuar me tirante druri, të cilave u kanë mbetur vetëm gjurmët. Ndriçohet vetëm nga një dritare në faqen veriore. Dyshemeja zbret duke ndjekur pjerrësinë

5) E. Riza, Vep. cit. f. 130.

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

e terrenit nga pjesa më e ulët e saj. Ajo ka një diferencë lartësie thuajse prej një kati me nivelin e dyshemesë së tri ambienteve të tjera të katit përdhe. Të njëjtin numër ambientesh përmban dhe kati i parë, tre prej të cilave kanë ndërlidhje të drejtpërdrejta me ambientin Nr. 5 që kryen funksionin e një divani. Të gjitha ambientet kanë tavan, dysheme dërrase dhe janë të suvatuara. Në faqen lindore të ambientit Nr. 5 përbri dritares së vetme që ka pasur ai është hapur më vonë një derë që komunikon me oborrin. Ambienti Nr. 6 ka shërbyer për banim dhe merr ndriçim nëpërmjet dy dritareve të mëdha me hapje vertikale të vendosura në faqen veriore. Në ambientin Nr. 7, i cili ka qenë oda e miqve në kompozimin e elementeve të brendësisë së tij, shohim një përkujdesje të veçantë, në krahasim me ambientet e tjera. Në faqen ballore në skeletin prej çatmaje, janë ndërtuar tri dritare të njëjta me ato të ambientit Nr. 6. Përveç këtyre ajo merr ndriçim nga një dritare e mbrojtur me hekura, e vendosur në faqen lindore. Tavani në mesin e tij ka të vendosur një rozetë të punuar me ornamentikë të thjeshtë. Në faqen e murit që e kufizon odën e miqve me ambientin Nr. 6 gjenden dy dollapë të pajisur me kapakë druri të gdhendur. Në pjesën fundore në bazë të gjurmëve që ekzistojnë ka qenë ndërtuar një çatma, në anën e majtë të së cilës vendosej dera, e cila nëpërmjet parahyrjes të lidhte me ambientin sanitar, odën e zjarrit dhe divanin. Në gjendjen e sotme

oda ka pësuar disa ndryshime, për shembull çatmaja është spostuar më në brendi të ambientit duke zvogëluar kështu sipërfaqen e tij, gjithashtu është zmadhuar dritarja e ambientit sanitar. Në zgjatim të odës së miqve ndodhet ambienti Nr. 8 që ka shërbyer si odë zjarri. Në faqen jugore të tij është vendosur oxhaku me dy kamaret. Ndriçohet nga lindja nëpërmjet dy dritareve, njëra prej të cilave, ajo në të majtë, është zmadhuar më vonë. Konstruksioni i çatisë është i ri.

Komunikimi nga oborri i parë në oborrin e dytë, ku është vendosur banesa, realizohet nëpërmjet portës së harkuar që mbështetej në murin e pamjes kryesore të banesës. Portës i kanë mbetur vetëm gjurmët e shpatullës së djathtë. Banesa është një ndërtim trekatësh dhe pjesërisht katërkatësh (Tab. I, III, IV, V, VII, VIII), me shtrirje sipërfaqësore thuajse të bara bartë për të tri katet. Në planimetri ajo ka formën shkronjës L. Katet ndërlidhen me shkallë të brendsh me guri dhe druri. Ajo i përket variantit me zhvillin në një krah. Pamja kryesore e banesës (Tab. 8) është e orientuar nga verilindja thuajse përballë qendrës së qytetit (qafës së pazarit). Në këtë pamje janë vendosur dy hyrje të harkuara, nëpërmjet të cilave komunikon me nëndivanin e katit përdhe (Tab. I). Hyrja e majtë (Fig. 4) është ndërtuar me një përkujdesje të veçantë. Në gurët që formojnë dy harqet e saj janë skalitur me mjeshtëri zogj dhe konfiguracione të ndryshme. Ndërsa hyrja e djathtë (Fig. 5) ndryshon mjaft nga teknika e ndërtimit e hyrjes së majtë. Duke u nisur dhe nga vendi që zë ajo në kompozimin e pamjes kryesore, kuptohet se është ndërtuar më vo-



Fig. 4



Fig. 5

DO NOT COPY

në. Kati përdhes përbëhet nga 6 ambiente, të cilat, përveç ambientit Nr. 6, kanë ndërlidhje të drejtpërdrejtë me ambientin Nr. 1. Gjendjen dhe transformimet që kanë pësuar ato po i rendisim për çdo ambient radhazi.

Ambienti Nr. 1. Është nëndivani që ka formën e një katërkëndëshi të përzgjatur dhe zë një sipërfaqe më të madhe se ambientet përreth tij, ai është i shtruar me pllaka guri dhe mbulohet me qemer cilindrik me hark gjysmërrethor, ndriçohet nga 4 dritare të harkuara dhe të mbrojtura me hekura të vendosura në faqen veriperëndimore, njëra prej të cilave është vendosur në pjesën e sipërme. Në faqen verilindore janë ndërtuar dy palë shkallë prej guri (Tab. I. IV). Shkalla në të majtë (Fig. 6) përbëhet nga dy rampa, nga të cilat e para është e përbërë nga 5 këmbë shkallë të mbështetura në bazament të plotë guri, kurse rampa e dytë, që është dhe kryesorja, mbështetet në këtë bazament dhe në dy hapësira, të mbuluara përkatësisht me qemerë çerek dhe gjysmërrethorë. Shkallët janë të ndërtuara me gurë të skalitur dhe të shtruara me rrasa guri të punuara me kujdes. Sheshpushimi i parë është i mbuluar me qemer me hark gjysmërrethor, ndërsa një pjesë e rampës kryesore mbulohej me dysheme prej dërrase, gjurmët e trarëve të së cilës dallohen qartë. Shkallët marrin ndriçim nga verilindja nga dy dritare të vendosura mbi njëra-tjetrën me formë si ato të nëndivanit. Shkallët e djathta, dy rampat e të cilave mbështeten mbi bazament të plotë guri, marrin ndriçim nëpërmjet dy dritareve të



Fig. 6



Fig. 7

DO NOT COPY

vendosura në pamjen kryesore (Tab. VIII), njëra prej të cilave, me përmasa të vogla dhe e mbuluar me arkitra guri, ndriçon kryesisht sheshpushimin dhe rampën e dytë. Tjetra është e harkuar dhe ndriçon kryesisht divanin e katit të parë. Kjo në krahasim me dritaren e vendosur mbi hyrjen origjinale ka përmasa më të mëdha dhe dyshemeja e saj është në një nivel me atë të divanit, gjë që na shtyn të pohojmë se është ndërtuar më vonë. Ndryshimi kryesor që ka pësuar nëndivani nga kompozimi fillestar i brendësisë së tij është ndërtimi i mëvonshëm i shkallëve të djathta të përshkruara më sipër. Për këtë pohim bazohemi në këto arsyetime:

Ndërtimi i tyre nuk është bërë me atë teknikë dhe përkujdesje që pamë në shkallët e majta.

Ambienti në të cilin janë ndërtuar fillimisht ka qenë katua i mbuluar me qemer cilindrik gjysmërrethor, gjurmët e të cilit shihen qartë (Fig. 7). Meqenëse hapja e hyrjes së dytë në pamjen kryesore, ndërtimi i shkallëve të djathta dhe i dritareve për ndriçimin e tyre kanë një lidhje të përbashkët për sa i përket anës funksionale dhe përkojnë nga teknika e ndërtimit, mund të themi se ndërtimi i tyre është bërë në të njëjtën kohë dhe i takon fazës së dytë. Mendojmë se arsyeja kryesore e këtyre transformimeve ka qenë nevoja për të pasur komunikim më vete mbas ndarjes së trashëgimtarëve. Përveç ambientit Nr. 6 që është transformuar ambientet e tjera të këtij kati, ashtu si nëndivani, janë të shtruara me rrasa guri të pasuvatuara dhe mbulohen me qemer cilindrik, me hark gjysmërrethor, mbi të cilin mbështetet e gjithë dyshemeja e katit të parë, rast ky unikal në Gjirokastër. Këto ambiente janë katonj që kanë shërbyer për mbajtjen e barit të kafshëve dhe zahireve të dimrit. Në përgjithësi ato ndriçohen nga dritare të njëllojta me ato të nëndivanit. Dyert që kryejnë ndërlidhje midis tyre dhe nëndivanit janë të harkuara, me përjashtim të derës që lidh nëndivanin me ambientin Nr. 4, e cila është e mbuluar me arkitra.

Ambienti Nr. 2. Që zë një sipërfaqe më të madhe se katonjtë e tjerë, ndriçohet nga dy dritare të vendosura në faqen verilindore, të të cilën më vonë është hapur një derë, tiranteve prej druri u kanë mbetur vetëm gjurmët.

Ambienti Nr. 3. Ka qenë krejtësisht i pandriçuar (më vonë është hapur një dritare në faqen verilindore për të marrë ndriçim nga ambienti Nr. 2). Në faqen juglindore ndodhet një vend i fshehtë. Hyrja në të bëhet nga ambienti Nr. 3 i katit të parë.

Ambienti Nr. 4 ka formë planimetrike thuajse katrore me një sipërfaqe afërsisht sa gjysma e çdonjërit prej katonjve të tjerë. Ky lidhet me anën e dy dyerve me ambientin Nr. 6 dhe nëndivanin. Gjatë kohës ka pësuar ndryshime, të cilat nuk kanë lidhje me ato të fazës së dytë. Në brendësi të tij është ndërtua një çatma, si pasojë e së cilës është formuar një ambient i ri, i cili ndahet në lartësi nga një dysheme dërrase, tek e cila të çon një shkallë druri. Pjesa e sipërme është përdorur për mbajtjen e zahireve të dimrit. Mungojnë tirantet e drurit të qemerit. Kanë mbetur vetëm gjurmët e tyre.

Ambienti Nr. 5, i cili ruan gjendjen fillestare, ndriçohet nga veriperëndimi nëpërmjet 3 dritareve, njëra prej të cilave është e vendosur në rreshtin e dytë. Në të tri faqet e katoit shohim të vendosura kamare të harkuara. Një derë e vetme e lidh atë me nëndivanin.

Ambienti Nr. 6 i vendosur në pjesën fundore të banesës mendojmë të ketë qenë fillimisht katua i mbuluar me qemer. Sot ai është krejtësisht i ttansformuar. Përveç dritares në faqen veriperëndimore dhe dyshemesë me rrasa guri atij nuk i ka mbetur tjetër gjurmë. Ai mbulohet nga dyshemeja prej dërrase që u përket ambienteve të gatimit të katit të dytë dhe është i suvatuar. Në mesin e tij janë ndërtuar shkallët spirale prej druri që e ndërlidhin ambientin me ambientet e gatimit të katit të parë dhe me divanin e sipërm të kësaj pjese të banesës. Ndërtimi i shkallëve spirale prej druri dhe rikonstruksioni i bërë në disa elemente të jashtme dhe të brendshme në disa ambiente të dy kateve të mësipërme i përkasin fazës së tretë të ndërtimit. Poshtë nëndivanit në pjesën më të ulët të banesës ndodhet stera e ujit (Tab. I, V), për pirje dhe larje, furnizimi i së cilës bëhet me ujin e shiut të mbledhur nga çatia me anën e qyngjeve. Stera ka një sipërfaqe thuajse të barabartë me nëndivanin. Ajo është e shtruar me pllaka guri dhe e mbuluar me qemer cilindrik me hark gjysmërrethor. Të katër faqet e saj janë të suvatuara me llaç të papërshkueshëm nga uji. Marrja e ujit prej sterës bëhet nga brenda, prej pusit që ndodhet në nëndivan dhe nga jashtë nëpërmjet një lëfyti të vendosur rreth 30 cm më sipër sesa niveli i dyshemesë së sterës, tek i cili të çojnë shkallët prej guri (Fig. 8) të mbuluara me qemer cilindrik me hark gjysmërrethor (Tab. I, IV). Pastrimi i saj bëhet duke hyrë nga një dritare e mbuluar me arkitra guri e vendosur në pamjen veriperëndimore (Tab. VIII). Rreth 20 cm nga dyshemeja e dritares ndodhet tubi për shkarkimin e ujërave të tepërta. Volumi i ujit që përmban stera është afro 130 m^3. Jashtë volumit të ndërtimit në të majtë të pamjes kryesore ka qenë kamerieja e zbuluar (Tab. I, VII, VIII) si pasojë e dëmtimit të rëndë që ka pësuar ajo nga bombardimi. Në gjendjen e sotme i kanë mbetur vetëm dy harqe të vogla të hapësirës juglindore që mbështeten në qendër në një kolonë të ndërtuar me gurë të rrumbullakët (Fig. 9). Gjendjen e saj fillestare në përgjithësi mendojmë se mund ta përcaktojmë duke u bazuar kryesisht në këto arsyetime: 1) Meqenëse

Download

hapësirat në planimetri janë pothuajse të barabarta, dhe zgjidhja konstruktive arkitektonike e dy hapësirave të tjera duhet të ketë qenë e njëllojtë. 2) Për pjesën e sipërme në bazë të gjurmëve të tiranteve prej druri që janë vendosur 70 m nga maja e harqeve të vogla, mund të përcaktojmë qemerin cilindrik gjysmërrethor me aksin nga veriu në lindje mbi të cilin mbështetej dyshemeja prej pllakash e kameries së katit të tretë, që kryente funksionin e një ballkoni. Kati i parë i banesës ose «pati», siç e quajnë vendësit, përbëhet ashtu si kati përdhes prej 6 ambientesh (Tab. III). Ambientet e banimit të këtij kati ose «dimëroret», të quajtura kështu se këtu banohej në stinën e dimrit, janë me volum më të paktë meqenëse lartësia e tyre është më e vogël se ajo e ambienteve të banimit të katit të dytë. Përveç ambientit Nr. 1 të gjitha të tjerat kanë tavan, dysheme dhe janë të suvatuara. Odat në përgjithësi janë pajisur me dy lloj dritaresh. Të poshtmet janë të harkuara, të mbrojtura me hekura të pajisur me kapakë druri nga brenda, kurse të sipërmet janë fikse, dyfishe, të ndërtuara me skelet allçie vetëm për ndriçim. Gjithashtu dyert janë të harkuara dhe njëflegërshe. Ambienti Nr. 1 është divani, i cili kryen funksion ndërlidhës për ambientet e tjera. Ai është krejtësisht i mbyllur, i shtruar me pllaka guri dhe pjesërisht i suvatuar. Divani nuk ka pasur tavan, por mbulohej nga dyshemeja e divanit të sipërm. Divani është dëmtuar mjaft nga bombardimi dhe ka pësuar transformime, një pjesë e të cilave lidhen me fazën e dytë të ndërtimit. Ai merrte ndriçim nga verilindja nga dy radhë dritaresh, prej të cilave ekzistojnë 3 të poshtmet, që së bashku me dyshemenë e divanit janë restauruar nga Atelieja e Gjirokastrës. Kurse tre të sipërmet për analogji me pjesën ballore të ambientit 3 dhe të dritareve të pjesës së sipërme të murit që kufizon ambientin Nr. 4 dhe Nr. 5, me divanin, duhet të kenë qenë prej skeleti allçie vetëm për ndriçim.

Në faqen verilindore, në anën e majtë të divanit, në brendësinë e ambientit të ndërtuar kohët e fundit, ndodhet dera e harkuar që të çon në ambientin përmbi shkallët në pjesën fundore të tij përmbi dyshemenë prej dërrase, ka qenë ndërtuar një çatma, në të cilën ka qenë një dritare e vogël për të vrojtuar se kush ngjitej nëpër shkallë. Gjurmët e çatmasë ruhen akoma. I gjithë kafazi i shkallëve mbulohej me qemer gjysmërrethor, gjurmët e të cilit dallohen qartë (Tab. IV). Simbas rilevimit të vitit 1962 ky ambient ndriçohej nga dy dritare të ndërtuara në pjesën e poshtme, nga veriperëndimi dhe nga verilindja. Me anën e kësaj të fundit vrojtohej pjesa e poshtme e kameries. Forma e dritareve duhet të ketë qenë e njëllojtë me dritaret e poshtme të këtij kati. Në pjesën e djathtë të divanit është ndërtuar kohët e fundit një ambient. Po në këtë anë ndodhet hapësira e shkallëve të ndërtua-



Fig. 8



Fig. 9

DO NOT COPY



Fig. 10

ra në fazën e dytë, si pasojë e së cilës është zvogëluar sipërfaqja e dyshemesë së divanit, gjithashtu në këtë anë në faqen verilindore kanë qenë shkallët e vetme prej guri që lidhnin divanin me divanin e sipërm. Shkallët përbëheshin nga një rampë e vetme, e cila mbështetej përkatësisht mbi qemerë çerek dhe gjysmërrethorë. Prej tyre ruhen ende gjurmët e 3 shkallëve të sipërme (Tab. IV).

Ambienti Nr. 2 është ambient banimi. Atë sot e gjejmë të transformuar krejtësisht. Këto transformime nuk lidhen me asnjë nga fazat kryesore, por janë të kohëve të fundit. Ndryshimi kryesor që ka pësuar ai, ka ardhur si pasojë e ndërtimit të mëvonshëm në brendësinë e tij të dy pareteve prej çatmaje, në mes të të cilave janë ndërtuar shkallët prej druri që të çojnë në ambientin Nr. 2 të katit të sipërm. Në pjesën ballore janë vendosur 6 dritare. Tre të sipërmet, të cilat i gjejmë të murosuran për analogji me ato të ambientit Nr. 3, kanë qenë prej skeleti allçie. Gjithashtu në të dy anët e pjesës ballore ka nga dy dritare njëra mbi tjetrën (në këto anë të sipërmet janë murosur). Në faqen C dallojmë konturet e dy dollapeve muri së bashku me gjurmët e oxhakut dhe të dy kamareve anash tij, të gjitha të murosura. Në vazhdim të faqes C janë hapur më vonë dy dritare. Ndryshimi i tyre nga ato origjinalet duket qartë. Në faqen kundrejt përballë shkallëve është hapur një derë, po në këtë faqe gjejmë gjurmët e 3 dollapeve muri. Në pjesën fundore mungon volumi karakteristik prej druri, i cili për analogji me ambientin Nr. 3 përmbante në pjesën e poshtme musandaranë dhe dy dyert, njëra prej të cilave të çonte në ambientin sanitar dhe tjetra nëpërmjet parahyrjes të lidhte me didanin.

Ambienti Nr. 3 është ambient banimi i vetmi në të gjithë banesën që nuk ka pësuar ndryshime të mëdha në brendësinë e tij. Në pjesën ballore ka dritare të vendosura në dy rreshta 3 nga 3 mbi njëri -tjetrin. (Fig. 10). Ai merr ndriçim nga verilindja nga dy dritare të vendosura mbi njëra-tjetrën. Dy dolla pet e murit të vendosura në këtë faqe janë pajisur m kapakë druri të gdhendur me mjeshtëri. Në faqen jug perëndimore dallojmë konturet e oxhakut dhe të d kamareve të murosura. Në pjesën fundore ndodhe volumi karakteristik prej druri që përmban në pjesën e poshtme musandaranë për mbajtjen e shtresave dhe në të sipërmen dhipaton për mbajtjen e zahireve, në të cilën të çojnë një palë shkallë të lehta prej druri. Në të dy anët e musandarasë janë dy dyer nga të cilat e para të çon të shkallët e mësipërme, kurse e dyta nëpërmjet një parahyrjeje të lidh me ambientin sanitar, me ambientin Nr. 4 dhe divanin.

Ambienti Nr. 4 i ndodhur në mes të ambienteve Nr. 3 dhe Nr. 5, zë një sipërfaqe më të vogël se ambientet e tjera të këtij kati. Duke u nisur dhe nga kompozimi i elementeve të brendësisë së tij, të lë të kuptosh se ky ambient është oda e zjarrit. Ai merr ndriçim nga divani nga dy dritare të vendosura dy nga dy mbi njëra-tjetrën. Dera që e lidh atë me divanin është murosur. Në faqen b duken konturet e oxhakut dhe të dy kamareve anash tij, të cilat janë murosur, kurse në faqen C janë hapur më vonë dy dritare, njëra prej të cilave është hapur aty ku më përpara ka qenë një dollap muri, i cili i shërbente ambientit Nr. 6.

Ambienti Nr. 5, ashtu si ambienti Nr. 2 dhe ai Nr. 3, ka shërbyer për banim, por sot e gjejmë të transformuar. Në pjesën ballore ka të vendosur 6 dritare dhe në të dy anët e kësaj pjese ka nga dy dritare (forma dhe mënyra e vendosjes është analoge me ato të pjesës ballore të ambientit Nr. 2). Të gjitha dritaret e sipërme i gjejmë të murosura. Në faqen jugperëndimore janë murosur oxhaku me kamaret dhe një dollap muri. Më vonë është hapur një derë që komunikon me brendësinë e ambientit të ndërtuar në pjesën e majtë të divanit. Në pjesën fundore ku fillimisht ka qenë volumi karakteristik i njëllojtë me atë të ambientit Nr. 3, më vonë janë ndërtuar shkallët prej druri që gjejmë sot. Çatmatë e ndërtuara në brendësi të tij e ndajnë atë në dy pjesë.

Ambienti Nr. 6 i vendosur në pjesën fundore të banesës është përdorur për gatim. Në mesin e faqes veriperëndimore është vendosur oxhaku dhe dy kamaret, kurse në të dy anët e tij janë dy dritare. Në faqen përballë ekziston dhe një oxhak tjetër dhe dy dritare me përmasa më të vogla se të parat. Në mesin e ambientit janë shkallët spirale prej druri, të cilat i përkasin rikonstruksionit të vitit 1894 që përfaqëson fazën e tretë të ndërtimit.

Kati i dytë i banesës (Tab. III) ka numër të ba-

DO NOT COPY

rabartë ambientesh me katin e parë. Divani i sipërm i hapur në pjesën ballore, lartësia e ambienteve më e madhe se në ato të katit të parë, i bën ato më të freskëta, të kenë më tepër ndriçim, prandaj dhe në to banohej vetëm në stinën e verës. Ambientet kanë tavan dhe dysheme dërrase dhe janë të suvatuara. Në përgjithësi ato ndriçohen nga dy radhë dritaresh, të vendosura mbi njëra-tjetrën. Dritaret e rreshtit të poshtëm mbulohen me arkitra druri dhe janë pajisur nga jashtë me kapakë druri, kurse të sipërmet janë analoge me dritaret e sipërme të katit të parë.

Ambienti Nr. 1 është divani i sipërm, nga i cili kryhej ndërlidhja me ambientet e tjera, të vendosura rreth tij. Ai nuk ka funksionin e dorës së parë që ka divani në banesën e Beratit, të Shkodrës, të Elbasanit etj., ku shërbente si vend për përpunimin e produkteve bujqësore dhe të punimeve artizanale[6]). Përveç funksionit ndërlidhës, divani i sipërm shërben si vend çlodhjeje, sepse pjesa ballore e tij, krejtësisht e hapur, lejonte një komunikim direkt me natyrën. Në stinën e verës përveç ndenjjes përdorej dhe për të fjetur. Si pasojë e bombardimit ai është dëmtuar rëndë dhe është bërë i pafunksionueshëm. Në bazë të gjurmëve të mbetura, dhe të dhënave gojore të banorëve më të vjetër, mendojmë se mund të paraqesim në përgjithësi gjendjen fillestare. Divani i sipërm ka pasur kryesisht dysheme dërrase, gjurmët e trarëve të të cilës duken qartë në pjesën fundore, kurse në pjesën e përparme ka qenë shtruar me pllaka guri, një pjesë e të cilave ekziston. Në anën e majtë ka pasur sofa dhe përmbi qemerin që mbulonte shkallët e gurit ka qenë tahtaposhi, i ngritur rreth 60 cm nga niveli i dyshemesë (Tab. IV). Përmbi dyshemenë prej pllakash të pjesës ballore mbështeteshin dy radhë shtyllash druri që mbanin arkadat, mbi të cilat mbështetej konstruksioni i çatisë. Tavani i divanit të sipërm formohej nga tri tavane të veçanta. Secili prej tyre kishte nga një rozetë në mesin e tij. Në faqen veriperëndimore ai, për analogji me atë të divanit të katit të parë, ka pasur 6 dritare të vendosura tri nga tri njëra mbi tjetrën me të njëjtën formë dhe funksion si ato të pjesës ballore të odës së miqve. Divani i sipërm ka qenë i suvatuar dhe i pikturuar me motive floreale. Gjurmët e këtyre pikturave ruhen ende.

Ambienti Nr. 2 i vendosur në të djathtë të divanit të sipërm është oda e miqve, që përfaqësonte ambientin më të pasur të banesës. Balli i saj është ndërtuar me skelet të hollë, për arsye se në këtë kat nevoja për mbrojtje zvogëlohej dhe njëkohësisht krijohej mundësia e një komunikimi më të afërt me natyrën. Përveç 6 dritareve të vendosura në pjesën ballore ajo merr ndriçim dhe nga dy çifte dritaresh të vendosura në të dy anët e saj (dritaret e sipërme i gjejmë të murosura). Nga sondazhet e bëra rezulton se oda e miqve ka qenë e suvatuar dhe e pikturuar. Tavani i saj duke u bazuar në teknikën e tij të thjeshtë, pa asnjë dekoracion, themi se është i rindërtuar më vonë. Gjithashtu më vonë janë ndërtuar në brendi të odës dy skelete prej çatmaje, kurse në mes të faqes juglindore shohim gjurmët e oxhakut dekorativ dhe të dy kamareve, në faqen përkundrejt gjurmët e tri dollapeve muri, ndërsa në pjesën fundore mungon volumi karakteristik musandër-dhipato.

Në ambientin Nr. 3 elemente të veçanta kanë pësuar një sërë ndryshimesh, të cilat kanë tjetërsuar formën, konstruksionin dhe funksionin fillestar. Të gjitha këto ndryshime kanë ardhur si rezultat i rikonstruksionit të bërë në vitin 1894. Ambienti merr ndriçim nëpërmjet 3 dritareve të mëdha me hapje vertikale të vendosura në pjesën ballore dhe nga verilindja nga një dritare e njëllojtë me të parat. Megjithëse nuk gjejmë asnjë gjurmë, mendojmë se numri, forma dhe mënyra e vendosjes së dritareve përpara rikonstruksionit, për analogji, duhet të ketë qenë si ato të pjesës ballore të odës së miqve. Gjithashtu mafili prej druri është zëvendësuar me mafilin prej çatmaje të suvatuar, në këtë kohë është ndërtuar dhe divani prej dërrase në të tria anët e odës, kurse oxhaku me dykamaret është murosur më vonë. Përveç elementeve të brendësisë së ambientit rikonstruksioni ka prekur dhe elemente të jashtme si për shembull shkurtimin e strehës dhe veshjen e saj me dërrasë dhe punimin e suvasë me fashatura anësore (Fig. 11).

Ambienti Nr. 4. Vendi i tij në kompozim të lë të kuptosh se ka kryer të njëjtin funksion si të ambientit nën të. Ai ndriçohet nga divani i sipërm nëpërmjet 5 dritareve të vendosura: dy në pjesën e poshtme, njëra prej të cilave është e murosur, dhe tri në pjesën e sipërme; në faqen juglindore gjejmë të murosur oxhakun dhe dy kamaret. Dy dyer e ndërlidhin atë me ambientin Nr. 6 dhe divanin e sipërm.

Ambienti Nr. 5 ka pësuar shumë transformime, të cilat nuk kanë lidhje me fazat kryesore, por janë bërë në kohë të ndryshme. Nga faqja veriperëndimore, ai merr dritë nga dy radhë dritaresh, kurse në të dy anët e kësaj faqeje merr ndriçim nga 3 çifte dritaresh prej të cilave të gjitha dritaret e sipërme janë murosur. Në vendin e një dritareje të hapur më vonë simbas rilevimit të vitit 1962, ka qenë oxhaku, dy kamaret anash tij dhe dy dollape muri. Dritarja e poshtme dhe tri të sipërmet që merrnin dritë nga divani janë murosur. Gjithashtu në pjesën fundore mungon musandaraja me dhipaton.

6) E. Riza, **vep. cit.** 130, 131.

DOKUMENT

DO NOT COPY



Fig. 11

Ambienti Nr. 6 mendojmë të ketë shërbyer si divan i ambienteve fundore. Në faqen veriperëndimore ka të vendosura 3 dritare si ato të ambientit në mesin e tij, i takojnë rikonstruksionit që përmendëm më sipër. Në faqen jugperëndimore ndodhet ambienti sanitar, i cili ndriçohet nga një dritare shumë e vogël në formë frengjie, ndërsa në faqen juglindore shohim të vendosur një frengji. Ambienti është i mbuluar me tavan dërrase, në mesin e të cilit është punuar një rozetë me dekoracion të thjeshtë. Çatia që shohim sot është e re. Si pasojë e bombardimit konstruksioni dhe forma e saj fillestare kanë ndryshuar krejtësisht.

Pamja e jashtme e banesës ka një trajtim të barazkujdesshëm thuajse në të tri pamjet e saj me përjashtim të asaj jugperëndimore. Por mbi të tria këto shquan pamja kryesore (Tab. VIII) ku dominojnë dy volumet anësore, ai i korpusit kryesor dhe kame rieja. Megjithëse të trajtuara në gjuhë të ndryshme arkitektonike, ato përkojnë për nga volumi dhe kon kurojnë nga elementet e veçanta. Pjesa qendrore me e zhvendosura në thellësi në dy katet e para shkëpu tet mjaft na dy volumet anësore për sa i përket trajti mit të thjeshtë, por bashkohet me to në katin e tret me divanin e sipërm, transparent e plot dritë. Lëvi zja e theksuar e volumeve, lidhja e përsosur me terre nin, shumimi dhe begatia e trajtimit të elementeve të ndryshme arkitektonike, duke u nisur nga poshtëlart e bëjnë këtë vepër një realizim të shquar arkitektur në qytetin-muze të Gjirokastrës.

Materialet dhe teknika e ndërtimit

Banesa është e ndërtuar me mur guri të zi shtre sor të lidhur në përgjithësi me llaç gëlqereje. Mure janë të qarkuara me breza druri prej lisi çdo 0,90--120 m, ato kanë dimensione 3-5 x 6-10 cm, zgjati mi i brezave gjatësore është realizuar duke i vendo sur njëri mbi tjetrin rreth 0,20 cm ose me falo (kalem dhe mbërthehen me gozhdë kovaçi. Ato lidhen me bi narë tërthorë 5 x 6 cm. Në të dy katet e para në për gjithësi dhe në të tri katet e pamjes jugperëndimore brezi i jashtëm është i maskuar me një rresht gurësh për të mos u dëmtuar nga agjentët atmosferikë. Qo shet e banesës janë të ndërtuara me gurë të bardhë të skuadruar. Në katin e dytë takojmë dy teknika të ndryshme me skelet druri. Teknika e parë, shembull i së cilës është balli i ambientit Nr. 2 (Tab. VI), ka rakterizohet nga një sistem shtyllash që lidhen me bi narë horizontalë të përforcuar me binarë vertikalë, të cilët kufizojnë hapësirat e dritareve. Boshllëqet në formë kuadrati janë mbushur me gurë. Trashësia e këtij konstruksioni është rreth 12 cm. Teknikën e dytë e takojmë në pjesët ballore të ambienteve Nr. 3 dhe Nr. 6, e cila i përket rikonstruksionit të vitit 1894 dhe është paraqitur në (Fig. 11). Ajo është realizuar nga një sistem shtyllash vertikale të lidhura me binarë horizontalë që kufizojnë hapësirat e tri dritareve. Në pjesën e poshtme ato përforcohen me binarë verti kalë. Boshllëqet e formuara mbushen me gurë, gjith ashtu dhe pjesa përmbi dritaret është e përforcua me binarë vertikalë, mbi të cilët mbërthehen në të dy anët parete dërrase. Dyshemeja e vjetër, një pje së të së cilës e gjejmë në divanin e sipërm, është e përbërë prej dërrasash të afruara të mbërthyera në trarë me dimensione 10 x 12 cm të vendosura rreth 40 cm larg nga njëri-tjetri. Nga sondazhet e deri tanishme kemi parë këto lloj suvatimesh. Të parin e hasim në ambientin Nr. 6 të katit përdhes dhe men dojmë se është bërë në kohën e rikonstruksionit të vitit 1894. Ky lloj suvatimi është i përbërë prej dy



Fig. 12

DO NOT COPY

shtresash, e para me trashësi 2,5 cm është prej balte të përzier me fije kashte, kurse tjetra rreth 0,5 cm me gëlqere të përzier me lesh dhie. Suvaja e odës së miqve dhe ajo e jashtmja që është e pikturuar është e përbërë nga shtresa e parë që ka trashësi 2-2,5 cm me llaç gëlqereje kurse shtresa e dytë 0,3 – 0,5 cm me gëlqere të përzier me lesh dhie. Suvatimi i sterës është bërë me harasan. Pjesa e jashtme e hapësirave të dritareve dhe të dyerve të brendëshme në të dy katet e para mbulohet me hark guri që është i përbërë prej 2 ose më shumë gurë. Mbi harkun e parë është ndërtuar një hark tjetër me trashësi 5-7 cm, i përbërë prej disa gurësh dhe formon një dhëmb rreth 3-4 cm; me harkun e parë. Kurse pjesa e brendshme e hapësirës së dritareve të rreshtit të poshtëm dhe të dyerve në të gjitha katet është e mbuluar me arkitra druri (Tab. VI). Me përjashtim të dyerve të ambientit Nr. 3 të katit të dytë të gjitha të tjerat janë njëflegërshe.

Restaurimi

Restaurimi i këtij monumenti me vlera të veçanta në gjininë e tij, shtronte në radhë të parë problemin e përcaktimit të kritereve që do të zbatonim në banesën tonë, përcaktim që do të kushtëzonte projektin e restaurimit për kryerjen e këtij studimi, duke pasur për qëllim si restaurimin e ndërtesave ashtu dhe vlerësimin maksimal shkencor e estetik të këtij monumenti, gjetëm si më të përshtatëshëm për rastin tonë këto kritere:

1) Në restaurimin e banesës një vend të rëndësishëm të zërë rikonstruksioni i pjesëve që mungojnë. Jemi të këtij mendimi duke u nisur sa më poshtë:

a. Rasti në shqyrtim është i veçantë për faktin se banesa në fjalë ka një vlerë të madhe arkitektonike dhe artistike, duke qenë një nga kulmet e banesës gjirokastrite.

b. Rikonstruksioni i pjesëve munguese të kësaj



Fig. 13

banese është jo vetëm i nevojshëm, po dhe i mundur, mbasi për këtë ekzistojnë, përveç gjurmëve dhe të dhënave gojore, një numër i madh banesash të të njëjtit tip. Duke qenë tipizimi i elementeve arkitektonike dhe konstruktive një karakteristikë e ndërtimeve popullore, kjo analogji mund të shihet dhe në këto elemente. Si model për pjesët munguese të banesës sonë na kanë shërbyer ato të disa banesave[7] të tjera (Fig. 12).

2) Përveç rikonstruksionit të pjesëve munguese, mendojmë që të heqim transformimet që i përkasin fazës së dytë duke i kthyer pjesët e ndryshuara prej tij në gjendjen fillestare (Tab. I, VIII). Për këtë vendim u mbështetëm në faktin se hapja e hyrjes së dytë në pamjen kryesore dhe ndërtimi i shkallëve të vona prej guri ka dëmtuar unitetin e banesës për sa i përket anës funksionale, njëkohësisht këto transformime kanë tjetërsuar kompozimin arkitektonik fillestar të pamjes kryesore.

3) Rikonstruksionin e vitit 1894 do ta ruc
këto arsye:
a. Duke qenë i datuar ky rikonstruksio
një pikë referimi mbi evolucionin e banesës
te në planin arkitektonik si të jashtëm dh
shëm, e sidomos për elemente të veçan
b. Ndryshimi i këtij rikonstruksioni
shumë hipotetik, mbasi nga gjendja fil
nuk ka mbetur asnjë gjurmë. Mbi fazë
reve hartuam projektin e restaurimit
menti me shumë vlerë në gjininë e
kësaj banese sipas projektit që para
tonte një herë e mirë pjesët e bane
e sotme u janë nënshtruar vepri
mosferikë. Nga ana tjetër kjo ba
numentalitetin (Fig. 13), duke
të karakterit tipologjik. Ky resto
pozitivisht në plotësimin e pa
gjes «Teqe», në të cilën kjo ba

7) Banesa në lagjen «Palorto» Rr. «Themo Vasi» Nr. 2, banesa në lagjen «11 Janari» Rr. «A. Kondi» Nr. 3,5,7, banesa në lagjen Varosh Rr. «K. Bako» Nr. 13, banesa në lagjen «Palorto» Rr. «A. Toto» Nr. 24.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

PLANIMETRIA E KATIT PERDHE

GJENDJA

PROJEKTI I RESTAURIMIT



LEGJENDE

- FAZA E I-RE
- FAZA E II-TE
- FAZA E III-TE v 1894

STERA



GEN-PLANI





TAB. II

ODAJASHTA

PAMJE LINDORE



PAMJE VERIORE



PLANIMETRIA E KATIT PERDHES



GJENDJA

PLANIMETRIA E KATIT I-RE



0 2 4 M

Legjendë

FAZA E I-RE

FAZA E II-TË

DO NOT COPY

Burhan STRAZIMIRI

L'ANCIENNE HABITATION DE LA ZONE DE PREZE

DO NOT COPY

RESUME

La bosse de la zone mamelonnée d'une altitude d'environ de 200 m au-dessus du niveau de la mer, commençant à Vore et s'étendant en direction nord-ouest jusqu'au golfe de Rodon, est parsemée d'une série de villages appartenant à la zone de Preze-Ishem.

Les habitants de cette zone sont pour la plupart des autochtones. Du point de vue administratif, celle-ci relève actuellement des districts de Tirana, Durres et Kruje, tandis que dans le passé elle était plus liée à Durres. Malgré cela, la population de cette zone a entretenu des contacts et des rapports avec les trois districts susmentionnés et à procéder à des échanges de produits d'élevage et agricoles avec ceux-ci.

L'économie de cette zone s'appuie sur l'agriculture, l'oliviculture et l'élevage. En général le manque de terres à titre personnel a contraint les paysans à se placer sous la dépendance économique des propriétaires terriens.

En général les villages de cette zone sont à tel point rassemblés qu'à l'intérieur du même village l'on relève des groupes de maisons constituant des quartiers, appartenant au fis le plus grand qui y habite ou portant son nom.

Des investigations effectuées dans les villages de Preze, entre autres Budell, Buba, Mozhe e Madhe, Mozha e Vogel, Mallkuç, Ahmetaj, Peloj, Kulles, Gjuric, Alsufaj, Kapedanaj, il ressort que la maison caractéristique paysanne, au fur et à mesure que l'on passe de la zone de Preze à celle d'Ishme, malgré les traits architectoniques communs, n'appartient pas au même type. Aussi, partant de ce fait, nous chercherons d'illustrer dans la présente communication seulement l'ancienne habitation de la zone de Preze. Notre but étant celui de définir l'extension territoriale de cette habitation et de relever, dans le même temps, ses traits et particularités architectoniques.

Les profondes transformations économiques et sociales survenues dans les campagnes ont entraîné la disparition totale des constructions auxiliaires et provisoires, ainsi que la modification radicale ou l'abandon des anciennes maisons. Aussi la zone de Preze ne conserve actuellement qu'un nombre fort limité de maisons anciennes caractéristiques, dont les éléments nous ont servi de fondement à la rédaction de la présente communication.

L'habitation de la zone de Preze, dans sa variante plus évoluée, est appelée konak; elle est à deux étages et comporte les pièces suivantes:

Au rez-de-chaussée il y a une pièce appelée maison du feu ou maison du ménage, dont la hauteur occupe les deux étages, puis vient le «burg», une espèce de local destiné au logement des animaux et le «hayat». Le deuxième étage comprend la chambre des amis, le «divanhane» une espèce de halle et parfois la chambre à coucher aussi.

Le noyau autour duquel se développe cette habitation est représentée par la maison du feu. Elle constitue la pièce principale, avec laquelle communiquent toutes les autres pièces de l'habitation, dans toutes les variantes sans exception, depuis celle plus simple à une pièce jusqu'à celle plus évoluée. C'est le milieu où se développe la vie quotidienne, où l'on prépare les aliments et l'on mange, bref où l'on vaque aux soins de l'économie domestique. Le foyer se trouve éloigné des murs extérieurs. Un élément particulier caractérisant toutes les anciennes maisons de la zone de Preze est le «mafil», qui est partie intégrante de la maison du feu. C'est là un balcon en bois large de 1.50 m, traversant une ou deux des faces latérales de la maison du feu à la moitié de sa hauteur. La hauteur même de la chambre du feu rend possible la construction du mafil.

Tout près de la maison du feu au rez-de-chaussée il y aussi le «burg». Il s'agit d'une pièce sombre illuminée par la porte et par deux fenêtres en forme de meurtrières. Habituellement face au «burg» et à la maison du feu se trouve le «hayat», une espèce d'atrium ouvert ou entièrement fermé par des murs de pierre.

Une autre pièce importante de cette habitation est la chambre des amis, disposée toujours au deuxième étage et appelée aussi «kulla des hôtes». Elle est contiguë de la chambre du feu et se trouve toujours au-dessus du burg.

Toute la façade du deuxième étage est parcourue par le «divanhane». Cette pièce se trouve toujours au-dessus du «hayat», généralement elle est fermée de planches de bois.

La chambre à coucher est une pièce que l'on ne retrouve pas dans toutes les habitations.

L'accès au deuxième étage se réalise de dehors à travers des escaliers à une rampe de bois ou de pierre.

Un fait caractéristique: chaque pièce de l'habitation a son noeud sanitaire à elle.

En général les cours des habitations de cette zone ne sont pas cernées, parfois elles sont entourées d'une haie sèche. Selon les témoignages des personnes plus âgées, à proximité de ce

DO NOT COPY

BANESE NE BUBQ





KATI II^TE

GJENDJE

KATI II^TE

RIKONTRUKSION

KATI I^RE



KATI I^RE



DO NOT COPY

KATI I^RE



GJENDJE

KATI I^RE



RIKONSTRUKSION

BANESE NE BUDELL



0 1 2 3



KATI II^TE



KATI II^TE

0 1 2 3 4 M

DO NOT COPY

BANESE NE BUDELL

GJENDJE





KATI IRE

RIKONSTRUKSION

KATI IITE







DO NOT COPY

BANESE NE MAZHE
TE VOGEL



GJENDJE
FILLESTARE

BANESE NE BUBQ



KATI I I^RE



GJENDJE
E SOTME

0 1 2 3 4 M



KATI I II^TE

0 1 2 3 4 M

ambienteve nga varianti me një kthinë në variantin më të zhvilluar sjellin pa dyshim dhe ndryshime në formulimin arkitektonik të jashtëm dhe të brendshëm të tyre. Bërthama e gjithë zhvillimit të saj ashtu siç është vënë në dukje edhe në banesën e fshatrave Mullet, Linxë, Lundër e Ndroq mbetet edhe këtu shtëpia e zjarrit. Nga ana tjetër mungesë e «shtratit» në shtëpi të zjarrit, të cilën nuk e kemi takuar në asnjë rast në variantet e zhvilluara, ekzistenca e divanhanes që i përngjet një çardaku të mbyllur si dhe hajati përpara i cili në të gjithë rastet e varianteve të zhvilluara është i mbyllur, i japin asaj veçori lokale.

Në përgjithësi të gjitha banesat që trajtuam janë të padatuara, por, simbas të dhënave gojore, variantet e paraqitura i përkasin gjysmës së dytë të shek. XIX e fillimit të shek. XX.

Mbi origjinën e kësaj banese ne nuk mund të shprehemi me siguri, por, duke u nisur nga bërthama e zhvillimit të saj, shtëpia e zjarrit që është me një formulim shumë të thjeshtë arkitektonik, një ambient i errët e pa ndriçim e me vatrën në mes, bindemi që këtu kemi të bëjmë me një tip mjaft të vjetër të transmetuar deri në mesin e shek. XX.

Duke u nisur nga fakti se dhomat e miqve në shumë raste ne i takojmë si ambiente jo të fazës fillestare, si dhe duke pasur parasysh që dritaret janë me përmasa jo të vogla e oxhakun e futur në mur, ne shprehim mendimin se këto ambiente i përkasin një periudhe më të vonë se vetë tipi i banesës së vjetër të zonës së Prezës dhe nuk i takojnë fazës që zë fill ky tip.



Fig. 8

FOTOKOPJE

shteten mbi zgjatimin e trarëve të dyshemesë, mbyllen me ndarje të lehta prej gardhi ose dërrasash. Mjeshtrit e ndërtimit kanë qenë dibranët, të cilët, të organizuar në grupe, merrnin përsipër vetëm zbatimin e punimeve, mbasi të gjithë bazën materiale e siguronte vetë pronari.

Banesa e kësaj zone në variantin më të thjeshtë është përdhese me një ambient. Nga emërtimi që i bëjnë vendësit asaj «shpeja», kuptohet që ajo kryente të gjitha funksionet e një banese. Një të tillë kemi gjetur në Mazhe të Vogël. Fig. 3.

Siç shihet, ajo është me vatrën në mes, ka sqoll për larjen e enëve dhe nyje sanitare, e cila del konsol jashtë mureve anësore. Kalimi për në nyje bëhet me shkallë të brendshme guri.

Një variant tjetër banese përdhese me një ambient kemi gjetur po në Mazhe të Vogël. (Tab. I). Në këtë variant, siç shihet në rikonstruksion, përveç shtëpisë së zjarrit kemi dhe hajatin, i cili përfshihet në mes zgjatimit të dy mureve anësore. Lartësia e madhe e shtëpisë së zjarrit dhe forma planimetrike katërkëndëshe e banesës që paraqesim (Tab. II), ka dhënë mundësinë që brenda sipërfaqes së nafilit me anë të një gardhi të suvatuar me baltë të krijohet një ambient për fjetje ose pritjen e miqve. Kjo zgjidhje ka bërë që nyja sanitare në këtë rast të jetë e përbashkët si për shtëpinë e zjarrit ashtu dhe për odën e fjetjes apo të pritjes së miqve.



Fig. 7

Një variant tjetër paraqet kjo banesë në fshatin Budëll (Tab. III, Fig. 4, 5). Divanhania dhe hajati këtu janë shfrytëzuar si sipërfaqe rezervë ndërtimi, sepse pronari, duke marrë nga një pjesë të sipërfaqes respektive të tyre, ka krijuar burgun e gjësë dhe odën e miqve mbi të. Shtëpia e zjarrit në këto banesa siç shihet ka dy nafile në dy faqet anësore, njëri nga të cilët ka shërbyer për fjetje. Kjo i përket periudhës para rikonstruksionit të saj.

Si fazë më të zhvilluar të banesës me shtëpi zjarri në këtë zonë ne mund të konsiderojmë atë që përbëhet që në fillim prej odës së miqve dhe odës së fjetjes. Një nga ky variant është dhe kjo banesë e gjetur në fshatin Budëll (Tab. IV Fig. 6, 7,). Ajo me kohë ka pësuar disa ndryshime, në bazë të gjurmëve të të cilave kemi paraqitur rikonstruksionin e saj. Faza fillestare e arritur me anë të rikonstruksionit të saj tregon se ambientet përbërëse fillimisht kanë qenë oda e miqve, oda e fjetjes dhe divanhania në katin e dytë dhe hajati, burgu i gjësë dhe shtëpia e zjarrit në katin e dytë.

Si të variantit të zhvilluar të këtij tipi ne shohim dhe këto dy banesa të ngjitura të ndërtuara që në fillim për dy familje. Ndodhet në fshatin Bubq (Tab. V) në një nga pikat nga dominohet e gjithë fusha nga ana lindore. Këto na paraqiten si bashkim i dy banesave të të njëjtit tip. Gjendja e saj e degraduar dhe e braktisur na e ka vështirësuar pak rikonstruksionin Fig. 8. Në kompozimin planimetrik të bie në sy vendosja paralele e ambienteve. Secila prej tyre ka qenë përbërë prej hajatit përpara shtëpisë së zjarrit në mes dhe burgut të gjësë prapa. Ambientet e katit të dytë ruajnë po të njëjtën vendosje. Te kjo banesë të bie në sy një ballkon i hapur e i ngushtë që përshkon tërësisht faqet lindore e veriore e pjesërisht atë perëndimore. Në këtë ballkon në mesin e faqes veriore, ku ai është i mbyllur me dërrasa, janë dy nyjet sanitare në shërbim respektiv të sëcilës banesë.

Banesa e vjetër e zonës së Prezës siç shihet na paraqitet në disa variante që mund të konsiderohen si faza të ndryshme të të njëjtit tip. Shtimi i numrit të

DO NOT COPY

fili përshkon tërësisht njërën e nganjëherë dhe dy prej faqeve anësore të shtëpisë së zjarrit në nivelin e rrafshit të dyshemesë. Në të hipet me shkallë druri. Nëpërmjet nafilit kalohet dhe në nyjen sanitare të shtëpisë së zjarrit.

Ngjitur me shtëpinë e zjarrit në katin përdhe gjendet «burgu». Është një ambient pothuaj i errët që ndriçohet nga porta dhe dy dritare në formë frengjie. Zakonisht përpara «burgut» dhe shtëpisë së zjarrit është hajati, që mund të jetë i hapur ose i mbyllur krejtësisht me mure guri. Kur ky gjendet i mbyllur, atëherë porta e hyrjes është e madhe aq sa mund të futet brenda kafsha me gjithë ngarkesë.

Ambienti tjetër i rëndësishëm i banesës është «oda e miqve» e cila gjendet gjithmonë në katin e dytë dhe thirret edhe me emrin kulla e miqve. Është ngjitur me shtëpinë e zjarrit dhe gjithmonë mbi «burgun». Në këtë ambient ka oxhak në mur me kamare anash tij. Edhe ky ambient është pa tavan dhe i pasuvatuar. Në ndryshim nga shtëpia e zjarrit, oda e miqve ndriçohet nga dy dritare. Rreth mureve gjinden dollapë muri me kapak dhe shtrethe. Oda e miqve shërbente si për pritje, ashtu dhe për fjetje.

Të gjithë ballin e katit të dytë të banesës e përshkon divanhania. Gjendet gjithmonë mbi hajat dhe përgjithësisht është e mbyllur me dërrasa. Është një ambient që mund ta konceptosh si çardak të mbyllur. Ai, përveç tharjes së produkteve bujqësore, shërben dhe për endjen e pëlhurës në vegje, zeje e cila është përdorur mjaft në këtë zonë. Dimensionet relativisht të mëdha të divanhanes kanë lejuar që me ndarje të lehta të krijohen oda fjetjeje.

Oda e fjetjes është një ambient që nuk e gjen në të gjithë banesat. Gjithmonë gjendet me oxhak. Ashtu si gjithë ambientet e tjera, dhe ky ambient është i pasuvatuar e pa tavan. Ndriçohet sikurse oda e miqve.

Hyrja në katin e dytë bëhet dhe nga jashtë me shkallë njërampëshe druri ose guri.

Karakteristikë është se çdo ambient i banesës shoqërohet me nyjen sanitare të vetën.

Në përgjithësi banesat e kësaj zone i kemi gjetur të parrethuara me mure avllie, por në disa raste ato janë të rrethuara me gardh. Sipas të dhënave gojore të më të moshuarve pranë banesës ka pasur aksesorë ndihmës si kotec (koshiq) për misër, vathë për mbajtjen e bagëtisë në periudhën verore etj. «Burgu» i gjasë shërbente vetëm në periudhën dimërore për mbajtjen e një numri të kufizuar bagëtish për nevojat ditore, mbasi pjesa tjetër dimëronte në kullotat fushore në kasolle.

Këto banesa janë ndërtuar me mure guri me llaç balte e breza druri. Çatia mbulohet me tjegulla vendi. Të gjitha nyjet sanitare që dalin jashtë mureve mbë-



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6

POOR COPY



Fig. 2

Bërthama rreth së cilës zhvillohet kjo banesë, është shtëpia e zjarrit. Në të gjitha variantet nga ai më i thjeshti me një kthinë deri tek ai më i zhvilluari mbetet ambienti kryesor, me të cilin ndërlidhen të gjitha ambientet e tjera të banesës. Është ambienti ku zhvillohet jeta e përditshme, shërben për gatim, ngrë-



Fig. 3

nie dhe pothuaj kryhen të gjitha punët për nevojat e ekonomisë shtëpiake. Në raport me ambientet e tjera të banesës ajo zë pjesën dërmuese të sipërfaqes së ndërtimit rreth 30 m^2 dhe në banesat dykatëshe shtrihet në tërë lartësinë e banesës. Sipërfaqja si dhe volumi i madh i ndërtimit në raport me ambientet e tjera tregon për rëndësinë dhe vendin që zë ky ambient në banesë. Në këtë ambient vendin e zjarrit e gjejmë të spostuar nga muret perimetrale, të përbërë prej dy pjesësh asaj ku ndizet zjarri që është vatra dhe pjesës tjetër pak më të ngritur ku mbështeten drutë e zjarrit që quhet **run.** Fig. 1. Mbi vatrën e zjarrit në një zinxhir të lidhur në trarin e çatisë varen enët e gatimit. Rreth vatrës zhvillohej jeta familjare. Shtëpia e zjarrit është një ambient pa ndriçim pa tavan i pa shtruar dhe i pa suvatuar. Dy baxha të ndërtuara vetëm me tjegulla sigurojnë ndriçimin mbi vatër të shtëpisë së zjarrit. Një element karakteristik që e gjen në të gjitha banesat e vjetra të zonës mbrenda shtëpisë së zjarrit është «nafili» Fig. 2. Ky është një ballkon prej druri me gjerësi mbi 1.50 m. që përshkon një, e nga një herë dy, prej faqeve anësore të shtëpisë së zjarrit në mezin e lartësisë së saj. Ndërtimin e nafilit e lejonte praktikisht dhe lartësia e madhe e shtëpisë së zjarrit. Funksioni i saj në fazat fillestare të banesës ka qënë për fjetje, por në variantet më të zhvilluar zor se mund ta ketë ruajtur këtë funksion. Në këtë rast ajo ka shërbyer si ndërlidhëse me ambientet e tjerë dhe me nyjen sanitare të shtëpisë së zjarrit. Interesant është fakti se për të mos lejuar shpërndarjen e tymrave nëpër ambientet e tjerë të banesës mbi muret e brendshëm të shtëpisë së zjarrit deri në nivelin e flegrave të çatisë janë ndërtuar ndarje të lehta prej gardhi të lyera me baltë. Ky fakt i detyron tymrat që të gjejnë rrugë dalje nëpër tjegullat e çatisë.

Në trajtimin e brendshëm të shtëpisë së zjarrit të bien në sy vendosja në një ose dy faqe muresh të dy ose tre dërrasash horizontale për mbajtjen e enëve të guzhinës që quhen **shtretha** (sergjene). Në muret anësore gjenden dhe dollape muri që mbyllen me kapakë të thjeshtë. Pranë njerës prej faqeve anësore gjëndet gjithmonë dybeku për çveshjen e orizit ose shtypjes së grurit e përbërë kjo prej një guri të groposur dhe një trau që bën lëvizje goditëse me anë të këmbës. Mbrenda këtij ambienti është sqolli për larjen e enëve dhe pranë tij enët e ujit. Në një këndt tjetër gjinden dhe magrypet e vajit.

Në shtëpinë e zjarrit hyhet direkt nga jashtë ose nëpërmjet hajatit. Nëpërmjet hajatit dhe divanhanes, me të cilët komunikon direkt, ndërlidhet brenda për brenda me të gjitha ambientet e tjera të banesës. Në divanhane nga shtëpia e zjarrit kalohet nëpërmjet një ballkoni druri, të cilin vendësit e thërrasin «nafil». Na-

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Burhan STRAZIMIRI

BANESA E VJETËR E ZONËS SË PREZËS

Mbi kurrizin e vargut të kodrinave me lartësi rreth 200 m mbi nivelin e detit që fillojnë nga Vora e shtrihen në drejtim të veriperëndimit deri te gjiri i Rodonit janë vendosur një seri fshatrash që i takojnë zonës Prezë-Ishëm.

Kjo zonë njihet si e banuar kryesisht prej vendësve. Administrativisht sot u përket rretheve; Tiranë, Durrës e Krujë, ndërsa në të kaluarën ajo ka qenë e lidhur më shumë me Durrësin. Pavarësisht nga varësia e saj administrative, popullsia e kësaj zone kontaktet dhe marëdhëniet i ka zhvilluar me tre rrethet e mësipërme, me të cilat ka kryer dhe shkëmbimet e prodhimeve blegtorale, bujqësore.

Ekonomia e kësaj zone mbështetej në bujqësinë, ullirin dhe blegtorinë. Në përgjithësi mungesa e tokës personale i ka detyruar fshatarët të ishin edhe në varësi ekonomike.

Përgjithësisht fshatrat e kësaj zone janë të mbledhura, bile shpesh brenda fshatit shihen grupe banesash mjaft të dendura në formë lagjeje që i përkasin ose thirren me emrin e fisit më të madh që jeton në të.

Duke gjurmuar në fshatrat Prezë, Budëll, Bubq, Mazhë e Madhe, Mazhë e Vogël, Mallkuç, Ahmetaq, Palaq, Kullas, Gjuric, Alsufaj, Kapedanaj etj. na ka rënë në sy se banesat popullore fshatare duke kaluar nga zona e Prezës në atë të Ishmit, megjithëse kanë karakteristika të përbashkëta arkitektonike, nuk i përkasin një tipi. Prandaj ne duke u nisur nga ky fakt, në këtë shkrim do të bëjmë objekt trajtimi vetëm banesën e vjetër të zonës së Prezës. Qëllimi ynë është që, duke evidentuar shtrirjen territoriale të kësaj banese, të vëmë në dukje dhe tiparet e veçoritë arkitektonike të saj.

Transformimet e thella ekonomike shoqërore kanë influencuar si në zhdukjen krejtësisht të ndërtimeve



Fig. 1

ndihmëse dhe me karakter të përkohëshëm, ashtu edhe në transformimet rrënjësore ose braktisjen e banesave të vjetra. Ky fakt ka bërë që nga e kaluara në fushën e banesave popullore të zonës të ruhet vetëm një numër shumë i vogël banesash të hershme, te të cilat ne kemi vjelur dhe materialin, mbi të cilin është mbështetur ky shkrim.

Në variantin e saj më të zhvilluar banesën në zonën e Prezës e thërresin konak, është dykatëshe dhe përbëhet prej këtyre ambienteve: Në katin përdhe prej shtëpisë së zjarrit ose shtëpisë së punëve, e cila zë në lartësi të dy katet, «burgut» të gjasë dhe hajatit. Në katin e dytë prej kullës së miqve ose odës së miqve, divanhanes dhe në disa raste edhe prej odës së fjetjes.

tion de Gjirokastra sur le plan architectonique aussi bien de l'extérieur que de l'intérieur, et en particulier de ses différents éléments.

b. Toute atteinte à cette reconstruction serait hypothétique du fait qu'ils ne restent presque pas de traces de la phase initiale.

C'est sur la base de ces critères que nous avons élaboré le projet de restauration de ce monument d'intérêt pour son genre.

Par la mise en oeuvre de ce projet, les différents éléments de cette habitation échapperont une fois pour toutes à l'action nuisible des agents atmosphériques. Par ailleurs, elle conservera son caractère monumental (Fig. 13) à cette habitation renfermant de grandes valeurs de caractère typologique et influera positivement sur l'ensemble du quartier Teqe, où l'habitation des Kabilaj occupe une position centrale, en améliorant sensiblement l'aspect général.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

assez par sa technique de construction de l'entrée aménagée sur le côté droit (Fig. 4), et traitée avec un plus grand soin. Partant aussi de la place qu'elle occupe dans la composition de la façade principale, il ressort que c'est une construction tardive. L'ouverture de deux fenêtres au-dessus de cette entrée de construction récente (Tab. VIII), dont la technique et la forme diffèrent assez de celles de la fenêtre originale aménagée au-dessus de la porte originale; l'escalier de pierre sur le côté droit du «nëndivan». Ces constatations se fondent sur les raisonnements suivants:

Les éléments mentionnés plus haut se caractérisent par une technique de construction différente et l'on n'y relève pas le même soin accordé à la construction de l'escalier gauche (Fig. 6);

La pièce où a été aménagé l'escalier tardif était à son commencement un local destiné au logement des animaux, comme l'indiquent clairement ses traces (Fig. 7).

A notre avis ces modifications, appartiennent à la même phase, parce qu'elles se caractérisent par une technique de construction analogue et remplissent des fonctions analogues.

La troisième phase des modifications est une conséquence de la reconstruction effectuée en 1894. C'est à cette période qu'est attribuée la construction de l'escalier de bois en spirale, qui assur la communication entre les pièces situées dans la partie terminale de l'habitation. Par suite de cette reconstruction, certains éléments de la pièce 3 du deuxième étage ont enregistré des altérations quant à leur forme, leur construction et leur fonction initiale. Sur la partie frontale de cette pièce ont été percées trois fenêtres s'ouvrant verticalement au lieu des fenêtres précédentes, qui devaient ressembler, par analogie, à celles de la partie frontale de la pièce 2. Dans le même temps le «mafil» de bois a été remplacé par un pan de bois enduit de mortier. C'est au cours de cette même période de temps qu'a été ajouté le «divan» des trois côtés de la chambre indiquée. A part les éléments intérieurs, cette reconstruction a affecté les éléments extérieurs. Ainsi, l'auvent par exemple a été raccourci et plafonné et on a utilisé le crépissage latéral (Fig. 11): La partie frontale de la pièce 6 a subi les mêmes modifications que celle de la pièce 3.

Le bombardement aérien a gravement endommagé la «kamerie», comme nous l'avons relevé plus haut. Pour définir son état initial, nous devons nous fonder sur le raisonnement suivant:

1) Puisque les espaces sur le plan sont de dimensions presque égales, la solution architectonique apportée à la construction des deux autres espaces doit avoir été analogue.

2) En ce qui concerne la partie supérieure, partant des traces laissées par les tirants de bois aménagés à 0,70 cm du sommet des petits arcs nous pouvons définir la forme de la voûte en plein cintre, dont l'axe regarde vers le nord-est et sur laquelle s'appuyait le plancher en dalles de la «kamerie» du deuxième étage, qui remplissait les fonctions d'un balcon. Sur la base des traces recupérées et des témoignages des habitants plus âgés, il est possible, à notre avis de reconstruire aussi le «divan» supérieur à son état initial Cette pièce avait un plancher revêtu en partie de planches de bois, comme l'indiquent les traces de leurs travées, et en partie de plaques de pierre dont quelques-unes existent encore (Tab. III). Sur son côté gauche avait été aménagé un «sofa» et, au-dessus de la voûte couvrant l'escalier de pierre, le «tahtaposh», à 0,60 m du niveau du plancher (Tab. IV). Au-dessus du plancher, dans la partie frontale il y avait deux rangées de colonnes de bois soutenant les arcades qui supportaient la construction du toit. Quant au plafond du divan supérieur, il était composé de trois plafons distincts avec une rosette à leur centre: Par analogie au «divan» du premier étage, celui du deuxième devait avoir 6 fenêtres disposées en deux rangées de 3 fenêtres placées l'une sur l'autre, dont la forme et la fonction sont analogues à celles de la partie frontale de la chambre des amis.

LA RESTAURATION

La restauration de ce monument d'un grand intérêt pour son genre, posait en premier lieu le problème de définir les critères sur lesquels il fallait se guider en l'occurence. Evidemment ces critères ne pouvaient pas ne pas conditionner l'élaboration du projet de restauration. Ayant en vue l'objectif de restaurer cette habitation et de relever le mieux possible ses valeurs scientifiques et esthétiques, nous avons considéré comme plus appropriés les critères suivants:

1) En ce qui concerne la restauration, une place de premier plan doit être accordée à la reconstruction des parties qui manquent. Nous sommes de cet avis pour les raisons suivantes:

a. Dans notre cas nous avons affaire a une habitation d'un grand intérêt architectonique et artistique, le summum de l'habitation gjirokastrite.

b. La reconstruction des pièces qui manquent est non seulement nécessaire mais encore possible, du fait qu'en dehors des traces et des témoignages oraux nous possédons un grand nombre d'habitations de même type. La typisation des éléments architectoniques et de construction étant une caractéristique des habitations populaires, cette analogie peut être relevée aussi dans les éléments qui seront reconstruits. Aussi avons-nous pris comme modèle pour les éléments qui manquaient à notre habitation ceux des habitations de même type. (Fig. 12).

2) En dehors de la reconstruction des parties qui manquent, nous pensons éliminer les modifications de la deuxième phase en ramenant ses éléments à leur état initial (Tab. I, VIII). Cette décision se fonde sur le fait que la deuxième entrée aménagée sur la façade principale et l'escalier de pierre construit plus tard ont entamé l'unité de l'habitation sur le plan fonctionnel; ils ont dans le même temps altéré la composition architectonique initiale de sa façade principale.

3) Par ailleurs il importe de conserver la reconstruction de 1894 pour les raisons suivantes:

a. Puisque cette reconstruction porte une date certaine, elle nous sert de système de référence à l'évolution de l'habita-

DO NOT COPY

y puisait l'eau à la fois de l'intérieur, à travers un puits percé au-dessous du «nëndivan», et de l'extérieur au moyen d'une tubulure disposée presque à 30 cm au-dessus du niveau du plancher de la citerne et à laquelle on y accédait à travers un escalier de pierre (Fig. 8) couvert d'une voûte en plein cintre. (Tab. I, IV). Pour nettoyer la citerne, on y entre à travers une fenêtre couverte d'un linteau de pierre et percée sur la façade nord-ouest (Tab. VIII); à 20 cm environ du rebord de la fenêtre, il y a un tube pour le déchargement du trop-plein.

Hors du volume de construction, à la gauche de la façade principale, il y a une «kamerie» (Tab I. VII, VIII), non couverte, par suite des graves dommages que lui ont causé les bombardements aériens; actuellement ils n'en restent que deux petits arcs de l'ouverture sud-est, s'appuyant au centre sur une colonne de pierre ronde (Fig. 9).

Le premier étage, comme celui au rez-de-chaussée, se compose de 6 pièces (Tab. III). Les chambres de cet étage ou «dimërore» (= du mot «dimër» signifiant en albanais hiver), comme on les appelle a Gjirokaster, parce qu'on n'y habitait qu'en hiver, se caractérisent par un volume plus petit du fait qu'elles sont moins hautes que les chambres d'habitation du deuxième étage. A l'exception de la pièce N° 1, toutes les autres sont plafonnées, crepies et ont un plancher revêtu. En général les chambres sont garnies de deux types de fenêtres, celles intérieures arquées et protégées par des barres de fer et munies de dedans par des panneaux de bois et celles extérieures qui sont fixes, avec un chassis de plâtre et destinées seulement à l'illumination. Les portes aussi sont arquées et à un battant. La pièce N° 1, ou «divan», met en communication les autres pièces. Elle est entièrement fermée, revêtue de dalles et en partie crépie. Ce «divan» a été gravement endommagé par les raids aériens et a subi de nombreuses modifications, comme les autres pièces. A sa gauche, sur la face nord-est, se trouvait l'escalier de pierre qui menait au «divan» de l'étage supérieur. La pièce N° 3 est la seule de toute l'habitation n'ayant pas subi des transformations profondes dans son intérieur. Sa partie frontale comporte 6 fenêtres disposées en deux rangées, dont chacune renferme 3 fenêtres (Fig. 10). Les armoires à mur sont munies de battants de bois travaillés avec art; sur la face sud-ouest l'on relève les contours d'une cheminée et deux niches sur ses deux côtés. Sur le fond de cette pièce se trouve un élément caractéristique de bois, dont la partie inférieure renferme la «musandra», qui sert à ranger le linge et la partie supérieure la «dhipaton», à laquelle on y accède à travers des escaliers légers. Des deux côtés de la «musandra» sont aménagées deux portes, dont la première conduit à l'escalier supérieur et la seconde met en communication entre eux, à travers un vestibule, le noeud sanitaire, la pièce N° 4 et le «divan».

Partant de la composition des éléments de l'intérieur de la pièce N° 4, on se rend clairement compte que nous avons affaire ici à la chambre du feu. Le deuxième étage (Tab. III) renferme un nombre de pièces égal à celui du premier. Ici le divan est ouvert dans sa partie frontale, les chambres sont plus hautes que celles du premier étage et, en conséquence, plus fraîches et mieux illuminées. En effet c'est ici qu'habitaient les gens pendant la saison d'été. Toutes les chambres sont plafonnées et leur plancher revêtu de planches de bois. Les fenêtres de la première rangée sont couvertes de linteaux de bois et munies à l'extérieur de battants de bois, celles de la deuxième rangée sont identiques aux fenêtres du premier étage. La pièce N° 1 ou «divan» supérieur, met en communication les autres pièces qui l'entourent. Elle n'exerce pas une fonction d'importance première comme le «tchardak» de la maison caractéristique de Berat, de Shkoder, d'Elbasan, etc., où l'on procédait à la transformation des produits agricoles et d'élevage et qui servait aussi comme atelier. En dehors de cette fonction, le divan de l'étage supérieur est utilisé comme lieu de séjour du fait que sa partie frontale étant complètement ouverte, il communique directement avec le milieu environnant. Les raids aériens l'ont rendu inutilisable. Les traces de crépi que l'on peut relever dans le «divan» supérieur et dans la pièce N° 2, qui n'est autre que la chambre des amis, montrent que ces pièces étaient peintes avec des motifs de fleurs. le Tab. VI reproduit la construction de la partie frontale.

L'extérieur de cette habitation dénote un soin presque égal dans le traitement de ses trois façades, à l'exception de celle sud-ouest. C'est la façade principale (Tab. VIII) toutefois qui frappe l'oeil. On y relève tout de suite deux volumes latéraux, le corps principal et la «kamerie». Bien que traités différemment sur le plan architectonique, ces deux composantes ont un volume égal et se concurrencent par leurs éléments. La partie centrale, la plus retirée en profondeur dans les deux étages, se distingue suffisamment des deux volumes latéraux par son traitement simple, mais elle s'approche de ceux-ci au troisième étage et précisément dans la pièce du «divan» qui est pleine de lumière. Le mouvement prononcé des volumes, la laison parfaite avec le terrain, la richesse des éléments architectoniques, de bas en haut, font de cet ouvrage une réalisation architecturale remarquable de la ville-musée de Gjirokaster.

MODIFICATIONS SUBIES PAR L'HABITATION DANS LE TEMPS

La maison des Kabilaj a subi une série de modifications, qui en ont affecté l'unité sur le plan fonctionnel et transformé ses éléments architectoniques et de construction. Ces modifications dénotent 2 phases de reconstruction et les graves dommages provoqués à la «kamarie», au toit et à presque tout le «divan» supérieur par suite des rais aériens. Mais la plupart des modifications relevées dans les différentes pièces, par exemple la fermeture par une maçonnerie des cheminées, des armoires muraux, des fenêtres supérieures, ou encore l'ouverture de fenêtres, d'armoires muraux ou du «dhipato», n'ont rien à voir avec les deux phases de reconstruction susmentionnées. Elles ont été effectuées en des périodes de temps différentes, aussi nous allons les reproduire graphiquement.

Parmi les modifications de la deuxième phase mentionnons: la construction de l'entrée sur le côté gauche (Fig. 5), qui diffère

Leonard SULI

DO NOT COPY

ETUDE SUR LA RESTAURATION DE LA MAISON DES KABILAJ DANS LA VILLE DE GJIROKASTER

RESUME

La maison des Kabilaj (Fig. 1), aussi fait part de la composition architectonique du quartier Teqe. Elle est entourée par des murs d'enceinte, à l'intérieur desquels se trouvent deux cours. C'est dans la première, à proximité de l'entrée principale, que se trouve l'«odajashta» (=la chambre extérieure), tandis que la seconde comporte la maison vraie et propre (Tab I). L'habitation des Kabilaj remonte aux premières années du XIXe siècle. La construction de cette maison, comme celle des Zekat, est reliée par les habitants plus âgés de la ville au nom d'Ali Pacha Tepelene. L'habitation en question était le «sérail» de Nelo Kabili, propriétaire terrien et entrepreneur des travaux pour la reconstruction de la Forteresse pendant la domination d'Ali Pacha. Sa construction a été portée à terme probablement en 1916. La dénomination de sérail n'est nullement exagérée, pour cette maison, si l'on tient compte de ses dimensions considérables, de son caractère profondément monumental et de la grande richesse de sa décoration, autant d'éléments attestant indubitablement le niveau éleve atteint par la maison gjirokastrite. Elle a subi dans le temps maintes modifications et elle a été gravement endommagée par un bombardement aérien en 1941. Aussi l'état technique dans lequel se trouve-t-elle n'est point satisfaisant (Fig. 2). Sa restauration posait donc des problèmes d'ordre constructif et architectonique, voilà pourquoi il fallait tout d'abord l'étudier dans son ensemble, en déterminant les phases essentielles de sa construction, les modifications qu'elle avait subies dans le temps et puis seulement concevoir son projet de restauration. Les résultats de cette étude constituent justement l'objet de cette communication.

L'ETAT ACTUEL DU MONUMENT

Les murs d'enceinte circonscrivant cette habitation ont des hauteurs différentes, ce qui est conditionné par le relief du terrain dans les parties nord-est et nord-ouest où leur hauteur atteint jusqu'à 5 m. Ces murs sont renforcés de contreforts (Fig. 3). Le mur nord-ouest est interrompu. Orientée vers l'est, la porte principale de l'entrée (Tab. 2) communique avec la première cour intérieure. Du point de vue de la technique de construction, celle-ci se distingue des autres portes de la ville, ce qui prouve qu'elle a été reconstruite. A proximité de cette porte, dans la partie intérieure de la première cour intérieure se trouve l'«odajashta» (Tab. II), une espèce d'habitation destinée au séjour des serviteurs et des amis de deuxième ordre du patron. Elle est à deux étages et en partie à trois étages, construite de pierres et avec une extension superficielle presque égale dans les deux étages supérieurs. Ces étages communiquent entre eux à travers un escalier intérieur de bois. Au commencement la communication avec l'«odajashta» était assurée par la seule porte aménagée sur le côté méridional.

La maison vraie et propre est à trois étages et en partie à quatre (Tab. I, III, IV, V, VII, VIII). C'est une construction de pierres, avec une extension superficielle presque égale dans les trois étages.

Elle a une planimétrie en L. Les étages communiquent entre eux par un escalier intérieur de bois et de pierre. Elle appartient à la variante se développant sur un côté. Sa façade principale (Tab. 8) est orientée vers le nord-est, elle regarde presque de face le centre de la ville (le col du marché). C'est sur cette façade qu'ont été aménagées deux entrées arquées, à travers lesquelles on communique avec l'intérieur de la maison. L'étage au rez-de-chaussée comporte six pièces (Tab. I), dont la pièce 1est le «nëndivan». Son plancher est revêtue de dalles; couverte par une voûte cylindrique avec un arc en plein cintre, elle est illuminée par quatre fenêtres arquées et protégées par des barres de fer sur la face nord-occidentale. Sur la face nord-est ont été aménagés deux escaliers de pierre, chacun d'eux à deux rampes (Tab. I, IV). Toutes les autres pièces de l'étage au rez-de-chaussée sont également revêtues de dalles, non crépies et couvertes par des voûtes cylindriques ayant un arc en plein cintre et supportant le plancher du premier étage. C'est là un cas unique pour la ville de Gjirokaster. Nous avons affaire à des lieux aménagés pour conserver le foin et les provisions d'hiver. En général ces pièces sont illuminées par des fenêtres analogues à celles du «nëndivan». Les portes intérieures sont arquées. Au-dessous du «nëndivan», dans la partie la plus basse de cette maison, se trouve une citerne (Tab. I, V); elle recueille et conserve les eaux de pluie à travers la gouttière du toit. D'une surface presque égale à celle du «nëndivan», cette citerne est revêtue de dalles et couverte d'une voûte cylindrique. Ses quatre faces sont enduites avec du mortier hydraulique. On



PAMJA VERI - LINDORE - Gjendja

PAMJA VERI - LINDORE - Projekt i restaurimit

DO NOT COPY



PAMJA VERI - PERENDIMORE - Gjendja



PAMJA VERI - PERENDIMORE - Projekt i restaurimit

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DETAJI I STREHES SE ÇARDAKUT
PROJEKT I RESTAURIMIT



DRITARE E KATIT TE I-RE



KONSTRUKSIONI I ÇATMASE TE KATIT II-TE





DETAJI I STREHES TE ÇATISE
PROJEKT I RESTAURIMIT.



PREMJA B-B - *Gjendja*

0 2 4 M



PREMJE B-B *Projekt i restaurimit*

0 2 4 M

DO NOT COPY



DO NOT COPY

PLANIMETRIA E KATIT I-RE

GJENDJA



PROJEKT I RESTAURIMIT



LEGJENDE

- FAZA E I-RE
- FAZA E II-TE
- FAZA E III-TE v 1894
- TRANSFORMIME NE KOHE TE NDRYSHME

PLANIMETRIA E KATIT II-TE

GJENDJA



PLANIMETRIA E KATIT II-TE

PROJEKTI I RESTAURIMIT



0 2 4 m.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 13

banese është jo vetëm i nevojshëm, po dhe i mundur, mbasi për këtë ekzistojnë, përveç gjurmëve dhe të dhënave gojore, një numër i madh banesash të të njëjtit tip. Duke qenë tipizimi i elementeve arkitektonike dhe konstruktive një karakteristikë e ndërtimeve popullore, kjo analogji mund të shihet dhe në këto elemente. Si model për pjesët munguese të banesës sonë na kanë shërbyer ato të disa banesave[7] të tjera (Fig. 12).

2) Përveç rikonstruksionit të pjesëve munguese, mendojmë që të heqim transformimet që i përkasin fazës së dytë duke i kthyer pjesët e ndryshuara prej tij në gjendjen fillestare (Tab. I, VIII). Për këtë vendim u mbështetëm në faktin se hapja e hyrjes së dytë në pamjen kryesore dhe ndërtimi i shkallëve të vona prej guri ka dëmtuar unitetin e banesës për sa i përket anës funksionale, njëkohësisht këto transformime kanë tjetërsuar kompozimin arkitektonik fillestar të pamjes kryesore.

3) Rikonstruksionin e vitit 1894 do ta ruajmë për këto arsye:

a. Duke qenë i datuar ky rikonstruksion përbën një pikë referimi mbi evolucionin e banesës gjirokastrite në planin arkitektonik si të jashtëm dhe të brendshëm, e sidomos për elemente të veçanta të saj.

b. Ndryshimi i këtij rikonstruksioni do të ishte shumë hipotetik, mbasi nga gjendja fillestare thuajse nuk ka mbetur asnjë gjurmë. Mbi fazën e këtyre kritereve hartuam projektin e restaurimit të këtij monumenti me shumë vlerë në gjininë e tij. Restaurimi i kësaj banese sipas projektit që paraqitëm do të shpëtonte një herë e mirë pjesët e banesës që në gjendjen e sotme u janë nënshtruar veprimit të agjentëve atmosferikë. Nga ana tjetër kjo banesë do të ruajë monumentalitetin (Fig. 13), duke pasur vlera të veçanta të karakterit tipologjik. Ky restaurim do të influenconte pozitivisht në plotësimin e pamjes së ansamblit të lagjes «Teqe», në të cilën kjo banesë zë një vend kryesor.

7) Banesa në lagjen «Palorto» Rr. «Themo Vasi» Nr. 2, banesa në lagjen «11 Janari» Rr. «A. Kondi» Nr. 3,5,7, banesa në lagjen Varosh Rr. «K. Bako» Nr. 13, banesa në lagjen «Palorto» Rr. «A. Toto» Nr. 24.

DO NOT COPY



Fig. 12

shtresash, e para me trashësi 2,5 cm është prej balte të përzier me fije kashte, kurse tjetra rreth 0,5 cm me gëlqere të përzier me lesh dhie. Suvaja e odës së miqve dhe ajo e jashtmja që është e pikturuar është e përbërë nga shtresa e parë që ka trashësi 2-2,5 cm me llaç gëlqereje kurse shtresa e dytë 0,3 – 0,5 cm me gëlqere të përzier me lesh dhie. Suvatimi i sterës është bërë me harasan. Pjesa e jashtme e hapësirave të dritareve dhe të dyerve të brendëshme në të dy katet e para mbulohet me hark guri që është i përbërë prej 2 ose më shumë gurë. Mbi harkun e parë është ndërtuar një hark tjetër me trashësi 5-7 cm, i përbërë prej disa gurësh dhe formon një dhëmb rreth 3-4 cm; me harkun e parë. Kurse pjesa e brendshme e hapësirës së dritareve të rreshtit të poshtëm dhe të dyerve në të gjitha katet është e mbuluar me arkitra druri (Tab. VI). Me përjashtim të dyerve të ambientit Nr. 3 të katit të dytë të gjitha të tjerat janë njëflegërshe.

Restaurimi

Restaurimi i këtij monumenti me vlera të veçanta në gjininë e tij, shtronte në radhë të parë problemin e përcaktimit të kritereve që do të zbatonim në banesën tonë, përcaktim që do të kushtëzonte projektin e restaurimit për kryerjen e këtij studimi, duke pasur për qëllim si restaurimin e ndërtesave ashtu dhe vlerësimin maksimal shkencor e estetik të këtij monumenti, gjetëm si më të përshtatëshëm për rastin tonë këto kritere:

1) Në restaurimin e banesës një vend të rëndësishëm të zërë rikonstruksioni i pjesëve që mungojnë. Jemi të këtij mendimi duke u nisur sa më poshtë:

a. Rasti në shqyrtim është i veçantë për faktin se banesa në fjalë ka një vlerë të madhe-arkitektonike dhe artistike, duke qenë një nga kulmet e banesës gjirokastrite.

b. Rikonstruksioni i pjesëve munguese të kësaj

type d'habitation il y avait des constructions accessoires. Mentionnons de leur nombre le silo du maïs, appelé par les gens du pays «kotec» (ou encore «koshiq»), l'enclos destiné au bétail pendant la période d'été. Le «burg» ne servait que pendant la période d'hiver au logement d'un nombre limité d'animaux pour faire face aux besoins quotidiens, le reste du bétail passant l'hiver dans les pacages de la zone plate dans une chaume.

Ces maisons ont des murs construits de pierres liées avec de la glaise et traversés par des bandes de bois. Leurs toits sont couverts de tuiles du pays. Tous les noeuds sanitaires dépassant les murs s'appuient sur le prolongement des travées du plancher, ils sont fermés par des parois légers de branchages entrelacées ou de planches de bois. Les maîtres batisseurs, originaires de la Dibra et organisés en équipes, ne s'assumaient que l'exécution des travaux, le futur propriétaire leur assurant les matériaux de construction nécessaires.

En ce qui concerne la variante plus simple de l'habitation de cette zone, elle est à rez-de-chaussée et ne comporte qu'une seule pièce.

En tant que phase plus évoluée de ce type nous pouvons considérer la maison à deux étages, qui comprend, en dehors de la chambre du feu, la chambre des amis et la chambre à coucher.

L'ancienne habitation de la zone de Preze, comme on vient de voir, se présente en différentes variantes qui ne sont que les différentes phases d'évolution de ce même type. L'accroissement numérique des pièces, depuis la variante à une seule pièce à celle plus évoluée, ne pouvait pas ne pas entraîner des changements dans la formulation architectonique de l'intérieur et de l'extérieur de cette maison. Comme cela a été aussi constaté dans la maison des villages de Mullet, Linxe, Lunder et Ndroq, le noyau autour duquel se développe ce type de maison reste toujours la maison du feu. Par ailleurs, l'absence du lit dans la maison du feu, que nous n'avons rencontré nulle part dans les variantes plus évoluées ainsi que l'existence de la «divanhane» ressemblant à une espèce de tchardak fermé et du hayat par devant, qui est toujours fermé dans les variantes plus avancées, sont autant d'éléments conférant à ce type d'habitation une couleur locale.

En général toutes les habitations que nous venons d'examiner ne sont pas datées, mais si nous nous en tenons aux témoignages des gens du pays il ressort que les variantes illustrées plus haut appartiennent à la période allant de la deuxième moitie du XIXe siècle au commencement du XXe.

En ce qui concerne l'origine de ce type d'habitation, il n'est pas facile d'exprimer une opinion certaine à se sujet. Mais partant de son noyau central, la maison du feu, une pièce sombre manquant l'illumination et avec un foyer en son milieu, donc caractérisée par une formulation architectonique rudimentaire, il ressort que nous sommes en présence d'un type relativement ancien qui est arrivé jusqu'à la mitié du XXe siècle.

Partant du fait que la chambre des amis n'est pas souvent une pièce appartenant à la phase initiale, que ses fenêtres ne sont pas de dimensions petites et que sa cheminée a été introduite dans le mur, il ressort à notre sens que cette chambre appartient à une période plus récente que le type même de l'ancienne habitation de la zone de Preze et ne peut être attribuée à la phase toute première de ce type.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Pirro THOMO

ARKITEKTURA E BANESAVE FSHATARE NË SHQIPËRINË E VERIUT GJATË SHEKULLIT XIX

Gjurmimi dhe studimi i banesave fshatare të Shqipërisë së Veriut gjatë këtyre viteve të fundit ka nxjerrë në dukje vlerat që ato përmbajnë dhe kanë bërë të mundur që të kemi një paraqitje më të plotë mbi tiparet e tipeve dhe varianteve të banesave në krahina të ndryshme, rrugën e zhvillimit dhe zonat e shtrirjes së tyre. Disa nga rezultatet më kryesore të këtyre studimeve do t'i paraqesim shkurtimisht në këtë kumtesë.

Materiali i ruajtur deri në ditët tona na dëshmon se në Shqipërinë e Veriut është zhvilluar një arkitekturë fshatare e pasur dhe e shumëllojshme. Një nga karakteristikat e kësaj arkitekture është larmia e tipeve dhe varianteve të përdorura. Për këto larmi kanë ndikuar kryesisht dy grupe faktorësh. Nga njëra anë faktorët historikë, që shprehen në mungesën e një uniteti të plotë politik, në pabarazinë në zhvillimin ekonomik e shoqëror, sollën si pasojë veçimin e theksuar të krahinave dhe favorizuan dallimet e forta lokale. Nga ana tjetër faktorët ekonomiko-natyrorë si shtresëzimi klasor i popullsisë, faktori i terrenit, ai klimaterik dhe i materialeve rrethanore, kanë sjellë edhe këto disa dallime lokale, që shprehen në larminë brenda për brenda tipit dhe krijimin e varianteve të ndryshme, të pasqyruara këto në shkallën e përsosmërisë së tipit, në formulimin arkitektonik të jashtëm, në teknikën e ndërtimit etj.

Por me gjithë ekzistencën e kësaj shumëllojshmërie tipesh, një sërë faktorësh të tjerë kanë bërë të mundur dallimin e disa grupeve krahinash me tipare të ngjashme arkitektonike (Për këtë ka ndikuar së tepërmi programi përgjithësisht i varfër, që duhej të plotësonte një banesë fshatare dhe që përmblidhej në kërkesa për një numër të kufizuar e të njëjtë ambientesh, gjë që të çonte shpeshherë në zgjidhje të njëjta ose të përafërta kompozicionale dhe funksionale). Lidhjet e ngushta ekonomike e shoqërore ndërmjet disa krahinave kufitare kanë bërë të adoptohen tipe arkitektonike të njëjta të ngjashme. Së fundi prania e grupeve ndërtuesish dhe lëvizja e tyre nëpër krahina të ndryshme solli një unifikim në arkitekturë, i cili shprehet më fort në teknikë ndërtimi, në përpunim dekorativ dhe dicka më dobët në kompozimin planimetrik e volumor.

Paraqitja e tipeve të banesave më kryesore sipas krahinave do të na japë mundësi për të nxjerrë karakteristikat e përgjithshme të tyre, formimin, përhapjen si dhe anët e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet tyre.



Fig. 1



Fig. 2

Banesat në Malësinë e Shkodrës[1]. Banesat më të zakonshme janë përdhese dhe me një kat (Tab. I) me një numër të kufizuar ambientesh dhe me formulim të varfër arkitektonik. Banesa më e thjeshtë është përdhese me një ambient. Rruga më e zakonshme e zhvillimit është ajo e shtimit të ambienteve në planin horizontal, me dy ose tri ambiente radhazi dhe me hyrje të veçanta nga jashtë.

Një vend me rëndësi në këto zona zë dhe banesa me kat. Lidhja ndërmjet kateve mund të jetë me shkallë të jashtme ose të brendshme. Edhe këto banesa kanë një zgjidhje të thjeshtë, me nga një ambient në çdo kat. Shtimi i ambienteve nuk shkon më larg nga skema dykthinëshe me kat, e cila formohet nga bashkimi i dy banesave njëkthinëshe të ndara, ose me perspektivë ndarjeje. Në mjaft raste ngjitur me banesën me kat gjejmë të ndërtuar një përdhese — shtëpinë e zjarrit.

Jo më pak të përdorura kanë qenë banesat me gjysmë kat. Këto banesa zakonisht ndërtohen në terrene të pjerrëta. Kati përdhe është pjesërisht i futur në tokë. Kati i sipërm përbëhet prej një ambienti të vetëm, i cili ngrihet pjesërisht mbi katin përdhe dhe pjesërisht mbi truall, ose prej dy ambientesh. Një nga këto ambiente ngrihet drejtpërdrejt mbi truall.

Karakteristikë e këtyre banesave është volumi i tyre i mbyllur prej guri, me hapësira ndriçimi të pakta dhe të zhveshura nga çdo element ose përpunim arkitektonik.

Këto banesa janë të përhapura në një zonë mjaft të gjerë, e cila kap pothuajse gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë së Veriut dhe përfshin Malësinë e Shkodrës, Dukagjinin, Mirditën Perëndimore, Malësinë e Lezhës dhe të Milotit[2]. Përveç zonave malore këto banesa u përhapën dhe në ultësirat e Shkodrës, të Zadrimës, në të cilat gjejmë banorë të zbritur nga malet fqinje.

Në disa rrënoja të banesave të ruajtura në disa vendbanime të braktisura (si në Dedaj të Shkrelit, në Kalanë e Drishtit, etj.) vërehen disa tipare arkitektonike të ngjashme me ato të banesave që përshkruam. Ky fakt dëshmon se në këto zona është trashëguar një tip i lashtë banese, i cili për arsye të nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik e shoqëror të krahinave ku u përhap, ruajti të papërpunuara mjaft tipare fillestare.

Banesat në Malësinë e Gjakovës[3]. Malësia e Gjakovës shquhet për një përhapje të gjerë të banesës së fortifikuar. Banesa më tipike është trekatëshe (Tab. II). Oborri i shtëpisë është mjaft i varfër me ambiente ndihmëse, gjë që e thekson edhe më tepër karakterin e mbyllur të banesës. Brenda këtij volumi zgjidhet i gjithë programi i nevojave të familjes. Kështu në katin përdhe strehohet bagëtia. Kati i dytë përmbush kërkesat e jetës së përditshme të familjes. Në të gjejmë shtëpinë e zjarrit dhe zakonisht dy dhoma të vogla fjetjeje ose qyleret, siç e quajnë vendësit. Në katin e tretë është vendosur gjithnjë dhoma e miqve, e cila paranjrihet nga një ambient i gjerë që quhet divanhane. Në divanhane dalin shkallët, që vijnë nga kati i dytë. Element karakteristik i divanhanes është «dyshekllëku» ose një platformë e ngritur, që shërben kryesisht për ndenjje. Ai zë vend në një qoshe ose gjatë gjithë ballit të divanhanes. Muret e dyshekllëkut janë më të holla se ato perimetrale, shpesh dalin pak jashtë dhe përmbajnë një sërë dritaresh të vogla.

Kërkesave për një jetesë të mbrojtur të familjes, që shtronin kushtet shoqërore të kohës për mjaft krahina të Shqipërisë së Veriut, ndërtimi i banesave iu

1) P. Thomo, Arkitektura e banesave fshatare shqiptare, Studime historike, Nr. 3, 1974, f. 126-127.

2) F. Zarshati, Të dhëna mbi banesën e fushës së Zadrimës, Monumentet Nr. 3, 1972, f. 189-198; V. Shtylla, Banesa të vjetra të fushës së Mbishkodrës, Monumentet Nr. 5-6, 1973, f. 177-188.

3) P. Thomo, Banesat e fortifikuara në Malësinë e Gjakovës, Studime historike, Nr. 3, 1973, f. 67-106.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

përgjigj si në shkallën e përsosmërisë së tipeve mbrojtëse, ashtu dhe në atë të përhapjes së tyre. Ekzistenca e disa ekzemplarëve të vjetër na jep të kuptojmë se ky formulim i ri është arritur kryesisht mbi bazën e përpunimit të elementeve arkitektonike dhe të teknikës së ndërtimit, duke ruajtur të pandryshuara zgjidhjet planimetrike dhe funksionale. Kështu nga banesat e vjetra, që kishin elemente prej druri në katin e sipërm, çati me strehë të gjera dhe një teknikë me gurë të lidhur me baltë e të përforcuar me breza druri, u kalua gradualisht me një ndërtim tërësisht me gurë e llaç gëlqereje dhe elementet e ndryshme arkitektonike përpunohen në përputhje me vetitë e materialit të ri, gurit. Në banesat e para të tilla shohim se dyshekllëku ruan formën dhe përmasat e dyshekllëqeve prej druri, por të zbatuar me gurë. Gjatë përpunimit banesa fiton një aspekt arkitektonik të ri si ftohtësinë dhe solemnitetin e masës së gurtë, rreptësinë e linjave etj. (Fig. 1).

Banesa në Has[4]. Zhvillimi i banesës në Has dallohet nga mënyra e veçantë e zgjidhjes së kërkesave të familjeve të mëdha patriarkale, me një numër të konsiderueshëm pjesëtarësh, që ekzistonin në të kaluarën në këtë krahinë. Nevojat e familjeve të tilla u zgjidhën me ndërtime të herëpashershme të vogla dhe me destinacione të ndryshme brenda një oborri të rrethuar. Ndërtimet ndahen në ndërtime ekonomike si «kosheri» i drithit, «çaraniku» i bulmetit, «pojatë» për bagëti dhe ndërtime për banim, si shtëpia e zjarrit, «qyleret» për fjetje dhe shtëpia e miqve.

Tipet e ndryshme të grupimeve të ndërtimeve të familjes që kemi gjetur në Has, na dëshmojnë se këto grupime kanë pësuar një evolucion në trajtimin kompozicional. Ky evolucion është kushtëzuar nga fazat e zhvillimit të vetë banesës dhe nga gjendja ekonomike e familjes. Në fazat e para si bërthamë fillestare e grupimit dhe si qendër e kompozimit ishte shtëpia e zjarrit, ndërsa ndërtimet e tjera të thjeshta përdhese prej druri e rrethonin atë. Në fazat e mëvonshme shtëpia e zjarrit nuk gjen zhvillim të mëtejshëm dhe, duke mbetur një ndërtim primitiv, humbet rolin që kishte në kompozim. Këtë rol, ndonëse jo si bërthamë fillestare e banimit, por si theksim arkitektonik në kompozim, fillon të lozë shtëpia e miqve, e cila arrin në konceptime arkitektonike më të lartë. Ajo bëhet dykatëshe, me katin përdhe të destinuar për bagëtinë dhe me katin e dytë që përmban dhomën e miqve dhe divanhanen e gjerë përpara saj.

E kushtëzuar nga mënyra e jetesës, ku kemi ndërtime të veçanta për çdo funksion, banesa në Has asnjëherë nuk e ndërlikon zgjidhjen planimetrike. Ndryshimet në të vijnë kryesisht nga përpunimi i elementeve arkitektonike dhe konstruktive. Këto ndryshime ndodhin kryesisht në shtëpinë e miqve (Tab. III).

Ndërtimet e para përdhese kishin përpara hajatin e hapur me shtylla druri në ballë. Me kalimin e

4) P. Thomo., Arkitektura e banesave fshatare në Has, «Studime Historike» Nr. 1, 1975, f. 111-140.



Fig. 5

kohës hajati mbyllet, duke u kthyer në një parahyrje përpara dhomës së miqve ose të fjetjes.

Në ndërtimet me kat kati përdhe ndërtohej me gurë, ndërsa kati i sipërm për një kohë të gjatë mbeti prej druri. Balli i hajatit ose i divanhanes ishte i hapur. Më tej, ashtu si dhe në banesat përdhese divanhania e hapur mbyllet duke lënë një varg dritaresh të vogla në ballë. Duke vazhduar rrugën e përpunimit, banesa fiton elemente të reja, siç është dyshekllëku. Mbasi banesa ka fituar një skemë planimetrike të caktuar dhe të gjitha elementet përbërëse, ajo i ruan deri në fund këto, por duke ia përpunuar formën dhe konstruksionin. Kati i sipërm fillon edhe ky të ndërtohet me gurë, dyshekllëku merr një trajtim të ri me një varg dritaresh në ballë, derisa në banesë mbetet prej druri vetëm muratura e dyshekllëkut.

Ndërtimi në Has dallohet për një përdorim të bollshëm të lëndës së drurit, që i ka dhënë banesës një karakter të ngrohtë dhe efekt piktoresk. Kjo ngrihet nga kontrasti i materialeve, dru e gurë, nga diferencimi dhe përpunimi i ndryshëm i tyre, duke dalluar volumet që mbajnë, masa e plotë e muraturës së gurit dhe volumet që mbahen, muratura e lehtë prej druri me trajtim të pasur (Fig. 2).

Banesat në Lumë. Ndonëse Luma ruajti deri vonë një unitet krahinor në aspekte të tjera të kulturës materiale e shpirtërore, në fushën e arkitekturës nuk paraqitet me tipare të unifikuara. Këtu dallohen dy tipe të ndryshme. Tipi i parë përbëhet nga banesa të mbyllura, më të shumtat e rasteve dykatëshe, me tipare mbrojtëse dhe, shpeshherë, pa ndonjë element arkitektonik dallues (Fig. 3). Ndërtimi planimetrik i këtyre banesave nuk bëhet sipas ndonjë skeme fikse. Takohen banesa me nga një kthinë në kat, por ka dhe raste kur ndërtimi planimetrik i katit të sipërm na kujton atë të Malësisë së Gjakovës ose të Hasit.

Një përhapje mjaft të madhe pati në Lumë tipi i dytë i banesave, i cili vazhdoi të ndërtohet deri vonë. Karakteristika dalluese e këtyre banesave është ekzistenca e një hajati të ngushtë në katin përdhe dhe e një çardaku sipër tij (Fig. 4). Hajati dhe çardaku janë të mbyllur në të dy anët e ngushta. Skema më e zakonshme planimetrike është me nga dy ambiente në çdo kat, ku secili ambient ka hyrje më vete; nga hajati dhe çardaku. Këto elemente në këto banesa kanë kryesisht funksion ndërlidhës të ambienteve.

Banesat në Mat[5]**.** Mati është një tjetër krahinë tipike ku gjeti një përhapje të gjerë banesa e fortifikuar. Kjo lloj banese zëvendësoi tërësisht banesat e vjetra dhe mbizotëruese në këto krahina.

Banesat më të zakonshme janë me tri kate me skemë planimetrike, njëkthinëshe në çdo kat. Kati përdhe u përket bagëtive, kati i dytë shërben si shtëpi zjarri, ndërsa kati i tretë përdoret për pritjen e miqve (Tab. IV). Hyrja për në banesë është një e vetme në katin përdhe dhe shkallët janë të brendshme prej druri. Ato dalin drejtpërdrejt në ambientet e vetme të kateve, hapësira e të cilave mbulohet me «qepen».

Karakteristikë për katin e sipërm, i cili përmban ambientin më paraqitës të banesës, janë «çikmatë» ose disa dalje të vogla në formën e ballkoneve të mbyllura që vendosen në disa pika të dhomës. Çikmatë kanë shtresën më të ngritur nga dyshemeja e dhomës dhe në murin e hollë e të nxjerrë jashtë që e mbyll janë hapur dritare të vogla. Ato janë vendosur në pika të tilla për të kontrolluar të gjitha anët e ndërtesës dhe janë të pajisura me frengji anash dhe poshtë. Çikmatë kanë një rol të dukshëm mbrojtës dhe njëkohësisht përdoren si kënde për ndenjje.

Banesa në Mat arriti fazën më të lartë të banesës së fortifikuar fshatare në Shqipërinë e Veriut (Fig. 5). Atë e takojmë dhe në pjesën lindore të Mirditës, në disa krahina të Dibrës, Lurë, Muhur, Dardhë, dhe aty-këtu, në të gjitha krahinat kufitare. Kjo banesë u për-

5) P. Thomo, Banesa popullore të tipit kullë në Mat dhe në Mirditë, «Etnografia shqiptare» Nr. 4, 1972, f. 202-241.

DO NOT COPY

punua në këtë formë andej nga mesi i shekullit të kaluar dhe arrin të zëvendësojë plotësisht banesat e vjetra vetëm nga gjysma e dytë e këtij shekulli. Disa ekzemplarë mjaft të vjetër banesash, siç është një në fshatin Derjan dhe një tjetër në Benjë (Fig. 6), dëshmojnë qartë se në këtë krahinë ka ekzistuar një koncept tjetër. Këto banesa janë dykatëshe, nga të cilat vetëm kati i sipërm përdoret për banim. Këtu përfshihet dhoma e zjarrit me përmasa mjaft të mëdha dhe krahas saj dhoma e miqve, e cila dallohet nga qoshku që zë vend në një faqe të dhomës, del jashtë mureve perimetrale, me dysheme të ngritur dhe i pajisur me dritare.

Në një periudhë të dytë vihet re heqja dorë nga kjo skemë kompozicionale dhe kalimi në skemë njëkthinëshe në kat. Edhe nga kjo periudhë ndërtimi janë ruajtur disa ekzemplarë me interes. Këto ndërtime trashëgojnë nga paraardhësit teknikën e ndërtimit dhe trajtimin e dhomës së miqve me qoshqe.

Banesa e fortifikuar i përket një periudhe të mëvonshme, e cila ruajti skemën planimetrike, ndërsa shohim të përpunojë elementet arkitektonike dhe të përsosë teknikën e ndërtimit.

Banesat në krahinat e Dibrës rreth Bulqizës[6]

Banesën me «qoshk», ekzemplarë të së cilës kanë mbetur të rralla në Mat, e gjejmë të përhapur gjerësisht në krahinat kufitare me Matin, rreth Bulqizës. Karakteristikat themelore janë po ato. Pra kemi të bëjmë me skemën njëkthinëshe të kateve, me një kompozim vertikal të banesës deri në tri kate dhe me ndarjen e



Fig. 6



Fig. 7

njëjtë funksionale të kateve (Tab. V). Në pamjen e jashtme këto banesa gjallërohen nga qoshqe mjaft të dala në pjesën e sipërme të ndërtesës, nga ndonjë ballkon që ndonjëherë shoqëron qoshkun dhe nga strehët e gjera të çatisë që kurorëzojnë banesën. Në këto banesa qoshku ka funksion për të krijuar vende komode ndenjje, hapësira e të cilave, duke u përfshirë me atë të dhomës së miqve, e zmadhon mjaft atë. Për këtë qëllim trajtimit të brendshëm dhe të jashtëm të qoshkut i kushtohet një kujdes më i madh (Fig. 7). Ato zakonisht vendosen në pikat ku lartësia e ndërtesës është më e madhe, prej nga hapet një panoramë e gjerë.

Në mjaft raste shkallët janë të jashtme dhe për të gjitha katet. Një mënyrë e tillë komunikimi në fakt i shkëput mjaft ambientet nga njëri-tjetri dhe e thekson mjaft dallimin funksional të tyre. Në banesa të tjera shkallët janë të jashtme deri në katin e dytë.

Banesat me qoshk i gjejmë të përhapura dhe në krahina të tjera, si në Malësinë e Krujës e të Tiranës. Në këto krahina ndërtimet me qoshk janë kryesisht dykatëshe. Në fshatrat e Krujës haset shpesh një skemë kompozicionale, që formohet nga bashkimi i dy bërthamave njëkthinëshe. Në këto raste vërehet një simetri e plotë karshi murit.

Në fshatrat malore të Tiranës, ku banesat shqu-

6) P. Thomo, Banesat me «qoshk» në Shqipërinë e Veriut, «Etnografia shqiptare», Nr. 8; 1976, f. 191-238.

Protected by Copyright

hen për një skemë kompozicionale përgjithësisht të përbërë, që kushtëzohet nga ekzistenca e familjeve të mëdha të bashkuara, ndërtimet me qoshk marrin pjesë në kompozim në mënyra të ndryshme. Ato mund të jenë të ndërtuara më vete në oborr, që në këtë rast përdoren si «konaqe» për miqtë, ose të bashkangjitura me banesën e familjes. Skema më e thjeshtë është atëherë kur shtëpisë së zjarrit, karakteristikë për këtë krahinë me përmasa të mëdha në plan dhe në lartësi, i bashkangjitet një ndërtim dykatësh me qoshk.

Duke u bazuar në zgjidhjen e njëjtë funksionale dhe në kompozicionin planimetrik të kateve, mund të konsiderojmë si variant të këtij tipi dhe banesën e Çermenikës, e cila ndryshon nga formulimi arkitektonik i jashtëm[7]. Për banesën e Çermenikës është karakteristike galeria e mbyllur prej dërrase që rrethon muret perimetrale të katit të sipërm dhe që përmban një këndndenjje, i cili përfshihet në hapësirën e ambientit të katit (Fig. 8).

* * *

Nga kjo paraqitje e shkurtër e tipeve dhe varianteve më kryesore të banesës në Shqipërinë e Veriut shohim se kemi të bëjmë me një ndërthurje principesh kompozicionale, zgjidhjesh planimetrike e funksionale, aplikime elementesh arkitektonike e teknikash ndërtimi të njëjtë në krahina të ndryshme, që dëshmojnë për një lidhje ndërmjet këtyre krahinave. Kjo ka shpënë në një tipizim karakteristik të banesave fshatare, gjatë së cilës vërehet një lirshmëri në zbatimin e këtij tipizimi sipas konditave lokale.

Kështu p.sh. në ndërtime volumore dhe zgjidhje funksionale të ndryshme takohen skema planimetrike dhe elemente arkitektonike të njëjta. Këtë e shohim në banesat e Malësisë së Gjakovës dhe të Hasit në formulimin planimetrik të katit të sipërm dhe në krijimin e ambienteve të veçanta për çdo funksion.



7) A. Muka, Banesa popullore e Çermenikës, «Studime historike» Nr. 1; 1974, f. 131-162.

PDF COPY

TAB. I

Në skema kompozicionale dhe funksionale të njëjta takohen formulime të jashtme dhe teknika ndërtimi të ndryshme, si p.sh. në banesat e Matit, Dibrës, Çermenikës etj.

Përveç këtyre aspekteve për lidhjen ndërmjet krahinave dëshmojnë dhe ndërtimi i ekzemplarëve tipikë të një krahine në një krahinë tjetër. Kështu p.sh. gjejmë banesa karakteristike për Malësinë e Gjakovës në Has, banesa e Matit, në Dibër, të Dibrës në Çermenikë dhe anasjelltas.

Zhvillimi i brendshëm dhe i pandërprerë i këtyre tipeve, derisa kalohet në konceptime arkitektonike të reja, është një tjetër karakteristikë e rëndësishme e arkitekturës fshatare të Shqipërisë së Veriut. Kjo duket qartë sidomos në formimin e banesave me tipare mbrojtëse në Malësinë e Gjakovës dhe në Mat. Ndonëse në këto banesa realizohet një ide e njëjtë, sigurimi i jetesës së mbrojtur dhe arrihet në kompozime volumore e teknikës ndërtimi të ngjashme, ato prapëseprapë ndryshojnë sipas krahinave ku janë ndërtuar. Dallimet vërehen si në aspekte thelbësore, siç është ndërtimi planimetrik, ashtu dhe në anësore, në elemente të ndryshme karakteristike. Kjo na tregon se, megjithëse këto banesa përvetësuan skemën e njohur mbrojtëse të rritjes së ndërtesës në lartësi dhe elemente të tjera mbrojtëse, në to ndihet ndikimi i fortë i banesave, paraardhëse, mjaft tipare karakteristikë të të cilave u ruajtën.

Në arkitekturën e banesave të Shqipërisë së Veriut nuk mungojnë dhe përpjekjet e mjeshtërve popullorë, që krahas përmbushjes së nevojave jetësore të japin realizime të goditura nga ana arkitektonike dhe artistike. Qoftë dhe në detajet e vogla shihet kujdesi i mjeshtrit, që çdo elementi konstruktiv t'i japë dhe një përpunim dekorativ, gjë që kryhet me masë dhe pa e dëmtuar funksionin kryesor.

Duke ndjekur në këtë kumtesë vetëm disa nga problemet e kësaj pasurie arkitektonike, mund të pohojmë se sa pa baza janë disa pretendime të disa autorëve të vjetër ose bashkëkohës për një primitivitet të banesave në Shqipërinë e Veriut ose për huazime tipesh nga vende të tjera.



DO NOT COPY

TAB. II TAB. III





PAMJE KRYESORE





KATI PERDHES





KATI I PARE



0 5 M

0 4 M

DO NOT COPY

















DO NOT COPY

Pirro THOMO

DO NOT COPY

L'ARCHITECTURE DES HABITATIONS RURALES DANS L'ALBANIE DU NORD PENDANT LE XIXe SIECLE

RESUME

Les travaux de recherche et l'étude des maisons rurales effectués dans l'Albanie du Nord, pendant ces dernières années, ont fait ressortir les valeurs que celles-ci renferment. Dans le même temps ils ont permis de dresser un tableau plus complet des traits caractérisant les différents types et les différentes variantes de ces habitations sur le plan régional, ainsi que des voies de leur développement et des zones de leur extension. Quelques-uns des résultats de ces études seront brièvement illustrés dans cette communication.

Le matériel conservé à nos jours témoigne que l'Albanie du Nord se caractérise par le développement d'une architecture rurale, riche de contenu et multiforme. Cette architecture se distingue par la diversité de ses types et de ses variantes.

Malgré cette grande diversité de types, une série d'autres facteurs ont permis d'identifier certains groupes de régions ayant des traits architectoniques analogues. Les liens étroits de nature économique et sociale, existant entre certaines régions voisines, sont les facteurs qui ont fait adopter à ces régions des types architectoniques identiques ou se ressemblant. L'existence d'équipes de bâtisseurs et leur déplacement à travers les mêmes régions ont conduit à l'unification de l'architecture, ce qui s'exprime surtout dans la technique de construction, le traitement décoratif et, dans une moindre mesure, dans la composition planimétrique et volumétrique.

L'exposition des principaux types d'habitation sur le plan régional nous permettra de faire mieux ressortir leurs caractéristiques générales, les voies de leur formation et diffusion, ainsi que les aspects qu'elles ont en commun ou qui les distinguent les unes des autres.

Habitations de la Malesie de Shkoder. — *Les plus habituelles parmi celles-ci sont à rez-de-chaussée ou à un étage (Tab. I), avec un nombre limité de pièces et une formulation architectonique simple. L'habitation plus simple est à rez-de-chaussée et ne comporte qu'une seule pièce. La voie plus habituelle de son développement est celle de l'adjonction de nouvelles pièces sur le plan horizontal, deux ou trois l'une après l'autre et chacune d'elles pourvues d'une porte s'ouvrant de dehors.*

Une place de relief occupé aussi dans ces zones l'habitation à étage. La communication entre les étages a lieu à travers un escalier extérieur ou intérieur. Ces maisons se caractérisent par une solution planimétrique simple, elles ont une seule pièce à chaque étage. L'adjonction de pièces nouvelles est au maximum au nombre de deux par étage, ce qui se réalise par la réunion de deux habitations à une pièce qui sont séparées ou peuvent l'être à l'avenir. Souvent tout près de la maison à étage l'on retrouve un rez-de-chaussée-maison du feu.

Une diffusion non moindre ont connu aussi les maisons à demi-étage. D'habitude elles s'élèvent sur des terrains escarpés. L'étage au rez-de-chaussée se trouve en partie au-dessous du niveau du sol. L'étage supérieur se compose d'une seule pièce, s'appuyant en partie sur l'étage à rez-de-chaussée et en partie sur le sol, et parfois de deux pièces. Une de celles-ci s'appuie directement sur le sol.

Ces habitations se caractérisent par un volume de pierre terme, par un nombre limité d'ouvertures destinées à l'illumination et par l'absence totale d'éléments architectoniques. Quant à leur diffusion, elle concerne une zone relativement vaste occupant presque toute la partie occidentale de l'Albanie du Nord, entre autres la Malesie de Shkoder, Dukagjin, la Mirdite occidentale, la Malesie de Lezhe et de Milot. En dehors de la zone montagneuse, ces mêmes habitations nous les retrouvons aussi dans les dépressions de Shkoder et de Zadrime, où, parmi la population il y a des gens descendus des zones montagneuses voisines.

Habitations de la Malesie de Gjakove. — *Cette région montagneuse se distingue par une diffusion large de l'habitation fortifiée. Le type d'habitation plus caractéristique est celui à trois étages (Tab. II). La cour de cette maison est d'aspect relativement simple avec ces locaux auxiliaires, ce qui marque encore plus le caractère fermé de ce type d'habitation. C'est à l'intérieur de ce volume fermé que trouvent leur solution toutes les exigences de la vie domestique. Ainsi l'étage au rez-de-chaussée est destiné au logement des animaux. Le deuxième étage satisfait les exigences quotidiennes de la vie familiale. Nous y retrouvons la maison du feu et presque toujours deux petites chambres à coucher, que les habitants du pays appellent «qyler». Au troisième étage se trouve toujours la chambre des amis, précédée par une pièce plus large dénommée «di-*

vanhane». C'est au «divanhane» que mène l'escalier venant du deuxième étage. Un élément caractéristique du «divanhane» c'est le «dyshekllëk», une espèce de plate-forme surélevée qui sert de lieu de séjour. Il se situe à un angle du «divanhane» ou longe sa partie frontale. Les murs du «dyshekllëk», moins épais que les murs extérieurs, forment souvent saillie et comportent une série de petites fenêtres.

Pour répondre aux exigences d'une vie familiale protégée, en raison des conditions sociales caractérisant à l'époque plusieurs régions de l'Albanie du Nord, il a fallu procéder au perfectionnement de ce type d'habitation fortifiée ce qui a entraîne aussi sa diffusion. L'existence de quelques exemplaires anciens nous indique que la nouvelle formulation est surtout le résultat d'un traitement ultérieur des éléments architectoniques et de la technique de construction, sans pourtant apporter des modifications aux solutions planimétriques et fonctionnelles. Ainsi, des anciennes habitations se caractérisant par des éléments de bois au premier étage, un toit avec des auvents larges et une technique avec des pierres liées avec de la glaise et renforcée par des bandes de bois, on est graduellement passé à des édifices entièrement construits de pierre et de mortier de chaux et dont les différents éléments architectoniques sont traités conformément aux propriétés du nouveau matériel, la pierre. Dans les premières habitations de ce genre le «dyshekllëk» conserve la forme et les dimensions des «dyshekllëk» de bois, à la seule différence que le bois a cédé la place à la pierre. C'est ainsi que cette habitation acquiert un nouvel aspect architectonique qui s'exprime par la froideur et la solemnité de la masse de pierre, par la rigueur de ses lignes (Fig. 1).

L'habitation de Has. — L'évolution de l'habitation dans la région de Has se distingue par le mode particulier de solution apportée aux exigences que sont celles des grandes familles patriarcales, d'une composition numérique considérable, qui existaient à l'époque dans cette zone. Ces exigences ont été satisfaites par de petites constructions successives, destinées à des buts différents, et élevées à l'intérieur d'une cour ceinte. Ces petites constructions se répartissent en constructions d'ordre économique, comme le «kosher» (silos) des céréales, le «çaranik», une espèce de local destiné aux laiteries, le «pojat», un local destiné au logement des animaux, et en constructions destinées à l'habitation vraie et propre, comme la maison du feu, les «qyler» faisant fonction de chambre à coucher et la maison des amis.

Les différents types de groupement d'habitations familiales, que nous avons identifié dans la région de Has, témoignent de l'évolution subie sur le plan de la composition par ces groupement. Cette évolution est conditionnée par les phases d'évolution de l'habitation même et par la situation économique des familles. Au cours des premières phases la maison du feu représente le noyau initial du groupement, le centre même de la composition, et elle est entourée par d'autres constructions simples, à rez-de-chausée, de bois. Pendant les phases successives la maison du feu, ne se développant plus et en raison de son caractère primitif, perd le rôle qu'elle remplissait dans la composition. Ce rôle, non comme un noyau initial de l'habitation, mais comme un trait prononcé architectonique de la composition, est rempli maintenant par la maison des amis qui atteint des conceptions architectoniques d'un niveau élevé. Celle-ci comporte à cette phase deux étages, dont celui au rez-de-chaussée est destiné au logement du bétail et celui au deuxième se compose de la chambre des amis ayant devant elle un «divanhane».

Conditionnée par le mode de vie, et avec des constructions particulières pour chaque fonction, l'habitation de Has ne se caractérise jamais par une solution planimétrique compliquée. Les modifications qui la concernent sont essentiellement un résultat de l'élaboration des éléments architectoniques et de construction. Ces modifications intéressent surtout la maison des amis (Tab. III).

On relève dans l'habitation de Has un emploi abondant du bois d'oeuvre, qui la protège des rigueurs de l'hiver et lui confère dans le même temps un aspect pittoresque. C'est là un résultat du contraste créé par les matériaux employés, le bois et la pierre, des différents modes dont ceux-ci sont traités, de manière à distinguer les volumes qu'ils supportent, du caractère massif de la maçonnerie de pierre et des volumes qui s'y appuient, et des parois légers de bois richement travaillés (Fig. 2).

Les habitations de Lume. — Quoique Lume se caractérise par le fait d'avoir conservé jusqu'à récemment encore à l'échelle régionale une unité dans différents autres aspects de la culture matérielle et spirituelle, il n'en est pas de même pour ce qui concerne le domaine de l'architecture. On relève dans cette région différents types d'habitation. Le premier type montre une habitation fermée, dans la majorité des cas à deux étages, à traits défensifs et, souvent, sans aucun élément architectonique particulier (Fig. 3).

Une diffusion assez grande a connu dans la zone de Lume le deuxième type d'habitation, dont la construction s'est prolongé jusqu'à ces derniers temps. La principale caractéristique de ce type d'habitation est la présence d'un «hayat» étroit au rez-de-chaussée et d'un «tchardak» au-dessus de celui-ci (Fig. 4). Ces deux pièces sont fermées sur leurs deux côtés plus étroits. Le schéma planimétrique plus habituel est celui à deux pièces par étage, où l'accès à chaque pièce se réalise par une porte particulière du hayat et du tchardak. Ces derniers éléments ont surtout la fonction de mettre en communication les différentes pièces de l'habitation.

Les habitations de Mat, — Mat est une autre région typique, où l'habitation fortifiée a connu une diffusion assez large. Ce type d'habitation a totalement remplacé les anciennes maisons, en devenant de la sorte le type prédominant en cette région.

Les habitations plus habituelles sont celles à trois étages, dont le schéma planimétrique prévoit une pièce à chaque étage. L'étage au rez-de-chaussée est réservé au bétail, le deuxième étage fait les fonctions de la maison du feu et le troisième est employé pour la réception des amis (Tab. IV). L'accès à l'habitation se réalise par une seule entrée aménagée au rez-de-chaussée et à travers un escalier de bois intérieur. Ses escaliers

DO NOT COPY

conduisent à la seule pièce de chaque étage, dont l'ouverture est couverte de panneaux appelés «qepen».

Le premier étage de cette habitation, qui renferme aussi sa pièce la plus présentable, se caractérise par la présence des «çikmate», une espèce de petites saillies en forme de balcons fermés, aménagés en certains points de la chambre. Leur pavement est plus élevé du niveau du plancher de la chambre, en plus le mur qui les ferme, légèrement en saillie et peu épais, comporte quatre petites fenêtres. Chacune d'elles est disposée de manière à pouvoir contrôler les quatre coins de l'édifice; par ailleurs, chaque fenêtre est munie de meurtrières dans ses parties latérale et inférieure. Les «çikmate» remplissent un rôle défensif évident et sont employés, dans le même temps, comme lieu de séjour.

L'habitation de Mat a atteint la phase plus évoluée de la maison rurale fortifiée dans l'Albanie du Nord (Fig. 5). On la retrouve aussi dans la partie orientale de la Mirdite, dans certaines régions de Diber, Lure, Muhur et Dardhe et, par endroits, en certaines régions avoisinantes. Son élaboration dans la forme indiquée remonte à la moitié du siècle passé, mais ce n'est que dans la deuxième moitié de ce même siècle qu'elle a remplacé entièrement les anciennes maisons. Certains exemplaires assez anciens de maisons, entre autres une d'elles située dans le village de Derjan et l'autre dans le village de Benje (Fig. 6), témoignent clairement que cette région se caractérisait par une conception de composition différente. Ces maisons sont à deux étages, dont celui supérieur seulement est destiné au logement. C'est ici que se trouve la chambre du feu de dimensions assez grandes et, à sa proximité, la chambre des amis se distinguant par le «qoshk» qui occupe un parement entier de la chambre. Cet élément formant saillie par rapport aux murs extérieurs, dispose d'un plancher plus élevé et est muni de fenêtres.

Dans une période successive l'on abandonne ce schéma de composition pour adopter le schéma à une seule pièce par étage. On en conserve quelques exemplaires intéressants. Ces constructions ont hérité de celles précédentes la technique de construction et le traitement de la chambre des amis à «qoshk».

La maison fortifiée appartient à une période récente; elle conserve le schéma planimétrique, mais on y relève un traitement plus poussé des éléments architectoniques et une amélioration de la technique de construction.

Les habitations de la région de Diber aux environs de Bulqize. — L'habitation à «qoshk», dont les exemplaires sont devenus rares à Mat, nous la retrouvons largement répandue aux environs de Bulqize, une région voisine de celle de Mat. Les caractéristiques essentielles sont les mêmes. Donc nous avons affaire au schéma à une seule pièce par étage, caractérisé par une composition verticale de l'habitation jusqu'au troisième étage et par une répartition fonctionnelle analogue des étages (Tab. V). En ce qui concerne leur aspect extérieur, ces habitations deviennent plus vives en raison des «qoshk» très en saillie dans la partie supérieure de l'édifice, de la présence d'un balcon s'associant parfois au «qoshk» et d'auvents larges accompagnant le toit. Dans ces habitations le «qoshk» permet la création de lieux de séjour agréables, dont l'espace associé à celui de la chambre de amis, le rend encore plus vaste. C'est à cette fin qu'une attentio toute particulière est consacrée au traitement intérieur et exté rieur du «qoshk» (Fig. 7). En général celui-ci est aménagé au point où la hauteur de l'habitation est plus élevé, de manière à pouvoir offrir à ses habitants un panorama aussi vaste que possible.

Souvent l'escalier est extérieur, et cela pour tous les étages. Un tel mode de communication sépare suffisament les pièces les unes des autres, en accentuant dans le même temps leurs fonctions différentes. Toutefois, dans d'autres habitations l'escalier extérieur n'arrive que jusqu'au deuxième étage.

Les habitations à «qoshk» nous les retrouvons aussi dans d'autres régions du pays, entre autres dans la Malesie de Kruje et de Tirana. Ici ce type de maison est à deux étages. Dans certaines villages de Kruje le schéma de composition est le résultat de la réunion de deux noyaux à une pièce, ce qui s'observe dans la symétrie complète par rapport au mur de refend.

Dans les villages de la zone montagneuse de Tirana, dont les habitations se distinguent par un schéma de composition en général mixte, conditionné par l'existence de familles nombreuses vivant sous le même toit, les constructions à «qoshk» participent à de manière différente à la composition. Elles peuvent représenter une construction à soi dans la cour, qui en l'occurence est employée comme «konak» pour recevoir les amis, ou comme construction contiguë de l'habitation de la famille. Son schéma plus simple est celui de la maison du feu, dont les dimensions sont grandes sur le plan et en hauteur dans cette région et qui se voit ajouter une autre construction de deux étages à «qoshk».

Partant de la même solution fonctionnelle et de la composition planimétrique des étages, il ressort que l'habitation de Çermenike aussi représente une variante de ce type, qui se différencie toutefois par la seule formulation architectonique de son extérieur. L'habitation de Çermenike se caractérise par une galerie fermée avec des planches de bois, circonscrivant les murs extérieurs de l'étage supérieur et renfermant un angle de séjour faisant part de l'espace de la pièce de l'étage, (Fig. 8).

o o
o

De ce bref exposé des principaux types et variantes d'habitation de l'Albanie du Nord, il ressort que nous avons affaire à un enchevêtrement de principés concernant la composition et de solutions planimétriques et fonctionnelles, ainsi qu'à l'emploi d'éléments architectoniques et de techniques de constructions analogues dans les différentes régions examinées, ce qui témoigne en faveur d'une liaison entre celles-ci. Une telle chose a entraîné la création d'un type caractéristique d'habitation rurale, se distinguant par une liberté dans l'application pratique de ce type selon les conditions locales.

Ainsi par exemple différentes constructions volumétriques et solutions fonctionnelles se caractérisent par des schémas plani-

DO NOT COPY

métriques et des éléments architectoniques identiques. Dans ce contexte, les habitations de la Malesie de Gjakove et de Has expriment cette analogie dans la formulation planimétrique de l'étage supérieur et par la création de pièces particulières pour chaque fonction.

Des schémas analogues de composition et fonctionnels se caractérisent par une formulation extérieure et une technique de construction différentes, exemple les habitations de Mat, Diber, Çermenike et autres.

Outre ces aspects, en faveur des liens existant entre les différentes régions témoignent aussi les exemplaires typiques d'une région construits dans une autre région. Ainsi, par exemple, la maison caractéristique de la Malessie de Gjakove nous la retrouvons à Has, celle de Mat à Diber, celle de Diber à Çermenike, et vice versa.

L'évolution intérieure et incessante de ces types, jusqu'à l'adoption de nouvelles conceptions architectoniques, est une autre caractéristique importante de l'architecture rurale de l'Albanie du Nord. Cela apparaît clairement surtout dans le processus de formation des habitations à traits défensifs de la Malesie de Gjakove et de Mat. Bien que ces habitations se fondent sur la même idée de sécurité de ses habitants, ce qui est obtenu par des compositions volumétriques et une technique de construction analogues, ces maisons se distinguent d'une région à l'autre. Et les différences en question concernent tant leurs aspects essentiels, par exemple la construction planimétrique, que leurs aspects collatéraux que sont les différents éléments caractéristiques. Ce qui montre qu'indépendamment du fait que ces habitations aient assimilé le schéma défensif habituel, prévoyant l'agrandissement de la maison en hauteur et la présence d'autres éléments défensifs, elles ont conservé quand même plusieurs traits caractéristiques des habitations précédentes.

Dans l'architecture des habitations de l'Albanie du Nord s'observent aussi les efforts fournis par les maîtres constructeurs populaires, qui, parallèlement à la satisfaction des exigences pratiques, n'ont pas manqué de donner des réalisation réussies du point de vue architectonique et artistique. Ce soin du maître constructeur s'observe même dans les plus petits détails, de manière à ce que chaque élément soit élaboré sur le plan de la décoration avec modération et sans porter atteinte à sa fonction essentielle.

En abordant dans cette communication rien que certains aspects du patrimoine architectonique que représentent les habitations rurales types de l'Albanie du Nord, il apparaît clairement combien infondées sont les affirmations de certains auteurs étrangers anciens ou contemporains attribuant à celles-ci un caractère primitif ou les considérant comme des emprunts d'autres pays.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Thanas KAMBERI

VENDBANIMET DHE BANESAT FSHATARE NË DROPULLIN E POSHTËM

Në këtë kumtesë do të trajtojmë dy çështje: së pari, mbi bazën e vrojtimeve në terren do të trajtojmë problemin e zhvendosjes në kohë të vendbanimeve fshatare nga lartësitë në zonën e ulët, pastaj arkitekturën e banesës fshatare të kësaj zone. Lugina e Drinos është e përbërë prej tokash aluviale që shfrytëzohen gjerësisht për bujqësi. Përgjatë saj kalonte një nga rrugët më të rëndësishme të vendit tonë, e cila lidhte Shqipërinë me krahinat veriore të Greqisë.

Fshatrat përgjatë mesjetës së mesme qenë vendosur larg rrugës, në shpatin lindor të Malit të Gjerë. Arsyet e kësaj vendosjeje në terrene relativisht të vështira duhet t'i kërkojmë kryesisht në synimin për t'iu larguar rrugës, e cila bartte rreziqe, si dhe në mbisunkalimin e kohës fillon gradualisht zbritja e këtyre fshatrave nga pjesët e larta në rrugën e shpateve, në afërsitë e fushës, por përgjithmonë në troje të pjerrëta mbi nivelin e fushës, për të mos u përmbytur nga vërshimet e Drinosit. Shkaqet e kësaj zhvendosje duhe- shpjeguar me ndryshimin e natyrës ekonomike të fshatit, nga blegtoralo-bujqësore në bujqësore-blegtorale.

Ekzistenca e pronës së madhe mbi tokat e luginës, kishte krijuar kushte shumë të vështira jetese për banorët e këtyre fshatrave, varfëria e të cilave ishte aq e madhe, sa i shtynte të emigronin jashtë vendit për të siguruar jetesën.

Po kalojmë tani në parashtrimin e njëkohtë të zhvendosjes së disa fshatrave dhe të disa tipareve arkitektonike të banesës në këto fshatra, aq sa lejojnë rrënojat dhe të dhënat burimore dhe gojore.

Prej tyre fshati Kollorcë që shtrihej rreth një fortifikimi të vjetër dhe që përmendet në defterin turk të vitit 1431-1432 si fshat me 56 shtëpi, zhvendoset gradualisht. Kështu në vitin 1910 ai numëronte vetëm 4 familje, të cilat merreshin më shumë me blegtori. Dhe këto në vitin 1911 u shpërngulën për në fshatrat përreth. Gjurmët e pakta të banesave të këtij fshati që ruhen deri më sot si dhe të dhënat gojore tregojnë se banesa më e përhapur e kësaj qendre ka qenë ajo perpendikulare me vatër në mes, e të njëjtit tip me banesën e përhapur deri vonë në këtë zonë.

Fshati më afër Gjirokastrës, në drejtimin jugor, është Dervicjani, ku gjejmë banesa të vjetra dhe kulla. Këto të fundit janë të së njëjtës periudhë me ato të ndërtuara në fshatrat e tjera të kësaj zone. Ky fshat më parë ndodhej gjysmë orë larg fshatit të sotëm dhe quhej «Kukula». Mbeturinat e këtij vendbanimi janë ende dhe sot në këmbë. (Fig. 1). Nga planimetria si dhe nga teknika e ndërtimit të muraturës prej guri në të thatë të këtyre rrënojave konstatojmë se ato ndryshojnë nga teknika e ndërtimit të banesave të fshatit të mëvonshëm, e cila ka një cilësi shumë më të mirë. Banesa me formulim të thjeshtë e këtij fshati, largësia nga fusha edhe afëria me kullotat malore, tregojnë se ky fshat merrej kryesisht me blegtori. Ndoshta zbritja e tij ka ndodhur para pushtimit turk, pra para shekullit XV, madje edhe sot lagjja më e madhe e fshatit ruan emrin e vjetër «Kukula». Më vonë, pas pushtimit turk, si duket mori emrin e sotshëm Dervicjan, i cili duket se është me origjinë turke. Në Dervicjan gjejmë banesa të vjetra, disa prej të cilave ruajnë origjinalitetin e tyre (Fig. 2). Po në këtë fshat veç banesave ruhen dhe disa kulla, ndonëse të adaptuara, të cilat duhet të jenë ndërtuar përpara banesave që ekzistojnë sot në këtë fshat dhe që nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha.

Një numër të madh kullash të tilla, disa prej të cilave në gjendje të mirë, ruhen në fshatin Goranxi (Fig. 3) Ky fshat është krijuar nga bashkimi i dy fsha



Fig. 1



Fig. 2

trave të vjetra, mbeturinat e të cilave ekzistojnë akoma dhe sot. Zbritja dhe bashkimi i tyre duhet të jetë bërë pas shekullit XIV. Në njërin nga këto fshatra ruhet në gjendje të mirë një kishë e shekullit XIV. Muratura e themeleve të banesave rrënojë siç rezulton nga vrojtimet në vend tregon për një punim të mirë të muraturës me gurë shtresorë të nxjerrë në vend. Teknika e ndërtimit është e njëjtë me atë të fshatit pasardhës. Bashkimi i këtyre dy fshatrave dhe ndërtimi më afër fushës i fshatit Goranxi, duhet të ketë ndodhur si pasojë e ndërtimit të kullave për shfrytëzimin e çifçinjve nga vetë pronarët e tokave. Nga sasia e madhe e kullave emri i këtij fshati ka marrë parashtesën Kulla, pra fshati thirret Kulla Goranxi (Goranxia e kullave), që më vonë aty nga fillimi i shekullit tonë fshatarët e kthyen në Kallogoranxi (Goranxi e mirë).

Spostime të tilla nga vende të mbrojtura, të padukshme nga rruga, drejt fushës kanë pothuajse të gjitha fshatrat e kësaj zone. Kështu fshatrat Vanistër, Haskovë, Dhuvjan kanë lëvizur me qëllim që t'u afrohen sa më shumë tokave të punueshme. Duke vazhduar drejt jugut krahas fshatrave të sotme, gjejmë lart tyre dhe fshatra të braktisura siç janë fshatrat që ndodhen afër Jergucatit dhe Buni i Kuq (Pirokopinoni) ose Prokopi siç quhet sot. Fig. 4. Këto dy fshatra ndryshe nga ato që pamë deri tani kanë një karakter më të theksuar bujqësor.

Fshati Isharat, sot rrënojë, ndahej në dy lagje,



Fig. 3



Fig. 4

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6

Lagjja e banuar ndodhet në krahun e djathtë me banesa të tipit perpendikular terrenit (Tab. I), me një teknikë ndërtimi që gjendet rrallë në fshatrat e tjera (Fig. 5). Muri i thatë, i lidhur dhe i puthitur mirë, ka mundur të mbajë atë qëndrim të braktisur deri në ditët tona.

Kasollet dhe lëmenjtë e shumtë që ruhen në këtë fshat tregojnë se ai merrej më shumë me bujqësi. Lëmenjtë janë rrethuar me mure guri të mëdhenj. Afër çdo lëmi gjejmë të ndërtuar nga një godinë njëkatëshe që për nga dimensionet dhe teknika e ndërtimit tregojnë se kryenin funksionin e kasolleve për depozitimin e kashtës. Kasolle të tilla dhe një sasi më të vogël lëmenjsh gjejmë dhe në pjesën e fundit të lagjes së banuar, por gjithmonë pranë fushës. Nga ngjashmëria e tipit të banesës, karakterit bujqësor të ekonomisë, distancës së afërt me këtë fshat mund të themi se edhe Prokopi duhet të ketë qenë i njëjtë me Isharatin. Banesat perpendikulare terrenit i takojmë më parë në gërmadhat e këtyre fshatrave dhe në mbarë Dropullin e Poshtëm. Ato kanë të njëjtën formë planimetrike, duke shfrytëzuar me mjeshtëri terrenin për të pakësuar sipërfaqen e kontaktit me tokën dhe për të pasur më pak volum ndërtimi. Këto banesa janë dykatëshe. Le të shohim nga afër një nga këto banesa. Kati i parë ka një ambient për mbajtjen e kafshëve, i cili ndriçohet nga dritare të vogla në formë frëngjie me dimensione 50 x 6 cm. (Tab. II). Kati i dytë me një ambient me dimensione të brendshme 10 x 4 m ka qenë shtruar pjesërisht me dysheme dërrase, siç e vërtetojnë vrimat e vendosjes së trarëve të dyshemesë. Balli nga ana e malit ka kamare si dhe në mes «harxovë» në pjesën e oxhakut. Me sa kuptohet këtu kryheshin të gjitha funksionet: gatimi, ndenja, fjetja si dhe pritja e miqve.

Po këtë tip banese e gjejmë të përsëritur dhe në fshatrat e tjera si në Dervicjan. I vetmi ndryshim është se kjo banesë oxhakun, që haset gjithnjë (nënkuptohet pa tymar), nuk e ka në faqen fundore se te kjo banesë në ambientin e vetëm të katit të dytë, të shtruar në gjysmën e fundit me baltë, gjendet vatra e zjarrit, vendi i varjes së saçit (pa furrë) si dhe sofallëqe e kamare për vendosjen e enëve të kuzhinës. Pjesa tjetër e këtij ambienti shtrohet me dysheme druri. Në faqen veriperëndimore të ambientit kemi vendin e larjes (nerohiti). Në katin e parë hyhet me portë të jashtme, përveç saj ka dhe një hyrje nga brenda nëpërmjet një qepeni. Asnjë nga këto banesa nuk ka tavane, kështu që tymi del lirisht nëpërmjet çatisë. Muret janë suvatuar me baltë dhe në asnjë rast nuk janë shërbetuar me gëlqere.

Në këto banesa hyrja zakonisht gjendet në fasadën juglindore për të qenë e mbrojtur nga veriu. Ajo është pajisur me kanata dërrase njëflegërshe dhe sigurohet nga brenda me katarah.

Në hyrje të çon një shkallë e thjeshtë guri. Për të mënjanuar lagështinë e madhe të kësaj ane, hyrja mbrohet nga sipër prej zgjatimit të flegrës së çatisë «hajatërisht». Çatitë e këtyre banesave janë të ngjashme, të punuara me lëndë druri të rrumbullakët. Forma e kësaj çatie që nuk e hasim në banesat e mëvonshme është nga format më të vjetra e interesante. Shpërndarja e peshës së saj në muret anësore bëhej pa asnjë mbështetje ndërmjetëse në trarët e tavanit, pra



Fig. 7

pa «sofallëqe». Zinxhiri i sipërm kalon pa kllaposje mbi zgjatjen e mahive dhe së bashku me arkareçat kompletojnë skeletin e kësaj çatie. Në këtë çati nuk hasim asnjë pjesë lënde të sharruar, bile dhe patavrat që kalojnë paralel mahive të mbështetura në arkareçat janë me lëndë të rrumbullakët. Muret të ndërtuara në të thatë me gjerësi 0,75 m mbeten të tilla gjatë gjithë periudhës në shqyrtim. Mungesa e llaçit në muret e banesës ka kërkuar nga mjeshtrit e asaj kohe një punë më të kualifikuar. Arsyeja e mospërdorimit të llaçit është mungesa e ujit dhe gëlqeres. Mungesa e ujit në këtë krahinë ka qenë problem për banorët, të cilët janë munduar ta sigurojnë duke shfrytëzuar ndonjë burim natyror, i cili në stinën e verës thahej, ose duke ndërtuar në fund të çdo fshati puse që mbusheshin nga filtrimet me shumë papastërtira. Thellësia e këtyre puseve shpeshherë i kalonte të 20 pashët. Uji këtu depërtonte nga muret e thata prej guri, me të cilat vishen ata.

Për të qenë banesa e mbrojtur nga ndonjë dhunim eventual, gjatë gjithë murit perimetral gjejmë vetëm dy dritare nga balli në drejtim të fushës, me qemer guri me dimensione 30 x 50 cm. (Fig. 6). Ndërtimi i dy dritareve të tilla në të katër muret perimetrale siguronte një dritë minimale, për ambientin e madh me dimensione 10 x 4 m. Pjesa nga ana e vatrës disa herë ndriçohej me anën e ndonjë baxhe Fig. 7 të lënë në çati midis rrasave të gurit. Kati i parë ndriçohej nga një dritare në formë frëngjie me dimensione 50 x 6 cm. Ushqimet për kafshët si dhe bagëtia e imtë mbahej në ndërtime të veçanta larg banesës.

Banesa me një ambient banimi me kalimin e kohës ndahet në dy ambiente, në atë të zjarrit dhe atë të fjetjes dhe pritjes së miqve. Teknika e murit ndarës ndryshon. Te banesat e Jergucatit ai ishte me purteka të thurura e të suvatuara me baltë, kurse në atë të fshatrave të tjera me dërrasa të holla. Hyrja në dhomën e miqve bëhej nga jashtë e nga brenda. Duke u ndarë banesa në dy kthina, duheshin dhe dy hyrje, kështu nga jashtë ndërtohet portë me qemer guri dhe për ambientin e dytë. Për të mbrojtur këto dy hyrje nga agjentët atmosferikë, lindin nevoja e zgjatjes së strehës, e cila dalngadalë arrinte deri te fasada kryesore dhe krijonte një divan të hapur.

Divani i hapur, duke qenë gjithmonë nën ndikimin e agjentëve atmosferikë si dhe nevojës së zgjerimit të familjes, mbyllet me kalimin e kohës, duke krijuar dhomën e tretë në këtë banesë, pa ndryshuar embrionin e saj (Tab. III).



Fig. 8

DO NOT COPY

Vatra me anekset e saj ngelet në shtëpinë e zjarrit pa dritare. Në disa nga këto banesa vendi i pjekjes është zëvëndësuar me furrën, siç është ekzemplari i gjetur në fshatin Jergucat.

Divani i mbyllur me dërrasa nga të tria faqet shërbente si dhomë fjetjeje, ai ka dimensione të vogla dhe një lartësi të ulët. Banesa të tilla me divan të mbyllur me skelet druri të veshur me dërrasa ruhen në gjëndje të mirë në fshatin Goranxi.

Me ndarjen e katit të banuar në dy ambiente dhe më vonë me shtesën e divanit ose të hajatit, fasadat e kësaj banese u pasuruan nga ana arkitektonike. Në banesat e thjeshta si në rastin e shembullit të Dervicjanit kemi një muraturë të thjeshtë. Dritaret nuk kanë nga jashtë asnjë zbukurim dhe korniza nën strehë ka kapakë guri të mbivendosur pa ndonjë kujdes të veçantë.

Në banesat e mëvonshme të datuara aty nga mesi i shek. XIX gjejmë një punë më të përsosur në muraturë ndonëse dhe ajo e ndërtuar në të thatë. Guri është punuar me mjeshtëri të rrallë, latimi i tij dhe puthitja tregojnë një nivel të lartë profesional. Në këto banesa gjejmë një sërë elementesh arkitektonike, të cilat të kompozuara me proporcione të goditura u rrisin vlerat arkitektonike të këtyre banesave. Me mjeshtëri janë ndërtuar harqet e qemereve si dhe streha, së bashku me elementët mbajtëse prej guri nën kapakët e gdhendur, që jo vetëm qëndrojnë shumë mirë, por sigurojnë dhe një mbyllje të plotë të nënstrehës. Bukur është punuar dhe dalja nën dritare (Fig. 8), nga ana e jashtme, e mbështetur dhe kjo me mjeshtëri mbi dy konsola të profiluar e të gdhendur bukur.

Veshja e divanit me dërrasa me kalimin e kohës u zëvëndësua me mur guri. Njëkohësisht ai u zgjerua, kurse çatia me rrasa guri nuk mbulohet më «hajatarisht», por kthehet si në banesat në çati në formë samari. Duke filluar prej shekullit XX, banesa e vjetër perpendikulare zëvendësohet me një tip të ri, atë të vendosur paralel me vijat rrushkulluese me një ambient ndërlidhës në qendër dhe nga një ambient anash për çdo kat. Shkallët në të janë të brendshme (Tab. IV). Siç duket banesa perpendikulare e terrenit që pamë do të ketë ekzistuar nga shekulli i 17-të deri në fillimin e shekullit të 20-të. Ajo takohet dhe në qytetin e



TAB. I

Gjirokastrës, sidomos në lagjen Dunavat dhe Pazar i Vjetër, banorët e të cilave janë marrë kryesisht me blegtori.

POOR COPY



DO NOT COPY

DO NOT COPY



PAMJE KRYESORE

0 4 M



KATI PERDHE



KATI PARE

DO NOT COPY





KATI PERDHE



KATI I PARE



Thanas KAMBERI

DO NOT COPY

AGGLOMERATIONS ET HABITATIONS RURALES DANS LE BAS DROPULL

RESUME

Dans cette communication nous allons aborder deux problèmes: premièrement, sur la base des observations faites sur place, nous allons examiner le problème du déplacement des agglomérations rurales de la zone haute à la zone basse et, deuxièmement, nous allons étudier l'architecture de la maison paysanne en cette zone. La vallée du Drinos comporte des terrains alluviaux largement exploités à des fins agricoles.

Pendant la moitié du Moyen âge les villages de cette zone se trouvaient loins de la route, sur le versant oriental de Mali Gjerë. Les motifs de leur disposition sur des terrains relativement difficiles doivent être recherchés surtout dans le souci de s'éloigner de la route pour en éviter les dangers, ainsi que par la priorité accordée à l'élevage par rapport à l'agriculture vraie et propre. Plus tard ces villages abandonnent les versants de montagne et s'approchent graduellement de la plaine, en s'installant toujours sur des terrains plus élevés que le niveau de la zone plate, et cela pour échapper aux inondations périodiques du Drinos. Les motifs de ce déplacement s'expliquent par les changements survenus dans la nature économique du village, qui est passé d'une économie d'élevage-agricole à une économie agricole-d'élevage.

Le village de Kollorcë, qui s'étendait à proximité d'une fortification ancienne et qui comptait 56 maisons selon le Registre ottoman de l'an 1431-1432, commence à ce déplacer graduellement. Ainsi, en 1910 il ne compte que quatre familles s'occupant surtout d'élevage. Plus tard, en 1911, même ces quatre familles s'en vont habiter les villages avoisinants. Les traces peu nombreuses de maisons conservées de nos jours encore et les témoignages des gens du pays indiquent que l'habitation la plus répandue en cette agglomération rurale était celle perpendiculaire ayant le foyer en son milieu, soit un type analogue à celui répandu jusqu'à récemment encore en cette zone.

Le village plus proche de Gjirokaster, en direction sud, est celui de Derviçan, où ont été identifiés des maisons anciennes et des kulla. Celles-ci appartiennent à une même période de construction que les maison des autres villages de cette zone. Derviçan se trouvait auparavant à une demie heure de marche de son emplacement actuel et sappelait «Kukula». On y trouve encore des maisons anciennes conservant leurs caractéristiques originales, voir même des kulla, peut-être adaptées et dont la construction précède celle des habitations actuelles de ce village, qui n'a pas enregistré des modifications profondes. Un grand nombre de kulla semblables, dont certaines conservées dans un état satisfaisant, ont été identifiées dans le village de Goranxi. Celui-ci est un résultat de la réunion de deux villages anciens, dont les ruines sont visibles de nos jours encore. Leur déplacement de la zone haute et leur fusion doivent avoir eu lieu après le XIVe siècle. Dans un de ces villages, il y a une église du XIVe siècle, conservée actuellement dans un état satisfaisant.

De tels déplacements des lieux protégés, non visibles de la route, en direction de la plaine, caractérisent presque tous les villages de cette zone. Ainsi, les villages de Vanister, de Haskove et de Dhuvian se sont déplacés dans le but de s'approcher des terres arables. En direction sud, de pair aux villages actuels, au-dessus de ceux-ci s'élèvent d'autres villages abandonnés. Exemple les villages situés à proximité de Jergucat et Buni i Kuq (Pirokopinoni), ou Prokop comme on l'appelle maintenant. Ces deux villages, à la différence que ceux que nous venons d'examiner, ont un caractère agricoles plus marquant.

Le village d'Isharat, actuellement en ruine, avait à l'époque deux quartiers. Celui situé à sa droite se caractérise par des maisons d'un type perpendiculaire au terrain et par une technique de construction que l'on retrouve rarement dans les autres villages. Le nombre élevé de chaumières et d'aires conservées de nos jours encore montre que ce village s'occupait surtout d'agriculture. Les rivières sont entourées de murs de pierre épais. Les maisons perpendiculaires au terrain apparaissent pour la première fois parmi les ruines de ces villages et dans tout le bas Dropull. Leur planimétrie exploite habilement le relief du terrain pour diminuer la surface de contact avec le sol et pour effectuer un volume de construction moindre. Ces maisons sont à deux étages. Le premier dispose d'un local destiné au logement des animaux et il est illuminé par de petites fenêtres en forme de meurtrières. Le deuxième étage ne comprend qu'une seule pièce destinée à la satisfaction de toutes les exigences de ses habitants: elle sert en même temps de cuisine, de chambre de séjour, de chambre à coucher et de chambre des amis.

Ce même type d'habitation nous le retrouvons aussi dans les autres villages. L'entrée est en général aménagée sur la façade sud-est, celle-ci, n'étant pas exposée aux vents du nord. On

accède à la porte d'entrée à travers un escalier en pierre de facture simple. Le prolongement du toit couvre cette partie de la maison pour éliminer l'humidité excessive.

Afin de faire face à toute attaque éventuelle, le long du mur extérieur il n'y a que deux petites fenêtres aménagées sur la partie de la façade regardant la plaine. Evidemment ces deux petites fenêtres ne procurent qu'une illumination très réduite à la grande pièce destinée à l'habitation. Parfois le foyer est illuminé par une lucarne ouverte dans le toit entre les plaques de pierre. Le premier étage reçoit la lumière d'une petite fenêtre en forme de meurtrière. La nourriture des animaux et le menu bétail sont tenus dans des constructions particulières s'élevant loins de la maison.

Avec le temps l'habitation à une seule pièce se divise en deux: d'une part le foyer et de l'autre la chambre à coucher qui sert aussi de chambre des amis. L'accès à la chambre des amis a lieu de dehors et de dedans. La division de la maison en deux entraîna la nécessité de deux entrées, ce qui fut réalisée de dehors en construisant une porte voûtée pour la deuxième pièce. Afin de protéger ces deux entrées des intempéries, il a fallu prolonger l'auvent, qui, avec le temps, rejoint la façade principale et crée ainsi une espèce de loggia ouverte, appelée hayat.

Cette loggia ouverte, sous l'influence constante des intempéries et de la nécessité d'extension des members de la famille, finit par être fermée, en créant de la sorte une troisième chambre sans pour autant modifier l'embryon de cette maison.

Le foyer et ses accessoires continuent à demeurer dans la maison du feu, qui manque toujours de fenêtres.

Par la division de l'étage destiné à l'habitation d'abord en deux pièces et puis par l'adjonction de la loggia ou du hayat, les façades de cette habitation s'enrichissent sur le plan architectonique.

Les maisons plus récentes datant la moitié du XIXe siècle se caractérisent par une moçonnerie plus soignée, bien que celle-ci soit en pierres sèches. Ces habitations comportent une série d'éléments architectoniques, composés dans des proportions harmoniques, ce qui ne fait que croître leur valeur architectonique. Les arcs des voûtes et les auvents notamment montrent l'habileté des maîtres bâtisseurs. D'une facture remarquable est aussi la saillie au-dessous de la fenêtre, s'appuyant de l'extérieur avec maîtrise sur deux consoles profilées et travaillées admirablement.

A partir du XXe siècle l'ancienne habitation perpendiculaire cède la place à un type nouveau, disposé parallèlement aux lignes de profondeur du terrain et comportant à chaque étage une pièce centrale mettant en communication les deux autres aménagées latéralement à celle-ci. L'escalier extérieur aussi a été remplacé par un escalier intérieur. A ce qu'il semble la maison perpendiculaire au terrain, que nous venons d'examiner, doit avoir existé du XVIIe siècle jusqu'au commencement du XXe. On la retrouve aussi dans la ville de Gjirokaster, et en particulier dans les quartiers de Dunavat et du Vieux Bazar, dont les habitants s'occupaient principalement d'élevage.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Faruk ZARSHATI

BANESA POPULLORE NË MALËSI TË LEZHËS

Në kuadrin e gjurmimit dhe të vënies në mbrojtje të ndërtimeve fshatare që intensivisht po ndërmerr Instituti ynë këto vitet e fundit, ne kryem disa ekspedita në Malësi të Lezhës, deri sot e pashkelur për qëllime studimi të banesës së asaj zone. Këtë banesë që ne hasëm do të përpiqemi ta japim këtu të përmbledhur, duke u përqëndruar në variantet më karakteristike që përbëjnë njëkohësisht dhe një unitet në trajtimin e tyre arkitektonik.

Malësia e Lezhës shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë, duke u kufizuar në perëndim nga fusha bregdetare me emër Bregu i Matit (vendësit i thonë Brehmatja), nga jugu me lumin e Matit, nga lindja me krahinën e Mirditës dhe në veri pjesërisht me Zadrimën dhe pjesërisht me malet e Potokut. Në ndarjen administrative të sotme kjo malësi bën pjesë në rrethin e Lezhës, ndërsa në ndarjen e vjetër territoriale bënte pjesë në 12 bajraqet e Mirditës. Fshatarët e kodrave buzë Pllanës, Zejmenit, Pruellit dhe Grykës së Manatisë, që bëjnë pjesë në këtë malësi e që ishin kryesisht fshatra blegtorale, punonin një sipërfaqe të kufizuar toke dhe në Bregun e Matit, e cila deri para 150 vjetësh ishte tokë me pyje e moçale. Këta madje i quanin të tyre këto toka dhe kullota. Mirëpo nga fillimi i shek. XIX, të përkrahur nga bushatllinjtë e Shkodrës, malësorë nga Kelmendi, Shkreli, Hoti, Kastrati, etj., të Malësisë së Madhe, filluan të vijnë këtu dhe të shfrytëzojnë këto kullota e madje të vendosen këtu me banim të përhershëm.

Fshatarët e Malësisë së Lezhës për vetë karakterin tepër të thyer të terrenit si dhe nga mungesa e ujit për vaditje para Çlirimit janë marrë më tepër me blegtori. Fshatrat janë të shpërndara dhe banesat janë të vendosura larg njëra tjetrës, duke shfrytëzuar me mjeshtëri terrenin edhe kur ky është shumë i thyer. Ato janë me oborre të parrethuar me mure (ai formohet nga rrethimi i truallit pranë banesës me gardhe). Në oborr në raste shumë të rralla, gjejmë ndërtime ndihmëse për mbajtjen e bagëtisë, të barit, shpendëve, apo të druve. Më shpesh gjejmë në oborr ndonjë qaranik prej druri, që shërben për mbajtjen e ushqimeve freskët (Fig. 1). Ambienti sanitar është gjithmonë brënda në banesë (Fig. 2,3). Hyrja për në banesë bëhet nëpërmjet një dere, gjithmonë të mbuluar me hark, realizuar me gurë të punuar ose jo. (Tab. I).

Le të shohim si organizohej jeta brënda në banesë. Në banesën e Malësisë së Lezhës ka pasur tri ambiente, të cilat ndryshonin si për nga funksioni, ashtu dhe kompozimi i elementeve arkitektonike përbërëse të tyre. «Shtëpia e grave» ishte vendi ku rrinin dhe gatuanin gratë; «oda e miqve» ose e burrave, ku pritej miku dhe zakonisht rrinin burrat e shtëpisë, dhe «burgu», që ishte vendi ku mbaheshin bagëtitë dhe kafshët e trasha. Me nxjerrjen e bagëtisë jashtë banesës ky i fundit e humbi funksionin që kishte dhe shfrytëzohet tani qoftë si shtëpi grash, qoftë për kurorat e veçanta. Por kjo nuk na e bën të vështirë studimin e gjendjes fillestare, të këtij ambienti, sepse janë ndryshime që mbahen mend nga më të moshuarit.

«Shtëpia e grave», siç shihet nga emri që i jepnin vendësit, ishte ambienti ku rrinin gratë së bashku me fëmijët. Aty ato dhe gatuanin. Ky ambient është gjithmonë pa tavan dhe në variantin më primitiv gatimi bëhej në vatrën e zbuluar, që vendosej pothuajse në mes të dhomës (Fig. 4). Kjo e fundit në këtë rast është e ndërtuar me pllaka guri dhe ka dy gurë pak më të ngritur anash. Zinxhiri ose «vargoi» ku vihet kusia e gatimit është i varur në trarët e çatisë tamam mbi vatër. Më vonë vatra u spostua dhe u vendos pranë një niqi në mur, që merr forma të ndryshme. Mbi të vendoset një pritëse xixash në formë koshi me konstruksion druri ose i thurur me thupra e lyer me baltë, që



Fig. 1



Fig. 2

DO NOT COPY

vendësit e quajnë «allaturka». Oxhaku prej guri me tymarin lart në çati që vendësit e quajnë «allafranga» është një element që ka hyrë më vonë në banesa të kësaj zone. Në një qoshe të këtij ambienti në banesat më të hershme ndodhej edhe furra e pjekjes së bukës (Fig. 4). Kjo ishte e ndërtuar prej guri dhe vendi i prushit mbulohej me një kupolë në trajtën e çereksferës, ndërtuar kjo me copa tjegullash. Ngandonjëherë furra kishte dy vende për pjekje. Sot nuk ndërtohen furra brënda banesës. Në raste të rralla ato ndërtohen jashtë saj (Fig. 5).

Ky ambient merrte dritë nëpërmjet një numri të kufizuar dritaresh të vogla. Ai ishte gjithmonë i errët nga tymrat, të cilat, pasi qarkullonin nëpër dhomë, dilnin nëpërmjet hatllave (sigurisht për rastet kur mungonte oxhaku).

«Oda e miqve» ose «oda e burrave» apo «çardaku» vlen të përmendim që në fillim se emërtimi «çardak» që i jepnin vendësit odës së miqve nuk ka të bëjë aspak me çardakun e mirëfilltë; ai emërtohet kështu vetëm kur banesa është me kat.

Ky ambient ka një trajtim që dallon nga ai i grave, për vetë faktin se aty do të pritej edhe miku. Zjarri këtu asnjëherë nuk bëhej në mes të ambientit, por pranë niqit me koshin sipër ose në oxhakun prej guri me kamaret anash. Vendi i mikut dhe i të zotit të shtëpisë, në raport me oxhakun, ishte i përcaktuar qartë. I zoti i shtëpisë rrinte pranë dollapit të kafesë, mbasi në fshatrat e Shqipërisë së Veriut kafenë në të kaluarën e bënte gjithmonë i zoti i shtëpisë. Këtu gjejmë gjithashtu sqollin që është vendi për larjen e duarve dhe nyjen sanitare që del jashtë mureve perimetrale të banesës. Katër dritare të vogla, ngandonjëherë dhe tri ose dy, që mbyllen me kapakë druri nga brenda, e ndriçojnë pak a shumë këtë ambient dhe e bëjnë sadopak të mos izolohet nga natyra përreth. Dy prej të cilave vendosen gjithmonë në faqen e murit ku ndiqet zjarri, ndërsa të tjerat në muret e tjera anësore të banesës. Kur banesa ishte me kat, ky ambient shtrohej me dysheme dërrase dhe tani vonë ka filluar të mbyllet me tavan.

«Burgu», ishte ambienti ku mbaheshin bagëtia ose kafshët e trasha. Ai ishte gjithmonë pa dritare, sepse fshatari në të kaluarën donte t'i ruante nga çdo e papritur dhe njëkohësisht t'i mbante ngrohtë. Burgu kishte gjithmonë hyrje nga jashtë të mbuluar me hark. Kompozimi planimetriko-volumor i këtyre ambienteve na jep dhe variantet e ndryshme të banesës që hasim në Malësi të Lezhës.

Ai më i thjeshti (Fig. 5) ka vetëm një ambient me hyrje drejtpërsëdrejti nga ana më e gjerë e banesës dhe shërben si shtëpi grash dhe si odë burrash. Vendësit e quajnë «jerevi» dhe ajo haset rrallë në këto zona, ndërsa më tepër në gjejmë afër fushës. Vatrën e ka të zbuluar dhe të vendosur në mes. I gjithë ambienti merr dritë nga një dritare e vogël. Tri kamare të vogla në faqet e murit e plotësojnë gjithë komoditetin e varfër të kësaj kthine për banim.

Për plotësimin e nevojave të zgjerimit të familjes, këtij ambienti i shtohet dhe një tjetër. Kemi kështu banesën përdhese me dy ambiente (Tab. II) me funksione të ndryshme, njëri për burrat, tjetri për gratë. Hyrja për në të dy këto ambiente bëhet drejtpërsëdrejti nga jashtë. Ato ndërlidhen nga brenda me anë të një dere. Të dy ambientet janë të thjeshta, pa tavan dhe kanë ato elemente që ne përshkruam më lart.

Kur dy nga të tri ambientet që përshkruam më si-

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

për oda e miqve dhe burgu kompozohen njëra mbi tjetrin, atëherë kemi **banesën me kat** me nga një ambient në çdo kat (Tab. III). Në fakt ambienti lart kryente dikur dy funksione, atë të odës së miqve dhe atë të shtëpisë së grave. Themi kryente, sepse tani nuk gjetëm asnjë banesë të këtij varianti me këto funksione ambientesh. «Burgu» e ka humbur funksionin fillestar, ai tani është shndërruar në shtëpi grash, dmth ambient ku dhe gatuhet. Aty janë hapur dritare, është ndërtuar dhe oxhaku prej guri. Komunikimi i këtyre ambienteve bëhet nëpërmjet shkallëve të thjeshta prej druri nga brenda banesës dhe asnjëherë jashtë saj.

Variantin e mësipërm e gjejmë shpesh më të zhvilluar kur kemi dy banesa të tilla të bashkangjitura me hyrje të veçanta, ku secila ka po atë numër dhe lloj ambientesh (Tab. IV). Në këtë rast pra kemi katër ambiente, dy për banim dhe dy për kafshët, dmth «burgjet» poshtë, ndërsa lart odën e miqve dhe shtëpinë e grave.

Tipi më i kristalizuar për mendimin tonë, është ai me tri ambiente, dmth banesa me kat me bazë të zhvilluar dhe ai me gjysmë kat. Banesën me kat me bazë të zhvilluar ose siç thonë vendësit kullë jerevi» (Fig. 7) «ne nuk e gjetëm asnjëherë me ambiente që të kryenin funksionin fillestar të tyre. Aty ambienti përdhes që ka kryer funksionin e shtëpisë së grave është shndërruar në dhomë për kurorat, kurse burgu në shtëpi grash. Në Breg të Matit kjo banesë haset shpesh, kurse në Malësi më rrallë.

Banesa që po paraqesim së fundi me gjysmëkat



Fig. 5



Fig. 6

paraqet një interes të veçantë për vetë faktin se atë e gjetëm shumë rrallë në këto zona dhe pothuajse autentike me kompozimin fillestar të saj. (Tab. V). Aty kemi të tri ambientet që kryejnë funksionet e tyre edhe sot të pandryshuara Fig. 8. Vendësit e quajnë këtë banesë me «jerevi përkjetë». Këtu shfrytëzimi i terrenit është bërë shumë racionalisht. Shtëpia e grave, tani e diktuar nga terreni, ka hipur lart në një nivel me odën e miqve, duke mbetur përdhese. Aty zjarri ndizet në vatrën që ndodhet pothuajse në mes të ambientit. Këtu gjithashtu nuk mungon asnjëherë furra e pjekjes së bukës. Oda e miqve, e shtruar me dysheme dërrase, është gjithashtu e thjeshtë, pa tavan dhe pa oxhak.

Në të gjejmë vetëm niqin e futur në mur me koshin si për. Këto dy ambiente komunikojnë edhe drejtpërdrejt nga brenda me anë të një dere njëkanatëshe, mbuluc me qemer guri.

«Burgu» ndodhet poshtë odës së miqve, ai është pa dritare e në të futesh gjithmonë nga jashtë nëpër mjet një dere me qemer me proporcione jo të zakonshme. Siç duket këto përmasa janë të tilla që kafshë e trasha të hyjnë lirisht në të. Fig. 9. Burgu ka përmasat e odës mbi të. Muri mbështetës i terrenit të thyer vazhdon gjithmonë deri lart dhe përfundon me çat në formë kallkani, duke kryer dhe funksionin ndarës të të dy ambienteve të sipërme. Ngandonjëherë përveç



Fig. 7



Fig. 8

DO NOT COPY

DO NOT COPY













TAB. III

BANESE NE FSHATIN PRUELL - LEZHE



PAMJE KRYESORE



PAMJE ANESORE



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE
(RIKONSTRUKSION)



PLANIMETRIA E KATIT I-RE

0 1 2 3m

DO NOT COPY

DO NOT COPY









BANESE NE FSHATIN GRYKA E MANATISE. - LEZHË



PAMJE ANESORE



PAMJE KRYESORE



PLANIMETRIA E KATIT TË-RE



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE

DO NOT COPY

Faruk ZARSHATI

DO NOT COPY

LA MAISON CARACTERISTIQUE DE LA MALESIE DE LEZHE

RESUME

La Malesie de Lezhe s'étend dans la partie nord-ouest de l'Albanie; elle a pour limites à l'ouest la plaine côtière de Bregu i Matit (que les habitants du pays appellent Bregmatja), au sud le fleuve Mat, à l'est la région de Mirdite et au nord en partie la Zadrime et en partie les monts de Potok. Du point de vue administratif elle dépend actuellement du district de Lezhe, alors qu'auparavant elle faisait part de la division territoriale des 12 baïraks de la Mirdite. Les paysans des villages de la zone mamelonnée de Pllane, de Zejmen, de Pruell et de la Gorge de Manati, dont la plupart pratiquaient à l'époque l'élevage, travaillaient aussi une étendue quelque peu limitée de terres relevant du Bregu i Matit qui, il y a 150 ans, était couvert de forêts et de marécages.

Avant la Libération les paysans de la Malesie de Lezhe, en raison même de la nature par trop accidentée du terrain et de l'absence de l'eau à des fins d'irrigation, s'occupaient surtout d'élevage. Les villages de cette zone sont parsémés et leurs maisons s'élèvent loin les unes des autres, en tirant habilement parti du terrain même lorsque celui-ci est très escarpé. Chacune d'elle à sa propre cour non ceinte de murs, mais d'une haie sèche entourant le terrain à proximité de l'habitation; en plus chaque cour est bien organisée, dans le sens qu'elle dispose de constructions auxiliaires servant au logement du bétail et de la volaille ou de remise pour le foin et le bois de chauffage. Souvent on y trouve aussi une construction de bois servant à conserver les denrées alimentaires. Le cabinet de toilette se trouve toujours à l'intérieur de la maison. L'accès à l'habitation a lieu directement à travers une porte toujours couverte d'un arc en pierres équarries ou non.

Et maintenant voyons comment est organisée la vie à l'intérieur de l'habitation. Dans la Malesie de Lezhe celle-ci comporte trois pièces, chacune se différenciant de l'autre tant sur le plan fonctionnel que sur le plan de la composition des éléments architectoniques qui en font part. «La Maison des femmes» c'est l'endroit où celles-ci séjournent et font cuire les aliments; la chambre des amis ou des hommes c'est l'endroit où l'on reçoit les hôtes et où d'habitude séjournent les hommes de la maison; et enfin le «burg» sert au logement des animaux et des bêtes de somme. Mais quand les animaux furent logés hors de la maison, le «burg» perdit sa fonction initiale et passa au service des femmes ou au logement des nouveaux couples.

«La maison des femmes», comme l'indique le nom que lui ont donné les habitants du pays, c'est la pièce où celles-ci séjournent avec leurs enfants et préparent les aliments. Elle manque toujours de plafond et dans sa variante la plus primitive les aliments sont cuits dans un foyer découvert placé au milieu de la chambre (Fig. 1 b). Le foyer est en plaques de pierres, sur ses deux côtés s'élèvent légèrement deux autres pierres. La chaîne où pend la marmite est attachée aux travées du plafond se trouvant justement au-dessus du foyer. Plus tard le foyer change de place et est aménagé à proximité d'une niche pratiquée dans le mur et ayant différentes formes; il est surmonté par une espèce de hotte en bois au en branchages entrelacées et couvertes de glaise, qui sert de pare-étincelles et que les habitants au pays appellent «à la turque». La cheminée de pierres sur le toit est un élément qui est apparu plus tard dans la maison de cette zone. Dans un angle de cette même pièce, dans les maisons de construction plus récente, il y a un four pour cuire le pain. Il est en pierres et son foyer, en forme d'un quart de sphère, est construit avec des morceaux de tuiles. Souvent il est à deux places.

«La chambre des amis» ou «chambre des hommes» ou encore «tchardak»

Il convient de relever dès le commencement que la dénomination «tchardak», que les gens du pays attribuent à la chambre des amis, n'a rien en commun avec le «tchardak» original. Il est appelé ainsi pour la seule raison que cette maison est à étage.

Cette chambre se distingue par un traitement différent de celui des femmes, en raison du fait que c'est ici que l'on reçoit les hôtes. Le feu n'est jamais allumé en son milieu mais à proximité d'une niche surmontée du pare-étincelles en forme de hotte ou dans le foyer en pierres ayant des niches latérales. La place de l'hôte et du maître du logis, par rapport au foyer, est bien déterminée. Le maître du logis s'asseoit à proximité du moulin à café, parce que c'est lui qui le prépare toujours.

DO NOT COPY

C'est ici que sont toujours aménagés le «sqoll», l'endroit où l'on se lave les mains et le noeud sanitaire qui sort hors des murs extérieurs de l'habitation. Quatre petites fenêtres (parfois même 3 ou 2), munies de panneaux en bois se fermant de dedans, dont deux aménagées toujours sur le parement du mur où l'on allumait le feu et les autres sur les murs latéraux de l'habitation, illuminent de manière plus ou moins suffisante cette pièce et ne l'isolent pas du milieu environnant. Quand l'habitation est à un étage, la chambre des amis dispose d'un plancher et plus tard d'un plafond.

Le «burg» (= prison) est l'endroit où logent les animaux et le gros bétail. Il manque toujours de fenêtres, car le paysan voulait parer à toute éventualité et tenir au chaud son bétail. on y accède toujours par une porte extérieure couverte d'un arc.

o o
o

La composition planimétrique et volumétrique de ces pièces nous permet aussi de définir les différentes variantes de la maison d'habitation caractérisant la Malesie de Lezhe.

Le type le mieux cristallisé, à notre sens, est celui à trois pièces, soit la maison à étage avec une base développée et celle à demi-étage. Le premier, que les habitants du pays appellent «kullë jerevi», nous ne l'avons jamais rencontré avec ses pièces exerçant leur fonction initiale. En effet, la pièce au rez-de-chaussée qui servait comme «chambre des femmes» a été convertie en une chambre où logent les nouveaux couples et le «burg» en «chambre des femmes». Cette dernière variante on la rencontre souvent dans la zone de Bregu i Matit et plus rarement dans celle de la Malesie de Lezhe.

L'habitation à demi-étage présente un intérêt particulier du fait que nous l'avons rencontré rarement en cette zone et sous une forme presque analogue à sa composition initiale. En effet ses trois pièces continuent encore à remplir leurs fonctions initiales, qui n'ont enregistré aucune modification dans le temps. Les habitants du pays appellent «jerevi përkjetë» ce type d'habitation. Ses bâtisseurs ont rationnellement exploité la nature du terrain sur lequel il est construit. La «maison des femmes», en raison de la nature du terrain, s'est élevée au niveau de la «chambre des amis», tout en faisant part du rez-de-chaussée. Les femmes continuent à allumer le feu dans le foyer qui se trouve au milieu de la chambre. On retrouve aussi toujours le four servant à cuire le pain. En ce qui concerne la chambre des amis, son plancher est de bois, mais elle manque toujours d'un plafond et d'une cheminée. On y relève seulement une niche aménagée dans le mur et couverte d'une hotte. Ces deux pièces, la chambre des femmes et celle des amis, communiquent entre elles directement de l'intérieur à travers une porte vôutée à un seul battant.

Le «burg» se trouve au-dessous de la chambre des amis, il manque de lumière et on y accède toujours de l'extérieur à travers une porte voûtée de dimensions habituelles, ce qui s'explique vraisemblablement par la nécessité de faciliter l'entrée du gros bétail. Quant à ses dimensions, elles correspondent à celle de la chambre au-dessus. Le mur de soutènement du terrain escarpé monte toujours jusqu'au toit en forme de «Kallkan» en séparant ainsi les pièces de la partie supérieure. Parfois, en dehors du «burg», tout à côté de celui-ci il y a une autre pièce, à laquelle on y accède directement du «burg». Elle est toujours couverte d'une voûte cylindrique et les habitants du pays disent qu'elle servait à la conservation des aliments.

Dans le type d'habitation, que nous sommes en train de décrire et qui concerne les villages de Patalej, Gjosh, Kaçinar et de la Gorge de Manati, on ne peut ne pas relever les traces d'une «sergjie», qui n'est autre qu'une espèce de balcon de bois faisant saillie hors du contour de l'habitation, tout juste au-dessus du «burg», quand celui-ci occupe une position latérale et non pas frontale par rapport à l'habitation. Il s'agit là d'un élément que nous n'avons rencontré dans aucune des maisons à étage décrites plus haut. Même dans celles où cet élément a existé, actuellement il a complètement disparu ou s'est converti en une pièce remplissant une fonction différente.

A notre avis cette espèce de balcon (sergjie) exerçait des fonctions presque analogues à celles du tchardak, les paysans y pendaient leurs produits agricoles ou y séjournaient pendant la période d'été. Avec le temps il a perdu cette fonction et a disparu sous l'effet nuisible des agents atmosphériques, sans que le paysan éprouve le besoin de le reconstruire. N'importe comment les traces sont là et les sources orales témoignent clairement en faveur de son existence.

L'habitation de la Malesie de Lezhe montre clairement son caractère non défensif. Il rentre dans le grand groupe de maisons d'habitation fermées. Comme on sait, la «kulla» n'est apparue en Mirditie que dans une période plutôt récente, vers la fin du XIXe siècle, et elle manque presque totalement dans la zone que nous sommes en train d'examiner. Bien que les habitants du pays appellent «kulle» n'importe quel type de maison à étage, celui-ci n'a rien en commun avec la «kulle» en tant qu'habitation fortifiée. A ce qu'il paraît les gens du pays considèrent comme telle toute habitation s'élevant en hauteur, voir même les maisons à 2 étages. La maison d'habitation de la zone plate, soit de Bregu i Matit, a des ressemblances avec celle de la zone montagneuse quant au traitement du volume et surtout du schéma «kulle-jerevi», qui est identique dans la zone montagneuse comme dans celle plate. Il convient de souligner que les habitants de la plaine, étant des nouveaux venus qui sont passés d'une condition sociale à une autre, de celle d'éleveurs à celle d'agriculteurs et d'éleveurs à la fois, ne pouvaient pas ne pas ressentir l'influence des conditions et des traditions locales, ce qui se reflète aussi dans les maisons qu'ils ont construites. Et ce type d'habitation n'était à ses débuts qu'une chaumière provisoire, puis permanente et plus tard une maison à étage.

De nos jours les nouvelles habitations construites conservent le schéma traditionnel. Leurs pièces se différencient seulement sur le plan fonctionnel et sur celui de l'ameublement. Grâce à l'incessante sollicitude du Parti pour améliorer le bien-être de la paysannerie, les différences essentielles entre la ville et le village sont en train de disparaître de jour en jour.

Fatbardha SHKUPI

DEKORACIONI I ARKITEKTURËS POPULLORE NË QYTETIN E SHKODRËS

(Historia e ndërtimeve, motivet e aplikuara, mjeshtrat)

DO NOT COPY

Qyteti i Shkodrës paraqet interes të veçantë në lëmin e ornamentikës popullore: gurskalitjen, gdhendjen e drurit, stukreliefin, pikturën murale dhe galvanoplastikën, të aplikuara kryesisht në dhomat e mira. Shumëllojshmëria e kompozimit dhe larmia e motiveve në materiale si mermeri, guri arenar, druri, në qindra objekte, na bind për nivelin artistik dhe ekonomik të këtij qyteti gjatë dy shekujve si një ndër qendrat më të zhvilluara të Ballkanit. Pasuria e vlerave artistike në Shkodër dhe qytete të tjera mbeti e panjohur për një kohë të gjatë, mjaft tavane u shkatërruan ose kaluan dorë më dorë deri jashtë kufijve të Shqipërisë duke zënë vënd nëpër muzeumet private ose shtetërore të botës[1]. Studjues dhe kronistë të huaj si Hani, Nopça, Haberlandi, Degrandi, Darami e të tjerë[2] janë munduar të hedhin dritë sadopak mbi këtë problem. Vetëm në kushtet tona u krijuan të gjitha mundësitë që nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Partisë dhe pushtetit të njihet, të mbrohet e të studjohet arkitektura dhe arti i popullit tonë. Shkodra ruan tradita të lashta ndërtimi, jehonën e të cilave ne e gjejmë duke filluar nga legjenda e murosjes në kalanë e Rozafatit, ku muret i ndërtojnë tre vëllezër, kryemjeshtra, me njëqind ustallarë[3]. Burimet historike na flasin për gurskalitësin Pjetër Dahni, i cili punoi disa monumente në këtë qytet gjatë shekullit XIV[4]. Me origjinë shkodrane qenë Albanezët e Viçencës, një familje e madhe arkitektësh, piktorësh e skulptorësh, të cilët lanë disa vepra me rëndësi[5]. Qyteti që nga shekulli XIII kishte korporatat e veta të mjeshtrive të ndryshme, të organizuara si shkolla (scola) ose vëllezëri (frataglie), të cilat vazhduan deri në fundin e shekullit XVIII[6].

Shqiptarët e mërguar në Venedik, krijuan korporata të tjera artizanale si shkolla arti, në calle degli albanesi (shtegu i shqiptarëve), në lagjen San Mauri-

---

1) Sipas informatave gojore ushtria serbe gjatë luftës ballkanike përvetsoi tre tavane të daltuar të sarajeve në kalanë e Peqinit, në vitin 1941 u ble nga tregtarët grekë një tavan në Krujë, ndërsa mobilje të daltuara, që gjëndeshin në Tiranë, u blenë prej British Muzeumit në vitin 1934. Për marrjen e një tavani në Shkodër, na vë në dijeni Nopça (F. Nopcsa **Albanien Bauten, Trachten und Geräte Nordaalbaniens.,** Berlin-Leipzig, 1925, 69.

2) J. Hahn, **Albanesische** Studien, Jena 1854, 137-150, A. Degrand, **Souvenirs de la Haute Albanie,** Paris, Welter 1901, 22, E. Durham; **Some tribal origins, laws and customs of the Balcans** – London, 1928, 25.

3) Q. Haxhihasani, **Këngë popullore,** Tiranë, 1955, 3-16.

4) R. Sokoli – **Humanistes et artistes Albanais anciens,** Albanie nouvellë, 2, 1970, 37.

5) R. Sokoli, **Albanezët e Viçencës një familje skulptorësh dhe piktorësh** shekujt XVI--XVIII, Ylli, 1, 1969, 29.

6) Z. Shkodra – **Esnafët në jetën qytetare ballkanike të shekujve XVII-XVIII,** Studime historike Nr. 1, Tiranë, 1975, 160-162.

cio, të cilat vazhduan deri në mbarim të shekullit XVIII me të gjitha të drejtat e gildës dhe rregulloren e tyre mariegola.[7]

Në Shqipëri periudha njëqindvjeçare pas pushtimit otoman kaloi pa kushte për krijimin e veprave artistike e artizanale në qytetet e rënuara të Shqipërisë, duke përfshirë këtu edhe Shkodrën[8]. Me krijimin e një farë stabiliteti ekonomik një dritë shprese për jetë e kulturë u ndez rishtas në shpirtin e popullit, kështu në prag të shekullit XVII në disa këngë popullore përmenden kulla të bukura me gurë të latuar e të lyera me ar[9]. Sipas të dhënave historike Anton Duoda ndërtoi për të parën herë në Tophanë një shtëpi në fillimin e shekullit XVIII. E pasuan disa familje të pasura (si Parucajt, Biankët, Dodmasejt, Villadanët, Angjellorët, Sinadinët ,Kroqët, Meseajt)[10], të cilët thirrën për këtë qëllim muratorë nga Dibra. Po kështu emigrantët shqiptarë të kthyer nga Italia, Dalmacia e Turqia dhe të zbriturit nga malet kushtëzuan rindërtimin e qytetit.

Ndërtuesit e parë në krahinën e Shkodrës qenë gogët që kishin punuar si çirakë me grupet e mjeshtrave dibranë, të cilët qenë tërhequr me dhunë nëpër qytetet kryesore të perandorisë, ku më vonë fituan të drejtën e punës pranë esnafit murator[11]. Këta gogë u dukën në Shkodër nga fundi i shekullit XVI – fillimi i shekullit XVII, siç këndon populli në poemën «Mujo e Halili» për të pasurin gogë, burri i motrës së kreshnikëve, fisi i të cilit nuk din të merret me tjetër gjë, veçse të ndërtojë «drume e bodrume»[12].

Në këto kohëra sinonimi i muratorit në Shkodër ishte «gogu». Të dhënat gojore të qytetit tregojnë se Mehmet Pashë Plaku, për ndërtimin e xhamisë së Plumbit dërgoi Ramadan Mukën të thërresë gogët, të cilët kryenin ndërtime në Kavajë në këto kohëra dhe se konaqet e Perashit dhe ato të Çinari i Hoxhë Dheut qenë ndërtuar prej gogëve.

Gogët ishin kryesisht ndërtues muratorë, siç vumë re punimet e tyre në Mat, Muhur, Arras e Lumë. Afër shkollës «Branko Kadia» një rrugicë quhej «Rruga e Gogëve».

Në bazë të gjurmimeve tona vumë re se ornamentistët (dekoruesit) e parë popullorë dolën nga esnafi i arkaxhive. Në Pazarin e Shkodrës deri më 1912 ndodhej «Sokaku i arkaxhive», të cilët do t'i gjejmë më vonë me dyqane të veçanta në qytet[13]. Këta ornamentistë ishin shkodranë dhe dibranë. Me shfaqjen e dibranëve, shkodranët u detyruan ta zëvendësojnë sinonimin e muratorit «gogë» me termin «dibrani»[14]. Këngët, me të cilat populli përkujton sot punën e tyre, na kanë ndihmuar shumë në gjurmimin tonë. Të dhënat na njohin me disa mjeshtra piktorë e arkapunues, që jetuan nga fundi i shekullit XIX, ndërsa për ata, që punuan gjatë shekullit XVIII nuk kemi asnjë njoftim[15]. Për këtë arsye artin e aplikuar të shek. XVIII e kemi evidentuar në tërësi, kurse artin e aplikuar të shekullit pasues e kemi klasifikuar sipas mjeshtrave, për të cilët morën të dhëna të sakta.

Fuqizimi ekonomik i Shkodrës gjatë shek. XVIII nxori në pah disa familje feudale, siç qenë Bushatlinjtë, Begollët, Çaushollët dhe një shtresë e pasur tregëtarësh[16], të cilët nëpërmjet punës së mjeshtrave popullorë ndërtojnë shtëpi madhështore të paisura me mindere, sergjene, rafte, trapazane, musandra, nishe e tavane, të cilat më vonë do të mbulohen me dekorime të daltuara në dru. Në to do të adaptohen oxhaqe në stuk relief të bardhë ose me ngjyrë, të modeluara me trajta gjeometrike e lulëzore dhe do të piktu rohen muret, tavanet e stendat e trapazanëve me peisazhe e buketa me lule e fruta nga më të këndëshmet. Kolonat e hajateve dhe harqet e portave do të skalisen në mermer, arenar ose dru e do të paisen me kapitele tip kaike.

Në këto vepra të artit të aplikuar në dru dhe stuk ndihet dhe influenca e stileve perëndimore e lindore

7) Z. Shkodra – **Kontribut për historinë e Diasporës shqiptare, kundrime shoqërore ekonomike,** Studime historike, Nr. 3, 1971, 103-104.

8) **Historia e Shqipërisë** Vëll. I, Tiranë, 1959, f. 323, 324, 326.

9) Q. Haxhihasani, **Vep. cit.** 252.

10) S. Naçi, **Shqipëria e Veriut në shekullin XVIII,** I, 1706-1756, Tiranë, 1967, 5, – Të dhëna për Shkodrën nga fondi i arkivit të sektorit të etnografisë.

11) Z. Shkodra – **Kontribut** ... 105-7.

12) Q. Haxhihasani – **Vep. cit.** 265-268.

13) **Punimi i drurit gjatë moteve. Punimi i drunit në Shkodër,** Fondi i arkivit të sektorit të Etnografisë.

14) Një këngë popullore bën fjalë për një mjeshtër tërnovas, i cili goditi doganierin, për shkak se ky e cënoi me fjalët «ik mor gogë dibre».

15) Sipas të dhënave gojore dhe materialit, **Punimi i drunit,** nga Fondi i arkivit të sektorit të Etnografisë përmëndim: Zef Arsenin, Ndoc Nikën, Muharrem Bakun, Temo Dibrën Selim Dibrën, Kin Kumrinë, Gjok Doksenin, Shefqet Krajën, Isa Berberin, Riza Dibrën etj.

16) S. Naçi – **Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatllijve,** Tiranë, 1964, **Historia e Shqipërisë,** I, 435.

DOMOT COPY

DO NOT COPY



A



B



C



D



E

Fig. 1

të shekujve XVIII-XIX[17]. Mjeshtrat do të thurin motive tradicionale me gjethe lisi, zambakë, trëndafilë e karafila me kompozime të papërsëritura. Ornamentet e para u aplikuan gjatë shekullit XVIII mbi raftet murale e rozetat tetëkëndëshe në trajtë ylli, me tetë dyfish, segmente të ndërprera, sipas stileve hatai dhe rumi[18]. Studimi i banesave popullore të Shqipërisë dëshmon për kompaktësinë e këtij arti, i cili i diferencuar sipas krahinës me tiparet e veta lokale qëndron madhështor brenda tipit të vetëm shqiptar, që e dallon nga ateljet e tjera ballkanike.

Repertori i ornamentikës së shekullit XVIII është trajtuar m[illegible] me ndrojtje. Akoma dekoratori nuk e ka krijuar metodën e tij personale të punës dhe dekoret e kompozuara nuk kanë përfshirë tërësisht motivet e trashëguara nga lashtësia, të cilat vazhdojnë në kostumet, orenditë e varret. Punimet me copëza dërrase quheshin «dograma», që turqisht don të thotë «copëza», kurse daltimet artistike në dru quheshin «ishleme»[19], që turqisht do të thotë qëndisje.

Raftet murale paraqesin trajta interesante dekoresh të stilizuar mbi sfonde këndrejtë. Në pjesën e sipërme gdhënden motive si gardhe me rathë të ndërprera ose rombe të thurura, që mbyllin nishe, me lajle tulipanësh të valëzuara, si në një raft muri të shekullit XVIII (banesë në Rr. «Alqi Kondi» Nr. 36) (Tab. I Fig. 1) dhe tulipanë të barasrenditur. Raftet janë ndërtuar me dy flegra të ndara në tri pjesë, zakonisht në pjesët e sipërme e të poshtme shohim dyfish palmeta, ose rozone me margarita, lule dielli e shermasheku. Po këtu në pjesën qendrore vizatohet skema e vazos me lule, shoqëruar me pisha, vetëm pisha pa vazo, ose vazo me dyfish palmeta si në një raft muri të shek. XVIII (banesa në rrugën Llujej nr. 124). (Tab. I, Fig. 2).

Motivi i yllit e poligonit haset në shumicën e zemrave (rozetave) të tavaneve, i kompozuar me tetë dyfish segmente të ndërprera, i pikturuar ose i thjeshtë. Ky motiv na paraqitet me nëntë tetëkëndësha në kornizë katrore tek rozetat, arkat e tryezat e disa familjeve shkodrane. Simotrat e këtij motivi i gjejmë në Berat e Gjirokastër, por gjatë shekullit XIX ai nuk aplikohet më[20]. Marrim si shembull një rozetë të shek. XVIII (banesa në rrugën Shyqyri Bushati Nr. 16). (Tab. I, Fig. 3).

Gjatë shekullit XVIII filluan të ndërtohen tavanet me thyerje tetëkëndore të kufizuara me buzina (bordura) sharëzash e gishtëzash, trekëndëshat e të cilave ishin të thjeshtë ose me ndonjë lule të vogël brenda rrethit si në një trekëndësh tavani të fundit shek. XVIII (banesa në rrugën «Musa Luli» Nr. 14) (Tab. I, Fig. 4) rozetat e tyre ndonjëherë kishin trajta katrore të dekoruara me pirografi, që paraqisnin palmeta fletëgjëra, sipas stilit hatai dhe anake (girlandes), sipas stilit rumi[21] si në një rozetë tavani të shek. XVIII (banesa në rrugën Musa Luli, Nr. 16) (Tab. I, Fig. 5).

Motivi i vulës së Salomonit dhe margaritës gjashtëpetalëshe aplikohet nga mjeshtrat e të dy shekujve mbi rafte e musandra te shtatë banesa të ndryshme. Bashkë me vulën e salomonit hasim motivin e çerek hënës mbi ballzinën e mermertë të xhamisë së Plumbit si dhe në dy banesa të tjera. Bashkë me ta shohim lloje lulesh zambaku, tulipani, trëndafilet e egra (eglantines) karafilat e shermashekët, që na kujtojnë periudhën e barokut oriental, kur dominonte motivi i tulipanit gjatë shekullit XVIII, i njohur në historinë si «epoka tulipan» (lale devri)[22], të cilin veç ballzinës së portës, të shek. XVIII, në xhaminë e mësipërme e gjejmë dhe mbi raftet e pesë banesave të tjera (Tab. I, Fig. 6).

Raftet rrethohen me gishtëzime (digitals) dy a tri rrathësh si në djepat e Matit. Ky motiv i njohur nga

17) Për influencën e këtyre stileve në vende të tjera të Ballkanit dhe zhvillimin e tyre në Evropë shih N. Mucopulu — **Ta Thesaliqi ambellaqia, Thesaloniqi,** 1975, 95-96; D. Drouмev — A. Vasiliev — **L'art bulgare de la sculpture sur bois,** Sofia 1955, 10-11. A. André. **Histoire de l'art. Etudes des styles du mobilier,** Paris, 1970, 94-97. I. Brunhammer — M. de Fayet — **Commert installer son interieur en directoire et empire** Paris 1964, 13-19. N. Jorga — **L'arte popolare in Romania** Roma 1930, 22-49.

18) V. Hahn — **Les courants des styles dans les mêtiers d'art des artisans chrétiens en XVI et durant les premiers décénies du XVII siècle dans les régions centrales des Balcans,** në Balcanica, Beograd, I, 1970, 242-3.

19) Konstatime të sektorit të artit në krahinën e Gollobordës dhe Shqipërinë e veriut gjatë viteve 1971-1976.

20) G. Bazin — **L'hisoire de l'art,** Paris, 1953, 161, Q. Čig, **Aunique ceiling style Newly discovered in the Harem of the topkapi Palace,** në Atti del secondo congresso internazionale di arte turca — Venezia 26-29 settembre 1963, Napoli 1965, 59, ku flet për tavanin e Veliaht dairesi, që është vizatuar me tetë dyfish segmente të ndërprera si yll. Motive ylli të kësaj gjinie kemi gjetur mbi pllakat e hojateve të disa faltoreve, të cilat u shtruan gjatë shekullit XVII si në Shën Mërinë Vllaherna të kalasë së Beratit dhe në shumicën e tavaneve beratase e gjirokastrite të shekullit XVIII.

21) E. Esin — **An Eightenth century «Jali», viewedd in the line of development forms in turkic Architecture,** në Atti. . . , 105-110.

22) E. Egli **Turkische Brünnen** në «La turqie kemaliste», Août 1938, 6-12.

PONOT COPY

DO NOT COPY



A



B



C



D

Fig. 2

lashtësia (Tab. I, Fig. 2) do të aplikohet gjatë gjithë kohës nga artistët dibranë, në shumicën e ornamenteve të rafteve dhe arkave gjatë shekujve XVIII e XIX, në veçanti prej mjeshtrit Mehmet Metani. Shihet analogji në mes kësaj ornamentike e motiveve të arkave të pajës, të cilat pjesërisht importoheshin nga ateljet e Venedikut, pjesërisht punoheshin në vënd. Këto arka tip Adriatik, që populli i quante «arka deti» ishin të pikturuara me selvi, vazo lulesh, fazanë, dallëndyshe e shqiponja dykrenare; simbole me origjina të ndryshme[23], të cilat i gjejmë të interpretuara nëpër interiere, si në një arkë në muzeun e Shkodrës (Tab. I, Fig 7).

Studimet tona nga Shkodra u shtrinë pothuaj në të gjitha qendrat e krahinat, ku ekzistonin vlera materiale. Në këto qendra si Lezha, Kruja, Tirana, Durrësi, Elbasani, Kavaja, Peqini, Fieri, Berati, Përmeti, Gjirokastra, Korça, Voskopoja, Mati e Golloborda, arrijtëm të klasifikonim rrotull 180 trajta e motive laike të kompozuara, 41 nëpër ikonostase e 22 në piktura murale të monumenteve të kultit të përfshira në stilet, që përmëndëm më sipër të gërshetuara me simbole magjike e mitologjike. Vetëm në qytetin e Shkodrës gjetëm 170 motive, ndër të cilat do të përmëndim litarthat, helikën dy deri 12 fletëshe, svastikën, diellin, rrotën, tetraskelin, triskelin, hënën, yllin, spiralin e vazhduar, rrathët bashkëqëndrorë, valëzat e shumë motiveve anësore, të cilat i trashëgojmë nga e kaluara sipas gjeturive arkeologjike të Maliqit, Kamenikut, Trenit, Sardës, Xibrit, Kukësit dhe të dhënave etnografike të rrethit të Matit, Mirditës, Gollobordës, Dukagjinit, Tropojës e Zadrimës[24]. Këto motive i hasim të gërshetuara me ornamentikën e shek. XIX, si në Shkodër, ashtu edhe në qytetet e tjera.

Fuqia krijuese e artistëve do të evidentohet më me vrull në fillimin e këtij shekulli, kur grupet e muratorëve dibranë bashkë me familjet nguliten në sheshin pranë Muzeut të qytetit, siç dëshmojnë pasardhësit e tyre, të cilët jetojnë e ndërtojnë dhe sot në Shkodër. Repertori i ornamentikës së realizuar prej tyre shfaqet mjaft i afërt me stolisjen e orendive e brendive të banesave të Kosovës[25]. Ai është mjaft i pasur e i ndërlikuar, me rozeta rrethore me rrathë bashkëqendrorë e suitë dekoresh rrethore, si në dy rozeta të fundit të shekullit XIX (te banesa në rrugën Nexhip Luli Nr. 10, Tab. II, 1, te banesa në Rrugën Oso Kuka Nr. 4, Tab. II, 2).

Rozetat rrethore e tetëkëndore shpesh kufizohen me buzina (bordura) tufëzash, kelqe ose zymbyla (rozetat në tab. II, 1-3, kjo e fundit te banesa në Rr. Migjeni Nr. 26).

Rozoni helikashtjellës aplikohet në të gjitha shtëpitë e qytetit mbi tavane, dyer, musandra, rafte, kurora oxhaqesh. Krahas tij zhvillohet drethka helikë nga dy deri pesë fletëshe (Tab. II, 1,2,4, — tavani i mesit shek. XIX te banesa në Rr. Andon Ballaci Nr. 102) Tab. III, 1 — rozetë e fundit shek. XIX në banesën Rr. Kukaj Nr. 8, 3 — trekëndësh tavani i fundit shek. XIX në Rr. Ali Kelmendi Nr. 89, 6 — oxhak i mesit shek. XVIII në stuko, në banesën në Rr. Ali Kelmendi Nr. 221).

Spirali i vazhduar dekoron zakonisht frizet e tavaneve (tab. II, 4 — tavan yllor në banesën e shënuar më sipër e gjejmë mbi rozeta (Tab. II, 3), të shoqëruar me lule lindëse si rreth një tavani yllor të fillimit të shek. XIX (Tab. II, 5 — banesa në Rr. Musa Luli Nr. 15) dhe mbi një raft muri të fillimit të shek. XIX (Tab. II, 4) banesa në Rr. Shyqyri Bushati Nr. 21). Simotrat e këtij motivi i gjejmë në disa banesa të Elbasanit dhe Beratit. Dielli pasqyrohet në fusha tavani me rreze dhe rozeta tip rrote ose i vizatuar origjinal, në më se njëzet objekte, ndërmjet tyre në tavanin (Tab. III, 1) dhe inçizime në ballzinën e një dere të fundit të shek. XIX (Tab. III, 2 — banesë në Rr. Halit Bajraktari Nr. 6). Motivin litarth e gjejmë si dekor frizesh e kornizë trekëndëshi (Tab. III, 3). Në shumicën e banesave të Shkodrës e Lezhës vizatohen gadi 20 lloje vazo e çajnikë, simbole të mikpritjes mbi rafte

23) M. Jevrič — **Isložba umetnička skrinj u Jugoslavije, od XIII do XIX stoleča** — në Muzei Primenenie umetnosti Beograd 1960-1961, 145-147. F. Nopsca **vep. cit.** 111. O.M. Dalton **Byzantine art and archeology** — Oxford; 1911, 685-712. A. Uçi — **Estetika, Jeta, arti** — Tiranë, 1973; 269-273.

24) G. Bazin **vep. cit.** 15. **G. D'Alviella — La migration des symboles — Paris. Leroux — 1891. A. Stipčević — Kukasti Križ kod starih ilira** në Gjurmime albanologjike — Prishtinë 1970, 109-127. M. Tirtja — **Elemente të kulteve ilire te shqiptarët** Kuvendi I i Studimeve Ilire, Tiranë 1972, 281-302. F. Prendi — **Le centre néolithique de Maliq** në Studia Albanica — Tirana 1966, 255-260 H. Spahiu, **Gjetje të vjetra nga varrezat e kalasë së Dalmacisë në Iliria, I,** Tiranë 1971, 244-246. M. Korkuti **«Qeramika e pikturuar e kohës së vonë të bronxit dhe e kohës së hershme të hekurit dhe karakteri ilir i bartësve të saj,** në Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve — Tiranë 1969, 55-65.

25) M. Krasniqi — **Duborez u Metohiji** — në Glasnik Muzeja. Kos. Met. III Priština 1958, 227-234. S.M. Nenadovič — **Prizrenske tavanice,** në Glasnik Kos, Met, 1956, 289-293. G. Palikruševa K. Tomovski — **Les tékkés en Macédoine aux XVIII-XIX siècles,** në Atti vep. cit. 203-207.

PO NOT COPY

DO NOT COPY



A



B



D



C

e tavane[26] (Tab. II, 4), ndërsa në më se 15 raste kemi gjetur dyer me dograma në trajtë svastike, mesi shek. XIX (Tab. III, 5 në banesën Rr. Skënderbej Nr. 56).

Në Shkodër e Varosh të Lezhës kemi gjetur mbi 30 oxhaqe të derdhur në stuk relief të bardhë (Tab. III 4 — fundi i shek. XVIII — banesa në Rr. Ndoc Mazi Nr. 38; tab. III, 6). Këto oxhaqe janë shfaqur nga fundi i shekullit XVIII duke u zhvilluar në mënyrë evolutive deri në çerekun e tretë të shekullit XIX. Ndahen në dy grupe kryesore me trup gjysëm cilindrik në fillim të shekullit të kaluar dhe gjysëm poliedrik nga mezi i tij[27]. Zakonisht janë rrethuar me kurora të valëzuara ndër tri, pjesë ose nëntë luhatje me fusha të thjeshta ose të dekoruara me bisqe dhe buzina me azhur. Veç tyre gjetëm rozeta me trajta rrethore, eliptike, katrore e baroke. Këto vepra u realizuan nga qindra artistë, ndër të cilët po përmendim më kryesorët; që i zbuluam nga të dhënat gojore në qytetet e fshatrat, ku ata jetuan:

Mjeshtri i parë i talentuar si skalitës druri, stuku e mermeri qe usta Jashar Xhafa nga Sebishti, që kreu punime në mjaft brendi banesash, të cilat i stolisi me tavane të bukura në trajtë ylli. Grupi i tij ndërtoi oxhaqe cilindrike me shkorzë (baldakin) baroke (fig. 1 E. banesa në Rr. Migjeni Nr. 26). Ndër veprat kryesore kemi brendi të daltuara të mesit të shek. XIX (fig. 1, A, D — banesa në Rr. Shyqyri Bushati Nr. 211, dhe B, banesa në rrugën Musa Luli Nr. 4) muraturat e të cilave i kishin ndërtuar si thamë më lart mjeshtrat gogë. Ai realizoi kompozime të shkëlqyera me motivet e tij të preferuara: dyer me svastika dhe yje me katër ose tetë cepa, që i gjejmë në djepat e Mirditës e të Matit, shoqëruar me vazo, çajnikë, bisqe, triskel, rozone, gjethe lisi (fig. 1 C, stelë varri në muze) kordela dhe buzina me zambakë në tavanet. Ai vizaton spiralen e vazhduar me lulelindësen në rathë bashkëqëndrore. Raftet e tij me vijëzime baroke paraqesin vazo të gjata me fazanë e bisqe dyfish helikë.

Në grupin e tij mësuan mjeshtra si Ramadan Dibra e Mehmet Metani, ndërsa më vonë me ta u bashkua mjeshtri Isuf Haxhiu.

Usta Ramadan Dibra, i mbiquajtur usta Dana nga Sebishti, qe një nga mjeshtërit më të mirë. Ai realizoi në mesin e shek. XIX dyer me svastika, kompozime spiralesh shtjellëse të fuqishme në rozeta katrore tetëkëndore dhe trikëndëshe tavanesh (fig. 2, A — konvikti i shkollës tregtare) mbi rafte (fig. 2, B, D, brend e banesës në rrugën Migjeni Nr. 4) si dhe në dekoret e oxhaqeve, (fig. 2 C banesë në bllokun Ndoc Mazi Nr. 50). Daltoi rrotull lulepjeshkës e zhabinës (anemonit) dekore me gjethe blini në spirale të vazhduar dhe rozone me lulonja.

Usta Mehmet Metani, i mbiquajtur usta Meta nga Zabzuni, shquhej për stuk reliefet e oxhaqeve e të tavaneve. Veprat më të bukura të këtij lloji, mjeshtri i modeloi në mesin e shek. XIX (fig. 3 A banesa në Rr. Migjeni, Nr. 26) ku ai krijoi rozeta me spirale gjethesh lisi të vizatuara në tri ose katër meandra dhe realizoi kufiza bedenash me azhur, rafte me motivin «flakëza» të aplikuara në shumë banesa të ndërtuara po prej tij. Oxhaqet e kësaj dore janë poliedrikë me shkorzë (baldakin) të rrethuar me kurora pa rozone ose me to si dhe dyer me dograma tip svastika (fig. 3 B banesë në Rr. Skënderbej Nr. 56). Daltoi rozeta baroke me katrorë të valëzuar, ose rrethore (fig. 3 C, banesa në Rr. Qukaj Nr. 10) dhe rozeta e rafte me drethka gjethesh të gërryera thellë rreth vazove me lule (fig. 3 D, shtëpia e Pionierit).

Usta Isuf Haxhiu, i mbiquajtur usta Cufa nga Sebishti, e sundonte drurin me daltë, duke gdhendur gjethe lisi dhe lule, të cilat duket sikur shpërthejnë nga vazot, në ajrin e lirë. Realizoi po në mesin e shek. XIX rozeta me tulipanë, tufëza gjethesh me vlloja e helika jashtëhedhëse e qendërmbledhëse. Veprat kryesore të këtij mjeshtri të shquar i gjejmë në Muzeun e qytetit, ku realizoi tavanin yllor me tetë cepa në qendër. Trapazani i tij mbetet ekzemplar i vetëm i këtij lloji në Shqipëri me hapësirat ndërharkore të dhëmbëzuara të mbështetura mbi kolona elegante me kapitele të harmonizuara e sfonde të dekoruara me vazo e lule[28] (fig. 4, A, B). Daltoi rozeta me rrathë bashkëqëndrorë të kufizuar me tufëza e palmeta dhe rafte me vazo vezake e drethka spirale (fig. 4 C banesa në Rr. Balaj Nr. 144 dhe 4 D banesa në Rr. 11 Janari nr. 8).

Në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar veproi një grup i tretë mjeshtrash të stërvitur prej mjeshtrave të mësipërmë ose bij të tyre, të cilët u specializuan si drugdhendës e gurskalitës.

Ramë Selim Mitku nga Tërnova, i mbiquajtur usta

26) Me këtë problem për artin ballkanik janë marrë G. Marçais — L'art musulman — Paris 1962. H. Balducci — **Architettura turca in Rodi** Milano — Pavia 1932, 174-5. V. Göknil — **Architettura ottomana** Milano. Il parnaso 1965, 139-149. H.T. Dagliogli — **Les plafonds des vieilles maisons de l'Ankara** në «La Turquie Kemaliste — Ankara août 1938, 2-4. Shih Mozaikun e Linit Për motivet gjeometrike.

27) F. Nopcsa, **Albanien** 76-93. C.D. Rossi — **Camino** — në Enciklopedia Trecani Vol. VIII, 542-545 (fiet mbi oxhakun katror europian).

28) Arkitektura e trapazanit ndjek arkitekturën e Alhambras dhe Alkazarit. Për to shih G. Bazin, **Vep. e cit.** 153-161. H. Gluck, E. Diez, **Die Kunst des Islam**, Propylaën, 1925, 38-39; 207, 208, 220-221.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



A



B



C



D

Fig. 4

DO NOT COPY



A



B



C



D

Fig. 5

DO NOT COPY



A



B



C

Fig. 6

Rama, nxënës i usta Cufës, krijoi variacione gjethesh majëmprehta të shoqëruara me palmeta dyspirale, tufëza e lira (lyra)[29] rozone helikë të realizuara mbi rozeta rrethore. Mbi sfondet e rafteve inçizoi krahas luleve, diellin në mënyrë origjinale (fig. 5 A, C, D, banesa në Rr. Shyqyri Bushati Nr. 14, fig. 5 B banesa në Rr. Nexhip Luli Nr. 10) Daltoi tavane elegante tetëkëndore dhe rafte me trajta të përsosura. Më vonë pas vdekjes së Isuf Haxhiut mori në dorë drejtimin e punimeve të lëna prej tij.

Usta Sadik Koçi nga Trebishti, i stërvitur pranë usta Danës, krijoi nga fundi i shek. XIX kompozime gjethesh të dhëmbëzuara në spirale të vazhduara brenda rozetash tetëkëndore. Tipari i tij është helika dy deri tre fletëshe e vizatuar me bisqe. Brendi të bukur kemi në dy prej banesave, ku ai punoi (Fig. 6 A banesë në Rr. Bajram Curri Nr. 23; Fig. 6 B banesa në Bllokun Ndoc Mazi Nr. 50), (Fig. 6 C banesë në Rr. Lidhja e Prizrenit Nr. 77) ku shohim kompozime baroke, shoqëruar me lulonja. Në Muzeun e Tiranës ndodhet një raft i punuar prej dorës së tij, ndërsa në Muzeun e Peshkopisë, një trekëndësh.

Vëllezërit Selman, Mahmut, Hasan e Isuf Metani, bijt e usta Metës të edukuar pranë tij dhe usta Danës, kryen punime të rëndësishme në shumë banesa shkodrane. Tipari i tyre kryesor është tavani me rreze diellore, ku sipas rastit punojnë tre duar brenda së njëjtës rozetë secili në mënyrën e vet të daltimit. Deri tashti kemi gjetur katër mbishkrime nga duart e Selmanit dhe Mahmutit.

Usta Sulejman Metani, i mbiquajtur usta Selmani, me gjethen e ceflosur thuri lajle bisqesh dredharake të dyfishta të alternuara me lulelindëse në rozeta me helika e tufëza si në dy brendi (fig. 7 A banesa në Rr. Ruzhdi Tyli Nr. 103 dhe fig. 7 B banesa në Rr. Lek Dukagjini Nr. 26) në trapazane (fig. 7 D në banesën e mësipërme) dhe rafte (fig. 7 C banesa në Bll. Salo Halili Nr. 59) ku evidentohet talenti i tij në harmoninë e kompozimit.

Usta Mahmut Metani, po nga fundi i shek. XIX daltoi gjethin e blinit në rozone shtjellëse jashtëhedhëse (centrifuge). Tipike për të janë rozetat me dekore rrethore të brendashkruara ndër rrathë (Fig. 8 A, banesa në Rr. Kukaj Nr. 8) aplikon në rafte medalione e vazo të zhdërvjellta (Fig. 8 B, D, banesa në Rr. Ali Kelmendi Nr. 1) dhe oxhaqe dekorativë (fig. 8 C banesa në Rr. Halit Bajraktari Nr. 21).

Hasan Metani, me lëvizjet e shkathta të gjetheve të lidhura me kordone spirale punoi brendi në disa objekte si trekëndësha tavani (fig. 9 A banesë në Rr. Ali Kelmendi Nr. 89) daltoi rozeta bashkë me vëllezëri si dhe tavanin e banesës së mësipërme (fig. 9 B). vëllai Isufi karakterizohet me lulet e dyfishvizuara ndë rrathë bashkëqëndrore (Fig. 9 C, D, banesë në Rr. Halit Bajraktari Nr. 10).

Usta Sali Osmani, i mbiquajtur usta Sala, vizatoi gjethe të inçizuara në trajtë grafike, të cilat afrojnë me skalitjet e gurta të Xhafer Isufit në Tërnovë të Gollobordës (fig. 10 A, B, banesa në Rr. Musa Lul Nr. 10). Mendojmë se ka qenë pjestar i grupit të Hasë Burgut. Preferon motivin gardh për nishet, rozone e helika për raftet e rrethuara me lajle (fig. 10 C banesë në Rr. 4 Qershori Nr. 24) por tipari kryesor i tij është rozeta tip rrote (fig. 10 D banesë në Bll. Salo Halili Nr. 33). Ai ka punuar edhe në Ulqin.

Usta Hasan Burgu qe mjeshtër i shquar tërnovas, moshatar i mjeshtrave të grupit të dytë të Shkodrës, të cilët punuan nga gjysma deri në fund të shekullit XIX dhe vitet e para të shekullit XX. I njohur si usta Hasa daltoi gjethen e lisit me valëzim të dyfishuar vertikal e horizontal në tavane, rafte, musandra, oxhaqe, arka të punuara në dru dhe stuk. Vizatoi vazo vezake dhe të drejta me tufa lulesh sahati dhe rozone shtjellëse si në brendinë e një banese në lagjen Varosh të Lezhës (fig. 11 A, B, C,) dhe në brenditë e dy banesave në Pazar të Lezhës (fig. 11 D). Veç këtij qyteti ka punuar në Krujë, Tiranë, Tërnovë, Ostren të madh, Shkup, Pejë, Gjakovë, Sarajevë Po kështu në Tërnovë në kullën e Burgajve gjetëm një arkë dhe një raft të punuar mjeshtrisht prej tij (fig. 11 E.)

Në Muzeun e Shkodrës gjetëm disa rafte në stuk të punuara nga mjeshtri Okshtunas Osman Sallaku dhe në qytet një tavan të punuar nga mjeshtri Zejnel Ramçi. Mjeshtrat e tjerë i kemi grupuar në ateljenë e Metanëve, sepse i gjejmë bashkë me ta, në këtë drejtim vemë në dukje se shumicën e oxhaqeve shkodrane të gjysmës së dytë të shekullit XIX e kanë punuar anëtarët e grupit të Metanëve. Grupet e ndërtimit kryesoheshin nga Haxhi Liman Lloshi, vendin e të cilit më vonë e zuri Ahmet Lila; Isuf Haxhiu, i zëvëndësuar nga Ramë Selim Mitku, ndërsa ateljeja më e fuqishme kryesohej nga Mehmet Metani, të cilin e zëvendësoi i biri usta Selmani. Kjo atelje emrat e pjestarëve të së cilës mbeten ende të panjohur, veproi në pothuajse gjysmën e qytetit të Shkodrës.

29) E. Esin **Vep. cit.** faqe 103. Flet për ornamentet me tufëza të ngjashme me ato të Shkodrës.

DOWNLOAD

DO NOT COPY



A



C



B



D

Fig. 7

DO NOT COPY



A



B



C



D

Fig. 1

DO NOT COPY



A



B



D



C

Fig. 9

DO NOT COPY



A



B



C



D

Fig. 10

DO NOT COPY



A



E



B



C



D

Fig. 11

DO NOT COPY



A



B



C



D

Fig. 12

DO NOT COPY



1



2



3



4



5



6



7

Pikturimi i shumicës së tavanëve është kryer më vonë nga mjeshtrat shkodranë Simon Dokseni e Gaspër Piktori. Sipas të dhënave të pasardhësve, drejtues të mjeshtrave dibranë gjatë shekullit të kaluar qenë Arsen Idromeno dhe i biri Kolë Arsen Idromeno.

Kolë Idromeno piktor dhe dekorator i shquar, i cili veproi gjatë shekujve XIX e XX në Shkodër, bashkëpunonte me grupet e mjeshtrave dibranë si në rastin e tavanit të pikturuar prej tij, të katër stinët e vitit (në banesa në Rr. 11 Janari Nr. 14). Ai bashkë me mjeshtrin Ahmet Lila udhëhoqi punimet e Bulevardit, deri te Fusha e Çelës, shkollën e mesme të ndërtimit, dhe vilën në Shirokë, dekoroi tavane (Fig. 12 A) dhe projektoi disa kangjella me motive hardhie e shqiponjash mbi shkallë e ballkone, në të cilat ndjehen ndikimet e artit europian të shek. XIX[30]. Këto objekte u derdhën në punishten e mjeshtrit Hamit Lloshi, që kryente proçese të komplikuara në fushën e hekurit dekorativ gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX në Shkodër (Fig. 12 B, banesë në Rr. Branko Kadia Nr. 61, Fig. 12 C shtëpia e Kulturës, fig. 12 D banesë në Rr. 11 Janari Nr. 14.)

Nëpër qytetet e Shqipërisë ne gjetëm motive dhe trajta arkitektonike të ngjashme me brenditë shkodrane të kompozuara në nivel të lartë artistik. Mjeshtrat drugdhendës zakonisht ishin nga Tërnova, Okshtuni, Sebishti, Borova e Zabzuni, fshatra të afërta me njeri tjetrin, fakt i cili shpjegon lehtas lidhjet dhe influencat reciproke në të gjitha këto qytete. Origjinaliteti i veprës së tyre konsiston në trajtat unike të papërsëritëshme brenda së tërës homogjene, nga shumëllojshmëria në unitet.

Ndër objektet e shqyrtuara më sipër vetëm një pjesë e vogël banesash qe vënë në mbrojtje deri në vitin 1975, si pasojë e punës gjurmuese të Sektorit të Artit të Institutit të Monumenteve u shtuan objekte të tjera në mbrojtje shtetërore.

Detyrat tona për mbrojtjen e ornamentikës së Shkodrës konsistojnë në pastrimin, dizinfektimin, retushimin, plotësimin e pjesëve të thyera, vernikosjen dhe modelimin me allçi, duke garantuar kështu ruajtjen në kushte të mira të kësaj pasurie së madhe në lëmin e krijimtarisë popullore.

DO NOT COPY

30) L. Crema **Soffitto** në Enciclopedia Trecani Vol. XXXII 17-19. Për motivet galvanoplastike shih ikonostaset e katedraleve në Elbasan e Berat.

Fatbardha SHKUPI

LA DECORATION DE L'ARCHITECTURE POPULAIRE DANS LA VILLE DE SHKODER

(Historique des constructions, les motifs appliqués et les maîtres populaires)

R E S U M E

La ville de Shkoder présente un intérêt particulier dans le domaine de l'ornementation, que l'on retrouve appliquée dans toutes ses variétés par les maîtres populaires aux intérieurs et aux façades. L'éventail des compositions et des motifs témoigne du niveau artistique élevé que cette ville a atteint dans les Balkans. Ce patrimoine n'a été mis en relief que très tard. Nombre d'étrangers dans le passé se sont emparés d'une part de nos ornements, qui, actuellement, sont admirés en différents musées du monde. S'il est vrai que certains hommes d'étude, entre autres Hahn, Nopcsa, Haberland, Degrand et Durham, ont effleuré ce problème, ce n'est que dans les années du Parti et du Pouvoir populaire et grâce à leur sollicitude constante qu'il a été sérieusement abordé.

Shkoder a d'anciennes traditions dans le domaine du bâtiment et celles-ci commencent avec la légende de Rozafat. Le tailleur de pierres Pjetër Dahni a travaillé à Shkoder. Les Albanais de Vicence sont originaires de cette ville. Il y avait ici dès le XIIIe siècle des corporations de métiers (scola et frateries), dont l'activité s'est poursuivie jusqu'au XVIIIe siècle. Des Albanais émigrés à Venise ont fondé en cette ville d'autres corporations de métiers, que l'on retrouve même au début du XIXe siècle.

Par suite de l'occupation ottomane, pendant tout un siècle aucun ouvrage architectonique laïque digne de ce nom n'a vu le jour en Albanie.

Vers le XVIIe siècle le pays connaît une période de stabilité, ce qui s'accompagne d'une activité accrue dans le domaine du bâtiment comme l'indiquent aussi les chansons populaires. Les sources historiques parlent d'un certain Anton Duoda qui construisit la première maison à Tophane vers le commencement du XVIIIe siècle. Son exemple fut suivi par d'autres familles du pays, qui font venir à cette intention des maîtres bâtisseurs de Dibër, ainsi que par les émigrés rentrés chez eux. A Shkoder, les premiers bâtisseurs furent les goges, les artistes de Diber étant retenus à la métropole par l'empire ottoman. Ils y firent leur apparition vers la fin du XVIe-commencement du XVIIe siècles. Au début la dénomination de goge était synonime de maçon. Plus tard, à la suite des protestations élevées par les debriotes, le mot de maçon fut substitué par celui de «dibran». Les chansons populaires renferment des éléments de valeur sur l'activité des goges. La Mosquée de Plumbi et d'autres demeures situées dans les quartiers de Perash et au lieu nommé le Peuplier de Hoxhë Dheu sont l'oeuvre des goges qui n'étaient que de simples maçons.

Les premiers décorateurs appartenaient à la guilde des arkaxhi (= artisan qui produit des caissons), qui, avec le temps, ont quitté le Bazar situé au pied de la Citadelle pour venir s'installer avec leurs boutiques en pleine ville. Nous disposons des données sur quelques maîtres en peinture et arkaxhi qui ont exercé leur métier vers la fin du XIXe siècle. En ce qui concerne les arkaxhi du XVIIIe siècle, en l'absence de renseignements exhaustifs, ils ont été regroupés selon leur style de travail. Toutefois les choses se présentent différemment pour les maîtres en architecture, du fait que nous avons réussi à recueillir une documentation suffisante sur leur activité pendant le XVIIIe siècle et plus tard.

Par suite de l'essor économique que la ville de Shkoder a connu pendant le XVIIIe siècle font leur apparition certaines familles féodales, entre autres les Bushatli, les Begolli, les Çausholli, et une couche de riches commerçants, qui, profitant de la présence des maîtres bâtisseurs, se construisent des demeures imposantes. Plus tard ils embellisent l'intérieur de ces habitations par des cheminées en moulure de plâtre et des pilastres de marbre et des plafonds somptueux.

Dans ces ouvrages, malgré l'influence des styles occidentaux (baroque, rococo, directoire et empire) des XVIIIe-XIXe siècles, on relève surtout, le style traditionnel composé de motifs dont les lignes s'entrecroisent de feuilles de chênes, de lilas, de roses et d'oeillets. Les premiers ornements remontent au XVIIIe siècle, ils sont appliqués sur des placards muraux et des rosettes octagonales en forme d'étoile selon le style hatai et roumi. En ce qui concerne notre art de l'habitation populaire, à quelque différence près de caractère local, il se présente compact et avec une

DO NOT COPY

couleur typiquement albanaise contrairement à ce qui se passe dans les autres pays balkaniques.

Dans le répertoire de l'ornementation, pendant le XVIIIe siècle, on relève parmi nos artistes un certain embarras du fait qu'ils ne se sont pas encore créée une méthode personnelle avec ses motifs à lui, empruntés de la tradition. Les ouvrages en placage de l'époque s'appellaient «dograma» et les fines ciselures «ishleme».

En ce qui concerne le traitement des placards muraux, il se caractérise par des décors longitudinaux d'un grand intérêt. Dans leur partie supérieure ont été aménagées des niches en traits rhomboïdes ou circulaires, agrémentées de tulipes. Quant aux battants de ces placards, ils comportent trois parties: celles ,supérieure et inférieure, ornées de rosaces ou de palmettes et celle médiane de vases schématiques ou de pins.

Le motif de l'étoile polygonée, peint ou simple, isolé ou complexe, embellit les plafonds, ainsi que les caissons et les guéridons des habitations scutarines, mais on le retrouve aussi dans les habitations et les meubles des villes de Berat et de Gjirokaster. Toutefois, ce motif n'est plus exécuté pendant le XIXe siècle.

C'est justement pendant le XVIIIe siècle que font leur apparition les plafonds à linéaments brisés octogonaux simples ou décorés de motifs (rosettes octogonales ou carrées), et incisés en pyrogravure (palmettes et guirlandes). Le motif du Sceau-de-Salomon et de la marguerite à six pétales a été exécuté pendant deux siècles de suite sur les placards et les placards profonds, ainsi que sur les linteaux des portes, en association à des croissant et à des fleurs de lilas, de roses et de tulipes, ce qui nous rappelle le baroque oriental «lale époque» (l'époque tulipe). Les placards sont entourés par des traits digitaux, comme cela s'observe sur les berceaux de Mat. C'est là un motif exécuté par les débriotes depuis longtemps et que l'on retrouve sur les meubles et les plafonds du XVIIIe siècle. Il s'agit là d'une tradition que le maître Mehmet Metani a poursuivi pendant le XIXe siècle. Entre cette décoration et les caissons de mer type Adriatique, il y a évidemment une certaine analogie dans les motifs à platanes, vases, faisans, hirondelles et aigles bicéphales.

Nos recherches ont été étendues de Shkoder à presque toutes les autres villes du pays, entre autres Lezhe, Kruje, Tirana, Durrës, Elbasan, Kavajë, Peqin, Berat, Përmet, Gjirokastër, Korçë, Voskopojë, Mat et Gollobordë, où ont été classifiés près de 240 modèles et motifs parmi les monuments laïques et de culte. Ce sont là des modèles et des motifs relevant des différents styles de l'art décoratif connus aussi bien en Occident qu'en Orient pendant ces deux derniers siècles. Mentionnons de leur nombre la cordelette, la croix gammée, l'hélice, la roue, le tétrascèle, le triscèle, le croissant, l'étoile. la spire, les cercles concentriques, les postes. Ce sont là des motifs que nous retrouvons dans nos centres archéologiques et sur l'ameublement de toutes les campagnes du pays. Ils caractérisent l'ornementation du XIXe siècle dans tous les centres urbains du pays.

Les premiers ouvrages digne de ce nom datent le premier quart du XIXe siècle et se rattachent à l'établissement de groupes de maçons débriotes à Shkodër. Le répertoire de leurs ornements présente maintes analogies avec les motifs embellissant les intérieurs de Kosovë, il est suffisamment riche et compliqué de motifs cerclés dont la composition se caractérise de formes différentes. Les rosettes circulaires et polygonales se terminent en bordure de calices, de nielles et de fleurs de lis.

Quant à la rosace hélicoïde, elle est exécutée dans tous les intérieurs: plafonds, loges et cheminées. De pair à celle-ci se développe le rinceau hélicoïde.

L'S continue décore des frises, des rosettes et des placages, entrelacés à ces fleurs bourgeonnées. Ces mêmes motifs nous les retrouvons à Elbasan et à Berat.

Le Soleil, il est exécuté en rayons, en rouelle ou en traits originaux sur le fonds des plafond, des portes et des placards.

Le motif de la cordellete nous le retrouvons sur les corniniches et les frises. Près de vingt types de vases et de théières, symboles de l'hospitalité traditionnelle albanaise, embellissent des placards et des plafonds, ainsi que des battants de porte, appliqués en croix gammée.

A Shkoder et dans le quartier Varosh de Lezhe ont été identifiées plus de 30 cheminées en plâtre, dont l'exécution s'échelonne de la fin du XVIIIe siècle jusqu'aux années 70 du siècle suivant. Elles ont au commencement une forme semi-cylindrique puis, dans la dernière période, une forme semi-polyédrique. Quant à leur ornement, il comporte des couronnes ondulées sur baldaquins décorés de rinceaux ajourés. La multitude de genres de rosettes sont composées de lignes cerclées, elliptiques, carrées et baroques.

Ces ouvrages ont été réalisés par des centaines d'artistes, dont les plus illustres sont les suivants:

Jashar Xhafa, originnaire du village de Sebisht, fut un tailleur de pierre plein de talent. Il a exécuté des plafonds merveilleux en traits d'étoile et des cheminées semi-cylindriques à baldaquin baroque, dans certaines demeures illustres du commencement du XIXe siècle, entre autres le Musée Gurakuqi où l'on relève des brillantes compositions aux arabesques tortueuses, des triscèles, des oiseaux, des vases, des portes à la croix gammée, des placards baroques, des étoiles rhomboïdes comme dans les berceaux de Mat et des rinceaux doubles hélicoïdes. Du nombre de ses élèves, mentionnons Ramadan Dibra, Mehmet Metani et Isuf Haxhiu.

Ramadan Dibra, originaire également du village de Sebisht et surnommé «maître Dana». Il s'est illustré pendant la moitié du XIXe siècle par de puissantes compositions spiralées sur des rosettes carrées et octagonales en feuilles de tilleul, et en fleurs d'abricots et d'anémones sur des rosaces et des fleurons.

Mehmet Metani, surnommé «maître Meta», était originaire du village de Zabzun. Il s'est fait un renom par ses reliefs de plafonds et de cheminées en plâtre exécutés vers la moitié du siècle passé. Son ornementation comporte des spires en feuilles de chêne, des méandres crénelés d'ajours, et des rosettes. Quant à ses placards, ils reproduisent le motif de la flammerole. Les cheminées polyédriques de Met Metani sont couronnées de

BOTIMOR

DO NOT COPY

bandes polylobées simples ou décorées de rosaces, les battanta de ses portes se caractérisent par la croix gammée. Du point de vue technique, ses feuilles sont tracées profondémment en creux et son burin créa de fortes saillies.

Isuf Haxhiu, surnommé «maître Cufa», est également originaire du village de Sebisht. Son ciseau domine le bois, il a réalisé des gerbes sveltes et charmantes s'élençant des vases, des rosettes à corniches de feuilles, ornées de rosaces et d'hélices centrifugales et centripétales. Parmi ses principaux ouvrages une mention particulière mérite le Musée de la ville de Shkodër, ou l'on ne peut ne pas admirer un plafond buriné en traits d'étoile à huit branches et une lohe, qui est un exemplaire unique en son genre en Albanie, décorée d'arcades dentelées et d'ornements en arabesques hélicoidales, et encore des placards en vases ovales dans la plupart des maisons.

Dans la deuxième moitie du siècle passé, nous avons le troisième groupe de maîtres qui se sont formés à l'école de leurs prédécesseurs ou de leurs parents. Entre eux mentionnons:

Rame Selim Mitku, surnommé «maître Rama» et originaire du village de Tërnovë, il s'est fait à l'école de maître Cufa. On lui doit un répertoire d'ornements comportant des petites feuilles aux pintes aiguës, dans des compositions de palmettes bispiralées, des plumes et des lyres, ainsi que des rosaces sur des rosettes circulaires. Il a sculpté d'élégants plafonds octogondux et des placards muraux, où le soleil est gravé en son aspect original.

Sadik Koçi, originaire du village des Trebisht, a fait son apprentissage auprès du maître Dana. Il inventa certains intérieurs, vers la fin du XIXe siècle, où lon relève son originalité dans le dessin des hélices à double ailes engendrant des feuilles dentelées, des rosettes octogonales, des compositions baroques et fleuronnées.

Des ouvrages importants ont été réalissé à Shkoder par les frères Selman, Mahmut, Hasan et Isuf Metani, les fils de maître Meta et instruits par lui-même et par maître Dana. Ils travaillaient tous ensemble et ont buriné des plafonds en rayons de soleil. Nous avons identifié quatre inscriptions en lettres turques faites de leur main.

Sylejman Metani, surnommé aussi «maître Selman»; il se distingue pour ses feuilles à la surface égrenée, en double rinceaux et entrelacées de fleurs bourgeonnées.

Mahmut Metani, vers la fin du XIXe siècle, exécute des feuilles de tilleul sur des rosaces spiralées centrifugales et des rosettes typiques décorées de cercles juxtaposés et circonscrits.

Hasan Metani et son frère Isuf ont travaillé ensemble à la décoration de certains intérieurs. Chez le premier les feuilles connaissent un développement farouche, tandis que l'individualité graphique du deuxième se caractérise par des lignes gravées en double traits.

Sali Osmani, surnommé «maître Sala», burinait le bois de la même manière que les oeuvres sculptées en pierre du maître Xhafer Isufi. Il travaillait dans l'atelier de maître Hasan Burgu. Sa caractéristique principale était la rosette ayant un aspect de rouelle.

Hasan Burgu, surnommé aussi «maître Hasa», est originaire du village de Ternova d'Albanie. De même âge que les autres maîtres du deuxième groupe de Shkoder, cet artiste remarquable s'est distingué pendant la période de temps allant de la moitié du XIXe siècle jusqu'à sa fin par les ouvrages qu'il a réalisé en Bosnie, à Kosovë, Scoplje, Pejë, Gjakovë, Lezhë, Krujë, Tirana, Ternovë et Ostren i madh. Son art se caractérise par des feuilles de chêne ondulées en sens vertical et horizontal qu'il sculptait sur des plafonds, des placards, des cheminées et des caissons travaillés sur bois et plâtre.

Dans le musée de Shkodër nous avons identifié deux placards travaillés en stuc par maître Osman Sallaku, originaire d'Okshtun, ainsi qu'un plafond travaillé au burin par Zejnel Ramçi. En ce qui concerne les autres maîtres, ils ont été regroupés dans l'atelier des Metan. La plupart des cheminées de Shkodër ont été modelées par des maîtres appartenant à cette famille. Un équipe de bâtisseurs avaient à tête d'abord Haxhi Liman Lloshi, puis Ahmet Lila. L'autre équipe Isuf Haxhiu; qui a cédé la place à Rame Selim Mitku. Le meilleur atelier a eu comme chef Mehmet Metani, qui a été remplacé plus tard par maître Selman.

Les plafonds ont été peints pendant une seconde période par les maîtres scutarins Simon Dokseni et Gaspër le Peintre.

Les maîtres débriotes ont eu comme ingénieur en chef Arsen Idromeno, son fils Kole Arseni, et l'ingénieur français Briot.

Kolë Idromeno, illustre peintre et décorateur, en collaboration avec les maîtres susmentionnés, a réalisé la grande Avenue de la ville, la Résidence de Shtrokë et d'autres édifices importans. Il a peint entre autres des plafonds et conçu le projet des grillages et des balustrades de différents escaliers et balcons en certaines habitations, (exemple la Maison de la Culture) avec des motifs de vignes et d'aigles selon le style européen du XIXe siècle. Ces objets étaient forgés dans l'atelier de maître Hamit Lloshi.

Dans d'autres villes du pays aussi, nous avons identifié des motifs et relevé des formes architecturales ressemblant à ceux des intérieurs scutarins et se caractérisant par une composition d'un niveau artistique élevé. Les maîtres travaillant sur bois et sur pierre étaient originaires des villages Leiçan, Tërnovë, Okshtun, Sebisht, Borovë et Zabzun. Tous ces villages sont voisins l'un de l'autre, ce qui explique les liens et les influences réciproques que l'on relève dans les différentes villes du pays. L'originalité de leur oeuvre se caractérise par des formes uniques en leur genre, par une diversité en pleine unité contraire à toute monotonie.

Parmi les objets examinés plus haut, une petite partie d'entre eux seulement avaient été placés sous la protection de l'Etat. Par suite des investigations effectuées par le Secteur d'Art, auprès de l'Institut des Monuments de la Culture, le nombre des objets de même nature protégé par l'Etat s'est accru sensiblement. Il est de notre devoir maintenant de conserver et de restaurer ce patrimoine qui est l'oeuvre de notre peuple.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

MBI FORTIFIKIMET E VONA ANTIKE TË VENDIT TONË

Arkitektura, destinimi dhe datimi i fortifikimeve të antikitetit të vonë në Shqipëri nxjerrin mjaft probleme para studjuesit, për më tepër kur burimet e shkruara janë fare të pakta, mbishkrimet lidhur me këto probleme thuajse mungojnë, ndërsa të dhënat nga gërmimet arkeologjike vijnë vetëm nga një numër i kufizuar qendrash. Problematika e gjerë që parashtron studimi kompleks i kësaj periudhe ka bërë që me të të preokupohen mjaft studjues.

Në komunikimin e Apollon Baçes bëhet ndër të tjera një përmbledhje dhe klasifikim edhe i elementeve të ndryshme të arkitekturës së këtyre fortifikimeve.

Lidhur me disa nga këto probleme do të shpreh im edhe ne mendimin tonë duke bërë në ndonjë rast sugjerime dhe plotësime.

Një nga tipet e fortifikimeve të kësaj periudhe të një karakteri të veçantë, janë muret pengues apo barierë, të cilat bllokonin ngushtica, rrugë të përshtatshme për kalimin e ushtrive armike e tjera, duke vënë në këtë mënyrë në mbrojtje territore mjaft më të gjëra nga ai i vetë qytetit të fortifikuar. Sipërfaqja e madhe apo e vogël e këtyre territoreve të mbrojtura varet krejtësisht nga kushtet e terrenit, d.m.th. nga vendndodhja e ngushticave apo vendeve të tjera të përshtatshme për ndërtime të këtij karakteri. Në qoftë se terreni nuk i ofronte këto mundësi, ndërtime të tilla sigurisht nuk kryheshin apo merrnin trajta të tjera. Pra në asnjë rast nuk duhen lidhur këto zona të mbrojtura me kufijtë administrativë të qyteteve. Ndërtime të tilla të njohura edhe në antikitet e më herët synonin të ruanin qytetin nga befasia si dhe në pjesëmarrjen e sa më shumë forcave njerëzore në mbrojtje.

Anonimi Bizantin i shekullit VI rekomandon të ndërtohen mure rrethuese të jashtme në mënyrë që të marrin pjesë në mbrojtje edhe banorët e qytetit. Ndërsa Prokopi, historian i perandorit me origjinë ilire Justiniani, shkon më tej duke rekomanduar mënyra mbrojtje të tilla ku të sigurohej jo vetëm qyteti, por edhe fshatrat përreth. Duke qenë se jo çdo qytet kishte kushte të tilla gjeografike për të ndërtuar muret barierë, më pak të kushtueshme, kjo arrihej nëpërmjet rrethimeve të jashtme të mëdha ku mund të strehohej edhe popullsia e fshatrave përreth, siç ndodhi në qytetin e Redestrës me afrimin e barbarëve[1]. Në vendin tonë ruhen dy ndërtime mbrojtëse të këtij karakteri nga periudha e vonë antike, njëri në Butrint dhe tjetri në veri të Durrësit, i njohur me emrin Muri i Portës. Ne jemi të prirur t'i datojmë këto ndërtime në periudhën e sundimit të Justinianit.

Muri i Portës është ndërtuar me teknikën «Opus — Mixum» me katër rreshta tullash në brez. Trashësia e llaçit 5-7 cm është më e madhe se ajo e tullës dhe përbëhet nga mbushës i trashë (zhavor). Ky mur është konsideruar nga Hezej, Prashniker dhe studjues të tjerë si një ndërtim i periudhës së perandorit Anastas I. Por ne mendojmë se mund të bëhet një datim më i saktë po të interpretohen më drejt burimet historike si dhe raporti me ndërtime të tjera të kësaj periudhe.

Nga Prokopi mësojmë se Justiniani plotësoi veprën e filluar prej Anastasit I. dhe shënohet si ndër-

1) V. Vëllkov. — **Grad v. Trakia i Dakia prez ksnata antiçnost** Sofia 1959, 178.

tues i një kalaje të re në Durrës. Kjo e dhënë përputhet edhe me të dhënat arkeologjike si dhe teknikën e ndërtimit. Sondazhi i bërë në Murin e Portës tregoi se ky i fundit nuk ishte ngritur mbi ndërtime më të vjetra, por i përkiste një periudhe të vetme ndërtimi[2]. Gjithashtu forma e kullave dhe teknika e ndërtimit ndryshojnë nga ato të Kalasë së Durrësit. Së fundi mund të shtojmë mungesën e monogrameve të murreve të Durrësit në atë të Portës dhe nga ana tjetër zbulimin e një monogrami të ri. Duke u nisur nga ky argument i fundit, Koço Zheku arriti në përfundimin e drejtë që ky mur nuk është i njëkohëshëm me muret e tjera të Durrësit, por nga ana tjetër ai u shpejtua të shfaqë mendimin se burimet historike mbi ndërtimet e perandorëve Justin dhe Justinian në Kalanë e Durrësit janë të dyshimta[3]. Përveç Murit të Portës, i cili me shumë gjasë i përket periudhës së Justinianit, kemi arsye të supozojmë për ndërtime të tjera të kësaj periudhe në Kalanë e Durrësit. Kur përshkruan murin verilindor të rrethojës së Durrësit, Hezei midis të tjerave përmend disa kulla katërkëndëshe, të cilat nuk janë të natyrshme për këtë kala, pasi të gjitha kullat e tjera janë me majë të mprehtë. Ato ndodheshin në pjesën më të dobët dhe më lehtë të sulmueshme të fortifikimeve të këtij qyteti[4], ku ka më tepër mundësi të jenë bërë rindërtime në kohën e perandorëve të fundit. Në të mirë të mendimit se Kalaja e Portës u ndërtua në shekullin VI flet dhe teknika e ndërtimit me breza tullash me trashësi llaci më të madhe nga ajo e tullës, e cila në këtë rast përkon me periudhën e dytë të ndërtimeve në Kalanë e Elbasanit të datuar nga fundi i shek. V. në shek. VI[5] me më shumë mundësi në periudhën e Justinianit. Nga ana tjetër kulla e vetme e ruajtur në Murin e Portës, si nga përmasat, vendosja e shkallëve, hyrjeve etj. të kujton menjëherë Kalanë e Rusafës në Siri ndërtuar nga ky perandor[6]. Për murin e Demës në Butrint nuk kemi ndonjë argument tjetër më të shëndoshë për datimin në të njëjtën periudhë veçse faktin e ekzistencës së ndërtimeve të të njëjtit karakter strategjik në Perandorinë Bizantine që ishin karakteristike për periudhën e Justinianit, siç janë muret që mbyllin Thermopilet dhe Istmin e Korintit, të ndërtuara ashtu si dhe muri i Demës mbi substruksione antike[7].

Të dy fortifikimet e tipit të mureve barierë të vendit tonë janë pajisur me kulla katërkëndëshe. Atëherë na lind pyetja: A ka ndonjë vlerë kronologjike edhe forma planimetrike katërkëndëshe e kullave në këtë rast? A ka qenë ajo më e përhapur në shek. IV, siç u shpreh në kumtesën e tij Apollon Baçe, qoftë pa e absolutizuar këtë përhapje, apo në shek. V-VI?

Forma katërkëndëshe e kullave, megjithëse më pak rezistente kundrejt makinave rrethuese gurëhedhëse, vazhdoi tu rezistojë kritikave të teoricienëve bashkëkohës të arkitekturës, duke filluar që nga Filoni (shek. III p.e.r.) deri tek anonimi bizantin (shek. VI), pasi ndërtohej më lehtë dhe ishte më pak e kushtueshme. Prandaj nga kjo pikëpamje përhapjen më të madhe të saj duhet ta kërkojmë në atë periudhë kur ndërtimet ushtarake ishin më intensive, dhe për pasojë shpenzimet më të mëdha dhe kjo periudhë përputhet me atë të sundimit të Justinianit, për kohën e vonë antike. Në këtë rast duhen dalluar si më të hershme kullat drejtëkëndëshe që dalin pak nga muret ose që i ndërpresin ato. Kullat drejtëkëndëshe të dala plotësisht nga muret i takojmë nga fundi i shek. III-IV si bashkëkohëse me ato në formë potkoi apo freskoreje që vendoseshin në qoshet e kështjellës. Ato i gjejmë të ndërtuara në të njëjtin fortifikim apo nëpër fortifikime të ndryshme bashkëkohëse. Mjafton të përmendim pallatin e Dioklacianit në Spalato, kështjellën e Mogorjeos në Bosnje, Paleokastrën shumë të ngjashme si nga planimetria, kullat dhe hyrjet, të cilat i përkasin afërsisht së njëjtës periudhës midis fundit të shek. III fillimit të shek. IV. Nga periudha e Dioklecianit njohim gjithashtu disa kështjella në provincën arabe, të cilat mbroheshin nga kulla në trajtë freskoreje në këndet dhe potkoi gjatë mureve shumë të ngjashme me Kalanë e Elbasanit dhe të Vigut, siç janë kampet e fortifikuara në El-Leggun dhe në Odruh, të përshkruara nga Brynov Domashevski[8]. Por nga ana tjetër duhet të vëmë në dukje se gati gjithë kështjellat që na bënë të njohura Sharl Dili nëpërmjet botimit të tij «Afrika Bizantine», kanë planimetri të rre-

2) Shih për këtë Gj. Karaiskaj – A. Baçe – **Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në antikitetin e vonë,** Monumentet 9, 1975.
3) K. Zheku **Zbulime epigrafike në muret rrethuese të kalasë së Durrësit,** Monumentet 3, 1972, 35-46.
4) L. Heuzey – H. Daumet – **Mission Archeologique de Macédoine,** Paris 1876, 349-392.
5) Gj. Karaiskaj – **Të dhëna të reja për datimin e Kalasë së Elbasanit,** Monumentet, 3, 1972.
6) H. Spanner – S. Guyer, **Rusafa,** Berlin. 1926, 71 Tab. II.
7) Ch. P. Kardara – **The istmian Wall,** Athens annals of Archeology IV, 1971, 85-89.
8) R.E. Brünnov – A .Domaszewski – **Die Provincia Arabia,** Strassburg 1904, vol. I. 433-459, vol. II, 1905, 25-27.

ZOKOTOKOY

gullt drejtëkëndëshe dhe kulla të po kësaj trajte në qoshet dhe gjatë mureve dhe më rrallë kulla të rrumbullakëta në qoshe[9]. Këto fortifikime datohen në shekujt VI-VII, duke i përkitur shumica e tyre periudhës së Justinianit. Këtyre shembujve mund t'u shtojmë edhe Kalanë e Rusafës, në të cilën gjejmë të përdorur si bashkëkohëse kullën me majë të mprehtë të datuar nga fundi i shek. V deri në fillim të shek. VII nga Sava Bobçev[10], me kullën drejtkëndëshe ndërsa nga vendi ynë mund të sjellim shembullin e Kalasë së Qafës të datuar në shek. VI[11]. Pra me gjithë rekomandimet e anonimit Bizantin kullat trekëndëshe apo me majë të mprehtë vetëm pjesërisht munden të zëvendësojnë tipet e tjera të kullave dhe në mënyrë të veçantë ato drejtkëndëshe. Shembujt e përdorimit të kullave trekëndëshe apo me majë të mprehtë që na u sollën nga vendi ynë, tregojnë se rastet janë të pakta. Këtyre shembujve po u shtojmë dhe një kullë trekëndëshe në Kalanë e Pogradecit, mbi të cilën në një periudhë të dytë që ndërtuar një kullë drejtkëndëshe, si dëshmi e triumfit përfundimtar të kësaj të fundit në prag të mesjetës. Në një diapazon më të kufizuar kohe duket kanë qenë përdorur kullat në formë patkoi dhe sidomos ato në trajtë freskoreje nëpër qoshe. Jashtë vendit tonë përveç dy shembujve të mësipërm, nga periudha e Dioklecianit mund të përmëndim raste të tjera nga Gadishulli Ballkanik dhe territoret ku shtrihej Perandoria Romako-Bizantine. Kalaja e Dinogetias në Rumani ka formë të çrregullt planimetrike, me kulla në formë freskoreje në qoshe dhe patkoi gjatë mureve. Ajo datohet në shek. IV, rindërtuar në shek. V-VI[12], Ndërsa qyteti i fortifikuar në Tropaeum, shumë i ngjashëm me Elbasanin edhe nga trajtimi i portave dhe rrugëve që i përshkonin ato në vitet 313-316[13].

Nga koha e Dioklecianit në Limesin e Renit të Sipërm krahas kështjellave të pajisura me kulla drejtkëndëshe që ndërpresin muret kemi prej tyre me kulla gati në formë patkoi. Kastrumi i Ulpianës në Iliri në madhësi të përafërt me Kalanë e Elbasanit ka formë planimetrike katrore 400 x 400 m me kulla rrethore në qoshet. Në të janë zbuluar disa kulla drejtkëndëshe gjatë mureve si dhe një hyrje që mbrohej prej dy kullash në formë potkoi si në Kalanë e Elbasanit dhe atë të Grazhdanit. Sipas studjuesve të kësaj qendre janë hetuar dy periudha ndërtimi, e para në shek. IV, ndërsa e dyta që i dha kalasë formën që ruan sot në kohën e Justinianit, gjë që konfirmohet dhe nga dëshmia e Prokopit[14]. Kështjella e Drobetës në Rumani me kulla në formë freskoreje në këndet, por të një tipi më të zhvilluar nga ato të sipërpërmendura datohet në shek. V[15]. Muret e qytetit të Nikeas, të pajisura me kulla në formë potkoi, datohen në fund të shek. IV etj. Në Limesin Danubian hasen shpesh kështjella të pajisura me kulla të tilla. Një pjesë e studjuesve ia atribuojnë këto ndërtime perandorit ilir Diklecian, ndërsa studjuesit më të fundit i lidhin këto ndërtime me emrin e Kostandinit të Madh[16]. Pra për to kemi një datim rreth fillimit të shek. IV që përputhet me kohën e ndërtimit të Kalasë së Elbasanit. Në këtë grup do të përfshinim edhe kështjellën e Vigut me kulla në formë freskoreje në këndet dhe me hyrje që mbrohen nga dy kulla në formë potkoi. Për më tepër kjo hyrje është e pajisur me një oborr të brendshëm ashtu si në Elbasan, element që zhduket në vazhdim të shek. IV[17]. Në një periudhë më të vonë datohen kështjellat në vendet malore apo me planimetri të çrregullt të pajisura me këtë tip kullash[18] siç është Kalaja e Grazhdanit. Për një pjesë kështjellash malore në vendin tonë është shprehur për një datim nga fundi i shek. IV Neritan Ceka[19]. Ndërsa për Kalanë e Grazhdanit (Boberosi Antik) do të propozonim si kohën më të mundshme të ndërtimit gjysmën e dytë të shek. IV, dhe për faktin e mungesës së oborrit të brendshëm në hyrje që e takojmë në Elbasan dhe Vig. Por një fakt që të tërheq vëmëndjen për një

9) Ch. Diehl — **L'Afrique byzantine,** Paris 1896.
10) S. Bobçev — **Kreposnite kuli s izdadem ostër rëb i znaçenieto im za ukrepjavaneto na antiçnite gradove,** I.A.I.XXIV, Sofia 1961.
11) N. Ceka — **Fortifikime të vona antike pranë rrugës Egnatia,** Monumentet 7-8, 1974, 79-80.
12) S. Gervan, **Dinogetia,** Studii si cercetari de Istorie veche, 1-2, 1953, 240.
13) G. Ionescu — **Les fortifications antiques et medievales sur le territoire de la Roumanie et leur rappets avec le monde mediterraneen.** Actes VIII, Réunion Scientifique Athenes, 1968, 25.
14) E. Cerskov — Lj. Popovic, **Ulpiana,** Prethodni izvestaj o arheoloskim istrazivanjima u 1957, G.M.K.M. Pristina 1957, 321 dhe G.M.K.M. 1958, 275.
15) **Römer in Rumanien,** 1969, 139.
16) S. Soproni — **Der spätromische Limes zwischen Visegrad und Esztergom,** Limes Romanus Konferenz Nitra, Bratislava 1959, 131.
17) R. Schultze, **Die römische stadttore,** Bonner, Irb. Heft 118, Bonn 1909, 280-352.
18) S. Soproni, **Vep. cit.** 133.
19) N. Ceka, **Vep. cit.** 71-86.

DOKTORATURA

datim më të hershëm nga shek. VI i kullave në trajtë potkoi apo të shkronjës U dhe në formë freskoreje është se ato nuk i hasim në ndonjë fortifikim si bashkëkohëse me kullat me majë të mprehtë siç ndodh me kullat katërkëndëshe që kanë një përhapje mjaft më të gjerë në kohë. Ky fakt e kufizon në kohë përdorimin si të kullave në formë potkoi ashtu edhe të atyre me majë të mprehtë respektivisht në shek. IV dhe V-VI, në grupin e këtyre të fundit nuk duhet të përzjemë ato mesjetaret, disa prej të cilave, si p.sh. të Kalasë së Artës. S. Bobçevi, i grupon me to[20].

Një problem që kërkon studime të mëtejshme është ai i teknikës së ndërtimit. Më i lehtë është datimi i mureve me breza tullash dhe pothuajse i pamundur, për kufi të ngushtë, ai i mureve krejtësisht me gurë. Në rastin e parë nuk ka të bëjë sasia e rreshtave të tullave në brez siç përpiqet të argumentojë Sava Bobçev[21], por trashësia e fugës së llaçit dhe përbërja e tij. Për sa i përket përbërjes së llaçit përgjithësimi i saj me më shumë shembuj nga ndërtimet e kësaj periudhe do të sillte me siguri rezultate pozitive.

Lidhur me trashësinë e fugës së llaçit, duke u mbështetur në shembuj të shumtë nga ndërtimet në Konstandinopol A. Shnajderi ka arritur në përfundimin se trashësia e fugës së llaçit fillon ta kalojë atë të tullës pas mesit të shek. V[22]. Një fenomen i tillë është vërtetuar nga teknika e ndërtimit në fortifikimet tona, ku mund të sjellim si shembull muret e Anastasit I në Durrës, murin e Portës, Kaninën dhe periudhën e dytë të ndërtimit në Kalanë e Elbasanit. Mjafton të përmendim se brezi i tullave në muret e Kalasë së Elbasanit në periudhën e dytë të ndërtimit përbëhet nga tri radhë kundrejt atij prej katër radhësh të periudhës së parë[23], për t'u bindur se nuk mund të bazohemi në rritjen e numrit të rreshtave të tullave në brez për të datuar si më të vonë një ndërtim nga një tjetër, siç u shpreh në kumtesën e tij dhe Apollon Baçe. Me sa duket, në antikitetin e vonë me kalimin e kohës ndërtuesit kanë synuar të krijojnë breza tullash sa më të trashë, duke përdorur sa më pak tulla, që ishte një material i kushtueshëm. Këtu nuk duhet të na ngatërojnë përdorimi me shumicë i tullave në ndërtime ushtarake të një rëndësie të veçantë, siç ishte fortifikimi i Durrësit. Nga ana tjetër duhet të kemi parasysh se kursimi i tullave nuk duhet të cënonte soliditetin e mureve, në të cilat trashësia e brezit luante një rol jo të paktë. Për të siguruar soliditetin e këtyre brezave me shtresa të trasha llaçi, janë përdorur si përzierje copëra tullash zhavor apo çakull i imtë si në Kalanë e Durrësit, të Portës, Elbasanit etj. Në dy rastet e fundit brezat janë vendosur mbi shtresa të trasha llaçi, të cilat nuk i hasim në ndërtime të tjera më të hershme. E njëjta përbërje llaçi me përzierje çakulli haset dhe në mure të ndërtuara vetëm me gurë, siç është rasti i Kalasë së Zaradishtës në rrethin e Korçës[24], për të cilën jemi të mendimit se është ndërtuar në shek. VI. Për këtë na e forcon më tepër bindjen përdorimi në përbërjen e llaçit në Kalanë e Durrësit si i çakullit ashtu dhe i copërave të tullave. Në përdorimin e tullës në përbërje të llaçit duhet të dallojmë atë të pluhurit të tullës që fillon të përdoret në ndërtimin e mureve qysh nga mesi i shek. III[25]. Raste të përdorimit të llaçit me përbërje copëra tullash apo çakulli që arrijnë nga një herë në dimensione deri në 3-4 cm diametër, kemi dhe në mjaft kështjella të kohës së vonë antike në vendin tonë si në Kalanë e Bellovodës, Gjonomadhit, Zvezdës, periudha III e Kalasë së Trajanit, të gjitha këto në rrethin e Korçës[26], në një fazë të dytë ndërtimi në Kalanë e Elbasanit[27] si dhe në disa kala pranë rrugës Egnatia si Kalaja e Qafës, Kalaja në Shkëmbin Mbret dhe Kalaja e Brajas, për më tepër në këto dy të fundit kjo teknikë hetohet respektivisht si fazë e dytë dhe e tretë ndërtimi[28]. Por, për të arritur në përfundime më të sigurta, nuk mjaftojnë vetëm shembujt e sjellë më lartë. Është detyrë e studjuesve të ardhshëm për ta zgjidhur përfundimisht këtë problem.

---

20) S. Bobçev — **Kreposnite kuli s izdadem ostër rëb i znaçenieto im za ukrepjavaneto na antiçnite gradove**, Izvestija na Arheologi çeskija Institut, XXIV, Sofia 1961.

21) S. Bobçev — **Smesenata zidaria y rimskite i ranovizantijskite stroezhi** Sofia 1952 dhe artikullin në I.A.I. pri B A N, XXIV, Sofia 1961.

22) A. Schneider — W. Karnapp, **Bemerkungen zur byzantinischen Mauertechnik**, Byzanz, Berlin, 1936, 13.

23) Gj. Karaiskaj **Kalaja e Elbasanit,** Monumentet 1, 1971, 61-70.

24) Gj. Karaiskaj — P. Lera, **Fortifikimet e vona antike në rrethin e Korçës.** Monumentet 7-8, 1974, 93.

25) S. Bobçev — I.A.I. pri BAN, 155.

26) Gj. Karaiskaj — P. Lera, **Vep. cit.**

27) Gj. Karaiskaj — **Kalaja e Elbasanit**, 65.

28) N. Ceka — **Vep. cit.** 72,77,79-80.

Dokumentacion

Nga ndërtimet e shumta mbrojtëse të antikitetit të vonë në Shqipëri mund të veçojmë si ndërtime të sigurta thjesht ushtarake vetëm ato kështjella me përmasa të vogla dhe planimetri të rregullt, qofshin këto malore apo fushore si Paleokastra, Vigu, Hollmi deri diku Prenjasi e ndonjë tjetër ose ndërtime të tipit kullë e veçuar si ajo në Petrelë, të cilat dominonin rrugë me rëndësi strategjike. Ndërsa për ndërtimet e tjera që nuk kanë këto karakteristika, nuk mund të përcaktohet karakteri i tyre thjesht ushtarak ose si një qendër ekonomike as edhe nga tiparet e materialeve arkeologjike qeramikë etj., të zbuluara në to pasi në shek. IV u lejua martesa e ushtarëve në kampet e fortifikuara. Për këtë flasin gjetjet e shumta të qeramikës dhe të materialeve të tjera arkeologjike në Paleokastër dhe sidomos të veglave bujqësore në Vig. Pa dyshim disa nga fortifikimet e kësaj periudhe janë ngritur me porosi dhe, me sa duket, edhe me fonde perandorake, siç është rasti i Kalasë së Durrësit, ku, siç tregojnë dhe monogramet në tulla, këto të fundit janë prodhuar në punishte të tilla. Por ka edhe ndërtime që janë kryer si nga fondet e vjela prej të ardhurave të qyteteve ashtu dhe prej tyre të ngritura nga inisiativa e vetë popullsisë të vëndbanimeve kryesisht fshatare. Dy shembujt e sjellë nga ndërtimet mbrojtëse të kategorisë së fundit në Malin e Vilës dhe Shkëmbin Mbret në Elbasan, me mure guri pa lidhje llaçi, e kufizojnë shumë këtë veprimtari ndërtuese. Në këto ndërtime duhet të përfshihen një pjesë e mirë e fortifikimeve malore të përbëra nga mure të thjeshta guri të lidhura me llaç, pa kulla që ndjekin formën e terrenit. Këto ndërtime do të shërbenin në rast rreziku edhe si rifuxhio për fshatrat përreth. Një mendim të tillë e kemi shprehur në studimin për fortifikimet e vona antike të rrethit të Korçës. Kështu mund të shpjegohet numri i math i ndërtimeve mbrojtëse të kësaj periudhe, që nuk përfshihet në dëshmitë e Prokopit. Këtyre duhet t'u shtohet dhe një pjesë e madhe prej tyre që janë zhdukur pa lënë gjurmë si dhe ato që nuk janë zbuluar akoma.

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

A PROPOS DES FORTIFICATIONS DE LA BASSE ANTIQUITE DE NOTRE PAYS

RESUME

L'architecture, la destination et la datation des fortifications de la basse antiquité en Albanie posent maints problèmes à l'homme d'étude, d'autant plus que celui-ci ne dispose que d'un nombre très réduit de sources écrites, que les inscriptions relatives à ces problèmes manquent presque absolument et que les résultats des fouilles archéologiques ne concernent qu'un nombre limité de centres. L'étude complexe de cette période pose donc une vaste gamme de problèmes, ce qui explique le nombre élevé de spécialistes qui se sont attelés à cette tâche.

Dans la communication qu'Apollon Baçe vient de lire au'cours de la présente session, il a fourni entre autres un sommaire et une classification des différents éléments architecturaux de ces fortifications.

C'est justement à propos de certains problèmes abordés dans cette communication que nous avons l'intention d'exprimer notre opinion, en avançant parfois même des suggestions et des complètements.

Parmi les types de fortification de cette période ayant un caractère tout à fait particulier, il y avait les murs barrière qui servaient à bloquer les détroits, une voie d'accès convenable au passage des troupes ennemies et d'autres moyens, en protégeant de la sorte un territoire beaucoup plus vaste que celui-même de la ville fortifiée. La surface plus ou moins étendue de ces territoires protégés dépend exclusivement des conditions du relief. Etant donnée que non toutes les villes jouissaient de conditions géographiques favorables à la construction de murs barrière, ce qui n'entraînait pas aussi de grosses dépenses, le même résultat était obtenu par la mise en place de murs d'enceinte le plus étendu possible en vue d'abriter aussi la population des villages avoisinants. Chez nous sont conservés deux ouvrages défensifs de cette nature relevant de la basse antiquité, l'un à Butrint et l'autre au nord de Durres et connu sous le nom de Mur de la Porte. Nous sommes enclins a attribuer ces deux constructions à la période de domination de Justinien.

Procope de Césarée nous apprend que Justinien a achevé l'ouvrage commencé par Anastase I et il l'indique comme constructeur d'une nouvelle forteresse à Durres. Ce renseignement concorde avec les données archéologiques et la technique de construction. En effet les sondages effectués au Mur de la Porte ont montré que celui-ci n'a pas été élevé sur les débris d'anciennes constructions, mais qu'il appartient à une seule période de construction. Par ailleurs, la forme de ses tours et la technique de sa construction diffèrent de celles de la Forteresse de Durres. En plus, au Mur de la Porte a été mis au jour un nouveau monogramme différant des monogrammes des murs de la Forteresse de Durres. Se fondant sur ce dernier élément, Koço Zheku a abouti à la juste conclusion que ce mur n'est pas contemporain des autres murs de Durres, mais par ailleurs il a exprimé une opinion par trop hâtive en affirmant que les sources historiques sur les constructions des empereurs Justin et Justinien dans la Forteresse de Durres sont douteuses. Que le Mur de la Porte soit une construction du VIe siècle en témoigne aussi sa technique de construction à bandes de tuiles avec une épaisseur du mortier plus grande que celle de la brique elle-même, ce qui en l'occurence correspond à la deuxième période de construction de la Forteresse d'Elbasan attribuée à une période de temps allant de la fin du Ve siècle au VIe et plus probablement à la période de Justinien. Par ailleurs, la seule tour conservée actuellement au Mur de la Porte nous rappelle immédiatement par ses dimensions, par la disposition de son escalier, de ses entrées et autres, la Forteresse de Rusafa en Syrie construite par ce même empereur. En ce qui concerne le mur de Deme à Butrint, nous ne disposons pas d'argument plus solide pour sa datation à une période analogue que les constructions de même nature stratégique mises en place dans l'Empire byzantin pendant le règne de Justinien. Exemple les murs bloquant les Thermopyles et l'isthme de Corinte, dont la construction comme celle du mur de Deme a été réalisée sur les anciens substrats.

Les deux fortifications type murs barrière existant chez nous sont flanquées de tours quadrangulaires. A ce propos se pose la question si la forme planimétrique quadrangulaire des tours aussi renferme en soi quelque valeur chronologique? Si une telle forme a connu une plus grande diffusion au IVe siècle, come l'a affirmé Apollon Baçe dans sa communication sans toutefois conférer un caractère absolu à cette diffusion, ou plutôt pendant les Ve-VIe siècles?

Les tours de forme quadrangulaire, bien que moins résistantes envers les engins de guerre lançant des pierres, ont fait face aux critiques avancées par les théoriciens de l'architecture

DO NOT COPY

DO NOT COPY

de l'époque, depuis Philon (IIIe siècle av.n.è.) jusqu'à l'anonyme byzantin (VIe siècle), du fait que leur construction était plus facile et n'entrainait pas des frais excessifs. Aussi leur plus grande diffusion doit correspondre dans le domaine des constructions militaires, à une période de temps caractérisée par une activité plus intense, et en conséquence par de plus grandes dépenses, et cette période ne peut être autre en ce qui concerne la basse antiquité que le règne de Justinien. Quant aux tours angulaires formant saillies complètement hors des murs, elles appartiennent à la fin du III-IVe siècles et sont contemporaines des tours en forme de fer à cheval ou en éventail flanquant les angles des forteresses. Nous les trouvons construites dans la même forteresse ou dans différentes fortifications contemporaines. Rappellons à ce sujet le palais de Dioclétien à Split, la forteresse de Mogorjeo en Bosnie, notre Paleokastro très semblable du point de vue de la planimétrie, des tours et des entrées. Toutes ces constructions appartiennent plus ou moins à une même période de temps s'échelonnant de la fin du IIIe siècle jusqu'au commencement du IVe. Au règne de Dioclétien sont attribuées aussi certaines forteresses construites dans la province arabe et protégées par des tours en éventail aux angles et par des tours en forme de fer à cheval le long des murs. Ces forteresses sont très semblables aux forteresses d'Elbasan et de Vig. Du nombre des ouvrages défensifs construits dans la province arabe, mentionnons les camps fortifiés d'El-Leggun et d'Odruh que nous connaissons à travers la description de Brünnov-Domaszewsky. Par ailleurs, il importe de mettre en relief que presque tautes les forteresses citeés par Charles Diehl, dans son ouvrage «l'Afrique byzantine», se caractérisent surtout par une planimétrie angulaire régulière et par des tours de forme analogue aux angles et le long des murs et rarement par des tours rondes aux angles. Ces fortifications, datant les VIe-VIIe siècles, sont attribuées dans leur grande majorité à la période de Justinien. On pourrait encore ajouter à ces exemples la forteresse de Rusafa, où nous retrouvons comme contemporaine de la tour à pointe aiguë, datant une période de temps allant de la fin du Ve siècle jusqu'au commencement du VIIe selon les indications de S. Bobcev, la tour angulaire; et puis chez nous il y a la Forteresse de Qafe datant le Vie siècle. Ainsi, malgré les recommandations de l'anonyme byzantin, les tours triangulaires ou à pointe aiguë ne substituèrent qu'en partie les autres types de tours et en particulier les tours angulaires. Les exemples de tours triangulaires ou à pointe aiguë, figurant dans la communication d'A. Baçe et concernant notre pays, sont peu nombreux. On pourrait leur ajouter la tour triangulaire de la Forteresse de Pogradec, au-dessus de laquelle, pendant une deuxième période, a été élevée une tour angulaire, ce qui témoigne le triomphe définitif de celle-ci à la veille du Moyen âge. En ce qui concerne les tours en forme de fer à cheval et surtout celles en éventail aux angles, leur construction concerne un intervalle de temps plus limité. En dehors de ces deux exemples concernant notre pays, quant à la période de Dioclétien nous pouvons mentionner d'autres cas relatifs à la péninsule balkanique et aux territoires de l'Empire romain-byzantin. La forteresse de Dinogetia en Roumanie se caractérise par une planimétrie de forme irrégulière, par des tours en éventail aux angles et en fer à cheval le long des murs. Celle-ci date le IVe siècle, elle a été reconstruite pendant les Ve-VIe siècles. Par ailleurs, la cité fortifiée de Tropaeum présente une ressemblance frappante avec la ville d'Elbasan même sur le plan du mode de traitement des portes et des rues qui la parcouraient pendant les années 313-316.

Pendant la période de Dioclétien nous avons à Limes, sur le haut Rhin, de pair aux tours angulaires le long des murs, des tours presque en forme de fer à cheval. Le castro d'Ulpien en Illyrie, de dimensions approximatives à la forteresse d'Elbasan, se caractérise par une planimétrie carrée de 400 x 400 m et par des tours circulaires à ses angles. A la suite des recherches effectuées, on a identifié des tours angulaires le long de ses murs ainsi qu'une porte flanquée de deux tours en forme de fer à cheval comme dans la forteresse d'Elbasan et dans celle de Grazhdan. Les spécialistes qui se sont occupés de ce centre y ont identifiées deux périodes de construction, la première pendant le IVe siècle et la deuxième pendant le règne de Justinien, au cours de laquelle cette forteresse a pris la forme qu'on lui connaît actuellement, ce qui est aussi confirmé par les indications de Procope de Césarée.

Les murs de la ville de Nicée, flanqués de tours en forme de fer à cheval, datent le VIe siècle. A Limes, sur le Danube, il y a plusieurs forteresses garnies de tours semblables. Une part des hommes d'étude les attribuent à l'empereur Dioclétien d'origine illyrienne ,d'autres, les auteurs les plus récents, rattachent ces constructions au règne de Constantin le Grand. Nous avons donc affaire à une datation marquant approximativement le commencement du IVe siècle, ce qui correspond à la période de construction de la Forteresse d'Elbasan. A ce même groupe appartient aussi, selon notre avis, la forteresse de Vig flanquée de tours en forme d'éventail à ses angles et dotée d'une entrée protégée de deux tours en forme de fer à cheval. En plus cette entrée est dotée d'une cour intérieure comme à Elbasan, maïs ce dernier élément disparait au cours du IVe siècle. C'est à une période plus récente que sont attribuées les forteresses élevées dans les zones montagneuses ou à planimétrie irrégulière et flanquée de ce type de tours, comme c'est le cas de la Forteresse de Grazhdan. Selon Neritan Ceka, une part de ces forteresses de montagne se dressant chez nous appartiennent à la fin du IVe siècle. En ce qui concerne la Forteresse de Grazhdan (le Doberos antique), nous sommes enclins à proposer comme date probable de sa conctruction la deuxième moitié du IVe siècle, d'autant plus qu'elle ne comporte pas une cour intérieure comme à Elbasan et à Vig. Mais ce qui nous permet d'avancer une datation plus ancienne que le VIe siècle pour les tours en forme de fer à cheval ou en U et en forme d'éventail est le fait que celles-ci ne sont présentes en aucune forteresse simultanément avec les tours triangulaires ou à point aiguë, comme cela advient avec les tours quadrangulaires qui connaissent une diffusion relativement grande à l'époque. Ce fait limite dans le temps l'emploi des tours en forme de fer à cheval comme de celles triangulaires respectivement aux IVe et aux Ve-VIe siècles. Toute-

DO NOT COPY

fois, il importe de ne pas englober dans ce dernier groupe les forteresses moyenâgeuses, entre autres la forteresse d'Arte, comme le fait S. Bobçev.

Un problème qu'il importe d'approfondir encore est celui de la technique de construction. Il est plus facile de fixer la date de construction des murs traversés par des bandes de briques et beaucoup plus difiicile, dirons-nous même presque impossible, celle des murs entièrement de pierres. Dans le premier cas l'important consiste non pas dans la quantité de rangées de briques en bandes, comme s'efforce de nous convaincre S. Bobçev, mais dans l'épaisseur du mortier employé dans le joint et dans la composition du premier. En généralisant la composition du mortier, à partir des nombreuses constructions appartenant à cette période, l'on pourrait obtenir des résultats satisfaisants.

Du grand nombre d'ouvrages défensifs de la basse antiquité concernant l'Albanie, nous pouvons qualifier comme ouvrages purement militaires seulement les forteresses de petites dimensions et à planimétrie régulière, que ce soit de montagne ou de campagne, de Paleokaster, de Vig, de Hollm et même celle de Prrenjas et quelque autre ou encore les constructions de type tour isolée, comme celle de Petrelë, qui par leur position contrôlaient les routes stratégiques importantes. Quant aux autres constructions n'ayant pas ces caractéristiques, on ne peut pas les considérer comme des ouvrages purement militaires ni comme des centres économiques, car une telle chose n'est pas confirmée par les particularités des matériaux archéologiques, de la céramique et autres mis au jour, d'autant plus qu'à partir du IVe siècle les soldats en garnison dans les camps fortifiés pouvaient se marier. En témoigne les nombreuses trouvailles de céramique et d'autres matériaux archéologiques à Paleokaster et surtout d'instruments agricoles à Vig. Sans doute certains de ces ouvrages ont été réalisés sur commande et, voire même, avec des fonds fournis par les empereurs, Exemple la forteresse de Durres, où, comme l'indiquent les monogrammes figurant sur les briques, celles-ci sont produites dans les ateliers impériaux. Mais il y a aussi d'autres constructions qui ont été élevées avec les fonds publics des villes ou encore sur l'initiative même de la population des agglomérations surtout rurales. Les deux exemples cités d'ouvrages défensifs de cette dernière catégorie, précisément les fortifications du mont Vile et de Shkëmbi Mbret d'Elbasan qui se caractérisent par des murs de pierres sèches, limitent par trop cette activité de construction. Il importe d'englober dans ce groupe une bonne part des ouvrages de montagne défensifs comprenant des murs simple de pierres liées au mortier, dépourvues de tours et épousant le relief du terrain. En cas de danger ces ouvrages pouvaient fort bien servir d'abri aux habitants des villages avoisinants. Une telle opinion nous l'avons exprimé dans une étude précédente sur les fortifications de la basse antiquité du district de Korçë. Se qui explique aussi le grand nombre d'ouvrages défensifs de cette période ne figurant pas dans les témoignages de Procope de Césarée. Il leur faut encore ajouter toutes les fortifications disparues à jamais sans laisser de traces et celles qui n'ont pas encore été mises à jour.

Riza T. DRISHTI

DO NOT COPY

QENDRAT ZEJTARE TË PRODHIMIT TË ARMËVE DHE TË BARUTIT NË SHQIPËRI

Në këtë diskutim do të përpiqemi të parashtrojmë përmbledhtazi mendime dhe propozime, për disa qendra dhe objekte të lidhur me historinë tonë, siç janë qendrat zejtare të prodhimit të armëve dhe të barutit të zi (me tym) në Shqipëri.

Gjatë qëndresës së vendosur shumëshekullore të popullit kundër pushtuesve të ndryshëm, shqiptarit i u desh t'i zhvillonte, prodhonte, riparonte, përshtaste dhe zbukuronte armët me forcat, mjetet dhe shijet e veta.

I mbështetur në talentin dhe aftësitë e veta, shqiptarët ndonse në kushte mjaft të rënda politike dhe ekonomiko-shoqërore, mundën të krijojnë dhe të ruajnë në krahas traditave të tjera edhe ato të zejtarisë, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë për të zhvilluar më tej zejtarinë e prodhimit të armëve të ftohta dhe të zjarrit si dhe të barutit të zi në vend, jo vetëm në qytetet zejtare, por edhe në disa krahina malore.

Sot, në truallin tonë ende ruhen gjurmë të shumta të kësaj tradite zejtare me karakter luftarak dhe përvojë shumëshekullore.

Në mënyrë paraprake, këto qendra dhe objekte mund të grupohen si vijon:

a. Qendrat zejtare të prodhimit të armëve dhe të barutit (nga mesjeta deri në vitin 1912).

b. Qendrat dhe ofiçinat — shtëpi të riparimit të armëve gjatë luftës Antifashiste Nacional çlirimtare (1939-1944).

c. Objektet e artilerisë të shpërndara në natyrë, të cilat i përkasin Luftës së Parë Botërore (1914--1918) Luftës së Vlorës (1920) dhe sidomos ato të përdorura gjatë Luftës Antifashiste Nacional çlirimtare (1939-1944).

* * *

Një nga qendrat e rëndësishme të prodhimit të armëve të zjarrit zejtare të kulturës popullore, ku kanë ngelur ende gjurmët e rënojave është edhe Hajmeli.

Hajmeli, ndodhet rreth 22 km në J.L. të Shkodrës atje ku bashkohet Drini me Gjadrin, në krahun e majtë të rrugës automobilistike Shkodër-Lezhë. Qendra zejtare e Hajmelit të vjetër ndodhet në faqen e zhveshur të malit të Vidhnave. Sot këto rrënoja janë të braktisura dhe fshati i ri ndodhet në fushë, në bregun e lumit të Gjadrit. Hajmeli si qendër e zejtarisë së armëve të zjarrit, shquhet për prodhimin e çarkut të pushkës së gjatë shqiptare. Prandaj nga populli edhe sot janë të njohur «çarkaxhinjtë e Hajmelit» dhe se punishtet e tyre njihen me emërtimin «Farkat e çarkaxhinjve». Nga të dhënat e pakta dhe paraprake të shkruara dhe tradita gojore shumë e gjallë e popullit, Hajmeli veprimtarinë e prodhimit të armëve duhet ta ketë filluar me sa duket rreth viteve 30 të shek. XVII, kohë në të cilën fillon edhe punimi i çarqeve në vend. E themi këtë duke u mbështetur jo vetëm nga të dhënat e shkruara dhe tradita gojore vendase; por edhe nga përhapja e gjerë e famës së prodhimit të çarqeve nga mjeshtrat hajmelas. Emri i çarkut të Çefës nga Hajmeli edhe sot ndëgjohet në trevat veriore të Shqipërisë. Në Hajmel u aktivizuan mbi 60 familje armëtarësh. Kulmin e zhvillimit ai duhet ta ketë patur gjatë sundimit të bushatlinjve të Shkodrës (shek. XVIII-XIX) kohë gjatë së cilës armëtarët hajmelas-çarkaxhinjtë, bëhen mjeshtrat më të dëgjuar të kohës. Në këtë drejtim është me interes që kjo qendër e madhe zejtare të vihet në mbrojtjen e shtetit. Me

interes paraqitet gjurmimi i mëtejshëm i kësaj qendre nëpërmjet ekspeditave studimore dhe restauruese me qëllim që të kthehet në qendër edukimi për masat e gjera punonjëse.

Zonë tjetër e madhe e zejtarisë së prodhimit të barutit me tym është edhe lugina e lumit Mat. Atje kanë ekzistuar dhe njihen deri më sot rreth 15 punishte baruti, të cilat funksionuan që nga shek. XV dhe deri më 1910. Sot, ruhet vetëm një ish punishte baruti në fshatin Dars e kthyer në mulli. Këto punishte, të quajtura nga vendasit «dingat e barotit» kanë qënë përqëndruar në fshatrat: Bejnë, Dars, Fshat, Fulqet, Ketë dhe Klos. Të dhënat e shkruara si dhe tradita shumë e pasur gojore e popullit, dëshmojnë se në këto fshatra ishte përqëndruar kryesisht kjo zejtari.

Këto qendra zejtare, me një traditë kaq të pasur, mendojmë se në të ardhmen do të restaurohen dhe do të kthehen në «muzeume në natyrë» dhe «dingat e barotit» do të bëhen qendra të vizitueshme. Atje brezi i ri dhe studjuesit tanë mund të mësojnë së afërmi se si populli dhe fshatari i thjeshtë prodhonte me forcat e veta, gjithnjë në rrethim dhe në kushte aq të vështira politike dhe ekonomiko-shoqërore, barutin me tym duke furnizuar kryengritësit shqiptarë.

Gjurmime duhen bërë edhe në shumë qendra të tjera zejtare që përmënden në burimet historike dhe të dhënat gojore. Të tilla deri më sot dihen p.sh. Grabova e Gramshit, Dumreja, Leskoviku, Delvina, Voskopoja, Shkodra, Elbasani, Berati etj.

Krahas këtyre qendrave zejtare sot njihen edhe familje të dalluara armëtarësh që për 5 deri në 8 breza (nga 150 deri në 240) e ushtruan këtë zejtari. Të tilla ndodhen në fshatin Mashtërkorë të rrethit të Mirditës, në Leskovik, në fshatin malor Vërri (Shëngjergj) të Tiranës etj.

* * *

Drejtim tjetër pak i studjuar dhe si rrjedhim i pajohur sa duhet është dhe vënia e shtëpive-ofiçina në mbrojtjen e shtetit ose duke vënë një pllakë përkujtimore sidomos ato të cilat gjatë Luftës Antifashiste Nacional çlirimtare (1939-1944) dhanë kontribut të çmuar në riparimin e armëve të popullit dhe të ushtrisë sonë.

Të tilla mund të ketë në shumë rrethe, por për ilustrim po përmëndim shtëpinë-ofiçinë të armëtarit Qiriako Toçi, në fshatin Ravonik të Korçës, atë të Mehdi Koçi Dumbos në fshatin Rremenj të Pogradecit, në Tërbuq të Gjirokastrës, ofiçinën e parë partizane që veproi në zonën Gorë-Opar, të Korçës, shtëpia-ofiçinë në malësinë e Tiranës, ajo e Jakup J. Dibrës në Shkodër etj.

Një problem, i cili më duket se meriton vëmëndje më të madhe dhe është shqetësues – paraqitet grumbullimi i objekteve të artilerisë, për faktin se ky armatim troje ndodhet i shpërndarë anë e kënd vendit tonë. Megjithëse një punë e madhe në këtë drejtim është bërë gjatë viteve 1969-1971 me rastin e hapjes së Muzeumit Kombëtar të armëve në Gjirokastër ku u grumbulluan rreth 2000 armë.

Këto janë armë të artilerisë, të cilat i përkasin Luftës së Parë botërore (1914-1918), Luftës së Vlorës (1920) dhe sidomos ato të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (1939-1944); të cilat prej shumë vitesh ndodhen të braktisura dhe të lëna në mëshirën e natyrës. Ato ndodhen jo vetëm në bregdet por edhe në thellësi të vendit. Për këto disponohen të dhëna të sakta, por që duhen verifikuar. Për ilustrim mund të përmëndim se vetëm që nga Guri i Topit (Pogradec), nga Suga të Qeparojt dhe deri në fshatin e Zvernecit (Vlorë) ndodhen rreth 14 topa të kalibrave të mëdhenj.

Këto armë duke u grumbulluar dhe ekspozuar në Muzeumin Historik Kombëtar do lejojnë që brezat e sotëm dhe të ardhshëm të kuptojnë se: «Armiqtë i mundëm me armët e tyre» – siç e ka theksuar shoku Enver Hoxha.

DO NOT COPY

Riza T. DRISHTI

DO NOT COPY

LES CENTRES ARTISANAUX DE PRODUCTION D'ARMES ET DE POUDRE EN ALBANIE

RESUME

Se fondant sur leur talent et sur leurs aptitudes, les Albanais, malgré les conditions politiques, économiques et sociales difficiles du passé, ont réussi à créer et à conserver de pair à d'autres traditions celle des métiers, en tirant profit de toutes les possibilités, pour développer davantage particulièrement le métier de production d'armés blanches et à feu, ainsi que de la poudre noire dans le pays, et cela non seulement dans les centres ruraux artisanaux mais encore dans certaines régions de montagne.

De nos jours même on peut observer nombreuses traces de ce métier traditionnel de caractère militaire, qui connaît chez nous une expérience pluriséculaire.

Pour le moment, ces centres et ces objets peuvent être regroupés de la façon suivante:

a. Centres artisanaux de production d'armes et de poudre (du Moyen âge jusqu'en 1912).

b. Centres et ateliers-maisons de réparation des armes pendant la Lutte antifasciste de libération nationale (1939-1944).

c. Pièces d'artillerie abandonnées dans la nature et appartenant à la Première Guerre mondiale (1914-1918), à la Guerre de Vlore (1920) et surtout celles employées pendant la Lutte antifasciste de libération nationale (1939-1944).

Un des centres le plus important de production artisanale d'armes de notre culture populaire et où l'on peut observer encore ses traces est Hajmeli.

Le centre artisanal de l'ancien Hajmeli se dresse sur le versant nu du mont des Vidhna. Il s'était fait un renom à l'époque pour la production du rouet (= çark en albanais) des fusils longs albanais. Aussi ses artisans et leurs ateliers sont-ils encore connus par le peuple sous le nom de «çarkaxhijtë e Hajmelit» (= producteurs de rouets de Hajmeli) et «Farkat e çarkaxhijve» (= les Forges des producteurs de rouets). La production d'armes à Hajmeli doit avoir commencé vers les années 30 du XVIIe siècle, période de temps qui correspond aussi à la production des rouets dans le pays. Les rouets de maître Çefa, originaire de Hajmeli, sont encore rappelés dans les contrées septentrionales du pays. Il y avait 60 familles à Hajmeli s'occupant de la production d'armes. Mais ce métier a probablement connu son plus grand essor pendant la domination des Bushatlli de Shkoder (XVIIIe-XIXe siècles), période de temps au cours de laquelle les armuriers de Hajmeli deviennent les maîtres plus renommés de l'époque.

Une autre zone d'importance en ce qui concerne le métier de production de la poudre à fumée est aussi la vallée du fleuve Mat. Ici ont existé et sont connus de nos jours encore 15 ateliers spécialisés dans la production de la poudre, dont l'activité s'étend du XVe siècle jusqu'en 1910. Actuellement, de leur nombre il ne reste qu'un seul atelier au village de Dars, qui a été converti en moulin. Ces ateliers, que le peuple appelait «dingat e barotit», se trouvaient à l'époque dans les villages de Bejnë, Dars, Fshat, Ketë et Klos. En témoigne les sources écrites et la riche tradition orale qui mentionnent aussi d'autres centres spécialisés dans la production d'armes et de poudre.

Aussi devons-nous effectuer des recherches dans les centres que sont Grabove (district de Gramsh), Dumre, Leskovik, Delvine, Voskopoje, Shkoder, Elbasan, Berat, etc.

De pair à ces centres artisanaux l'on connaît des familles entières qui se sont fait un renom dans le métier d'armuriers pour l'avoir exercé successivement de 5 à 8 générations. Celles-ci se trouvent dans le village de Mashtërkorë (district de Mirdite), à Leskovik, dans le village de montagne Vërri de Shëngjergj (district de Tirana) et ailleurs.

Un autre problème à peine abordé et qui mérite d'être pris en considération est celui de placer sous la protection de l'Etat les maisons-ateliers de réparation d'armes, notamment celles qui ont donné une contribution précieuse en cette direction pendant la Lutte antifasciste de libération nationale (1939-1944). Mentionnons de leur nombre les maisons-ateliers du village de Ravonik (Korçe), de Rremenj (Pogradec), te Tërbuq (Gjirokaster), le premier atelier des partisans installé dans la zone d'opérations Gore-Opar (district de Korçe), la maison-atelier de la zone montagneuse de Tirana.

Un autre problème de grand intérêt et méritant une attention toute particulière est celui de rassembler les pièces d'artillerie actuellement parsemées dans les quatre coins du pays, pour les exposer au Musée de l'histoire nationale.

Ainsi les générations présentes et futures seront en mesure de saisir à travers ces armes lourdes si puissantes l'héroïsme sans précédent et l'épopée la plus glorieuse du peuple albanais, elles seront en mesure de comprendre à fond les paroles du camarade Enver Hoxha: «Les ennemis nous les avons battus avec leur propres armes».

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

MBI DISA PROBLEME TË KISHËS SË MANASTIRIT TË APOLONISË

Ndërhyrjet për vlerësimin shkencor dhe estetik të një monumenti, që përbëjnë shkallën më të lartë të ndërhyrjeve restauruese, nuk ka si të mos sjellin të dhëna me vlerë për studjuesin e monumentit përderisa ato e prekin dhe e zbulojnë atë thellësisht. I tillë është edhe rasti i kishës së manastirit të Shën Mërisë të Apolonisë, një ndër monumentet më me rëndësi të mesjetës sonë.

Ne kemi botuar vite më parë një studim për arkitekturën e kishës[1], në të cilin ndër të tjera përcaktojmë fazat e ndërtimit dhe japim një rikonstruksion të fazës fillestare të ndërtimit. Duke qenë se patëm vërejtur fragmente mjaft të vogla të një shtrese të pikturuar nën afresk e njohur që paraqet perandorin Paleolog, gjë që vinte në pikëpyetje pasjen e një portiku me dy kollona në anën perëndimore, siç e kishim menduar ne në rikonstruksionin që paraqesim[2], ndërmorëm në verën e vitit 1972 një sondazh në anën nga jugu të portës perëndimore të narteksit, atje ku nuk kishte afresk. Në përfundim të sondazhit na rezultoj se nuk kishte asnjë mundësi për një portik të tillë, sepse muratura me gurë të mëdhenj të skuadruar e faqes perëndimore vazhdonte e tillë deri në kontaktin me shpatullat e portës dhe gurët e harkut që e mbulojnë atë. Në të kundërt sikur të kishte pasur dikur portik, do të ruheshin gjurmët në mur të qemerit të portikut siç ruhen në anën jugore të narteksit, ku portiku është i rrëzuar.

Një të dhënë të re përfituam duke parë më me vëmëndje kupolën në anën e jashtme. Vërejmë se fillimet e kupolës duken edhe me anën e jashtme, pa u fshehur nga kornizat dhe pjesa e sipërme e tamburit siç ndodh zakonisht. Mendojmë se kjo do të jetë rezultat i ndonjë hezitimi nga ana e ndërtuesve për lartësinë e tamburit, të cilin duhej ta vinin në një formë të re me dymbëdhjetë nikje, trajtë e papërdorur në kishat e provincës, ose edhe e ndonjë kërkese tjetër të karakterit estetik si mund të ishte kërkesa për një tambur më të lartë në dukje, përderisa ndërtimi i kornizës në sipërfaqe të tamburit, po të ruhej e njëjta pjerrësi e çatisë, do të zvogëlonte lartësinë e tamburit.

Një e dhënë tjetër me interes që duam të biem këtu është se gurët, me të cilët është ndërtuar kisha e Shën Mërisë, janë të shkallares së teatrit të qytetit antik të Apolonisë. Ne na pat tërhequr vëmëndjen fakti që gurët kishin nga një bordurë të gdhendur që kalonte me kubaturë në faqen e rrafshët të gurëve, por nuk qemë në gjendje ta shpjegonim këtë veçanti. Duhej që me gërmimin e teatrit[3] të dilnin në dritë gurët e shkallares për të kuptuar njëherazi shpjegimin që kërkonim. Shumica e gurëve kanë bordurën në brinjën më të gjatë, ndërsa një pjesë edhe në njerën nga brinjët e ngushta. Gurët e parë janë gurë të zakonshëm të ndenjësve, ndërsa të dytët gurë të ndenjëseve pranë shkallëve-rrugë kalimi përgjatë shkallares. Kemi të bëjmë pra me një rast të ripërdorimit të materialit antik të Apolonisë fenomen i njohur gjatë mesjetës së mesme dhe të vonë.

Lidhur me kumtesën interesante të Hasan Nallbanit «Të dhëna të reja rreth pikturës së kishës së Manastirit të Apolonisë» që u mbajt në këtë sesion,

---

1) A. Meksi **Arkitektura dhe datimi i kishës së manastirit të Apolonisë.** Monumentet 1, 1971, 103-17.

2) **Po aty,** Tab. V. 2.

3) Gërmim në vazhdim i Qendrës së Studimeve arkeologjike, nën drejtimin e Aleksandra Manos, të cilën e falenderoj për vënien në dispozicion të materialit.

DO NOT COPY

do të deshëm të trajtonim dy probleme: atë të portikut të ekzonarteksit dhe të datimit. Duke mos pasur në dorë të dhëna burimore historike në artikullin tonë, i kemi trajtuar këto dy probleme në vija të përgjithshme, duke lënë vend për saktësime të mëvonshme.

Përsa i përket portikut, përcaktimi i formës fillestare të tij dhe lidhur me të kohës së ndërtimit, është i vështirë, sepse dalin një sërë problemesh të paqarta. Së pari që ekzonarteksi ka ekzistuar në një formë të pakapshme sot për sot edhe përpara pikturimit të skenës së Paleologëve përderisa në të ruhen gjurmë të një pikture më të vjetër, ekzistenca e së cilës pas sondazheve të H. Nallbanit është jashtë çdo dyshimi. Së dyti që mbishkrimi i përmbysur me datën 1380 të jep të kuptosh që nëse kolonada është më e hershme se ajo datë, kemi të bëjmë me një rindërtim të saj. Së treti që përdorimi i kapiteleve romantike pas vitit 1380 do të ishte ose një influencë shumë e vonë në këtë anë të bregdetit të Adriatikut ose një ripërdorim, gjë jo e pamundur, përderisa kemi një më tepër të përdorur mbi pilastrin qendror nën kornizën. Për këtë problem të fundit nuk na duket bindës mendimi i H. Nallbanit që ky kapitel është zëvëndësuar në kolonadë me një tjetër, sepse për mendimin tonë do të qe më e lehtë që kapiteli i ri të vendosej lart, madje pa qenë e nevojshme që të punohej nga të dy anët pra dhe në anën jo në dukje.

Për të përcaktuar si formën e parë dhe ndryshimet në kohë të ekzonarteksit dhe ndonjë rindërtim eventual të kolonadës do të ishte e nevojshme të shqyrtoheshin fugaturat për të dalluar ndryshime, gjë relativisht e vështirë, sepse ato janë mjaft të holla, si dhe të ndërmiren sondazhe deri në gërmimin e terrenit pranë, i cili sot është paksa i ngritur ndaj dyshemesë të ekzonarteksit.

Në pikëpamje të datimit të kolonadës problemi duhet parë më gjërë në kuadrin e ndodhive historike dhe influencave të artit perëndimor që vërehen jo vetëm në kapitelet e portikut, por edhe në harqet e mprehta të portave të portikëve të naosit dhe dritares së absidës gjithnjë duke konsideruar vendin e tyre në tërësinë e kishës që i përket arkitekturës bizantine dhe rolin më tepër piktoresk të tyre dhe si element të dorës së dytë në formën arkitekturale (harqet e mprehta janë prapa portikëve).

Për sa i përket datimit, duke konsideruar vështirësitë e mësipërme dhe duke menduar ta ritrajtojmë këtë problem më gjerë më vonë, në studimin tonë iu përmbajtëm principit të datimit relativ të fazave të ndërtimit dhe vendosjes së kufijve maksimal të nxjerrë nga mbishkrimet. Ndërsa duke u nisur nga tipi arkitektonik, kemi datuar kishën si të gjysmës së parë të shek. XIII (përpara 1250), duke konsideruar influencat e arkitekturës perëndimore si dhe prej një sërë rrethanash historike lidhur me to krahas përdorimit të tipit të qartë kryeqytetas në një zonë të largët pa shembuj të ndërmjetëm (çka vështirëson datimin) jemi shprehur që mund të jetë dhe përpara kësaj kohe, pra më e hershme. Piktura e gjetur kohët e fundit si dhe sondazhet që duhet të ndërmiren krahas thellimit të studimit sigurisht që do të kontribuojnë për ndriçimin e këtyre problemeve.

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

A PROPOS DE QUELQUES PROBLEMES RELATIFS A L'EGLISE DU MONASTERE D'APOLONIE

RESUME

Il y a quelques années nous avions consacré une étude à l'architecture de cette église, où entre autres nous avions tenté de définir ses différentes phases de construction et de reconstruire sa phase initiale de construction. Etant donné qu'à l'époque nous avions relevé certains petits fragments de peinture à fresque reproduisant l'empereur Paléologue, ce qui mettait en doute l'existence d'un portique à deux colonnes sur le côté occidental de l'église, comme nous l'avions supposé dans notre reconstruction susmentionnée, pendant l'été 1972 nous avons effectué un sondage sur le côté méridional de la porte occidentale du narthex, précisément là où il n'y avait pas de fresque. En effet les résultats du sondage ont confirmé qu'il n'y avait aucune possibilité pour l'existence d'un tel portique, du fait que la maçonnerie à grandes pierres équarries de la face occidentale se prolongeait telle jusqu'au contact avec les montants de la porte et avec les pierres de l'arc qui la surmontent. Si par contre un portique avait existé dans le passé, ses traces auraient été conservées dans le mur de sa voûte comme elles le sont sur le côté méridional du narthex, où le portique est écroulé.

Nous avons relevé une donnée nouvelle en observant attentivement la coupole de l'extérieur. En effet on y discerne les parties initiales de la coupole, celle-ci n'étant pas dissimulées comme d'habitude par les corniches et la partie supérieure du tambour. C'est là, à notre sens, le résultat de quelque hésitation montrée par les constructeurs à propos de la hauteur du tambour, qui se présente sous une forme nouvelle à douze niches jusqu'alors inconnue dans les églises provinciales, ou encore le résultat de quelque exigence d'ordre esthétique pour avoir un tambour plus élevé en apparence, puisque la construction de la corniche sur la surface de celui-ci, en conservant évidemment la même inclination au toit, aurait diminuer la hauteur du tambour.

Une autre donnée intéressante qui mérite d'être mentionnée est le fait que les pierres, qui ont été employées pour la construction de l'église de Sainte-Marie, appartiennent aux marches du théâtre de la ville antique d'Apollonie. Donc nous sommes en présence d'un cas où les matériaux antiques d'Apollonie ont été réemployés. Il s'agit là d'un phénomène habituel pour le moyen et bas Moyen âge.

A propos de la communication intéressante de Hasan Nallbani «Données nouvelles sur la peinture de l'église du Monastère d'Apolonie», présentée à cette session, nous désirons aborder deux problèmes.

En ce qui concerne le portique, la détermination de sa forme initiale et de sa date de construction présente maintes difficultés du fait que nous sommes en présence d'une série de problèmes qui attendent une solution. Premièrement, l'exonarthex a existé en une forme actuellement insaisissable même avant que fut peinte la scène des Paléologues, puisqu'il conserve les traces d'une peinture plus ancienne, ce que l'on ne peut plus mettre en doute après les sondages effectués par H. Nallbani. Deuxièmement, l'inscription à l'envers portant la date de 1380 nous induit à penser que si la colonnade est antérieure à la date susmentionnée, cela signifie que nous avons affaire à une reconstruction de celle-ci. Troisièmement, l'emploi de chapiteaux romans après la date de 1380 peut s'expliquer ou comme une influence très tardive de ce côté de l'Adriatique, ou comme un cas de remploi, ce qui est possible, d'autant plus que nous avons un chapiteau en plus couronnant le pilastre central au-dessous de la corniche. A propos de ce dernier problème, nous ne pouvons pas partager l'opinion de H. Nallbani selon laquelle ce chapiteau aurait été substitué dans la colonnade par une autre, parce qu'à notre avis il aurait été plus facile de placer plus haut le nouveau chapiteau, sans qu'il fut besoin de travailler des deux côtés, voir même du côté invisible.

Pour déterminer la forme première ou les modifications enregistrées par l'exonarthex dans le temps, ou encore pour discerner quelque reconstruction éventuelle de la colonnade, il est indispensable d'examiner les joints pour relever les changements survenus, ce qui est relativement difficile, parce que les joints sont très fins; en plus il faut effectuer des sondages, voir même creuser le terrain à proximité de l'exonarthex, qui, actuellement, se trouve à un niveau plus élevé que celui du plancher de l'exonarthex.

En ce qui concerne la datation de la colonnade, c'est là un problème qu'il faut envisager dans le contexte plus vaste des événements historiques et des influences de l'art occidental que l'on relève non seulement dans les chapiteaux du portique, mais aussi dans les arcs en ogive des portes appartenant aux

DO NOT COPY

portiques du naos et dans les fenêtres de l'abside, en les appréciant toutefois dans l'ensemble de l'église qui appartient à l'architecture byzantine et en leur attribuant un rôle profondément pittoresque et en tant qu'élément d'importance secondaire de la forme architecturale (les arcs en ogive se trouvent derrière les portiques). Quant à la datation de ce monument, toute considération faite des difficultés mentionées plus haut, et malgré notre intention d'aborder à nouveau ce problème prochainement dans notre étude nous nous en étions tenu au critère de la datation relative des différentes phases de construction et des limites maximales résultant des inscriptions. Mais si l'on se fonde sur le type architectonique, cette église doit être attribuée à la première moitie du XIIIe siècle (avant la date de 1250), et cela en considération de l'influence de l'architecture occidentale et d'une série d'événements historiques se rattachant à ces influences. Par ailleurs, l'emploi d'un type clairement métropolitain dans une zone reculée, et cela en l'absence d'exemples intermédiaires (ce qui évidemment rend encore plus difficile la datation), nous induit à penser que cetté église ait été construite antérieurement à la datte susmentionnée. La peinture mise au jour récemment, ainsi que les sondages qu'il faut effectuer de pair à des études plus approfondies en cette direction, contribueront sans faute à éclaircir ces problèmes qui attendent une solution.

DO NOT COPY

Gjergj FRASHËRI, Sulejman DASHI

Diskutim rreth kumtesës:

«KONTRIBUTI I TRADITËS VENDASE NË ARKITEKTURËN E XHAMISË TIPIKE TIRANASE»

DO NOT COPY

Ndër objektet e larmishme arkitektonike që Shqipëria ka trashëguar nga e kaluara e saj mijëvjeçare, një vënd të veçantë zënë padyshim edhe faltoret islamike-xhamitë.

Siç dihet tek ne, këto monumente kulti janë të lidhura me periudhën shekullore të sundimit osman dhe me islamizimin e shumicës së popullsisë së vëndit. Si vatra të dogmatizmit obskurantist, xhamitë si dhe kishat na kujtojnë përpjekjet qindravjeçare që zhvilluan sundimtarët e huaj dhe klasat shfrytëzuese për t'i mbajtur masat popullore në robërinë e tyre politike, në zgjedhën e shfrytëzimit feudal dhe në hallkat e skllavërisë mendore. Por institucionet fetare, nga presioni i të cilave populli ynë tashmë është çliruar përfundimisht, kanë edhe një aspekt tjetër. Si objekte arkitektonike ato në shumë raste janë prodhime të mjeshtrave të talentuar dhe të puntorëve duarartë vendas, të cilët nuk u bënë skllevër të kërkesave kanonike të kultit, por ditën t'i integrojnë ato në përputhje me kushtet ekonomiko-shoqërore dhe politike të kohës, në një unitet me përvojën ndërtimore vëndase, shijet artistike të popullsisë dhe kushtet gjeografike lokale. Në këtë drejtim ato përbëjnë një material të vyer për historinë e arkitekturës Shqiptare.

E ndoqëm me vëmëndje kumtesën e shokut Koço Miho për të hedhur dritë mbi këto probleme duke u përqëndruar në xhamitë e Tiranës, nga të cilat ai analizoi dy prej tyre: Xhaminë e vjetër e ndërtuar në fillim të shek. XVII sot e shëmbur, dhe xhaminë e Haxhi Ethembeut, e cila qëndron edhe sot në këmbë në qendër të kryeqytetit.

Me të drejtë në kumtesë u vu në dukje se në xhamitë e Tiranës kanë ndërhyrë elementë të konsiderueshëm të arkitekturës vëndase, në mënyrë të tillë që ato i dallojnë nga faltoret e tjera të botës islame në përgjithësi dhe të sferës osmane. Si elementë të cilët bien më tepër në sy, ai numroi ndër të tjera çatinë e pjerrët mbuluar me tjegulla, portikun e hapur në formë prostili, harqet e plota dhe kupola hemisferike, strehët e gjëra dhe gdhëndja e gurit dhe në mënyrë të veçantë gamën e ngjyrave të faltores dhe larminë e peizazheve të afreskut.

Megjithatë në disa çështje të tjera që përmban kumtesa le t'na lejohet të çfaqim mendimin tonë.

Para së gjithash krahasimi që bëhet midis dy faltoreve të Tiranës (të lartpërmëndura) për të parë rrugën që ka ndjekur evolucioni i xhamisë së Tiranës nga shek. XVII deri në XIX nuk na duket i drejtë. Në të vërtetë xhaminë e vjetër në pamjen e saj fillestare nuk e njohim, sepse ajo në vitin 1844, pësoi një rikonstruksion total, prandaj pamja e peizazhit të Eduard Lir pikturuar më 1848 nuk mund të shërbejë si krahasim për më tepër sepse, rindërtimi i saj u krye në rivalitet me xhaminë e H.E. Beut, e ndërtuar më parë. Si rrjedhim kemi të bëjmë me dy faltore që i takojnë të njëjtës periudhë shek. 19. Pra asnjëra as tjetra nuk na japin mundësi të gjurmojmë rrugën që ndoqi arkitektura e faltoreve islamike në Shqipëri dhe aq më pak në Tiranë, qysh nga koha e pushtimit osman.

Turqit i përhapën xhamitë në Ballkan në shek. 15, kur nuk e kishin kristalizuar stilin e tyre, dhe në

gadishull ende nuk ishte krijuar një popullsi myslimane. Prandaj xhamitë e tyre të para u ndërtuan për funksione lokale të garnizoneve ushtarake. Për më tepër rruga e ndërtimit në këtë periudhë, qe zakonisht, adaptimi i kishave, pra tërthorazi ndikoi arkitektura kishtare e periudhës Bizantine. Në këtë drejtim është shumë interesant të hetohet se në ç'masë ka ndikuar arkitektura e kishave të Shqipërisë në ndërtimet e xhamive të para në viset Shqiptare. Por kjo është një çështje më vehte.

Me interes këtu është të vemë në dukje se stili klasik i xhamisë osmane u konkretizua në shek. 16. Me platformë xhaminë Arabe omajade, të përpunuar nga turqit Selxhuk, në formimin e stilit osman, nuk morën pjesë vetëm turqit si kombësi, por edhe mjeshtërit të dalë nga popullsitë tashmë të islamizuara. Në këtë proces dhanë një kontribut të rëndësishëm edhe mjeshtrit e talentuar Shqiptarë siç qenë Mimar Sinani, Mimar Kasemi, Zadefqar Mahmeti etj. Pikërisht për këto arsye nuk kemi të bëjmë me një arkitekturë turke por me një arkitekturë osmane. Më tej akoma kjo arkitekturë osmane nuk u zbatua në mënyrë (shabllone) në të gjitha viset e perandorisë.

Në Gadishullin Ballkanik që ne na intereson ajo e pësoi evolucionin në dy drejtime në hapësirë dhe në kohë, kjo do të thotë se nuk u zbatua njëscj në të gjitha vendet e Ballkanit, sepse në seicilën prej tyre ku më pak e ku më shumë pësoi ndikime në përputhje me kushtet historike ekonomiko-shoqërore kulturale të këtyre vendeve. Nga ana tjetër kjo arkitekturë në seicilin vënd ju nënshtrua gjithashtu evolucionit kohor. Kështu u krijua një stil Ballkanik – osman i xhamisë me dallime nacionale (lokale) në vënde të ndryshme të gadishullit. Pra nuk na duket me vënd përcaktimi që u dha në kumtesë për xhamitë e gadishullit duke i quajtur ato të arkitekturës Ballkaniko-turko-osmane dhe aq më pak na duket e drejtë teza, se me rrugën që ndoqi xhamija Tiranase nga shek. 17 në xhaminë e H. e Beut (shek. 19) u arrit me këtë të fundit niveli klasik i xhamisë ballkaniko-turko-osmane.

Mendojmë se me xhaminë e H. e Beut në sajë të elementeve shqiptarë që përvehtësoi kemi të bëjmë me variantin shqiptar më karakteristik të xhamisë Ballkano-osmane, ose në qoftë se na lejohej ta quajmë me përfaqësuesen më tipike shqiptare islamike.

Dy fjalë edhe për një çështje të fundit. Autori në kumtesë parashtron si element tiranas në arkitekturën e xhamisë asimetrinë e planimetrisë dhe së bashku me të asimetrinë e fasadës, të cilat sipas tij zakonisht nuk ndeshen në viset e tjera mbrënda dhe jashtë Shqipërisë. Një përgjithësim i tillë na duket jo fort i argumentuar. Zakonisht të gjitha xhamitë me një minare kanë planimetri asimetrike. Veç kësaj ne kemi ndeshur në xhami jo vetëm me një por me dy minare që janë asimetrike (si p.sh. kujtojmë xhaminë e Alaedinit në Nigjde ose xhaminë e Ulu-jt në Dhibrigji, të dyja të shek. 13 në sferën selxhuke). Bile xhami me planimetri asimetrike ka edhe përballë Stambollit, është xhamija e Ysqydarit, e ndërtuar nga vetë Mimar Sinani në shek. 16. Për të mos thënë pastaj xhamitë e shumta me planimetri asimetrike të shpërndara gjithandej nëpër Ballkan. Dëshërojmë ta mbyllim duke vënë në dukje një rast. Me planimetrinë që ka xhamija e H.E. Beut por me vendosje të kundërta të minares e të portikut e ka patur dikur edhe xhamija e kuqe në kala të Beratit (e shëmbur gjatë shek. 19), gjë që tregon sipas mendimit tonë se Tirana nuk ka qenë kaq e izoluar (e mbyllur në vetvehte) sa të krijonte një stil xhamije të veçantë, por si pjesë e Shqipërisë së tërë, ajo dha e mori (TAB. I, FOTO 1, 2, 3, 4) me viset e tjera të Atdheut dhe si pasojë e këtyre marëdhënieve, shpresojmë që së shpejti të flasim për një variant shqiptar të xhamisë, ose për një arkitekturë tipike shqiptare edhe në fushën e faltoreve islamike.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



1



2



3



4

Gjergj FRASHËRI et Sulejman DASHI

DO NOT COPY

Discussion à propos de la communication

«CONTRIBUTION DE LA TRADITION LOCALE A L'ARCHITECTURE DE LA MOSQUEE TYPIQUE TIRANOISE»

RESUME

Parmi les différents monuments architectoniques que notre pays a hérité de son passé pluriséculaire, une place de premier plan occupent certes les temples islamiques que sont les mosquées.

Nous avons suivi avec attention la communication du camarade Koço Miho centrée principalement sur les mosquées de Tirana et en particulier sur deux d'entre elles: la Mosquée ancienne construite au commencement du XVIIIe siècle et actuellement détruite et la Mosquée de Haxhi Ethembey, qui de nos jours encore se dresse en plein coeur de la Capitale.

L'auteur de cette communication a raison lorsqu'il affirme que la présence d'éléments de l'architecture locale dans les temples de culte musulman est à tel point élevé que ceux-ci se distinguent des temples du monde islamique en général et de la sphère ottomane en particulier. De leur nombre il relève, entre autres, le toit en pente couvert de tuiles, le portique ouvert en forme de perostyle, les arcs en plein centre et les coupoles hémisphériques, les auvents larges, la pierre gravée et tout particulièrement la gamme des nuances revêtant le temple et la varitété des paysages reproduits dans les fresques.

Toutefois, nous nous permettrons d'exprimer notre point de vue sur d'autres problèmes soulevés dans cette même communication.

Tout d'abord la confrontation faite entre ces deux temples de Tirana, pour décrire l'évolution enregistrée par la mosquée tiranoise pendant les XVIIe-XIXe siècles, ne nous semble pas heureuse. En vérité nous ne connaissons pas l'aspect initial de la Mosquée ancienne, celle-ci ayant été entièrement reconstruite en 1844, d'où le paysage peint par E. Lear en 1848 ne peut être pris comme terme de comparaison, d'autant plus que la reconstruction en question a été réalisée en rivalité avec la mosquée de H.E. Bey construite précédemment. Donc, nous sommes en présence de deux temples appartenant à une même période: au XIXe siècle. En conséquence ni l'une ni l'autre ne nous offre la possibilité de connaître la voie d'évolution suivie par l'architecture des temples islamiques en Albanie et d'autant moins à Tirana, depuis l'occupation du pays par les Turcs.

La diffusion des mosquées dans les Balkans remonte au XVe siècle, alors que les Turcs n'avaient pas encore cristallisé un style particulier en ce domaine et que manquait une population musulmane dans la péninsule balkanique. Aussi, les premières mosquées construites par les Turcs sont-elles principalement destinées aux soldats en garnison dans le pays. Par ailleurs, pendant cette période nous avons affaire plutôt à une adaptation des églises en mosquées, ce qui ne pouvait pas ne pas ressentir l'influence de l'architecture religieuse de la période byzantine. Aussi serait-il intéressant d'étudier en ce domaine l'influence exercée par l'architecture des églises d'Albanie sur la construction des premières mosquées élevées dans les contrées albanaises. Evidemment, il s'agit là d'un problème à soi.

Il convient de relever tout de suite que le style classique de la mosquée ottomane ne s'est concrétisé que pendant le XVIe siècle. Le style ottoman a comme fondement la mosquée arabe, élaborée par les Turcs seldjouks, et à la formation duquel ont participé non seulement des maîtres de nationalité turque mais encore des maîtres relevant des population désormais islamisées. Il importe de relever que les maîtres des talent albanais ont apporté une contribution importante en cette direction. C'est justement pour cette raison que nous avons affaire non pas à une architecture purement turque, mais, à une architecture ottomane. Voir même cette architecture ottomane n'a pas été éxécutée de manière stéréotypée dans toutes les contrées de l'empire.

Dans la peninsule des Balkans l'évolution de l'architecture ottomane s'est accomplie à la fois dan l'espace et dans le temps, ce qui veux dire qu'elle n'a pas été éxécutée de la même manière dans tous les pays des Balkans sous l'influence des

différentes conditions historiques de nature économique, sociale et culturelle caractérisant chacun d'eux. Par ailleurs, dans chacun de ces pays cette architecture a également évolué dans le temps. C'est ainsi qu'a vu le jour un style de mosquée balkano-ottoman reflétant les différences locales de chaque pays de la péninsule. C'est pourquoi nous ne pouvons admettre la définition proposée dans la communication en question de considérer les mosquées de la péninsule balkanique comme appartenant à un style balkano-turco-ottoman; de même, nous ne pouvons considérer comme juste la thèse selon laquelle la voie parcourue par la mosquée tiranoise pendant les XVIIe-XIXe siècles s'est terminée par la construction de la mosquée de Haxhi Ethembey, qui représente la forme classique de la mosquée balkano-turco-ottomane.

A notre sens la mosquée de H. Ethembey, grâce aux éléments albanais qu'elle reflète, représente la variante albanaise plus caractéristique du type de mosquée balkano-ottomane ou, s'il nous est permi de nous exprimer de la sorte, la mosquée plus typique albano-islamique.

Encore deux mots à propos d'un dernier problème. Selon l'auteur de cette communication, l'asymétrie de la planimétrie et l'asymétrie de la façade de la mosquée de Tirana constituent un élément architectural local, parce qu'une telle chose ne s'observe pas dans les autres régions du pays ni à l'Etranger. Une telle généralisation ne nous semble pas fondée. En général toutes les mosquées à un seul minaret ont une planimétrie asymétrique. Par ailleurs, il y a dans la péninsule balkanique des mosquées à planimétrie asymétrique non pas à un mais à deux minarets.

Une dernière constatation intéressante à faire. En ce qui concerne sa planimétrie, la mosquée de H. Ethembey a son analogue dans la Mosquée rouge de la Forteresse de Berat (détruite au XIXe siècle), à la seule différence de son minaret et de son portique qui ont une disposition contraire. Ce qui indique, à notre sens, que Tirana n'était pas tellement isolée au point de se créer un style de mosquée à elle; au contraire, en tant que partie intégrante de l'Albanie entière, elle a entretenu des rapports avec les autres contrées de la Patrie (Figs. 1, 2, 3, 4) et, en conséquence de ces rapports, a vu le jour une variante de mosquée albanaise. Prochainement nous aurons l'occasion de parler d'une architecture typique albanaise même dans le domaine des temples islamiques.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Apollon BAÇE

OBORRI I FORTIFIKUAR I QYTETIT MESJETAR NË BERAT

Krahas oborreve të tjerë të fortifikuar, të cilët gjenden në një sërë qytetesh dhe kështjellash mesjetare të vendit tonë, ai i Beratit paraqet një nga rastet e vetëm, ku data e ndërtimit të tij mund të përcaktohet me saktësi dhe njëkohësisht të ndiqet evolui-mi në kohë.

Oborri gjendet në anën veriore të qytetit të fortifikuar[1] (fig. 1), e cila, në ndryshim prej anëve të tjera të mbrojtura nga natyra, paraqitet e volitshme për komunikim, por dhe e lehtë për t'u sulmuar. Këtu një qafë e sheshtë, rreth 70 m e gjerë, e lidh kodrën që mbart fortifikimin, me një kodër më të vogël në verilindje të saj, atë të Biftës, shpatet e gjerë e me pjerrësi të pakët të së cilës krijonin kushte të mira fushimi dhe sulmi (fig. 2). Rrjedhimisht kjo është ana më e përshtatshme për ndërtimin e hyrjes kryesore, por njëkohësisht dhe ana që kërkon mbrojtje të veçantë. Ky kujdes duket që në periudhën antike: Për të arritur tek hyrja, duhej kaluar detyrimisht para një kulle të fuqishme 5 këndshe, prej së cilës ruhet vetëm bazamenti, dhe kurtinës 31 m e gjatë (fig. 1). Vetë hyrja e tërhequr në thellësi ndahej në dy korridore, me sa kuptohet të pambuluar, prej të cilëve i pari, fillimisht i papaisur me portë, shërbente si një farë oborri embrional që kufizonte numrin e sulmuesve.

Këtë kujdes e shohim të shtuar më tepër në mesjetë, kur ndërtohet oborri i mirëfilltë. Oborri me sipërfaqe 810 m^2 përbëhej prej një muri ballor 26,30 m të gjatë të mbështetur në traktin midis kullës së hyrjes dhe kullës kryesore (fig. 3, 4), në mesin e të cilit gjendej hyrja për në oborr. Me të lidhet një mur i harkuar me gjatësi 53,50 m, i cili vijon deri tek kulla kuadratike 3 (fig. 2). Oborri është ndërtuar në mënyrë që ndërsa i kundërvihet sulmit nga jashtë duke paraqitur një mbrojtje të efektshme për hyrjen kryesore, mbetej krejt i hapur ndaj goditjeve nga kullat dhe kurtinat e zonës së hyrjes (fig. 5, 6). Në këtë mënyrë ai ishte jo vetëm i papërdorshëm për mbrojtje nga ana e sulmuesve, por dhe i kufizonte ata në numër e sipërfaqe. Si pasojë elementë përbërës të oborrit mund të kundrohen dhe kulla e hyrjes 2, kulla kuadratike 3, kulla kryesore 1 dhe traktet e mureve ndërmjet tyre (fig. 1).

Udhëtari turk i shek. XVII Evlija Çelebiu, që na ka lënë një përshkrim të plotë dhe mjaft të saktë të Beratit, na bën të ditur se hyrja veriore përbëhej prej tri portash 100 hapa larg njëra tjetrës. Sipas tij dy porta çeleshin në drejtim të veriut, ndërsa e treta shihte lindjen[2]. Prej tyre porta lindore i përgjigjet hyrjes kryesore, ndërsa nga ana veriore ruhet vetëm një portë, ajo në mes të murit ballor, afërsisht 100 hapa larg hyrjes kryesore. Në të kundërt porta e tretë nuk ekziston. E thëna e Çelebiut gjen një farë mbështetje nga prania e gjurmëve të një muri të zbuluar gjatë punimeve të pastrimit të ndërmarra nga IMK. Muri i lexueshëm deri në 3,20 m gjatësi, mbi 1,40 m i gjerë, i mbështetet kullës kryesore në anën e saj veriperëndimore (fig. 3). Nga ana tjetër muri ballor nuk bashkohet me harkorin me brinjë të qarta, por me linjë të çrregullt dhe përforcohet nga një kontrafort. Si pasojë mundësija e qënies së një oborri të dytë para oborrit kryesor, i cili do të kontrollohej mjaft mirë prej kullës kryesore, kurtinës bri saj dhe murit

1) A. Baçe, **Qyteti i fortifikuar i Beratit,** Monumentet 2, 43-58.
2) E. Çelebi, Sejahatname, Istambul, 1898, VII, 620.



Fig. 1

DO NOT COPY

ballor është reale. Oborri, në se e pranojmë qënien e tij, duhet të jetë rrënuar në periudhën prej fundit të shek. XVII, kur u pa nga Çelebiu, deri në fillimin e shek. XIX kur prania e tij nuk vihet në dukje nga udhëtarët e studjuesit e shumtë, që vizitojnë dhe përshkruajnë kalanë e Beratit, ndërmjet të cilëve dhe specialistë si Prashnikeri.

Së pari të shqyrtojmë elementet përbërës të oborrit kryesor.

Muri ballor 2,35 m i gjerë (fig. 3, 4) përshkohet në mes nga hyrja, anash së cilës gjenden dy patura që e ngushtojnë atë nga 3,85 m në 2,80 m. Në anën e brendshme hyrja mbulohet me një qemer me shigjetë të ulët (fig. 4) të punuar me gurë të latuar, kyçi i të

DO NOT COPY



Fig. 2

cilit gjendet 5,20 m lart tabanit, ndërsa pjesa e paturave mbulohet me hark rrethor 1,25 m më të ulët se qemeri i brendshëm, i cili njëkohësisht nuk lejonte hapjen e flegrave të portës jashtë (fig. 7). Siç kuptohet nga 2 blloqe anash paturave ku shihen vrimat e boshteve të rrotullimit të flegrave, porta ka qenë dy flegërshe. Mungesa e vrimave të katarahut tregon se sigurimi i tyre për mos hapjen brenda kryhej me anën e traut, që rrotullohej në një nga flegrat.

Harku, i cili mbulon paturat nga jashtë përbëhet prej grupe tretullëshe të kombinuara me gurë smërçi të qarkuar sipër nga një kornizë dy tullëshe (fig. 7). Në anën e djathtë të harkut gjendet një monogram prej tullash i përbërë prej një kryqi, anash shtagave të të cilit lexohen 4 shkronja të alfabetit grek. Muri ballor në pjesën e sipërme ndahet në shtegun e pjerrët të kalimit dy pjesësh (0,85-0,75 m) dhe gjoksmbrojen 2,90 m të lartë dhe 0,70 m të gjerë të përshkuar nga 21 frengji dhe një hundë për katran (fig. 8, 4).

Frengjitë të destinuara për qitje me pushkë me përmasa 0,25 – 0,30 x 0,36 – 0,45 m nga brenda, ngushtohen dhe zgjaten jashtë, duke arritur në 0,70 – – 1 m x 0,07 – 0,10 m (fig. 9). Ato gjenden në lartësi të përshtatura për qitje gjunjazi dhe në këmbë. Hunda e katranit ka formën e një kanali 0,30 x 0,45 m me pjerrësi 45°, të mbuluar nga jashtë me një konsol prej gurësh ranorë (fig. 9).

Para hyrjes, në anën e jashtme, gjendet një mur 4,65 m i gjatë dhe 4,20 m i lartë për mbrojtjen e saj nga goditjet anësore (fig. 3).

Muri harkor (fig. 1, 2) ka gjerësi 2,50 m dhe lartësi rreth 19 m deri në pjesën e sipërme të gjoksmbrojës. Fillimisht faqet e tija kanë qenë të drejta, për më tej atyre u është dhënë një pjerrësi 8-10°. Në pje-

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

sën e sipërme muri ndahet në shtegun e kalimit, i cili është restauruar në mënyrë të gabuar, duke u ngritur 0,60 – 1 m mbi nivelin e tij, dhe në gjoksmbrojën 0,60 m të gjerë.

Në pjesën e fillimit, afër bashkimit me murin ballor, shihet se muri fillimisht ka qenë paisur me bedene rreth 0,80-1,00 m të gjatë e 1 m të lartë të alternuar me boshllëke, ndërsa në pjesën e mesit harku dhëmbëzohet dhe në të gjendet një frengji tipi 0,50 m e gjerë brenda 1,30 m jashtë (fig. 1). Më tej, afër bashkimit me kullën kuadratike, ruhen frengji pushke të ngjashme me ato të murit ballor.

Oborri nga ana e tij siç e pamë më sipër, kontrollohej nga kullat e kurtinat e kësaj zone. Prej tyre kulla kryesore me planimetri 5 këndëshe, më masivja



Fig. 5



Fig. 6



Fig. 7

dhe me lartësi më të madhe se tërë kullat e tjera, ishte gjymtyra kryesore për mbrojtjen e zonës veriore (fig. 2). Kulla të pakën 18,70 m e lartë dhe anë 9,05, 9,70 (x2), 6,80 (x2) m të gjata, në pjesën e sipërme ndahej në gjoksmbrojen e pajisur me bedenë, të zëvëndësuar më vonë me frëngji topi me hapje jashtë. Afrimin tek hyrja e oborrit të fortifikuar ajo e kontrollonte nga afër nëpërmjet dy faqeve lindore, e ndihmuar në këtë drejtim dhe prej traktit 12 metër të gjatë dhe 12 metër të lartë prej saj e deri tek muri ballor. Midis këtyre dy elementeve dhe murit ballor para hyrjes, krijohej një qark i mbyllur nga tri anë, i kontrolluar tërësisht prej tyre (fig. 4). Po këta elementë kontrollonin dhe oborrin e përparshëm, në se ka pasur një të tillë. Nga ana tjetër nëpërmjet lartësisë dhe anëve të gjera kulla ndihmonte dhe në kontrollin e oborrit të mirëfilltë në se ky merrej prej sulmuesve.

Si pasojë e tërheqjes së trashëguar nga antikiteti të hyrjes kryesore (fig. 1) në thellësi, vetë hyrja nuk goditet lirisht prej pjesës së parme të oborrit e penguar nga dhëmbëzimi i murit në pikën G. Nga ana tjetër zonat e vdekura për goditjen nga brenda nuk ekzistojnë. Në të kundërt atij i kundërvihen. Kulla e hyrjes kryesore, traktet e kurtinave dhe kulla 3, duke krijuar zona zjarri të kryqëzuar. Për më tepër lartësia e madhe e kullave (fig. 5) krijonte mundësi thuajse

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 8

vertikale zjarri. Kurtinat i kundërviheshin oborrit me bedenë, të zëvëndësuar më tej me frengji pushke, ndërsa në kullën e hyrjes kryesore shihet se bedenat janë zëvëndësuar me 6 frengji pushke dhe një frengji topi me ballë (fig. 5). Përveç tyre në këtë kullë gjenden dhe dy frengji kuadratike në katin e saj të dytë.

*
* *

Në elementet e oborrit të mirëfilltë, në saje të teknikës së përdorur, mund të diferencojmë 3 faza kryesore, përveç meremetimeve të tjera.

Fazën e I e gjejmë deri në 3/4 e lartësisë së traktit ballor, të punuar kryesisht me blloqe të ripërdorur antikë, prej formacioni gëlqeror, me përmasa deri 1,90 m. (fig. 7).

Për të eliminuar faqet e bymyera, që sipas ndërtuesve mund të lejonin ngjitjen, blloqet janë vendosur me faqen e bashkimit jashtë. Si pasojë fugat midis tyre, mjaft të mëdha (deri 1 m të larta dhe 0,15 m të gjera), janë mbushur me tjegulla, zakonisht të vendosura horizontalisht, deri në 15 rreshta. Mbushja mbulohet me një shtresë llaçi të hirtë, të stukuar me llaç të kuq. me pluhur e kokrriza tulle. Kjo fazë, së cilës

DO NOT COPY



Fig. 9

i përket dhe themelimi i oborrit në saje të monogramit në anën e djathtë të hyrjes datohet në një diapazon mjaft të ngushtë. Monogrami, i cili në rast se ndiqen lëvizjet e bërjes së kryqit, përmbante shkronja M H L K M transkriptohet M (i) h (ai) l K (o) m (nen)[3] (fig. 9). Siç dihet Berati kaloi në duart e Mihal Komnenit në vitin 1204 ndërsa në vitin 1214[4] ai vritet në këtë qendër, pra diapazoni i ndërtimit është 1214. Nga ana tjetër, në kullën 1, të ndërtuar me teknikë krejtësisht të njëjtë me murin ballor vihet re se rreshtat ndërmjetës në brezat e tullës janë të tërhequr në thellësi dhe të stukuar specifikë kjo për shek. XII[5]. Siç kuptohet, oborri u ndërtua fillimisht në kompleks me kullën kryesore, pa ndonjë oborr të dytë përpara.

Më e vonë se kjo fazë duket se është qemeri i cekët, nga ana e brendshme të hyrjes, i njëjtë me atë të pjesës së brendshme të hyrjes kryesore (hyrjes së I).

Më tej e mbivendosur mbi to gjendet një teknikë e çrregullt me gurë me madhësi mesatare, dhe copa tjegullash midis tyre, të cilën e kemi parë si të shek. XIV[6] me këtë teknikë është ndërtuar muri që e supozojmë të oborrit të II dhe bedenët e murit harkor.

Fazës së fundit i përket parapeti mbi murin ballor i përshtatur për frengji pushke, pjerrësimi i murit harkor dhe frengjitë e pushkës. Muret janë punuar me gurë të gdhendur ashpër, të renditur pak a shumë horizontalisht, të niveluar çdo 1,20 m me pllaka të holla guri, që përngjet së tepërmi me teknikën e kullave të ndërtuara në kohën e sundimit të Kurt Pashës, ose Ali Pashës.

3) A. Aleksudhi (**Syntomos istoriqi perigrafe tes jeras metropoleos Belegradon,** Korkyra, 1868, i cili e zbërthen i pari monogramin e datoi në v. 1205, por nuk e argumenton këtë datë fikse, kështu që më i drejtë na duket datimi në diapazon.

4) S. Hopf, **Geshichte Grichenlands vom Beginn des Mittelalters bis auf unsere Zeit,** Leipzig, 1870, 245.

5) A.M. Schneider, **Byzanz,** Berlin, 1936, 13.

6) A. Baçe, **Vep. cit.** 50, 51.

Apollon BAÇE

DO NOT COPY

LA BARBACANE DE LA VILLE FORTE DE BERAT

RESUME

La barbacane de la ville forte de Berat est un cas tout à fait particulier, du fait qu'on peut déterminer avec exactitude sa date de construction et suivre, dans le même temps, son évolution dans le temps.

La cour se situe sur le coté septentrional de la ville fortifiée (Fig. 1), qui, à la différence des autres côtés jouissant d'une protection naturelles, est propice à la communication mais se prête plus facilement aux attaques éventuelles (Fig. 2). En conséquence c'est le côté le plus approprié a la construction de l'entrée principale et, dans le même temps, le côté qui exige une protection particulière. Ce qui apparaît dès la période antique: en effet, pour arriver jusqu'à cette entrée, il fallait sans faute passer devant une puissante tour pentagonale et une courtine longue de 31 m. En plus, la tour elle-même retirée en profondeur était divisée par deux couloirs, dont la première remplissait le rôle d'une avant-porte.

Ce souci pour une protection particulière se manifeste plus profondément au Moyen âge, à l'occasion de la construction de la cour originale. D'une surface de 810 m², elle comprenait un mur frontal long de 26 m (fig. 3, 4) se rattachant à un autre mur arqué long de 53,50 m (fig. 2). Cette cour est construite de manière à parer les attaques venant de l'extérieur, du fait qu'elle assure une défense effective à l'entrée principale, mais elle est complètement exposée aux attaques entreprises depuis les tours et les courtines de la zone d'entrée. Ainsi elle n'était d'aucune utilité aux attaquants du point de vue de la défense, limitant leur nombre et la surface et laissant découverts ses éléments constitutifs: les tours, 1, 2 et 3 et les tronçons de mur entre celles-ci.

Le voyageur turc du XVIIe siècle Evliya Celebi indique que l'entrée principale se composait de trois portes, située à 100 pas l'une de l'autre. Toujours selon le même auteur, parmi ces portes, deux s'ouvraient en direction nord et la troisième en direction est. En effet cette dernière correspond à l'entrée principale, tandis que du côté septentrional il n'existe qu'une seule porte, celle aménagée au milieu du mur frontal, à 100 m environ de l'entrée principale. La troisième porte aussi n'existe plus. Les affirmations de Celebi sont confirmées par les traces d'un mur, mis au jour pendant les travaux de déblayage et s'appuyant sur le côté nord-ouest de la tour principale (Figs. 1). Par ailleurs le mur frontal ne se lie pas au mur arqué par des côtés évidents, mais par des lignes irrégulières. Il existait donc une deuxième barbacane, devant la barbacane principale, pouvant être bien contrôlée par la tour principale, par la courtine contiguë et par le mur frontal.

Examinons tout d'abord les éléments constitutifs de la cour principale. Son mur frontal large de 2,35 m est traversé en son milieu par une entrée, d'un côté de laquelle sont aménagés deux chambrales. Dans sa partie intérieure cette entrée est surmontée par une voûte surbaissée (Fig. 4), tandis que les chambrales sont couverts par un arc circulaire empêchant dans le même temps l'ouverture des battants de la porte vers l'extérieur.

Sur le côté droit de l'arc il y a un monogramme de briques représentant une croix, dont on peut lire 4 lettres de l'alphabet grec. Dans sa partie supérieure le mur frontal comporte un chemin de ronde et un parapet, où s'ouvrent 20 meurtrières et une saillie en forme de nez pour verser le goudron sur les assaillants.

Devant l'entrée, dans la partie extérieure, s'élève un mur qui la protège des attaques latérales.

Le mur arqué (Fig. 1, 2) a une hauteur de 9 m environ jusqu'à la partie supérieure du parapet. Au commencement ses parements étaient verticaux, puis on leur a donné une inclination de 8-10°. Dans sa partie supérieure, ce mur se divise en chemin de ronde et en parapet.

Dans la partie initiale du mur arqué, à proximité du point où il se réunit au mur frontal, on peut constater qu'au début le parapet était muni de créneaux, qui plus tard ont été substitués par des meurtrières. Au milieu du mur arqué l'on relève aussi une embrasure.

En ce qui concerne la cour, comme on l'a vu, elle était contrôlée par les tours et les courtines de cette zone. De leur nombre la maîtresse tour, d'une planimétrie pentagonale, qui représente une construction plus massive et plus haute que les autres tours. C'est le principal ouvrage destiné à la protection de la zone septentrionale.

Haute au moins de 18,70 m et large de 6,80 m, dans sa partie supérieure cette tour se divise en un parapet, muni d'un créneau qui plus tard a été substitué par des meurtrières à canon s'ouvrant vers l'extérieur.

Dans l'espace entre la tour, la courtine et le mur frontal, à proximité de l'entrée se crée une espèce de circuit fermé sur ses trois côtés et contrôlé complètement par les éléments susmentionnés. Ces mêmes éléments contrôlent aussi la cour antérieure, si une telle cour a jamais existé. Grâce à son hauteur et à ses côtés larges, cette tour contribue aussi au contrôle de la cour originale même si celle-ci se trouve dans les mains des assaillants.

Dans la cour originale il n'y a pas de zones mortes pour le tir provenant de l'intérieur, au contraire les tours et les courtines étant très hautes une telle chose crée la possibilité d'effectuer des tirs verticaux et croisés.

En ce qui concerne les éléments de la cour originale, la technique employée nous permet de relever trois phases de construction principales.

La phase I se retrouve jusqu'au 3/4 de la hauteur du tronçon frontal, qui a été construit en remployant des blocs anciens. Ces blocs ont été mis en place avec leur face d'assemblage vers l'extérieur. En conséquence les joints sont relativement grands (jusqu'à 1 m de hauteur et 0,15 m de largeur), remplis de tuiles et, en général, disposés horizontalement jusqu'à 15 rangées semblables. En plus ils sont revêtus d'une couche de mortier rouge, préparée avec de la poudre et des grains de tuiles. Cette face, qui résulté être aussi contemporaine de la construction de la cour grâce au monogramme se trouvant sur le côté droit de l'entrée, est attribuée à une période de temps relativement brève. Il suffit de suivre le mouvement du monogramme à travers la croix, pour se rendre compte qu'il comporte les lettres M H L K M dont la transcription nous donne M(i)-h(ai)l K(o)m(nen). Donc cette période de construction s'étend depuis le jour que la ville de Berat est tombé dans les mains de Michel Comnène jusqu'en 1214, date à laquelle il a été assassiné toujours à Berat. Par ailleurs, dans la tour 1, dont la technique de construction est analogue, ont été relevées des bandes de briques. Ces bandes, où les rangées de briques intermédiaires sont retirées et crépies est une caractéristique du XIIe siècle. Il ressort donc que la cour en question a été construite dans le même temps que la maîtresse tour.

Ensuite l'on relève une technique irrégulière avec des pierres de dimensions moyennes, ayant des morceaux de tuiles entre elles, technique que nous avons attribué au XIVe siècle dans un article précédent sur la ville forte de Berat. Par ailleurs, une technique analogue caractérise le mur de la cour II et les créneaux du mur arqué.

A la dernière phase sont attribués le parapet, situé au-dessus du mur frontal et adapté en meurtrières d'armes à feu, ainsi que l'inclination des murs de la cour et les meurtrières d'armes à feu pratiquées dans ces murs. Les murs sont travaillés selon une technique ressemblant beaucoup à celle des tours mises en place pendant la période de domination de Kurt Pacha ou d'Ali Pacha.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Ndreqje Gabimesh

Faqe	rjeshti	Kollona	Si është	Si duhet
184	12	I	Brehmatja	Bregmatja
223	34	I	që i përshkonin ato në vitet 313-316	që i përshkonin ato datohet në vitet 313-316
223	34	II	Boberosi Antik	Doberosi Antik

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Çmimi 10 lekë